2GJSH.1.1.1. Posedon njohuritë elementare për gjuhën (ç'është gjuha, si funksionon, veçoritë e saj) etj. Respekton gjuhën e tij dhe gjuhën e të tjerëve; përdor fjalë (shprehje) stereotipe për gjuhën. E di nocionin e tekstit dhe dallon pjesët e tij (hyrjen, pjesën kryesore, përmbajtjen, përfundiminfundin), po ashtu dallon llojet e teksteve (varësisht nga diskursi). Ka njohuri për sociolinguistikën sidomos për njëgjuhësinë (monolinguizmin) dhe shumëgjuhësisë (polilinguizmin) dhe njeh rastet gjegjëse gjuhësore në Shqipëri, Kosovë, Mqedoni, Serbi…). E di konceptin e varietetit gjuhësor dhe njeh varietete themelore të gjuhës.	• ndërton dhe zhvillon njohuri të reja rreth gramatikës dhe leksikologjisë përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstet qëlexon; • përdor njohuritë gramatikore dhe leksikore gjatë të folurit dhe të shkruarit për të arritur qëllime ose efekte të caktuara; • dallon disa ndryshime mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve dhe gjuhës standarde; • zotëron rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit në gjuhën shqipe; • shkruan saktë, pa gabime, dhe argumenton mënyrën e të shkruarit, duke cituar rregullat drejtshkrimore; • përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore	– Gjuha shqipe gjuhë indoevropiane (Model I dhe II) – Teza ilire për gjuhën shqipe (Model I dhe II) – Teksti argumentues skema dhe struktura, elemntet, llojet e argumenteve – Përemri, Përemri vetor (Model I dhe II) – Përemri vetevetor (Model I dhe II) – Përemri dëftor (Model I dhe II) – Artikulli i gazetës, kryeartikulli, reklama – Përemri pronor – Eseja argumentuese

	në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan. • përdor strategjitë e të lexuarit dhe bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve; • përdor organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit, parafrazon dhe përmbledh tekstet e punuara; • kupton tekste të llojeve të ndryshme;	– Përemri i pacaktuar – Eseja letrare – Thonjëzat, kllapat, shumëpikëshi – Eseja historike – Përemri lidhor, pyetës – Eseja filozofike – Ndajfolja, shkallët dhe shprehjet ndajfoljore – Parafjala – Lidhëzat (bashkë dhe nënrenditëse) – Relacioni – Procesverbali – Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras si dhe me vizë në mes – Letra zyrtare – Curriculum vitae
2GJSH.1.1.2. Dallon gjuhën letrare (standarde) nga dialekti; e di ndarjen dialektore të gjuhës shqipe; ka njohuri për dialektin e tij dhe për dialektin tjetër të gjuhës shqipe si dhe për të folmet e tjera dhe kështu përdor fjalë apo shprehje nga e folmja e tij, nganjëherë edhe nga e folmja e palës tjetër, por gjithmonë është konservator ndaj varietetit gjuhësor së cilës i përket. Me shembuj mund t'i paraqes veçoritë që i dallojnë të dy dialaktet e shqipes (nga aspekti fonetik, gramatikor e leksikor) dhe kështu mund ta mësojë, ta ruaj e ta kultivojë edhe më shumë gjuhën letrare. Njeh gramatikat kryesore dhe librat normativë të shqipes, të cilat i përdor në situata të caktuara. E di që gjuha shqipe zë një vend të rëndësishëm në rrethin e gjuhëve indoevropiane, duke pasur një traditë të gjatë të të folurit dhe të shkruarit dhe kjo ka po ashtu një rëndësi të madhe për kulturën shqiptare. Ka njohuri për etapat e zhvillimit të	• zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti; • përdor materiale udhëzuese dhe gjurmon në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasurua rfjalorin; • analizon tema të ndryshme, duke zbuluar gjuhën e figurshme të tekstit; • identifikon faktin dhe opinionin në tekste të ndryshme; • realizon punë kërkimore; • përzgjedh informacione për qëllime të ndryshme;	– Klasifikimi i gjymtyrëve të dyta – Llojet e teksteve (informues, shpjegues) – Shkrimi i ligjeratës së drejtë dhe të zhdrejtë (kthimi nga e drejta në të zhdrejtë dhe anasjelltas) – Dallimi mes tekstit letrar dhe joletrar – Kronika (historike) – Kundrinorët – Autobiografia, Ditari, Letra personale

gjuhës letrare, fillimet e shkrimit të shqipes dhe rregullat e drejtshkrimit. 2GJSH.1.1.3. E di nocionin e theksit. Në fjali mund t'i dallojë llojet e theksave (theks i lirë, dinamik, ritmik, logjik, i fjalisë). Mund t'i ndajë tingujt në: tinguj zanorë dhe bashkëtingëllorë dhe i bashkon në formimin e fjalëve duke i dhënë kuptim atyre. Kur shqipton me zë më të fortë ose me zë më të ngritur një fjalë a një pjesë të fjalisë, mund ta vë rëndësinë kuptimore të saj dhe kështu i heton dallimet eventuale mes akcentit të tij nga ai letrar. 2GJSH.1.1.4. E di definicionin e fjalës dhe karakteristikat e saj. Njeh njësitë themelore të gjuhës (fonemën, morfemën, fjalën, togfjalëshin dhe fjalinë). Ndan fjalët në njësi më të vogla gjuhësore si p.sh.: fjalët për-pun-oj, kënd-o-j etj, Fjalën mund ta analizoj nga aspekti gramatikor me parashtesa, prapashtesa e mbaresa. Njeh mënyrat elementare të ndërtimit të fjalëve. Fjala si strukturë ka dy anë: përmbajtjen dhe formën dhe kështu dallon aspektin leksiko-gramatikor nga ai fonetiko-gramatikor. 2GJSH.1.1.5. Fjalinë e shkruan sipas rregullave gramatikore; mund t'i klasifikojë njësitë sintaksore; dallon fjalitë pohore dhe mohore; analizon fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra. 2GJSH.1.1.6. Ka një fond leksikor, i cili i përmbush nevojat në nivelin e mesëm të arsimimit; bën dallimin mes leksikut letrar dhe joletrar dhe i përdor sipas situatës së krijuar; ka njohuri për domethënien e fjalës; njeh grupet (paradigmat) e fjalëve: sinonimet, antonimet, homonimet; njeh metaforën si mekanizëm leksikor. Nëse ndonjë fjalë ka prejardhje të huaj, e përdorë dhe nuk ndien ndonjë "armiqësi" ndaj saj. Por, nganjëherë bën edhe kritika për shkak të futjes së saj në strukturën e shqipes. Njeh nocionin e frazeologjisë. Përdor fjalorët e gjuhës shqipe (Fjalorin drejtshkrimor, frazeologjik, sinonimik) etj. 2GJSH.2.1.1. Ka njohuri më të thella për gjuhën në krahasim me nivelin	vlerëson informacionin e përzgjedhur nga të tjerët, përmbledh materiale të ndryshme, si dhe nxjerr përfundime.	– Rrethanorët – Teksti përshkrues, lloji, skema, karakteristika – Përcaktorët – Përshkrimi i njerëzve, objekteve, vendeve, mjediseve, imazheve – Përcaktori kallëzuesor – Sinonimet, antonimet, homonimet – funksioni

fillestar; Njeh njësitë, të cilat i përkasin niveleve të ndryshme të gjuhës, pra nënsistemet; Ka njohuri për shkrimin e letrave. Tashmë njeh parimet kryesore të gjuhës shqipe si parimin fonetik, morfologjik, etimologjik etj.; I di disa gjëra elementare për gjuhët e botës (ngjajshmëritë gjuhësore, përbashkësitë (universaliet) gjuhësore; I njeh parimet e zhvillimit të dialogut; kupton nocionin e aktit të të folurit; në tekst dallon pjesëzat dëftuese apo deiksin; Njeh varietetet gjuhësore të shqipes gjatë paraqitjes së një moderatori në medie kur ai flet në vernakularin gjuhësor – krahinor, pra nëse përdor ndonjë fjalë apo shprehje nga rajoni i tij. 2GJSH.2.1.2. I di tiparet dalluese të të dy dialekteve të gjuhës shqipe; P.sh.: në sistemin fonetik për gegërishten është karakteristike seria e zanoreve hundore kurse në toskërishte ka vetëm zanore gojore (hĩ-ni, rê-ja, zã-ni-gegërishte dhe hi-ri, re-ja, zë-ri-toskërishtja); toskërishtja ka **"ë"** në serinë e zanoreve të theksuara kurse gegërishtja nuk e ka, pra ajo i përgjigjet toskërishtes me **ã**; gegërishtja ka grupin nistor **vo** kurse toskërishtja ka grupin **va** (vaj, varr, vatër-toskërishtja., dhe voj, vorr, votër-gegërishtja) etj.; Në toskërishte ruhen grupet **mb, nd, ng** ndërkaq në gegërishte kanë dhënë **m, n, n**; Po ashtu e di se këto dialekte veçohen edhe nga tiparet morfologjike e leksikore; Mund t'i rirendis etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, të cilat janë të njohura edhe më parë; 2GJSH.2.1.3. Njeh aparatin e të folurit dhe mënyrën se si prodhohen tingujt; dallon tingujt sipas pikëpamjes së artikulimit; e jep definicionin për fonemën; bën ndarjen fonetike të të folurit dhe në një frazë apo sintagmë spikat llojin e theksit (theks logjik, emfatik apo emocional) dhe kështu në mënyrë të drejtë mund ta shqiptojë fjalën në njësitë e lartëpërmenduara; njeh mekanizmat e ndryshimit të tingujve (ndryshimet kombinatore) siç janë: asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat e tingujve (proteza, epenteza, epiteza), rëniet e tingujve (afereza, sinkopa, apokopa).		

2GJSH.2.1.4. Ka njohuri të gjera për fjalën dhe veçoritë e saj; e di se forma e fjlaës është fonetiko-gramatikore sepse përbëhet nga elemente fonetike e gramtikore duke e paraqitur me shembull si bie fjala: emri *vëlla-i* ka tingujt e nyjëtuar *v-ë-ll-a-i* dhe temën fjalëformuese *vëlla-* dhe mbaresën *–i*, e cila tregon gjininë, numrin, rasën e trajtën e emrit; e njeh termin morfemë; ndan apo zbërthen fjalën në morfema si p.sh.: mal-or, qytet-ar, hekur-os, lag-a, mal-i, për-dredh, sh-thur etj., dhe në bazë të shembujve dallon morfemat rrënjore, parashtesore e prapashtesore; i di anët kryesore të strukturës së fjalës (përmbajtjen dhe formën); zbaton kriterin theksor (akcentologjik) si kriter dallues i fjalës së një tipari fonetik. 2GJSH.2.1.5. Gjatë procesit të ligjërimit, përdor fjalë duke i bashkuar për ta shprehur e transmetuar mendimin dhe ato (fjalë) duke hyrë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore krijojnë njësi të ndryshme sintaksore; dallon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra; analizon fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme; ka njohuri të gjera rreth sintagmës; klasifikon fjalitë e varura; njeh termin elipsë; i di rasat dhe kategoritë gramatikore të foljes. 2GJSH.2.1.6. Ka fond të pasur leksikor (leksikun individual e të huaj); është i njoftuar për prefiksat e sufiksat që përdoren nga gjuhët e huaja në shqipen; fondin leksikor e shfrytëzon sipas rastit; sipas tij, gjuha është i vemi mjet i komunikimt që shërben për ta shprehur mendimin e tij, por edhe përvojën individuale dhe kështu e pasuron edhe më tepër fjalorin; njeh hiperoniminë, hiponiminë, paroniminë; dallon shtresat leksikore; njeh metaforën dhe metoniminë si mekanizma leksikorë. 2GJSH.3.1.1. E di që ekziston lidhja e afërt mes gjuhës dhe mendimit dhe e di nocionin e tyre; e jep përkufizimin e fjalisë duke e ditur gjithashtu se ajo ka dy anë: anën kuptimore dhe anën strukturore;		

dallon kohezionin leksikor dhe gramatikor. 2GJSH.3.1.2. Gjatë ndarjes së fjalëve në rrokje, përdor mjetet fonetike për spikatjen e saj (rrokjes) si: gjatësinë dhe forcën. 2GJSH.3.1.3. Ka njohuri për morfologjinë në kuptimin e gjerë të fjalës, në të cilën jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes..; e ndan apo e zbërthen fjalën në morfema duke e dalluar morfemën rrënjë, parashtesore dhe prapeshtesore. 2GJSH.3.1.4. Ka njohuri më të gjera për përdorimin e rasave dhe të formave foljore; mund t'i analizojë fjalitë nga pikëpamja morfologjike (duke i gjetur pjesët e ligjëratës); i njeh tipat e fjalive; dallon kryefjalën, kallëzuesin dhe gjymtyrët e dyta duke i analizuar sintaksorisht. 2GJSH.3.1.5. Ka njohuri themelore për fjalorët dhe për strukturën e tyre.		
2GJSH.1.2.1. Njeh autorët nga programi obligativ shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letraro-historik. 2GJSH.1.2.2. Njeh terminologjinë e teorisë së letërsisë, në të cilën njihen shkrimet e veçanta dhe ku letërsia trajtohet në mënyrë teorike. 2GJSH.1.2.3. Në interpretimin e pjesëve letraro – artistike dhe pjesëve letraro-shkencor, dallon metodat e qasjes së brendshme dhe të jashtme. 2GJSH.1.2.4. Vëren dhe me shembuj argumenton tiparet letrare, poetike, gjuhësore, estetike e strukturore të veprave letrare. 2GJSH.1.2.5. I di tiparet e letërsisë si dhe i shpjegon raportet e saj me gjuhën dhe marrëdhëniet me artet e tjera. 2GJSH.1.2.6. Paraqet tiparet historike dhe poetike të periudhave letrare, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe botërore duke përfshirë edhe shkrimtarët shqiptarë e të huaj nga lektura e obliguar shkollore.	• analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë, si: temat dhe motivet, idetë, përshkrimin e kohës dhe mjedisit, rrëfimtarin, marrëdhëniet ndërmjet personazheve, fabulën dhe subjektin; • analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik, si: motivet kryesore, përdorimin e gjuhës, figuracionin, rimën, ritmin, llojet e strofës etj.; • analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti dramatik, si: trajtimin e temës, konfliktet e përshkruara në vepër, analizën e marrëdhënieve ndërmjet personazheve etj.; • dallon gjinitë kryesore, si dhe tiparet e çdo gjinie letrare;	**– Romantizmi në letërsi** – Lëvizja "Stuhi dhe vrull" – "Stuhi dhe vrull" – Gëte, gjeniu krijues – Analizë "Fausti" – Koment "Natë" – V. Hygo – Pena e artë e romantizmit – Analizë "Katedralja e Parisit" – Koment "Esmeealda" – Ese letraro – filozofike – Xh. Bajron, poeti i lirisë – Analizë "Shtegtimet e Çajld Haroldit"

2GJSH.1.2.7. Analizon pjesët letrare nga ato joletrare dhe mund t'i argumentoj teorikisht. 2GJSH.1.2.8. Shfrytëzon po ashtu literaturën sekondare qoftë letrare, historike, kritike, poetike, teorike duke i sjellë punimet e tij para të tjerëve. 2GJSH.1.2.9. Duke i lexuar veprat e letërsisë shqipe dhe botërore, e kupton rëndësinë e të lexuarit të pjesës letrare dhe kështu ky pozitivitet ndikon në formimin e identitetit të tij gjuhësor, letrar, kulturor e kombëtar. 2GJSH.2.2.1. Interpreton veprën letrare duke nxjerrë thelbin dhe veçoritë e saj; kontekstin historik; motivet letrare; tematikën para se gjithash; kompozicionin; figurat letrare; idenë e shkrimtarit; aspektin gjuhësor e stilistik etj. 2GJSH.2.2.2. Njeh terminologjinë e Teorisë së Letërsisë dhe njohuritë teorike-letrare i zbaton në mënyrë adekuate në interpretimin e pjesëve apo edhe veprave letrare. 2GJSH.2.2.3. Dallon metodat e qasjes së brendshme e të jashtme në interpretimin e pjesëve apo veprave letraro-arstistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistike.	• interpreton dhe analizon zhvillimin historik të gjinive letrare; • dallon dhe analizon veçoritë e llojeve epike, si: poema epike, miti, legjenda, përralla, tregimi, novela, romani; • dallon dhe analizon veçoritë e llojeve lirike, si: elegjia, himni, soneti, lirika moderne; • dallon dhe analizon veçoritë e llojeve dramatike, si: tragjedia, komedia, drama; • dallon figurat e kuptimit, si: krahasimi, personifikimi, antiteza, kontrasti, hiperbola, simboli, paralelizmi figurativ; • dallon figurat e shqiptimit poetik, si: pyetja retorike, pasthirrma, apostrofa, epanastrofeja, aliteracioni; • dallon figurat e fjalëve dhe të shprehjeve, si: metafora, metonimia, sinekdoka, ironia, sarkazma, alegoria, eufemizmi; • rrëfen subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti;	– Koment "Shqiperia dhe shqiptarët" **– Letërsia romantike shqiptare** – Studim teksti "Shqipëria çka qenë ç'është e çdo të bëhetë?, S. Frashëri – Jeronim de Rada, jeta dhe vepra – Analizë "Këngët e Milosaos" – Studim "Këngët e Milosaos" – Naim Frashëri – vepra – Analizë "Lulet e veresë" – Studim teksti "Fjalët e qiririt" **– Realizmi** – Balzaku – jeta dhe vepra – Analizë "Xha Gorio" – Koment "Vdekja e Gorioit" – Gustav Flober – jeta dhe vepra – Analizë "Zonja Bovari" + koment – Fjodor Dostoevski, jeta dhe vepra – Analizë "Vëllezërit Karamazovë" – Koment "Paradoksi mbi lirinë e zgjedhjes" **– Simbolizmi në letërsi** – Sharl Bodler, poet i nëmur

		– Analizë "Lulet e së keqes" + koment
2GJSH.2.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave letraro-artistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistik si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekstet apo veprat përkatëse. 2GJSH.2.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv dhe këto elemente e përcaktojnë edhe vetë llojin si: tragjedinë, komedinë, elegjinë etj. 2GJSH.2.2.6. Gjatë interpretimit të pjesëve letraro-artistike dhe letraro-shkencor, i përdor njohuritë paraprake nga fusha e teorisë së letërsisë; i njeh drejtimet dhe formacionet e zhvillimit të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.2.2.7. Në mënyrë të pavarur analizon pjesët letrare dhe mund t'i argumentojë qëndrimet e tij përballë të tjerëve. 2GJSH.2.2.8. Shfrytëzon literaturë shtesë nga letërsia, historia dhe fusha të tjera shoqërore, me qëllim të afirmimit të tij në interpretimin e pjesëve të tjera letraro-artistike e letraro-shkencor të parapara sipas planit dhe programit mësimor. 2GJSH.2.2.9. Duke i lexuar veprat letrare shqipe e botërore, e zhvillon edhe më shumë aftësinë shprehëse për interpretim dhe vlerësim të pjesëve të ndryshme letraro-artistike dhe letraro-shkencor , po ashtu e pasuron fondin leksikor, letrar, kulturor; me leximin e veprave të ndryshme, ai mund të bëhet më i arsimuar e më i kulturuar. 2GJSH.3.2.1. Lexon dhe analizon pjesët letraro-artistike dhe letraro-shkencor të parapara nga plani dhe programi mësimor dhe tekstet shtesë	• përcakton dhe analizon fabulën e një teksti; • analizon ngjarjet kryesore të një teksti; • dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon funksionin dhe rëndësinë e tyre; • dallon konfliktin/et në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër; • analizon rolin e didaskalive në tekste dramatike; • analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.; • evidenton ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet personazheve (karakteri, sjelljet etj.); • dallon llojet e personazheve (reale, historike, të trilluara, mitologjike, të jashtëzakonshme, kryesore, dytësore); • përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën në një vepër letrare; • veçon mjetet artistike që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën; • analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një tekst; • dallon temën dhe motivet e një teksti; • analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori	**Lektura shtëpiake:** *7. Xh. Bajron – Çajld Harold* *8. Jeronim de Rada – Këngët e Milosaos* *9. Naim Frashëri – Bagëti e Buqësia* *10. Sami Frashëri – Besa* *11. Onore Balzak – Xha Gorio* *12. Sharl Bodler – Lulet e së keqes* **Vërejtje: arsimtari mund të bëjë zgjedhje të lirë të lekturave shtëpiake në pajtueshmëri me planin dhe programin për klasën e tretë të Gjimnazit.*

apo fakultative po ashtu letraro-artistike dhe letraro-shkencor duke i analizuar në kontekst më të gjerë historik. 2GJSH.3.2.2. Është i njoftuar me terminologjinë teorike-letrare duke e zbatuar në interpretimin e veprave letraro-artistike dhe letraro-shkencor të cilat janë të parapara me planin dhe programin mësimor; shfrytëzon edhe vepra të zhanreve të tjera, jashtë obligatives. 2GJSH.3.2.3. Në procesin e interpretimit të veprave përkatëse, zbaton metodat adekuate të qasjes së brendshme e të jashtme. 2GJSH.3.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave gjegjëse e publicistike si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekst. 2GJSH.3.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv. 2GJSH.3.2.6. Gjatë interpretimit dhe vlerësimit të veprave letraro-artistike dhe letraro- shkencor, zbaton dhe krahason tiparet historike e letrare (stilistike) të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.3.2.7. I vëren e i interpreton problemet dhe idetë në veprën letrare dhe qëndrimet e tij mund t'i argumentojë në bazë të tekstit primar dhe kontekstit letrar. 2GJSH.3.2.8. Për ta interpretuar (njohur) apo për t'i bërë analizë filologjike veprës letrare, duhet të ketë njohuri të caktuara, një kulturë letrare nga leximi i veprave të tjera që për nga rëndësia hyjnë në radhën e kryeveprave nacionale e botërore. 2GJSH.3.2.9. Pasi t'i ketë lexuar veprat letrare shqipe e botërore, të cilat janë obligative, dhe veprat	për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar; • veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst, si p.sh.:gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); • përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja hiperbola, ironia etj.); • muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.); • rrëfimtari dhe veta e rrëfimit (veta e parë, veta e tretë);	

letrare me përzgjedhje, vërehet aftësia e tij shprehëse kundrejt të tjerëve dhe me këto zhvillohet e pasurohet edhe më shumë identiteti i tij kulturor e arsimor.		
2GJSH.1.3.1. Flet qartë duke respektuar drejtshqiptimin (ortoepinë) e gjuhës letrare; zbaton theksin (akcentin) gjuhësor-letrar ose e krahason akcentin e tij me atë letrar me tendencë të përshtatjes; Rrjedhshëm dhe qartë lexon me zë tekstet letrare dhe joletrare; shprehimisht lexon dhe lehtë i tregon tekstet letrare artistike; Në situata formale flet për temat e thjeshta si: nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe të kulurës duke u shërbyer me shprehje korrekte gjuhësore; Pra, flet qartë, pa pengesa, pa dridhje të zërit e pa pauza të mëdha; Sipas nevojës, përdor teminologjinë shkencore për gjuhën dhe letërsinë, duke e përshtatur me rastet apo situatat, bashkëfolësin ose përdor edhe mjetet gjuhësore verbale a joverbale sidomos mimikën, gjestikulacionin, lëvizjet e duarve etj, që në gjuhësi njihet me emrin Semiotikë; Ka kulturë të të dëgjuarit kur dikush flet në gjuhën e tij dhe me vëmendje dëgjon e kupton ligjëratat nga fusha e gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës dhe kështu gjatë dëgjimit të ndonjë ligjërimi, mund të marrë shënime;	• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme, mbështet ose kundërshton një pozicion të caktuar, merr në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi; • dallon karakteristikat e gjuhës së folur si një formë komunikimi, si dhe krahason përdorimet e kësajgjuhe në shkollë dhe në komunitet; • realizon prezantime të ndryshme me gojë, përdor strategjitë e duhura për të përmbushur qëllimin që ka dhe, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës, respekton kohën gjatë prezantimit; • përdor TIK-un për të realizuar prezantime të ndryshme, sidomos në situata formale.	Gjuha e medies; Gazeta; Publiciteti, reklama; Tekstet e digjitalizuara.
2.GJSH.1.3.2. Dukë folur apo shkruar për ndonjë temë nga gjuha, letërsia apo për jetën shoqërore, e strukturon rrëfimin dhe i lidh pjesët në mënyrën e duhur; Dallon të rëndësishmen nga e parëndësishmja dhe i përmbahet temës kryesore; Shkruan një tekst duke u shërbyer nga përshkrimi e ekspozicioni dhe shkurtazi përshkruan ndjenjat e tij dhe përjetimin e pjesës letrare ose të ndonjë pjese tjetër artistike; Rrëfen tekstin letrar artistik dhe i ndanë pjesët kryesore. Në fund jep një përmbledhje (rezyme) të tekstit letrar ose joletrar; 2GJSH.1.3.3. Në diskutime me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura, në pika të shkurtëra mund ta shpreh dhe ta argumentojë idenë ose qëndrimin	• përdor strategjitë e të dëgjuarit dhe kupton tekste të llojeve të ndryshme; • analizon tiparet e formës e të përmbajtjes së teksteve; • përdor material udhëzuese dhe hulumton në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin; • përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënit, duke	

për të cilin angazhohet; Pra, ai mund të flasë ngadalë duke u mbështetur kryesisht në fakte; Është në gjendje ta dëgjojë mendimin e tjetrit dhe ta marrë parasysh gjatë argumentimit të tij; Shkruan tekst me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura; 2GJSH.1.3.4. Shfrytëzon librin drejtshkrimor të gjuhës shqipe; zbaton rregullat elementare të drejtshkrimit dhe mund të shërbehet me botime të tjera nga Ortografia; Në të shkruar ndan pjesët tekstit, jep titujt dhe nëntitujt, citon dhe parafrazon; Bën punimin e maturës duke respektuar rregullat e shkruarjes së punimit shkencor (përdor fusnotat, shkruan përmbajtjen dhe bibliografinë); Shkruan letra zyrtare dhe jozyrtare, biografi (CV), lutje, ankesë, kërkesë; Di të mbushë formularë të ndryshëm etj.; 2GJSH.1.3.5. Ka aftësinë që në mënyra të ndryshme (informim, mësim, zhvillim personal, përjetim estetik, argëtim …) të lexojë tekstet të rëndësisë (tekstet letrare, tekste profesionale, shkencore, popullore) nga fusha e shkencës për gjuhën dhe letërsinë, tekstet nga mediet; tekstet që janë të përshtatshme për përpunimin e planit për gjuhë dhe letërsi); zbaton strategjitë e të lexuarit; 2GJSH.1.3.6. Kupton tekstin letrar e joletrar dhe njeh rëndësinë e tyre, gjen informacione nga më të ndryshmet, ndan pjesët kryesore të tekstit; e di kuptimin e përmbajtjes në tekst; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste. 2GJSH.1.3.7. Në mënyrë kritike jep sqarim për tekstin letrar e joletrar; dallon faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson (dhe argumenton) se a i prezanton autori i tekstit joartistik të gjitha informacionet e nevojshme dhe a jep fakte të mjaftueshme e të besueshme për atë që thotë; vlerëson se a është neutral autori i tekstit ose i angazhuar apo i anshëm dhe e arsyeton vlerësimin e tij; njeh gjuhën e urrejtjes, diskriminimit, sharjes dhe për këto çështje ka qëndrim negativ.	përfshirë edhe të nxënit në distancë; • vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediesh; • është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.	

2GJSH.1.3.8. Njeh strukturën, elementet e ndryshme, figurat stilistike (metoniminë, metaforën, asonancën, aliteracionin, onomatopenë, anaforën…); Njeh domethënien konotative të fjalës në kontekstin e dhënë dhe kupton qëllimin e domethënies konotative në tekstin letrar dhe joartistik; vlerëson domethënien e fjalëve të panjohura në bazë të kontekstit dhe modelit të formacionit; kupton domethënien e leximit për pasurimin e fondit leksikor. 2GJSH.2.3.1. Nëpër situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë, flet për temat nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës, duke e përdorur gjuhën letrare dhe terminologjinë përgjegjëse; merr pjesë në bisedat publike ku ka më shumë pjesëmarrës; vlerëson auditoriumin dhe e përshtat fjalimin e tij sipas mundësive dhe kërkesave të tij; në të folur duhet ta zhvillojë më shumë kulturën e tij shprehëse; me vëmendje dëgjon prezantimet nga të tjerët (psh. ligjëratat) me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura etj. 2GJSH.2.3.2. Ndërton tekstin e folur a të shkruar nga gjuha, letërsia etj., duke e karakterizuar nga kohezioni dhe koherenca, pra me mënyrën se si lidhen midis tyre në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës njësitë që e përbëjnë tekstin (kohezioni) dhe me organizimin logjik të tekstit me mënyrën se si gjykimet dhe arsyetimet lidhen midis tyre (koherenca); në diskutimet e shkruara apo të folura, shpreh idetë dhe argumenton qëndrimet e tij; përkujdeset që të shkruaj e të folë në mënyrë të drejtë duke respektuar normën gjuhësore pa bërë ndonjë digresion (shmangie) nga rregullat; shfaq përjetimin dhe përshtypjet e tij rreth pjesës letrare ose artistike; rrëfen tekstin letrar dhe jep një përfundim për të sipas mundësive të tij shprehëse; zbaton rregullat drejtshkrimore etj. 2GJSH.2.3.3. Për të pasur një informim edhe më te gjerë, pra për ta zhvilluar aftësimin personal dhe për ta arritur përjetimin letrar e estetik, lexon tekste edhe më të ndërlikuara si		

tekste letraro-artistike, tekste shkencore, tekste nga mediet etj; është i apasionuar pas leximit; zbaton dhe zgjedh strategjitë e përshtatshme të leximit. 2GJSH.2.3.4. Kupton tekstin joletrar; nxjerr thelbin e tij; gjen pjesët e nënkuptueshme, por edhe e shtjellon tekstin në fjalë; gjen idenë kryesore; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste për të kuptuar aspektin domethënës e stilistik; i gjen dhe i analizon motivet dhe figurat, të cilat paraqiten në veprën letrare; interpreton tekstet duke u mbështetur në tekstet e tjera letrare.		
2GJSH.2.3.5. Në mënyrë kritike jep vlerësim për tekstin letrar joartistik; ndan faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson neutralitetin (anshmërinë) e autorit; vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit argumentues; prezanton të gjitha informatat dhe faktet e autorit për ato që i thotë. 2GJSH.2.3.6. Vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit joartistik; teksti a është koheziv dhe koherent, a janë dhënë idetë qartë dhe saktë; vëren dukuritë stilistike; vëren se sa ndikojnë pjesët e caktuara të tekstit për ta kutpuar atë. 2GJSH.3.3.1. Diskuton për temat komplekse nga gjuha, letërsia dhe kultura; flet për tekstet letrare dhe joletrare duke shfrytëzuar terminologjinë profesionale. 2GJSH.3.2.2. Prezanton në situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë paraqitet me tema nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës; është orator dhe paraqet qëndrimet e tij para auditoriumit me argumente; gjatë ligjërimit përdor fjalë dhe shprehje nga gjuha amtare duke respektuar normën e gjuhës standarde etj. 2GJSH.3.3.3. Shkruan në mënyrë kompozicionale e logjike tekstin		

profesional me temë nga gjuha dhe letërsia si edhe artikullin gazetaresk. 2GJSH.3.3.4. I mbledh, i shënon dhe në fund i përpunon informacionet nga tekstet letrare joartistike në bazë të rregullave të parapara. 2GJSH.3.3.5. Teksti mendon se ka një strukturë dhe organizim të brendshëm, kuptohet pa vështirësi, lexohet me kënaqësi, pra bart informacionin te lexuesi dhe është i shkruar sipas rregullave të ndërtimit të fjalive dhe të periudhave; 2GJSH.3.3.6. I njeh stilet funksionale të shqipes standarde (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili stili shkencor-teknik, stili juridik-administrativ) dhe të gjitha këto (stile) mund t'i trajtojë sipas veçorive të tyre leksikore. 2GJSH.3.3.7. Në të shkruar, përdor shenjat e pikësimit varësisht nga lloji i fjalive (dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse, urdhërore).		

Fjalët kyçe: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, kultura e gjuhës

Disa përmbajtje mësimore për të cilat mësuesi vlerëson se gjatë vitit ato nuk mund t'i realizojë gjatë orëve të rregullta, mund të planifikohen për përpunim gjatë orëve të mësimit me projekt, orëve në ambient të hapur, si dhe në orët të tjera të mësimit shtues e plotësues dhe në eksione.

UDHËZIME DIDAKTIKO – METODIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Programin e mësimdhënies dhe nxënies të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe përbëhet prej tri fushave/lëmive mësimore: Letërsisë, Gjuhës dhe Kulturës së Gjuhës. Shpërndarja e rekomanduar e orëve sipas fushave të njihurive është: Letërsi -36 orë, Gjuhë -34 orë dhe Kultura e gjuhës – 20 orë. Fondi i përgjithshëm i orëve, në nivelin vjetor, është 90 orë. Të tri fushat e programit të mësimdhënies dhe nxënies janë të ndërlidhura dhe nuk mund të mësohen të ndara dhe pa bashkëpunim ndërmjet njëra – tjetrës.

Programi mësimor dhe mësimor i Gjuhës dhe Letërsisë shqipe bazohet në rezultatet, domethënë në procesin e të mësuarit dhe arritjet e nxënësve. Rezultatet janë një përshkrim i njohurive të integruara, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që nxënësi ndërton, zgjeron dhe thellon nëpër të tri fushat lëndore të kësaj lënde.

I. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

Programi i mësimdhënies dhe mësimit i orientuar në rezultate, mësuesit i jep liri më të madhe krijimi dhe për të menduar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Roli i mësuesit është që mënyrat e ralizimit të studimit dhe mësimit t`ia përshtat nevojave të çdo paraleleje, duke pasur parasysh:përbërjen e paraleles dhe karakteristikat e nxënësve; tekstet dhe materialet tjera të cilat do t`i shfrytëzojë; kushtet teknike, mjetet mësimore dhe mediumet të cilat shkolla i disponon; resurset, mundësitë, si dhe nevojat e mjedisit local ku shkolla gjendet, duke u nisur nga rezultatet e dhëna dhe përmbajtjet, mësuesi fillimisht harton planin e vet vjetor, të quajturin plani global i punës, nga i cili më vonë do të zhvillojëplanet e veta operative. Rezultatet e definuara sipas lëmive i lehtësojnë mësuesit operacionalizimin e mëtejshëm të rezultateve në nivelin e njësive konkrete mësimore. Nga mësusei pritet që për çdo njësi mësimore, në fazën e planifikimit dhe hartimit të përgatitjes për orën e mësimit t`ia përshtatë rezultateve të mësimit. Gjatë planifikimit, gjithashtu, duhet patur parasysh se disa rezultate realizohen më shpejtë e më lehtë, por për pjesën më të madhe të rezultateve (veçanësrisht për fushën lëndore Letërsi) duhet më tepër kohë, më shumë aktivitete të ndryshme dhe punë në shumë tekste të ndryshme. Rezultatet e rekomanduara nuk janë të diferencuar sipas niveleve të të arriturave të nxënësve. Ota paraqesin pjesë obligative të përshkrimit të standardeve dhe mund

të imtësohen ose të zgjerohen, në vartësi prej mundësive individuale të nxënësit dhe nevojave të tjera mësimore.

Në fazën e planifikimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies është shumë e rëndësishme të keni parasysh se teksti është një mjet mësimor dhe se nuk përcakton përmbajtjen e lëndës. Për këtë përmbajtjeve të dhëna në tekst është e nevojshme t`i qasemi në mënyrë selektive dhe në raport me rezultatet e parashikuara që duhet të arrihen. Përveç kësaj nxënësit duhet të aftësohen për shfrytëzimin e tekstit, si një nga burimet e njohurive, mësuesi vlen që t`i udhëzojë në mënyrat dhe format e përdorimit të burimeve të tjera të njohurive

II. REALIZIMI I MËSIMIT DHE NXËNIES

LETËRSIA

Boshtin e programit të letërsisë e përbëjnë tekstet nga lektura. Lektura është e ndarë sipas gjinive letrare – lirika, epika, drama dhe e pasuruar me zgjedhjen e teksteve jofikcionale, shkencore – popullore dhe informative. Zgjedhja e veprave në masën më të madhe bazohet në principin e përshtatjes së moshës. Krahas teksteve që duhet përpunuar gjatë orës është dhënë lista e lekturës shtëpiake. Qëllimi i përpunimit të veprës në kuadër të lekturës shtëpiake është formimi, zhvillimi ose kultivimi i shprehive të leximit tek nxënësit. Veprat voluminoze nxënësit mund t`i lexojnë gjatë pushimit, me çka nxitet zhvillimi i vazhdueshëm i shprehisë së leximit. Krahas listës obligative të veprave është dhënë edhe zgjedhja plotësuese e teksteve. Pjesa e zgjedhur i mundëson mësimdhënësit mundësi më të madhe kreativiteti në arritjen e rezultateve.

Me një korpus dominuese të teksteve të shkrimtarëve që mund të ndikojnë në formimin e shijes estetike të nxënësve, ndërton dhe pasuron vetëdijen për natyrës e letërsisë kombëtare (dhe vlerat e klasikëve të letërsisë botërore), por edhe identitetin kulturore dhe kombëtar.

Qëllimi i sjelljes së veprave letrare bashkëkohore është që sipas motivit ose me përkatësisë tematike të tyre lidhen me temat dhe motivet ekzistuese brenda programit mësimor, dhe me shembuj të tillë të tregojë se si shkrimtarët bashkëkohorë i mendojnë traditat epike popullore ose temat e miqësisë, etikës, zhvillimin e imagjinatës dhe empatisë, me çka do të pasurojnë përvojën vertikale të leximit të nxënësve dhe modernizon qasjen në mësimdhënie. Përmes një numri veprash letrare të shkrimtarëve bashkëkohorë, nxënësit do të jenë në gjendje të në mënyrë kritike të vlerësojnë poetikën e veprave të tyre.

Zgjedhja e veprave mundëson aplikimin e qasjes së studimit krahasues të të krijimtarisë letrare, me zgjedhjen e niveleve të ndryshme të përpunimit: interpretimit, paraqitjes ose rishikimeve. Dallimet në tërësinë artistike dhe vlerat informative të disa teksteve ndikojnë në zgjidhje përkatëse metodike (përshtatja e leximit të llojit të tekstit, shtrirja e komentimit të tekstit në vartësi nga ndërlikueshmëria e strukturës së tij, lidhja dhe grupimi me përmbajtjet gjegjëse nga fushat tjera lëndore – gramatika, drejtshkrimi dhe kulturë gjuhe dhe të ngjashme.).

Tekstet nga pjesa e programit plotësues duhet t`i shërbejë mësimdhënësit edhe gjatë përpunimit të njësive mësimore nga gramatika, si dhe për përpunim dhe përforcim të përmbajtjeve nga kultura e gjuhës. Veprat të cilat nuk i përpunon mësimdhënësi duhet t`i rekomandojë nxënësve për lexim gjatë kohës së lirë.

Programi i ri bazohet në njohjen e natyrës dhe rolin e veprës letrare, si dhe njohjen e dallimit të teksteve letrare dhe jo letrare, përkatësisht korelaciont të tyre.

Nxënësit duhet të jenë të aftë të dallojnë veçantitë e tekstit letrar (konotacionin, veprimet letrare, denotativitetit, informimin, dhe duke treguar në bazë të fakteve dhe të dhënave në mënyra të ndryshme të teksteve jo letrare. Korelacioni është mundësuar me kombinime adekuate të veprave obligative dhe zgjedhore. I njëjti tekst mund të lidhet me të tjerët në mënyra të ndryshme, sipas motiveve të ndryshme ose tonit të rrëfimit, në kuadër të mësimit me projekt, që bazohet në rezultate, kurse jo në përmbajtjet mësimore.

Tekstet e propozura obligative, letrare, shkencore – popullore dhe informative dhe përmbajtja e lekturës shtëpiake obligative, si dhe shembujt nga zgjedhja plotësuese, me rastin e planifikimit të planit vjetor të punës, dhe pastaj edhe gjatë formësimit të planeve të punës orientuese mujore, mund të ledhen tamatikisht.

Nga lista e zgjedhjes plotësuese mësimdhënësi zgjedh oto vepra të cilat, me pjesën obigative të lekturës, përbëjnë tërësitë tematike – motivuese. Mësimdhënësi mund t`i grupojë sipas gjinisë veprat nga programi obligativ dhe plotësues në mënyra të ndryshme. Shembujt e mundshëm të lidhjes funksionale të njësive mësimore mund të jenë këto (në asnjë mënyrë të vetme).

GJUHA

Në mësimin e gjuhës nxënësit aftësohen të komunikojnë të drejtë me gojë e me shkrim në gjuhën standarde shqipe. Nga kjo kërkesat në këtë program nuk janë të drejtuar vetëm në

përvetësimin e rregullave gjuhësore dhe normës gramatikore, por edhe në kuptimin e funksioneve të tyre dhe zbatimin e drejtë në të shprehurit me gojë e me shkrim.

Kur në përmbajtjet e programit jepen njësi mësimore, të cilat nxënësit i kanë përpunuar edhe më herët, kuptohet se shkalla e përvetësimit dhe aftësimit të zbatimit të lëndës së përpunuar më herët verifikohet, kurse përsëritja dhe ushtrimi në këta shembuj i paraprin përpunimit të përmbajtjeve të reja, me çka sigurohet kontuiniteti i punës dhe sistematizimit në lidhjen e materialit të ri me njohuritë ekzistuese.

Granmatika

Kërkesa themelore programore në mësimin e gramatikës është që nxënësve gjuha t`i paraqitet dhe t`i shpjegohet si sistem. Asnjë dukuri gjuhësore nuk duhet të studiohet dhe shpjegohet e izoluar, jashtë kontekstit në cilin realizohet funksioni i saj (në secilin rast të përshtatshëm mund të vendosen në funksion, njohuritë nga gramatike, në shpjegimin e tekstit, si atij artistik edhe atij shkencor – popullor). Një nga veprimet e veçanta funksionale në mësimin e gramatikës është ushtrimet e bazuara në shfrytëzimin e shembujve nga praktika e drejtpërdrejtë e të folurit, çka mësimin e gramatikës ia ofron nevojave jetësore, në të cilat paraqitet gjuha e aplikuar si aktivitet i motivuar dhe i gjithanshëm i aktivitetit njerëzor

Në këtë mënyrë tek nxënësi zhvillohet edhe vetëdija e rëndësisë së kulturës e të folurit, e cila është e domosdoshem në jetën e përditshemsi pjesë e kulturës së përgjithshme, e jo vetëm si pjesë e programit mësimor.

Mësimi i morfologjisë nënkupton rrumbullakësimin e e njohurive për ndërtimin e formave foljore. Është e domosdoshme lidhja e përmbajtjeve të reja me mësimet e punuara në klasat e më hershme, prandaj me shikimin e të gjitha formave foljore të përpunuara të bëhet nj[sintezë dhe të ndahen të gjitha format e foljeve fillimisht në vetore dhe pavetore dhe pastaj format e foljeve vetore në kohë dhe mënyra. Gjithashtu, është e nevojshme të theksohet edhe ndarja e të gjitha formave të foljeve në të thjeshta dhe të përbëra. Përdorimin e mbiemrit pasiv të foljes duhet shpjeguar me shembujt më tipik të konstruksioneve pasive. Duhet sistematizuar llojet e fjalëve duke përvetësuar përmbajtje të reja si: lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat.

Mësimi i sintaksës nënkupton sjellja e shprehjes së sintagmës dhe njohjen e gjymtyrës kryesore dhe të varur në kuadër të saj. Në shembujt e qartë dhe të pakontestueshëm nxënësit nëpërmjet ushtrimeve dallojnë gjymtyrënkryesore dhe të varur si dhe llojin e sintagmës. Futet atributi edhe atë si sintagmor, e jo si gjymtyrë e fjalisë. Është e rëndësishme të thaksohet se cilat lloje të fjalëve paraqiten në kuadër të atributit. Në klasat e më hershme është përpunuar subjekti gramatikor, kurse tani futet edhe shprehja e subjektit logjik.

Drejtshkrimi

Përmbajtjet nga drejtshkrimi është e domosdoshme të lidhen me temat përkatëse edhe në orët e gramatikës edhe në ato të letërsisë. Për shembull. Kur përpunohet ndërtimi i formave të foljeve, duhet përpunuar edhe zgjidhjet drejtshkrimore të foljeve në lidhje me drejtshkrimin e formave të foljes. Në lidheje me përvetësimin e tipave të fjalisë është e nevojshem të përpunhen edhe pikësimi, para së gjithash presjen si shenja më të rëndësishme të pikësimit. Duhet të jepen qartë rregullat kur duhet të shkruhet presja, dhe kur presja është shenjë jo e domosdoshme ose veçori e stilit. Lidhja e përmbajtjeve nga gramatika dhe letërsia bëhet me analizimin e përdorimit të presjes në fjalitë e ndara dhe dallimin e përdorimit të presjes në veprat letrare. Në pika të shkurta duhet theksuar në specifikat e stilit artistiko – letrar, ku mdonjherë si rezultat i kreativitetit të shkrimtarit me qëllim nuk zbatohen rregulat e drejtshkrimit (veçanërisht në poezi). Kombinimi i shenjave të drejtshkrimit miratohet që në klasat e më hershme në lidhje të folurit e drejtuar, por edhe tani theksohet në llojet tjera të shenjave drejtshkrimore të kombinuara, para së gjithash në përdorimin e presjes pas shkurtesave dhe numrave rendor. Shkrimi i shkurtesave ka të bëjë me përsëritjen e asaj që është mësuar në lidhje me shkurtesat, por edhe në zgjerimin e llojeve të shkurtesave të cilat theksohen në drejtshkrimin që është në fuqi.

Rregullat e drejtshkrimit miratohen me anë të ushtrimeve sistematike (diktimeve drejtshkrimore, përmirësimit të gabimeve në tekstin e dhënë, testeve me pyetje nga drejtshkrimi etj.). gjithashtu duhet nxitur nxënësit që vet të dallojnë dhe përmirësojnë gabimet drejtshkrimore gjatë komunikimitme SMS, si dhe në llojet e ndryshme të komunikimit nëpërmjet internetit. . Pos kësaj, nxënësit duhet udhëzuar në shërbimin e drejtshkrimit dhe të fjalorit të drejtshkrimit (botim shkolle). Është e preferueshme që mësimdhënësi të sjellë në orë ekzemplar të Drejtshkrimit sa herë që përpunohen tema të drejtshkrimit (kështu do të mund që individualisht nxënësve t`i japë të gjejnë fjal[në fjalorin drejtshkrimor dhe të përcaktojnë formën e rregullt të saj ose shkrimin e drejtë).

Drejtshqiptimi

Ushtrimet drejtshqiptimore nuk duhet realizuar si njësi të veçanta mësimore, por përmes temave përkatëse nga gramatika, por edhe në orët nga letërsia. Në këtë nivel nxënësit duhet të dallojnë dallimet ndërmjet theksit zbritës dhe atij ngjitës dhe t`i shënojnë drejtë të theksat në shembujt tipik. Nëse për këtë ekzistojnë kushtet, mësimdhënësi duhet të lëshojë incizime të drejtshqiptimit dhe t`i tregojë dallimet në shqiptim. Nxënësit duhet mësuar të njohin, riprodhojnë dhe përvetësojnë të folurit e theksuar, kurse në vendet ku shmangemi nga norma e theksimit të dallojnë theksin standard nga theksi i vet, ose nga theksimi dialektor.

KULTURA E GJUHËS

Një nga detyrat themelore të mësimit të kulturës së gjuhës ka të bëjë përvetësimin e mjeteve të shprehjeve gjuhësore tek nxënësit, kurse qëllimi i fundit është që nxënësit të aftësohen në vendosjen e cislësisë dhe të komunikimit kuptimplotë. Edhe pse fusha e kulturës gjuhësore është e konstituar si hapësirë e veçantë programore, është parashikuar në mësimin e tërësishëm të gjuhës dhe letërsisë shqipe të lidhet edhe me dy fushat e tjera letërsinë dhe gjuhën. Fusha Kulturë gjuhe përfshinë të shprehurit me gojë dhe meshkrim. Me ç`rast duhet kushtuar kujdes të njejtë të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

Në këtë moshë duhet shqyrtuar specifikat e dy stileve funksionale, atij letraro – artistik dhe publicistik.

Nxënësit duhet të inkurajohen që në tekstin e dhënë, të përzier dhe të kreuar me dedikim të gjejnë dhe të radhisin fjalitë duke pasur parasysh se a i përkasin stilit letraro – artistik apo atij publicistik. Pastaj, të gjejnë fjalinë e shkruar në tekst në stilin publicistik, i cili është shkruar në stilin letraro – artistik dhe anasjelltas. Duhet të shpjegojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet dy stileve funksionale, të zhvillojnë aftësitë e kuptimit të veçorive të tyre.

Koherenca paraqet një shenjë të rëndësishme të strukturës tekstuale dhe udhëzohet në karakterin kontinuitiv të ndonjë teksti. Nga kjo në mësmin e kulturës gjuhësore duhet aftësuar nxënësit që në formë gojore dhe me shkrim të koncipojnë përbërjet sipas drejtimeve të cila do t`u jenë dhënë. Për shembull, duhet të hartojnë tekste të menduara logjike në bazë të fjalëve të dhëna të cilat fjalë duhet patjetër t`i përdorin; të hartojnë tekste gjatësia e të cilëve do të jetë e kufizuar (numri i kufizuar i fjalëve); që në tekstin që e hartojnë të përdorin kryesisht modele të caktuara gramatikore ose të leksikun e caktuar. Gjithashtu, duhet inkurajuar të mendojnë disa fillime të ndryshme të tekstevenë temën e njejtë të dhënë ose të mendojnë disa përfundime të ndryshme me përgatitje të dedikuar dhe sipas tekstit të përshtatshëm të papërfunduar; të ndryshojnë fundin (ose pjesë tjera të përshtatshme) e një shabloni letrar; të vendosin renditje të shthurur kronologjike ose të menduar në tekstin e dhënë dhe ngjashëm.

Një kompetencë shumë e rëndësishme e cila gjendet në baën e shumë niveleve të kuptimit të teksti, është shkathtësia e argumentimit. Duke pasur parasysh që zhvillimi i mendimit të argumentuar ka rol të rëndësishëm në arsim, sepse mund të ndikojë pozitivisht në fitimin e njohurive, gjatë mësimit të kulturës gjuhësore duhet verifikuar deri në ç`masë nxënësit janë në gjendje të kuptojnë tekstet e argumentuara. Duhet inkurajuar nxënësit që të arsyetojnë me argumente qëndrimin e vet lidhur me situatën problemore në veprën letrare; që me argumente të arsyetojnë qëndrimin e vet eksplicit të paraqitur për dikë, për ata, çështje e rëndësishme.

Një nga format themelore të shprehjes me gojë dhe me shkrim – përshkrimi. Paraqet përmbajtje bazike programore për përsosjen dhe kultivimin e kulturës së duhur gjuhësore të nxënësit. Në këtë moshë nxënësit duhet të shfrytëzojnë të dy llojet e përshkrimit: teknik dhe sugjestiv, përkatësisht duhet aftësuar të përshkruajnë një lëndë, nocion apo qenie të caktuar, fillimisht nëmënyrë objektive (përshkrim teknik), dhe pastaj duke i shprehur përshtypjet e veta (përshkrim sugjestiv). Gjithashtu, duhet inkurajuar të mendojnë paralelisht të dy llojet e përshkrimit të të njëjtit send përshkrimi; të gjejnë elemente e dy përshkrimeve në tekstin e përzier;

Gjatë mësimit të kulturës së gjuhës në këtë moshë duhet tërhequr vëmendjen nxënësve, ndërmjet tjerash, edhe në metodat e paraqitjes së burimeve dhe ideve, si dhe shpjegimeve plotësuese të cilat përdoren në tekst. Duhet inkurajuar të shpjegojnë shkaqet dhe funksionet e citimit; të shpjegojnë situatat problemore të vërejtura në tekstet letrare dhe të tjera me ndihmën e citateve: të komentojnë rëndësin dhe kuptimin e fusnotës së përdorur në shembullin e dhënë; të dallojnë citatet dhe parafrazat në shembujt e dhënë. Gjithashtu, duhet tërhequr vërejtjen në rregullat të cilat ndikojnë në shkrimin numrave të eksponuar me të cilët shënohen fusnotat në fund të fjalisë.

Llojet e ushtrimeve gjuhësore duhet zgjedhur sipas intersimeve të nxënësve ose në kontekst ë përmbajtjes mësimore. Këto mund të jenë: plotësimi i tekstit me forma të ndryshme të fjalëve të ndryshueshme; plotësimi tekstit me fjalë të pandryshueshme; shënimi i fjalive komunikuese në tekst; paraqitja e gjymtrës së fjalisë në mënyra të shumta.

Me zbatimin e ushtrimeve gjuhësore krijohet shprehia që të mendojnë dhe kërkojnë shprehje adekuate për atë që e dëshirojnë ta tregojnë (në vartësi prej situatës së komunikimit) dhe të shtojnë fondin e shprehjeve të trillanë fjalorin e tyre, me theks të veçantë në frazeologjizma dhe shprehje të krijuara (shembujt të meren nga tekstet e përpunuara).

Në çdo gjysmëvjetor punohen nga dy detyra (hartime) me shkrim (gjithsej katër në vit).

Rekomandohet të punohen tetë detyra (hartime) me shkrim (përmbajtje të shkruara).

III. PËRCJELLJA DHE VLERËSIMI I MËSIMIT DHE NXËNIES

Përcjellja dhe vlerësimi i rezultateve të përparimit nxënësit është në funksion të realizimit të rezultateve, kurse fillon me vlerësimin inicial të nivelit të arritur të njohurive, në raport me atë se si do të matet përparimi mëtejshëm dhe si do të formohet notimi. Secila orë mësimore dhe çdo aktivitet i nxënësit është rast për notimin formal të nxënësit, përkatësisht regjistrimi i përparimit të nxënësit dhe udhëzimi për aktivitete të mëtejshme.

Vlerësimi formal është pjeës e qasjes moderne të mësimit dhe nënkupton vlerësimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe sjelljeve si dhe zhvillimin e kompetencave përkatëse gjatë mësimit dhe nxënies. Matja formale nënkupton grumbullimin e të dhënave mbi të arriturat e nxënësit, me ç`rast më shpesh zbatohen këto teknika: realizimi i detyrave praktike, vështrimi dhe regjistrimi i aktiviteteve të nxënësit gjatë mësimit, komunikimii drejtpërdrejtë ndërmjet nxënësit dhe mësimdhënësit, regjistri për çdo nxënës (harta e përparimit) etj. Rezultatet e vlerësimit formal në fund të ciklit mësimor duhet të jenë të paraqitur edhe me notë numerike.

Puna e çdo mësimdhënësi përbëhet nga planifikimi, realizimi, përcjellja dhe vlerësimi. Është e rëndësishme që mësimdhënësi, krahas arritjeve të nxënësit, në vazhdimësi të përcjellë dhe vlerësojë punën e vet. E gjitha që tregohet e mire dhe efikase, mësimdhënësi do ta shfrytëzojë edhe më tej në praktikën e vet mësimore, kurse ajo që vlerësohet si e pamjaftueshëm efektive, duhet të avancohet.

4. PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR PËR KLASËN E TRETË TË SHKOLLËS SË MESME – TEKNIK I MAKINERISË

Emri i lëndës	**GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE**
Qëllimi	Qëllimi i mësimit të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe është që të përvetësojnë rregullat themelore të gjuhës letrare standarde shqipe me qëllim të përdorimit të drejtë në të folur, në të shkruar dhe gjatë të shprehurit në komunikim; kultivimi i vetëdijes mbi rëndësinë e rolit të gjuhës në ruajtjen e identitetit kombëtar; aftësimin e nxënësit për të komentuar pjesë të zgjedhura letrare dhe vepra të zgjedhura artistike nga letërsia shqipe dhe trashëgimia botërore, me qëllim të kultivimit të traditës dhe kulturës së popullit shqiptar; zhvillimin interkulturor; Zhvillimi i aftësisë dhe kulturës së leximit; gjetjes së përvojave dhe ideve letrare; nxitjen dhe vlerësimin e krijimtarisë personale dhe krijimtarisë së të tjerëve; kuptimin e tekstit në kontekste të ndryshme kulturore, ndërkulturore dhe shoqërore.
Klasa	**E TRETË**
Fondi vjetor i orëve	**96 orë**

KOMPETENCAT E PRGJITHSHME LËNDORE

Nxënësi njeh veprat e letërsisë shqipe që i përkasin trashëgimisë kulturore kombëtare dhe korrespondojnë me epokën e saj, njihet me kryeveprat e letërsisë botërore dhe parimet themelore të interpretimit të teksteve letrare. Ai njihet me karakteristikat themelore të komunikimit, rregullat e komunikimit me gojë dhe me shkrim janë të qarta për të. Ai flet dhe shkruan duke respektuar pritjet e normave gjuhësore. Ai krijon një tekst të plotë, të saktë gojor dhe të shkruar, në përputhje me aspektet stilistike, kupton dhe vlerëson në mënyrë kritike atë që ka lexuar, pasuron përgjithmonë fondin e tij leksikor. Ai lexon, përjeton dhe interpreton vepra letrare dhe joletrare. Ai e konsideron të lexuarit si një mjet për të njohur veten dhe botën. Ai gradualisht bëhet lexues, zgjedh leximin sipas shijes së tij, zhvillon nevojën për të përmirësuar kompetencën e tij për të kuptuar tekstin dhe kulturën e të folurit. Ai respekton, ruan me vetëdije gjuhën e tij amtare.

Niveli bazë

Nxënësi flet qartë dhe rrjedhshëm, respekton normat gjuhësore, dëgjon me kujdes dhe me respekt mendimet e të tjerëve. Përbën një tekst të plotë, gjuhësor dhe stilistik, të formuar mirë, më të shkurtër, më të thjeshtë me gojë ose me shkrim. Miraton zakone zyrtare dhe informale të shkrim-leximit në praktikë. Ai kupton tekste letrare dhe joletrare më të shkurtra, më të thjeshta, të ndërlidhura dhe rishikon në mënyrë kritike përmbajtjen e tyre. Gradualisht ai ndërtoi fondin e tij poetik leksikor.

Nxënësi ka njohuri themelore për gjuhën, faktorët dhe funksionet e komunikimit, njeh shtresat gjuhësore dhe dallon variantet gjuhësore. Ai mëson bazat e fonetikës, fjalorit dhe sintaksës së gjuhës shqipe, dhe është në gjendje të zbatojë rregulla gramatikore në të folur dhe shkrim. Përvetëson njohuri themelore të tekstologjisë dhe stilistikës.

Nxënësi pasuron vazhdimisht fondin e tij leksikor, dhe prej tij, sipas situatës, ai zgjedh dhe përdor shprehje të përshtatshme. Ata zhvillojnë një nevojë natyrore për të mësuar, ruajtur dhe ushqyer gjuhën e tyre amtare.

Nxënësi i njeh veprat letrare të përcaktuara nga kurrikula, dhe është në gjendje t'i vendosë ato sipas opusit të autorit dhe kontekstit letrar-historik. Ai dallon qartë karakteristikat themelore poetike dhe stilistike të epokave stilistike dhe drejtimeve të letërsisë shqiptare dhe botërore. Njoh karakteristikat gjuhësore, kompozicionale dhe stilistike të teksteve dhe është në gjendje të përdorë argumente për të argumentuar përfundimet e tyre. Zhvillon zakonet e të lexuarit, mëson rolin e të lexuarit në njohjen e vetvetes.

Nxënësi njihet me përdorimin e manualeve, me rregullat e përdorimit të bibliotekës, merr njohuri për mënyrat e mbledhjes së informacionit përmes Internetit. Ai është i qartë për rregullat e gjuhës elektronike, si dhe sistemin e rregullave të nevojshme për krijimin e dokumenteve elektronike. Përdor fjalorët më të rëndësishëm, rregullat e drejtshkrimit, njeh strukturën e artikullit të fjalorit.

Niveli i mesëm

Nxënësi përballet mirë në situata të ndryshme të komunikimit publik. Ai flet para një audiencë mbi tema gjuhësore, letrare dhe kulturore. Ai gjithashtu paraqet mendimet e tij pikërisht kur harton tekste më komplekse të gjuhës gojore ose të shkruara. Ka një shije të formuar leximi. Ai i kupton dhe interpreton tekstet më të gjata, thjesht të lidhura letrare dhe joletrare gjatë leximit, që synojnë të fitojnë përvojë dhe me një qëllim shkencor. Ai rishikon në mënyrë kritike tekstet letrare dhe joletrare.

Nxënësi ka një njohuri më të gjerë për karakteristikat e gjuhës, rolin, funksionet dhe ka një njohuri themelore të gjuhëve të botës. Ai menaxhon në botën e mediave masive, njihet me zhanret e mediave. Ai njihet me origjinën e gjuhës shqipe, epokat e saj historike, si dhe historinë e zhvillimit të letërsisë shqipe. Ai e kupton që gjuha jeton në variante, bën dallimin midis dialekteve dhe varianteve gjuhësore shoqërore. Ai ka një njohuri më të gjerë për gramatikën e niveleve të gjuhës (fonetikë, leksikë, sintaksë, tekstologji). Ai analizon tekste të ndryshme bazuar në njohuritë e tij për stilistikën dhe aspektet e klasifikimit të llojeve të teksteve, dhe krijon veprat e tij.

Nxënësi pasuron përgjithmonë fondin e tij leksikor, zbaton njohuritë e tij për gjuhën dhe gramatikën në praktikë, ai mund të shprehet saktësisht, qartë dhe ndryshe.

Nxënësi interpreton me vetëbesim temën, mesazhin e teksteve letrare, karakteristikat e tyre kompozicionale, poetike, stilistike, gjuhësore dhe zhanre. Ai i njeh konceptet e teorisë letrare dhe i zbaton ato kur interpreton veprat letrare. Lexon tekste me mirëkuptim. Në mënyrë të pavarur njeh dhe analizon çështjet themelore të veprave letrare, shpjegon mendimin e tij me argumente bindëse. Njoh natyrën dhe karakteristikat e lidhjeve midis letërsisë dhe arteve të tjera.

Nxënësi është i njohur me rregullat në lidhje me përdorimin e bibliotekës dhe manualeve, d.m.th. Internetit për të mbledhur informacion. Mund të përdorë një program për përpunimin e fjalëve për të hartuar një tekst që përputhet me rregullat e drejtshkrimit.

Niveli i avancuar

Nxënësi përvetëson aftësinë për të diskutuar tema komplekse letrare, kulturore dhe gjuhësore të përcaktuara nga materiali mësimor. Ai ka një aftësi të zhvilluar për retorikë. Ai krijon tekste profesionale në të cilat merret me tema gjuhësore dhe letrare.

Zhvillon aftësinë për të lexuar dhe interpretuar tekste, me vetëdije ushqen rolin pritës (lexues). Ai zhvillon një qasje kritike, të udhëhequr nga mendimi i tij dhe kur interpreton tekste më të ndërlikuara letrare dhe joletrare. Ajo njeh tiparet kompozicionale dhe stilistike të teksteve me siguri. Përveç leximit të detyrueshëm në shtëpi, ai mund të interpretojë edhe tekste që ai zgjedh vetë. Kur prezanton mendimin e tij, ai aplikon teknikën e argumentimit të pjekur. Ai bëhet një lexues i rregullt, duke përshtatur strategjitë e leximit me karakteristikat e një vepre të caktuar letrare dhe qëllimet e leximit (përvoja, kërkimi, krijimi). Ai është në gjendje të përdorë në mënyrë të pavarur njohuritë e tij për lidhjen midis degëve të ndryshme të artit për të zbuluar lidhje intermediative.

Ai ka njohuri të gjera për gjuhën dhe sistemin e gjuhës shqipe, si dhe zhanret e vjetër dhe të rinj të komunikimit. Njeh dhe krahason karakteristikat poetike, kompozicionale dhe stilistike të teksteve. Ai zbaton njohuritë teorike të marra në lidhje me mjetet gjuhësore të shtresave stilistike në praktikë (kur analizon dhe krijon tekste). Ai njihet me drejtimet e gjuhësisë moderne dhe i vë njohuritë e marra në një kontekst ndërdisiplinor. Ndërsa mëson karakteristikat pragmatike të tekstit, kështu që akti i funksionimit të gjuhës i zbulohet atij, hapen mundësi të shumta për të analizuar kuptimin e tekstit.

Ai administron bibliotekën, manualet dhe internetin me siguri. Kur interpreton vepra letrare, ai rregullisht përdor letërsi më të gjerë profesionale. Duke pasur parasysh rregullat etike në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit, ai krijon veprat e tij duke përdorur përparësitë dhe mjetet e mediave dixhitale. Ai zbaton një sistem rregullash të nevojshme për krijimin e dokumenteve elektronike, në përputhje me rregullat gjuhësore të dokumenteve elektronike.

Studenti ka një njohuri të gjerë për karakteristikat e përgjithshme të gjuhës, funksionet e tij dhe sistemin e gjuhës shqipe (rreth niveleve të ndryshme të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji). Duke pasur njohuri për tekstologjinë, ai është në gjendje të vartësojë faktorët e botës tekstuale në aspektet e përpunimit të tekstit. Ai fiton njohuri në drejtimet e gjuhësisë moderne, dhe zbaton njohuritë e marra gjatë përpilimit të punimeve të projektit të tij. Kupton natyrën e marrëdhënies midis gjuhësisë dhe fushave të tjera shkencore.

KOMPETENCA E VEÇANTA Gjuha shqipe dhe komunikimi

Niveli bazë

Nx[nësi përvetëson njohuri për rolin themelor të gjuhës, karakteristikat dhe funksionet e tij komunikuese. Ai tregon respekt për gjuhën e tij amtare, si dhe gjuhën dhe kulturën e popujve të tjerë. Në nivelin bazë, ai zotëron sistemin e gjuhës shqipe (gramatika e niveleve të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji).

Nxënësi gjendet mirë në nivele më të ulëta të tekstit, përvetëson njohuri për fonetikë, dallon llojet e fjalëve, njeh sistemin morfologjik të gjuhës shqipe. Ai është në gjendje të formulojë në mënyrë të pavarur mendimet e tij, në përputhje me normat gjuhësore, fjalitë e qarta dhe të sakta dhe të analizojë fjalitë në një nivel bazë. Përvetëson njohuri për marrëdhëniet midis shenjës dhe kuptimit, njihet me zhvillimin historik të gjuhës shqipe.

Njoftohet me karakteristikat e përgjithshme të tekstit, shtresat stilistike, konceptet themelore të stilistikës, llojet e teksteve. Mund të përcaktojë elementet e teksteve të shkurtra (temën, titullin, analizën, paragrafët), njeh forcën lidhëse, elementët lidhës të tekstit.

Ai mëson rregullat e shqiptimit të saktë, mjetet e shprehjes gjuhësore të kultivuar. Në mënyrë ekspresive dhe besnike, ai rrëfen fragmente më të shkurtër tekstesh, memorizuesish, në origjinal.

Përdor fjalorët më të rëndësishëm të gjuhës shqipe, rregullat e drejtshkrimit dhe fiton përvojë në mbledhjen e informacionit nga Interneti. Miraton rregullat e sjelljes së gjuhës dhe rregullat etike të komunikimit në internet. Ai me edukatë dhe argumentim shpreh mendimin e tij në debate mbi temën nga materiali mësimor dhe çështje nga jeta e përditshme.

Ai e ndërton strategjinë e tij të diskutimit në paraqitjen e argumenteve në një mënyrë logjike dhe të dëgjojë me kujdes mendimet e njerëzve të tjerë. Mund të përdor llojet themelore të teksteve të shkruara joformale dhe formale (lutjet, CV, letër motivuese, ankesë), si dhe programe kompjuterike dhe teknika prezantimi. Në fund të shkollimit, ai shkruan një punim diplome, duke respektuar kërkesat tematike, stilistike dhe kompozicionale në lidhje me shkrimin e një punimi profesional.

Niveli i mesëm

Nxënësi tregon njohuri më të plota të veçorive të sistemit gjuhësor. Nocioni i farefisnisë së gjuhëve është i qartë për të, ashtu si dhe sistemi i marrëdhënieve të farefisnisë midis gjuhëve. Di dhe zbaton në shprehjen e rregullave të shqiptimit të saktë dhe mjeteve të të folurit të kultivuar. Gjatë leximit me zë të lartë dhe interpretimit të teksteve letrare, si dhe në situata të komunikimit të përditshëm, ai krijon prodhimin e tij në bazë të njohurive për mjetet e fonetikës së tekstit. Di dhe zbaton rregullat themelore të drejtshkrimit.

Nxënësi zhvillon një kuptim të konceptit të integritetit të sistemit gjuhësor. Ai ka një njohuri më të plotë mbi sistemin e llojit të fjalëve dhe strukturën e fjalive. Duke përdorur aftësinë për të analizuar me siguri, ai përdor sistemin morfologjik të gjuhës amtare, njeh pjesë të një fjalie dhe i analizon duke përdorur modele të përshtatshme të fjalive.

Njeh tiparet stilistike të llojeve dhe zhanreve të ndryshëm të teksteve, si dhe mjeteve stilistike. Ai është i sigurt në temën e komunikimit masiv, njihet me zhanret e mediave.

Ai lexon në mënyrë ekspresive, pasuron fondin e tij leksikor, në situata të ndryshme të të folurit ai shprehet në përputhje me rrethanat komunikuese, dhe në shprehjen e folur dhe të shkruar përdor elemente të përshtatshme të fjalorit.

Informohet nga burime të shtypura dhe elektronike. Ai mund të hartojë lloje më të ndërlikuara të teksteve, ai shprehet saktësisht dhe qartë. Në mënyrë të pavarur përgatit letra për tema të ndryshme.

Niveli i avancuar

Nxënësi ka një njohuri më të gjerë për karakteristikat e përgjithshme të gjuhës, funksionet e saj dhe sistemin e gjuhës shqipe (rreth niveleve të ndryshme të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji). Duke pasur njohuri për tekstologjinë, ai është në gjendje t`i vartësojë faktorët e botës tekstuale në aspektet e përpunimit të tekstit. Ai i di karakteristikat formale të përmbajtjes së zhanreve të reja të komunikimit dhe llojeve të teksteve në internet, dhe në mënyrë të pavarur formon një mendim rreth tyre.

Tiparet pragmatike të tekstit janë të qarta për të. Fiton njohuri në drejtimet e gjuhësisë moderne, zbaton njohuritë e tij gjatë përpilimit të dokumenteve të projektit. Njoh natyrën e lidhjeve midis gjuhësisë dhe fushave të tjera shkencore.

Duke aplikuar njohuri për retorikën, ai është në gjendje të krijojë dhe të paraqesë një tekst argumentues bindës, duke përdorur me vetëdije mjete gjuhësore dhe jo-gjuhësore të interpretimit të tekstit, duke marrë parasysh pritjet e dëgjuesve. Krijon dhe interpreton tekste të ndryshme profesionale, gazetare dhe letrare, duke mbajtur në vëmendje shkallën e krijimit të tekstit, në një stil që i përgjigjet situatës së të folurit dhe zhanrit, duke aplikuar elementet e duhura të lidhjes.

Ai është në gjendje të kryejë punë kërkimore në bibliotekë, mbledh në mënyrë të pavarur dhe klasifikon informacione me qëllim të punimeve të shkruara, paraqitjeve dhe eseve, në të cilat ai paraqet mënyrën e tij individuale të të gjykuarit.

KOMPETENCAT E VEÇANTA: Letërsia

Niveli bazë

Lexon qartë dhe rrjedhshëm. Ai është në gjendje të lexojë tekste letrare dhe joletrare, kupton dhe parafrazon tekste të shkurta letrare të thjeshta. Ai është në gjendje të përmbledhë temën e një vepre letrare, dallon informacionin e kërkuar në një tekst jo letrar. Ai i njeh veprat letrare të përcaktuara me planin dhe programin mësimor, krijimtarin e autorëve dhe karakteristikat më të rëndësishme përmbajtësosoro-formale të epokave letrare. Dallon letërsin[gojore nga ajo e shkruar. Ai i di karakteristikat e poezisë popullore dhe autoritare, si dhe lidhjen e tyre. Njeh tiparet formale, stilistike dhe zhanre të veprave letrare, është në gjendje të formulojë temën dhe karakteristikat e botës së tyre tekstuale. Interpreton pyetje që lidhen me tekste letrare të thjeshta. Ai e kupton rëndësinë e leximit për zhvillimin e personalitetit të tij dhe fondit leksikor. Kur shpreh përshtypjet dhe konkluzionet e tij, ai i referohet shembujve nga tekstet letrare dhe joletrare. Ai mund të bëjë dallimin midis përmbajtjes litrare dhe asaj transmetuese, metaforike. Mund të përcaktojë vendin e letërsisë në sistemin e artit (muzikë, film, arte të bukura, teatër, etj.). Përvetëson njohuri ndërdisiplinore.

Niveli i ndërmjetëm

Njeh strategjitë themelore të leximit dhe di si t'i përdorë ato në situata të dhëna leximi. Ai përdor më shumë këndvështrime në interpretimin e tij dhe i konsideron në mënyrë kritike tekste të gjata, të thjeshta letrare dhe joletrare. Duke përdorur njohuritë e marra sipas programit mësimor, ai interpreton dhe dallon elementet të rëndësishme të përbërjes dhe shtresave të kuptimit të një vepre letrare, karakteristikat stilistike, gjuhësore dhe formale të saj. Ai i njeh konceptet themelore letrare, teoriko – letrare, termat, dhe kur interpreton veprat letrare i përdor ato në harmoni me qëllimin. Në mënyrë të pavarur analizon çështje që lidhen me veprat letrare, argumenton gjykimin e tij për to. Ai është në gjendje të zbulojë lidhje midis veprave të ndryshme letrare, epokave dhe drejtimeve stilistike. Zbulon lidhjet intertekstuale dhe ndërdisiplinore midis veprave letrare. Kupton dhe vlerëson lidhjen midis letërsisë dhe arteve të tjera. Merr një qëndrim të qartë ndaj tekstit të lexuar. Ai zgjedh në mënyrë të pavarur veprat për të lexuar nga vargu i letërsisë, i përshtatshëm për moshën e tij. Vë në dukje kureshtjen e lexuesit. Kupton rëndësinë e leximit për zhvillimin e kulturës dhe njohurive të tij të përgjithshme. Në mënyrë eksploruese dhe krijuese, ai përvetëson një aftësi leximi që mund ta përdorë, gjatë studimit të veprave dhe zhanreve të ndryshme letrare, me ndihmën e të cilave mund të zhvillojë identitetin e tij letrar, gjuhësor, kulturor dhe kombëtar.

Niveli i avancuar

Me dëshirë, kureshtje hulumtuese dhe mënyrë kritike lexon, interpretojë dhe vlerëson tekste komplekse letrare dhe joletrare të rekomanduara nga programi mësimor, por gjithashtu kënaqësi liston dhe interpreton si veprat e rekomanduara dhe ato të zgjedhura në mënyrë të pavarur. Në mënyrë të pavarur vëren dhe interpreton çështje që trajtohen në veprat letrare. Ai përdor disa këndvështrime kur interpreton vepra letrare, ai është në gjendje t'i vendosë ato në një kontekst të ndërmjetëm ndërdisiplinor: lidh ato me degë të tjera artistike dhe fusha shkencore. Ai përvetëson aftësinë e krahasimit të tipareve të shquara tematike dhe formale – stilistike të veprave letrare. Ai përvetëson një teknikë të zhvilluar të argumentimit kur shpreh mendimin e tij mbi tekstin dhe

përfundimet e tij. Kur interpreton vepra letrare të përcaktuara nga programi mësimor, ai hulumton tërësisht letërsinë profesionale të shkruar dhe elektronike. Zbaton strategjitë e leximit në përputhje me detyrën e leximit. Ai përvetëson një kulturë të zhvilluar leximi, leximi i një vepre letrare është një përvojë për të. Përmes leximit, ai pasuron njohuritë e tij, fondin leksikor, zhvillon aftësinë e argumentimit, di të shprehë mendimin e tij, di të mbrojë pozicionin e tij. Ai mund t'u rekomandojë vepra letrare të tjerëve dhe të shpjegojë zgjedhjen e tij. Ai tregon respekt për vlerat e letërsisë dhe kulturës kombëtare dhe për kulturën e kombeve të tjera. Ai pasuron njohuritë e tij ndërkulturore duke u njohur me përkthimet e veprave letrare të huaja dhe kontaktet me kombet e tjera. Ai aplikon një aspekt kritik kur zgjedh midis burimeve të letërsisë profesionale në lidhje me veprat letrare në internet, ai u jep përparësi revistave cilësore.

Rezultatet e mëposhtme përshkruajnë atë që nxënësi e di dhe është në gjendje ta bëjë në **nivelin themelo**r të çdo fushë të njohurive.

GJUHA DHE LETËRSIA SHQIPE

(Klasa e tretë)

Standardet e përgjithshme të arritjeve – Standardet arsimore për përfundimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për lëndën Gjuhë dhe Letërsi shqipe përmbajnë standarde e arritjeve për fushat: Gjuha, Letërsia dhe Kultura e Gjuhës. Brenda secilës fushë/temë, janë përshkruar kërkesat në tre nivele.

Standardet e përgjithshme të arritjeve – standardet arsimore për fund të arsimit të mesëm për lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe:	**REZULTATet** Sipas temës së kryer / fusha Nxënësi është në gjendje që:	**Permbajtja**
2GJSH.1.1.1. Posedon njohuritë elementare për gjuhën (ç'është gjuha, si funksionon, veçoritë e saj) etj. Respekton gjuhën e tij dhe gjuhën e të tjerëve; përdor fjalë (shprehje) stereotipe për gjuhën. E di nocionin e tekstit dhe dallon pjesët e tij (hyrjen, pjesën kryesore, përmbajtjen, përfundiminfundin), po ashtu dallon llojet e teksteve (varësisht nga diskursi). Ka njohuri për sociolinguistikën sidomos për njëgjuhësinë (monolinguizmin) dhe shumëgjuhësisë (polilinguizmin) dhe njeh rastet gjegjëse gjuhësore në Shqipëri, Kosovë, Mqedoni, Serbi…). E di konceptin e varietetit gjuhësor dhe njeh varietete themelore të gjuhës. 2GJSH.1.1.2. Dallon gjuhën letrare (standarde) nga dialekti; e di ndarjen dialektore të gjuhës shqipe; ka njohuri për dialektin e tij dhe për dialektin tjetër të gjuhës shqipe si dhe për të folmet e tjera dhe kështu përdor fjalë apo shprehje nga e folmja e tij, nganjëherë edhe nga e folmja e palës tjetër, por gjithmonë është konservator ndaj varietetit gjuhësor së cilës i përket. Me shembuj mund t'i paraqes veçoritë që i dallojnë të dy dialaktet e shqipes (nga aspekti fonetik, gramatikor e leksikor) dhe	• ndërton dhe zhvillon njohuri të reja rreth gramatikës dhe leksikologjisë përmes studimit të funksionit dhe ndikimit të tyre në tekstet qëlexon; • përdor njohuritë gramatikore dhe leksikore gjatë të folurit dhe të shkruarit për të arritur qëllime ose efekte të caktuara; • dallon disa ndryshime mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve dhe gjuhës standarde; • zotëron rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit në gjuhën shqipe; • shkruan saktë, pa gabime, dhe argumenton mënyrën e të shkruarit, duke cituar rregullat drejtshkrimore; • përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore	– Gjuha shqipe gjuhë indoevropiane (Model I dhe II) – Teza ilire për gjuhën shqipe (Model I dhe II) – Teksti argumentues skema dhe struktura, elemntet, llojet e argumenteve – Përemri, Përemri vetor (Model I dhe II) – Përemri vetevetor (Model I dhe II) – Përemri dëftor (Model I dhe II) – Artikulli i gazetës, kryeartikulli, reklama – Përemri pronor – Eseja argumentuese

kështu mund ta mësojë, ta ruaj e ta kultivojë edhe më shumë gjuhën letrare. Njeh gramatikat kryesore dhe librat normativë të shqipes, të cilat i përdor në situata të caktuara. E di që gjuha shqipe zë një vend të rëndësishëm në rrethin e gjuhëve indoevropiane, duke pasur një traditë të gjatë të të folurit dhe të shkruarit dhe kjo ka po ashtu një rëndësi të madhe për kulturën shqiptare. Ka njohuri për etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, fillimet e shkrimit të shqipes dhe rregullat e drejtshkrimit. 2GJSH.1.1.3. E di nocionin e theksit. Në fjali mund t'i dallojë llojet e theksave (theks i lirë, dinamik, ritmik, logjik, i fjalisë). Mund t'i ndajë tingujt në: tinguj zanorë dhe bashkëtingëllorë dhe i bashkon në formimin e fjalëve duke i dhënë kuptim atyre. Kur shqipton me zë më të fortë ose me zë më të ngritur një fjalë a një pjesë të fjalisë, mund ta vë rëndësinë kuptimore të saj dhe kështu i heton dallimet eventuale mes akcentit të tij nga ai letrar. 2GJSH.1.1.4. E di definicionin e fjalës dhe karakteristikat e saj. Njeh njësitë themelore të gjuhës (fonemën, morfemën, fjalën, togfjalëshin dhe fjalinë). Ndan fjalët në njësi më të vogla gjuhësore si p.sh.: fjalët për-pun-oj, kënd-o-j etj, Fjalën mund ta analizoj nga aspekti gramatikor me parashtesa, prapashtesa e mbaresa. Njeh mënyrat elementare të ndërtimit të fjalëve. Fjala si strukturë ka dy anë: përmbajtjen dhe formën dhe kështu dallon aspektin leksiko-gramatikor nga ai fonetiko-gramatikor. 2GJSH.1.1.5. Fjalinë e shkruan sipas rregullave gramatikore; mund t'i klasifikojë njësitë sintaksore; dallon fjalitë pohore dhe mohore; analizon fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra. 2GJSH.1.1.6. Ka një fond leksikor, i cili i përmbush nevojat në nivelin e mesëm të arsimimit; bën dallimin mes leksikut letrar dhe joletrar dhe i përdor sipas situatës së krijuar; ka njohuri për domethënien e fjalës; njeh grupet (paradigmat) e fjalëve: sinonimet, antonimet, homonimet; njeh metaforën si mekanizëm	në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan. • përdor strategjitë e të lexuarit dhe bën identifikimin e tipareve të formës e të përmbajtjes së teksteve; • përdor organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit, parafrazon dhe përmbledh tekstet e punuara; • kupton tekste të llojeve të ndryshme; • zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti; • përdor materiale udhëzuese dhe gjurmon në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasurua rfjalorin; • analizon tema të ndryshme, duke zbuluar gjuhën e figurshme të tekstit; • identifikon faktin dhe opinionin në tekste të ndryshme; • realizon punë kërkimore; • përzgjedh informacione për qëllime të ndryshme; vlerëson informacionin e përzgjedhur nga të tjerët, përmbledh materiale të ndryshme, si dhe nxjerr përfundime.	– Përemri i pacaktuar – Eseja letrare – Thonjëzat, kllapat, shumëpikëshi – Eseja historike – Përemri lidhor, pyetës – Eseja filozofike – Ndajfolja, shkallët dhe shprehjet ndajfoljore – Parafjala – Lidhëzat (bashkë dhe nënrenditëse) – Relacioni – Procesverbali – Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras si dhe me vizë në mes – Letra zyrtare – Curriculum vitae – Klasifikimi i gjymtyrëve të dyta – Llojet e teksteve (informues, shpjegues) – Shkrimi i ligjeratës së drejtë dhe të zhdrejtë (kthimi nga e drejta në të zhdrejtë dhe anasjelltas) – Dallimi mes tekstit letrar dhe joletrar – Kronika (historike) – Kundrinorët – Autobiografia, Ditari, Letra personale

leksikor. Nëse ndonjë fjalë ka prejardhje të huaj, e përdorë dhe nuk ndien ndonjë "armiqësi" ndaj saj. Por, nganjëherë bën edhe kritika për shkak të futjes së saj në strukturën e shqipes. Njeh nocionin e frazeologjisë. Përdor fjalorët e gjuhës shqipe (Fjalorin drejtshkrimor, frazeologjik, sinonimik) etj. 2GJSH.2.1.1. Ka njohuri më të thella për gjuhën në krahasim me nivelin fillestar; Njeh njësitë, të cilat i përkasin niveleve të ndryshme të gjuhës, pra nënsistemet; Ka njohuri për shkrimin e letrave. Tashmë njeh parimet kryesore të gjuhës shqipe si parimin fonetik, morfologjik, etimologjik etj.; I di disa gjëra elementare për gjuhët e botës (ngjajshmëritë gjuhësore, përbashkësitë (universaliet) gjuhësore; I njeh parimet e zhvillimit të dialogut; kupton nocionin e aktit të të folurit; në tekst dallon pjesëzat dëftuese apo deiksin; Njeh varietetet gjuhësore të shqipes gjatë paraqitjes së një moderatori në medie kur ai flet në vernakularin gjuhësor – krahinor, pra nëse përdor ndonjë fjalë apo shprehje nga rajoni i tij.		– Rrethanorët – Teksti përshkrues, lloji, skema, karakteristika – Përcaktorët – Përshkrimi i njerëzve, objekteve, vendeve, mjediseve, imazheve – Përcaktori kallëzuesor – Sinonimet, antonimet, homonimet – funksioni
2GJSH.2.1.2. I di tiparet dalluese të të dy dialekteve të gjuhës shqipe; P.sh.: në sistemin fonetik për gegërishten është karakteristike seria e zanoreve hundore kurse në toskërishte ka vetëm zanore gojore (hĩ-ni, rê-ja, zã-ni-gegërishte dhe hi-ri, re-ja, zë-ri-toskërishtja); toskërishtja ka **"ë"** në serinë e zanoreve të theksuara kurse gegërishtja nuk e ka, pra ajo i përgjigjet toskërishtes me **ã**; gegërishtja ka grupin nistor **vo** kurse toskërishtja ka grupin **va** (vaj, varr, vatër-toskërishtja., dhe voj, vorr, votër-gegërishtja) etj.; Në toskërishte ruhen grupet **mb, nd, ng** ndërkaq në gegërishte kanë dhënë **m, n, n**; Po ashtu e di se këto dialekte veçohen edhe nga tiparet morfologjike e leksikore; Mund t'i rirendis etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, të cilat janë të njohura edhe më parë; 2GJSH.2.1.3. Njeh aparatin e të folurit dhe mënyrën se si prodhohen tingujt; dallon tingujt sipas pikëpamjes së artikulimit; e jep definicionin për fonemën; bën ndarjen fonetike të të		

folurit dhe në një frazë apo sintagmë spikat llojin e theksit (theks logjik, emfatik apo emocional) dhe kështu në mënyrë të drejtë mund ta shqiptojë fjalën në njësitë e lartëpërmenduara; njeh mekanizmat e ndryshimit të tingujve (ndryshimet kombinatore) siç janë: asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat e tingujve (proteza, epenteza, epiteza), rëniet e tingujve (afereza, sinkopa, apokopa). 2GJSH.2.1.4. Ka njohuri të gjera për fjalën dhe veçoritë e saj; e di se forma e fjlaës është fonetiko-gramatikore sepse përbëhet nga elemente fonetike e gramtikore duke e paraqitur me shembull si bie fjala: emri *vëlla-i* ka tingujt e nyjëtuar *v-ë-ll-a-i* dhe temën fjalëformuese *vëlla-* dhe mbaresën *–i*, e cila tregon gjininë, numrin, rasën e trajtën e emrit; e njeh termin morfemë; ndan apo zbërthen fjalën në morfema si p.sh.: mal-or, qytet-ar, hekur-os, lag-a, mal-i, për-dredh, sh-thur etj., dhe në bazë të shembujve dallon morfemat rrënjore, parashtesore e prapashtesore; i di anët kryesore të strukturës së fjalës (përmbajtjen dhe formën); zbaton kriterin theksor (akcentologjik) si kriter dallues i fjalës së një tipari fonetik. 2GJSH.2.1.5. Gjatë procesit të ligjërimit, përdor fjalë duke i bashkuar për ta shprehur e transmetuar mendimin dhe ato (fjalë) duke hyrë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore krijojnë njësi të ndryshme sintaksore; dallon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra; analizon fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme; ka njohuri të gjera rreth sintagmës; klasifikon fjalitë e varura; njeh termin elipsë; i di rasat dhe kategoritë gramatikore të foljes. 2GJSH.2.1.6. Ka fond të pasur leksikor (leksikun individual e të huaj); është i njoftuar për prefiksat e sufiksat që përdoren nga gjuhët e huaja në shqipen; fondin leksikor e shfrytëzon sipas rastit; sipas tij, gjuha është i vemi mjet i komunikimt që shërben për ta shprehur mendimin e tij, por edhe përvojën individuale dhe kështu e pasuron edhe më tepër		

fjalorin; njeh hiperoniminë, hiponiminë, paroniminë; dallon shtresat leksikore; njeh metaforën dhe metoniminë si mekanizma leksikorë. 2GJSH.3.1.1. E di që ekziston lidhja e afërt mes gjuhës dhe mendimit dhe e di nocionin e tyre; e jep përkufizimin e fjalisë duke e ditur gjithashtu se ajo ka dy anë: anën kuptimore dhe anën strukturore; dallon kohezionin leksikor dhe gramatikor. 2GJSH.3.1.2. Gjatë ndarjes së fjalëve në rrokje, përdor mjetet fonetike për spikatjen e saj (rrokjes) si: gjatësinë dhe forcën. 2GJSH.3.1.3. Ka njohuri për morfologjinë në kuptimin e gjerë të fjalës, në të cilën jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes..; e ndan apo e zbërthen fjalën në morfema duke e dalluar morfemën rrënjë, parashtesore dhe prapeshtesore. 2GJSH.3.1.4. Ka njohuri më të gjera për përdorimin e rasave dhe të formave foljore; mund t'i analizojë fjalitë nga pikëpamja morfologjike (duke i gjetur pjesët e ligjëratës); i njeh tipat e fjalive; dallon kryefjalën, kallëzuesin dhe gjymtyrët e dyta duke i analizuar sintaksorisht. 2GJSH.3.1.5. Ka njohuri themelore për fjalorët dhe për strukturën e tyre.		
2GJSH.1.2.1. Njeh autorët nga programi obligativ shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letraro-historik. 2GJSH.1.2.2. Njeh terminologjinë e teorisë së letërsisë, në të cilën njihen shkrimet e veçanta dhe ku letërsia trajtohet në mënyrë teorike. 2GJSH.1.2.3. Në interpretimin e pjesëve letraro – artistike dhe pjesëve letraro-shkencor, dallon metodat e qasjes së brendshme dhe të jashtme. 2GJSH.1.2.4. Vëren dhe me shembuj argumenton tiparet letrare, poetike, gjuhësore, estetike e strukturore të veprave letrare. 2GJSH.1.2.5. I di tiparet e letërsisë si dhe i shpjegon raportet e saj me	• analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë, si: temat dhe motivet, idetë, përshkrimin e kohës dhe mjedisit, rrëfimtarin, marrëdhëniet ndërmjet personazheve, fabulën dhe subjektin; • analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik, si: motivet kryesore, përdorimin e gjuhës, figuracionin, rimën, ritmin, llojet e strofës etj.; • analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti	**– Romantizmi në letërsi** – Lëvizja "Stuhi dhe vrull" – "Stuhi dhe vrull" – Gëte, gjeniu krijues – Analizë "Fausti" – Koment "Natë" – V. Hygo – Pena e artë e romantizmit – Analizë "Katedralja e Parisit" – Koment "Esmeealda"

gjuhën dhe marrëdhëniet me artet e tjera. 2GJSH.1.2.6. Paraqet tiparet historike dhe poetike të periudhave letrare, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe botërore duke përfshirë edhe shkrimtarët shqiptarë e të huaj nga lektura e obliguar shkollore. 2GJSH.1.2.7. Analizon pjesët letrare nga ato joletrare dhe mund t'i argumentoj teorikisht.	dramatik, si: trajtimin e temës, konfliktet e përshkruara në vepër, analizën e marrëdhënieve ndërmjet personazheve etj.; • dallon gjinitë kryesore, si dhe tiparet e çdo gjinie letrare; • interpreton dhe analizon zhvillimin historik të gjinive letrare;	– Ese letraro – filozofike – Xh. Bajron, poeti i lirisë – Analizë "Shtegtimet e Çajld Haroldit" – Koment "Shqiperia dhe shqiptarët" **– Letërsia romantike shqiptare** – Studim teksti "Shqipëria çka qenë ç'është e çdo të bëhetë?, S. Frashëri – Jeronim de Rada, jeta dhe vepra – Analizë "Këngët e Milosaos" – Studim "Këngët e Milosaos" – Naim Frashëri – vepra
2GJSH.1.2.8. Shfrytëzon po ashtu literaturën sekondare qoftë letrare, historike, kritike, poetike, teorike duke i sjellë punimet e tij para të tjerëve. 2GJSH.1.2.9. Duke i lexuar veprat e letërsisë shqipe dhe botërore, e kupton rëndësinë e të lexuarit të pjesës letrare dhe kështu ky pozitivitet ndikon në formimin e identitetit të tij gjuhësor, letrar, kulturor e kombëtar. 2GJSH.2.2.1. Interpreton veprën letrare duke nxjerrë thelbin dhe veçoritë e saj; kontekstin historik; motivet letrare; tematikën para se gjithash; kompozicionin; figurat letrare; idenë e shkrimtarit; aspektin gjuhësor e stilistik etj. 2GJSH.2.2.2. Njeh terminologjinë e Teorisë së Letërsisë dhe njohuritë teorike-letrare i zbaton në mënyrë adekuate në interpretimin e pjesëve apo edhe veprave letrare.	• dallon dhe analizon veçoritë e llojeve epike, si: poema epike, miti, legjenda, përralla, tregimi, novela, romani; • dallon dhe analizon veçoritë e llojeve lirike, si: elegjia, himni, soneti, lirika moderne; • dallon dhe analizon veçoritë e llojeve dramatike, si: tragjedia, komedia, drama; • dallon figurat e kuptimit, si: krahasimi, personifikimi, antiteza, kontrasti, hiperbola, simboli, paralelizmi figurativ; • dallon figurat e shqiptimit poetik, si: pyetja retorike, pasthirrma, apostrofa, epanastrofeja, aliteracioni; • dallon figurat e fjalëve dhe të shprehjeve, si:	– Analizë "Lulet e veresë" – Studim teksti "Fjalët e qiririt" **– Realizmi** – Balzaku – jeta dhe vepra – Analizë "Xha Gorio" – Koment "Vdekja e Gorioit" – Gustav Flober – jeta dhe vepra – Analizë "Zonja Bovari" + koment – Fjodor Dostoevski, jeta dhe vepra – Analizë "Vëllezërit Karamazovë"

2GJSH.2.2.3. Dallon metodat e qasjes së brendshme e të jashtme në interpretimin e pjesëve apo veprave letraro-arstistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistike. 2GJSH.2.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave letraro-artistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistik si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekstet apo veprat përkatëse. 2GJSH.2.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv dhe këto elemente e përcaktojnë edhe vetë llojin si: tragjedinë, komedinë, elegjinë etj. 2GJSH.2.2.6. Gjatë interpretimit të pjesëve letraro-artistike dhe letraro-shkencor, i përdor njohuritë paraprake nga fusha e teorisë së letërsisë; i njeh drejtimet dhe formacionet e zhvillimit të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.2.2.7. Në mënyrë të pavarur analizon pjesët letrare dhe mund t'i argumentojë qëndrimet e tij përballë të tjerëve. 2GJSH.2.2.8. Shfrytëzon literaturë shtesë nga letërsia, historia dhe fusha të tjera shoqërore, me qëllim të afirmimit të tij në interpretimin e pjesëve të tjera letraro-artistike e letraro-shkencor të parapara sipas planit dhe programit mësimor. 2GJSH.2.2.9. Duke i lexuar veprat letrare shqipe e botërore, e zhvillon edhe më shumë aftësinë shprehëse për interpretim dhe vlerësim të pjesëve të ndryshme letraro-artistike dhe letraro-shkencor , po ashtu e pasuron fondin leksikor, letrar, kulturor; me leximin e veprave të ndryshme, ai mund të bëhet më i arsimuar e më i kulturuar. 2GJSH.3.2.1. Lexon dhe analizon pjesët letraro-artistike dhe letraro-	metafora, metonimia, sinekdoka, ironia, sarkazma, alegoria, eufemizmi; • rrëfen subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti; • përcakton dhe analizon fabulën e një teksti; • analizon ngjarjet kryesore të një teksti; • dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon funksionin dhe rëndësinë e tyre; • dallon konfliktin/et në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër; • analizon rolin e didaskalive në tekste dramatike; • analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.; • evidenton ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet personazheve (karakteri, sjelljet etj.); • dallon llojet e personazheve (reale, historike, të trilluara, mitologjike, të jashtëzakonshme, kryesore, dytësore); • përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën në një vepër letrare; • veçon mjetet artistike që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën; • analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një tekst;	– Koment "Paradoksi mbi lirinë e zgjedhjes" **– Simbolizmi në letërsi** – Sharl Bodler, poet i nëmur – Analizë "Lulet e së keqes" + koment **Lektura shtëpiake:** *13. Xh. Bajron – Çajld Harold* *14. Jeronim de Rada – Këngët e Milosaos* *15. Naim Frashëri – Bagëti e Buqësia* *16. Sami Frashëri – Besa* *17. Onore Balzak – Xha Gorio* *18. Sharl Bodler – Lulet e së keqes* **Vërejtje: arsimtari mund të bëjë zgjedhje të lirë të lekturave shtëpiake në pajtueshmëri me planin dhe programin për klasën e tretë të Gjimnazit.*

shkencor të parapara nga plani dhe programi mësimor dhe tekstet shtesë apo fakultative po ashtu letraro-artistike dhe letraro-shkencor duke i analizuar në kontekst më të gjerë historik. 2GJSH.3.2.2. Është i njoftuar me terminologjinë teorike-letrare duke e zbatuar në interpretimin e veprave letraro-artistike dhe letraro-shkencor të cilat janë të parapara me planin dhe programin mësimor; shfrytëzon edhe vepra të zhanreve të tjera, jashtë obligatives. 2GJSH.3.2.3. Në procesin e interpretimit të veprave përkatëse, zbaton metodat adekuate të qasjes së brendshme e të jashtme. 2GJSH.3.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave gjegjëse e publicistike si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekst. 2GJSH.3.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv. 2GJSH.3.2.6. Gjatë interpretimit dhe vlerësimit të veprave letraro-artistike dhe letraro- shkencor, zbaton dhe krahason tiparet historike e letrare (stilistike) të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.3.2.7. I vëren e i interpreton problemet dhe idetë në veprën letrare dhe qëndrimet e tij mund t'i argumentojë në bazë të tekstit primar dhe kontekstit letrar. 2GJSH.3.2.8. Për ta interpretuar (njohur) apo për t'i bërë analizë filologjike veprës letrare, duhet të ketë njohuri të caktuara, një kulturë letrare nga leximi i veprave të tjera që për nga rëndësia hyjnë në radhën e kryeveprave nacionale e botërore.	• dallon temën dhe motivet e një teksti; • analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar; • veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst, si p.sh.:gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); • përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja hiperbola, ironia etj.); • muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.); • rrëfimtari dhe veta e rrëfimit (veta e parë, veta e tretë);	

2GJSH.3.2.9. Pasi t'i ketë lexuar veprat letrare shqipe e botërore, të cilat janë obligative, dhe veprat letrare me përzgjedhje, vërehet aftësia e tij shprehëse kundrejt të tjerëve dhe me këto zhvillohet e pasurohet edhe më shumë identiteti i tij kulturor e arsimor.		
2GJSH.1.3.1. Flet qartë duke respektuar drejtshqiptimin (ortoepinë) e gjuhës letrare; zbaton theksin (akcentin) gjuhësor-letrar ose e krahason akcentin e tij me atë letrar me tendencë të përshtatjes; Rrjedhshëm dhe qartë lexon me zë tekstet letrare dhe joletrare; shprehimisht lexon dhe lehtë i tregon tekstet letrare artistike; Në situata formale flet për temat e thjeshta si: nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe të kulurës duke u shërbyer me shprehje korrekte gjuhësore; Pra, flet qartë, pa pengesa, pa dridhje të zërit e pa pauza të mëdha; Sipas nevojës, përdor teminologjinë shkencore për gjuhën dhe letërsinë, duke e përshtatur me rastet apo situatat, bashkëfolësin ose përdor edhe mjetet gjuhësore verbale a joverbale sidomos mimikën, gjestikulacionin, lëvizjet e duarve etj, që në gjuhësi njihet me emrin Semiotikë; Ka kulturë të të dëgjuarit kur dikush flet në gjuhën e tij dhe me vëmendje dëgjon e kupton ligjëratat nga fusha e gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës dhe kështu gjatë dëgjimit të ndonjë ligjërimi, mund të marrë shënime; 2.GJSH.1.3.2. Dukë folur apo shkruar për ndonjë temë nga gjuha, letërsia apo për jetën shoqërore, e strukturon rrëfimin dhe i lidh pjesët në mënyrën e duhur; Dallon të rëndësishmen nga e parëndësishmja dhe i përmbahet temës kryesore; Shkruan një tekst duke u shërbyer nga përshkrimi e ekspozicioni dhe shkurtazi përshkruan ndjenjat e tij dhe përjetimin e pjesës letrare ose të ndonjë pjese tjetër artistike; Rrëfen tekstin letrar artistik dhe i ndanë pjesët kryesore. Në fund jep një përmbledhje (rezyme) të tekstit letrar ose joletrar; 2GJSH.1.3.3. Në diskutime me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura, në pika të shkurtëra mund ta shpreh dhe	• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme, mbështet ose kundërshton një pozicion të caktuar, merr në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi; • dallon karakteristikat e gjuhës së folur si një formë komunikimi, si dhe krahason përdorimet e kësajgjuhe në shkollë dhe në komunitet; • realizon prezantime të ndryshme me gojë, përdor strategjitë e duhura për të përmbushur qëllimin që ka dhe, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës, respekton kohën gjatë prezantimit; • përdor TIK-un për të realizuar prezantime të ndryshme, sidomos në situata formale. • përdor strategjitë e të dëgjuarit dhe kupton tekste të llojeve të ndryshme; • analizon tiparet e formës e të përmbajtjes së teksteve; • përdor material udhëzuese dhe hulumton në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin; • përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me	Gjuha e medies; Gazeta; Publiciteti, reklama; Tekstet e digjitalizuara.

ta argumentojë idenë ose qëndrimin për të cilin angazhohet; Pra, ai mund të flasë ngadalë duke u mbështetur kryesisht në fakte; Është në gjendje ta dëgjojë mendimin e tjetrit dhe ta marrë parasysh gjatë argumentimit të tij; Shkruan tekst me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura; 2GJSH.1.3.4. Shfrytëzon librin drejtshkrimor të gjuhës shqipe; zbaton rregullat elementare të drejtshkrimit dhe mund të shërbehet me botime të tjera nga Ortografia; Në të shkruar ndan pjesët tekstit, jep titujt dhe nëntitujt, citon dhe parafrazon; Bën punimin e maturës duke respektuar rregullat e shkruarjes së punimit shkencor (përdor fusnotat, shkruan përmbajtjen dhe bibliografinë); Shkruan letra zyrtare dhe jozyrtare, biografi (CV), lutje, ankesë, kërkesë; Di të mbushë formularë të ndryshëm etj.; 2GJSH.1.3.5. Ka aftësinë që në mënyra të ndryshme (informim, mësim, zhvillim personal, përjetim estetik, argëtim …) të lexojë tekstet të rëndësisë (tekstet letrare, tekste profesionale, shkencore, popullore) nga fusha e shkencës për gjuhën dhe letërsinë, tekstet nga mediet; tekstet që janë të përshtatshme për përpunimin e planit për gjuhë dhe letërsi); zbaton strategjitë e të lexuarit; 2GJSH.1.3.6. Kupton tekstin letrar e joletrar dhe njeh rëndësinë e tyre, gjen informacione nga më të ndryshmet, ndan pjesët kryesore të tekstit; e di kuptimin e përmbajtjes në tekst; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste. 2GJSH.1.3.7. Në mënyrë kritike jep sqarim për tekstin letrar e joletrar; dallon faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson (dhe argumenton) se a i prezanton autori i tekstit joartistik të gjitha informacionet e nevojshme dhe a jep fakte të mjaftueshme e të besueshme për atë që thotë; vlerëson se a është neutral autori i tekstit ose i angazhuar apo i anshëm dhe e arsyeton vlerësimin e tij; njeh gjuhën e urrejtjes,	bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënit, duke përfshirë edhe të nxënit në distancë; • vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediesh; • është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.	

diskriminimit, sharjes dhe për këto çështje ka qëndrim negativ. 2GJSH.1.3.8. Njeh strukturën, elementet e ndryshme, figurat stilistike (metoniminë, metaforën, asonancën, aliteracionin, onomatopenë, anaforën…); Njeh domethënien konotative të fjalës në kontekstin e dhënë dhe kupton qëllimin e domethënies konotative në tekstin letrar dhe joartistik; vlerëson domethënien e fjalëve të panjohura në bazë të kontekstit dhe modelit të formacionit; kupton domethënien e leximit për pasurimin e fondit leksikor. 2GJSH.2.3.1. Nëpër situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë, flet për temat nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës, duke e përdorur gjuhën letrare dhe terminologjinë përgjegjëse; merr pjesë në bisedat publike ku ka më shumë pjesëmarrës; vlerëson auditoriumin dhe e përshtat fjalimin e tij sipas mundësive dhe kërkesave të tij; në të folur duhet ta zhvillojë më shumë kulturën e tij shprehëse; me vëmendje dëgjon prezantimet nga të tjerët (psh. ligjëratat) me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura etj.		
2GJSH.2.3.2. Ndërton tekstin e folur a të shkruar nga gjuha, letërsia etj., duke e karakterizuar nga kohezioni dhe koherenca, pra me mënyrën se si lidhen midis tyre në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës njësitë që e përbëjnë tekstin (kohezioni) dhe me organizimin logjik të tekstit me mënyrën se si gjykimet dhe arsyetimet lidhen midis tyre (koherenca); në diskutimet e shkruara apo të folura, shpreh idetë dhe argumenton qëndrimet e tij; përkujdeset që të shkruaj e të folë në mënyrë të drejtë duke respektuar normën gjuhësore pa bërë ndonjë digresion (shmangie) nga rregullat; shfaq përjetimin dhe përshtypjet e tij rreth pjesës letrare ose artistike; rrëfen tekstin letrar dhe jep një përfundim për të sipas mundësive të tij shprehëse; zbaton rregullat drejtshkrimore etj. 2GJSH.2.3.3. Për të pasur një informim edhe më te gjerë, pra për ta zhvilluar aftësimin personal dhe për ta		

arritur përjetimin letrar e estetik, lexon tekste edhe më të ndërlikuara si tekste letraro-artistike, tekste shkencore, tekste nga mediet etj; është i apasionuar pas leximit; zbaton dhe zgjedh strategjitë e përshtatshme të leximit. 2GJSH.2.3.4. Kupton tekstin joletrar; nxjerr thelbin e tij; gjen pjesët e nënkuptueshme, por edhe e shtjellon tekstin në fjalë; gjen idenë kryesore; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste për të kuptuar aspektin domethënës e stilistik; i gjen dhe i analizon motivet dhe figurat, të cilat paraqiten në veprën letrare; interpreton tekstet duke u mbështetur në tekstet e tjera letrare. 2GJSH.2.3.5. Në mënyrë kritike jep vlerësim për tekstin letrar joartistik; ndan faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson neutralitetin (anshmërinë) e autorit; vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit argumentues; prezanton të gjitha informatat dhe faktet e autorit për ato që i thotë. 2GJSH.2.3.6. Vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit joartistik; teksti a është koheziv dhe koherent, a janë dhënë idetë qartë dhe saktë; vëren dukuritë stilistike; vëren se sa ndikojnë pjesët e caktuara të tekstit për ta kutpuar atë. 2GJSH.3.3.1. Diskuton për temat komplekse nga gjuha, letërsia dhe kultura; flet për tekstet letrare dhe joletrare duke shfrytëzuar terminologjinë profesionale. 2GJSH.3.2.2. Prezanton në situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë paraqitet me tema nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës; është orator dhe paraqet qëndrimet e tij para auditoriumit me argumente; gjatë ligjërimit përdor fjalë dhe shprehje nga gjuha amtare duke respektuar normën e gjuhës standarde etj.		

dallon morfemat rrënjore, parashtesore e prapashtesore; i di anët kryesore të strukturës së fjalës (përmbajtjen dhe formën); zbaton kriterin theksor (akcentologjik) si kriter dallues i fjalës së një tipari fonetik. 2GJSH.2.1.5. Gjatë procesit të ligjërimit, përdor fjalë duke i bashkuar për ta shprehur e transmetuar mendimin dhe ato (fjalë) duke hyrë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore krijojnë njësi të ndryshme sintaksore; dallon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra; analizon fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme; ka njohuri të gjera rreth sintagmës; klasifikon fjalitë e varura; njeh termin elipsë; i di rasat dhe kategoritë gramatikore të foljes. 2GJSH.2.1.6. Ka fond të pasur leksikor (leksikun individual e të huaj); është i njoftuar për prefiksat e sufiksat që përdoren nga gjuhët e huaja në shqipen; fondin leksikor e shfrytëzon sipas rastit; sipas tij, gjuha është i vemi mjet i komunikimt që shërben për ta shprehur mendimin e tij, por edhe përvojën individuale dhe kështu e pasuron edhe më tepër fjalorin; njeh hiperoniminë, hiponiminë, paroniminë; dallon shtresat leksikore; njeh metaforën dhe metoniminë si mekanizma leksikorë. 2GJSH.3.1.1. E di që ekziston lidhja e afërt mes gjuhës dhe mendimit dhe e di nocionin e tyre; e jep përkufizimin e fjalisë duke e ditur gjithashtu se ajo ka dy anë: anën kuptimore dhe anën strukturore; dallon kohezionin leksikor dhe gramatikor. 2GJSH.3.1.2. Gjatë ndarjes së fjalëve në rrokje, përdor mjetet fonetike për spikatjen e saj (rrokjes) si: gjatësinë dhe forcën. 2GJSH.3.1.3. Ka njohuri për morfologjinë në kuptimin e gjerë të fjalës, në të cilën jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes..; e ndan apo e zbërthen fjalën në morfema duke e dalluar morfemën rrënjë, parashtesore dhe prapeshtesore.		

2GJSH.3.1.4. Ka njohuri më të gjera për përdorimin e rasave dhe të formave foljore; mund t'i analizojë fjalitë nga pikëpamja morfologjike (duke i gjetur pjesët e ligjëratës); i njeh tipat e fjalive; dallon kryefjalën, kallëzuesin dhe gjymtyrët e dyta duke i analizuar sintaksorisht. 2GJSH.3.1.5. Ka njohuri themelore për fjalorët dhe për strukturën e tyre.		
2GJSH.1.2.1. Njeh autorët nga programi obligativ shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letraro-historik. 2GJSH.1.2.2. Njeh terminologjinë e teorisë së letërsisë, në të cilën njihen shkrimet e veçanta dhe ku letërsia trajtohet në mënyrë teorike. 2GJSH.1.2.3. Në interpretimin e pjesëve letraro – artistike dhe pjesëve letraro-shkencor, dallon metodat e qasjes së brendshme dhe të jashtme. 2GJSH.1.2.4. Vëren dhe me shembuj argumenton tiparet letrare, poetike, gjuhësore, estetike e strukturore të veprave letrare. 2GJSH.1.2.5. I di tiparet e letërsisë si dhe i shpjegon raportet e saj me gjuhën dhe marrëdhëniet me artet e tjera. 2GJSH.1.2.6. Paraqet tiparet historike dhe poetike të periudhave letrare, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe botërore duke përfshirë edhe shkrimtarët shqiptarë e të huaj nga lektura e obliguar shkollore. 2GJSH.1.2.7. Analizon pjesët letrare nga ato joletrare dhe mund t'i argumentoj teorikisht. 2GJSH.1.2.8. Shfrytëzon po ashtu literaturën sekondare qoftë letrare, historike, kritike, poetike, teorike duke i sjellë punimet e tij para të tjerëve. 2GJSH.1.2.9. Duke i lexuar veprat e letërsisë shqipe dhe botërore, e kupton rëndësinë e të lexuarit të pjesës letrare dhe kështu ky pozitivitet ndikon në formimin e	• analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë, si: temat dhe motivet, idetë, përshkrimin e kohës dhe mjedisit, rrëfimtarin, marrëdhëniet ndërmjet personazheve, fabulën dhe subjektin; • analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik, si: motivet kryesore, përdorimin e gjuhës, figuracionin, rimën, ritmin, llojet e strofës etj.; • analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti dramatik, si: trajtimin e temës, konfliktet e përshkruara në vepër, analizën e marrëdhënieve ndërmjet personazheve etj.; • dallon gjinitë kryesore, si dhe tiparet e çdo gjinie letrare; • interpreton dhe analizon zhvillimin historik të gjinive letrare; • dallon dhe analizon veçoritë e llojeve epike, si: poema epike, miti, legjenda, përralla, tregimi, novela, romani; • dallon dhe analizon veçoritë e llojeve lirike, si: elegjia, himni, soneti, lirika moderne; • dallon dhe analizon veçoritë e llojeve	**– Romantizmi në letërsi** – Lëvizja "Stuhi dhe vrull" – "Stuhi dhe vrull" – Gëte, gjeniu krijues – Analizë "Fausti" – Koment "Natë" – V. Hygo – Pena e artë e romantizmit – Analizë "Katedralja e Parisit" – Koment "Esmeealda" – Ese letraro – filozofike – Xh. Bajron, poeti i lirisë – Analizë "Shtegtimet e Çajld Haroldit" – Koment "Shqiperia dhe shqiptarët" **– Letërsia romantike shqiptare** – Studim teksti "Shqipëria çka qenë ç'është e çdo të bëhetë?, S. Frashëri – Jeronim de Rada, jeta dhe vepra – Analizë "Këngët e Milosaos"

identitetit të tij gjuhësor, letrar, kulturor e kombëtar. 2GJSH.2.2.1. Interpreton veprën letrare duke nxjerrë thelbin dhe veçoritë e saj; kontekstin historik; motivet letrare; tematikën para se gjithash; kompozicionin; figurat letrare; idenë e shkrimtarit; aspektin gjuhësor e stilistik etj. 2GJSH.2.2.2. Njeh terminologjinë e Teorisë së Letërsisë dhe njohuritë teorike-letrare i zbaton në mënyrë adekuate në interpretimin e pjesëve apo edhe veprave letrare. 2GJSH.2.2.3. Dallon metodat e qasjes së brendshme e të jashtme në interpretimin e pjesëve apo veprave letraro-arstistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistike. 2GJSH.2.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave letraro-artistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistik si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekstet apo veprat përkatëse. 2GJSH.2.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv dhe këto elemente e përcaktojnë edhe vetë llojin si: tragjedinë, komedinë, elegjinë etj. 2GJSH.2.2.6. Gjatë interpretimit të pjesëve letraro-artistike dhe letraro-shkencor, i përdor njohuritë paraprake nga fusha e teorisë së letërsisë; i njeh drejtimet dhe formacionet e zhvillimit të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.2.2.7. Në mënyrë të pavarur analizon pjesët letrare dhe mund t'i argumentojë qëndrimet e tij përballë të tjerëve. 2GJSH.2.2.8. Shfrytëzon literaturë shtesë nga letërsia, historia dhe fusha të tjera shoqërore, me qëllim të afirmimit të tij në interpretimin e pjesëve të tjera letraro-artistike e	dramatike, si: tragjedia, komedia, drama; • dallon figurat e kuptimit, si: krahasimi, personifikimi, antiteza, kontrasti, hiperbola, simboli, paralelizmi figurativ; • dallon figurat e shqiptimit poetik, si: pyetja retorike, pasthirrma, apostrofa, epanastrofeja, aliteracioni; • dallon figurat e fjalëve dhe të shprehjeve, si: metafora, metonimia, sinekdoka, ironia, sarkazma, alegoria, eufemizmi; • rrëfen subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti; • përcakton dhe analizon fabulën e një teksti; • analizon ngjarjet kryesore të një teksti; • dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon funksionin dhe rëndësinë e tyre; • dallon konfliktin/et në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër; • analizon rolin e didaskalive në tekste dramatike; • analizon personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.; • evidenton ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet personazheve (karakteri, sjelljet etj.); • dallon llojet e personazheve (reale, historike, të trilluara,	– Studim "Këngët e Milosaos" – Naim Frashëri – vepra – Analizë "Lulet e veresë" – Studim teksti "Fjalët e qiririt" **– Realizmi** – Balzaku – jeta dhe vepra – Analizë "Xha Gorio" – Koment "Vdekja e Gorioit" – Gustav Flober – jeta dhe vepra – Analizë "Zonja Bovari" + koment – Fjodor Dostoevski, jeta dhe vepra – Analizë "Vëllezërit Karamazovë" – Koment "Paradoksi mbi lirinë e zgjedhjes" **– Simbolizmi në letërsi** – Sharl Bodler, poet i nëmur – Analizë "Lulet e së keqes" + koment **Lektura shtëpiake:** *19. Xh. Bajron – Çajld Harold* *20. Jeronim de Rada – Këngët e Milosaos* *21. Naim Frashëri – Bagëti e Buqësia* *22. Sami Frashëri – Besa* *23. Onore Balzak – Xha Gorio* *24. Sharl Bodler – Lulet e së keqes*

letraro-shkencor të parapara sipas planit dhe programit mësimor. 2GJSH.2.2.9. Duke i lexuar veprat letrare shqipe e botërore, e zhvillon edhe më shumë aftësinë shprehëse për interpretim dhe vlerësim të pjesëve të ndryshme letraro-artistike dhe letraro-shkencor , po ashtu e pasuron fondin leksikor, letrar, kulturor; me leximin e veprave të ndryshme, ai mund të bëhet më i arsimuar e më i kulturuar. 2GJSH.3.2.1. Lexon dhe analizon pjesët letraro-artistike dhe letraro-shkencor të parapara nga plani dhe programi mësimor dhe tekstet shtesë apo fakultative po ashtu letraro-artistike dhe letraro-shkencor duke i analizuar në kontekst më të gjerë historik. 2GJSH.3.2.2. Është i njoftuar me terminologjinë teorike-letrare duke e zbatuar në interpretimin e veprave letraro-artistike dhe letraro-shkencor të cilat janë të parapara me planin dhe programin mësimor; shfrytëzon edhe vepra të zhanreve të tjera, jashtë obligatives. 2GJSH.3.2.3. Në procesin e interpretimit të veprave përkatëse, zbaton metodat adekuate të qasjes së brendshme e të jashtme.	mitologjike, të jashtëzakonshme, kryesore, dytësore); • përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën në një vepër letrare; • veçon mjetet artistike që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën; • analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një tekst; • dallon temën dhe motivet e një teksti; • analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar; • veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst, si p.sh.:gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); • përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja hiperbola, ironia etj.); • muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.); • rrëfimtari dhe veta e rrëfimit (veta e parë, veta e tretë);	**Vërejtje: arsimtari mund të bëjë zgjedhje të lirë të lekturave shtëpiake në pajtueshmëri me planin dhe programin për klasën e tretë të Gjimnazit.*
2GJSH.3.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave gjegjëse e publicistike si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekst. 2GJSH.3.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i		

nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv. 2GJSH.3.2.6. Gjatë interpretimit dhe vlerësimit të veprave letraro-artistike dhe letraro- shkencor, zbaton dhe krahason tiparet historike e letrare (stilistike) të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.3.2.7. I vëren e i interpreton problemet dhe idetë në veprën letrare dhe qëndrimet e tij mund t'i argumentojë në bazë të tekstit primar dhe kontekstit letrar. 2GJSH.3.2.8. Për ta interpretuar (njohur) apo për t'i bërë analizë filologjike veprës letrare, duhet të ketë njohuri të caktuara, një kulturë letrare nga leximi i veprave të tjera që për nga rëndësia hyjnë në radhën e kryeveprave nacionale e botërore. 2GJSH.3.2.9. Pasi t'i ketë lexuar veprat letrare shqipe e botërore, të cilat janë obligative, dhe veprat letrare me përzgjedhje, vërehet aftësia e tij shprehëse kundrejt të tjerëve dhe me këto zhvillohet e pasurohet edhe më shumë identiteti i tij kulturor e arsimor.		
2GJSH.1.3.1. Flet qartë duke respektuar drejtshqiptimin (ortoepinë) e gjuhës letrare; zbaton theksin (akcentin) gjuhësor-letrar ose e krahason akcentin e tij me atë letrar me tendencë të përshtatjes; Rrjedhshëm dhe qartë lexon me zë tekstet letrare dhe joletrare; shprehimisht lexon dhe lehtë i tregon tekstet letrare artistike; Në situata formale flet për temat e thjeshta si: nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe të kulurës duke u shërbyer me shprehje korrekte gjuhësore; Pra, flet qartë, pa pengesa, pa dridhje të zërit e pa pauza të mëdha; Sipas nevojës, përdor teminologjinë shkencore për gjuhën dhe letërsinë, duke e përshtatur me rastet apo situatat, bashkëfolësin ose përdor edhe mjetet gjuhësore verbale a joverbale sidomos mimikën, gjestikulacionin, lëvizjet e duarve etj, që në gjuhësi njihet me emrin Semiotikë; Ka kulturë të të dëgjuarit kur dikush flet në gjuhën e tij dhe me vëmendje dëgjon e kupton ligjëratat nga fusha e gjuhësisë,	• merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme, mbështet ose kundërshton një pozicion të caktuar, merr në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi; • dallon karakteristikat e gjuhës së folur si një formë komunikimi, si dhe krahason përdorimet e kësajgjuhe në shkollë dhe në komunitet; • realizon prezantime të ndryshme me gojë, përdor strategjitë e duhura për të përmbushur qëllimin që ka dhe, për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e	Gjuha e medies; Gazeta; Publiciteti, reklama; Tekstet e digjitalizuara.

letërsisë dhe kulturës dhe kështu gjatë dëgjimit të ndonjë ligjërimi, mund të marrë shënime; 2.GJSH.1.3.2. Dukë folur apo shkruar për ndonjë temë nga gjuha, letërsia apo për jetën shoqërore, e strukturon rrëfimin dhe i lidh pjesët në mënyrën e duhur; Dallon të rëndësishmen nga e parëndësishmja dhe i përmbahet temës kryesore; Shkruan një tekst duke u shërbyer nga përshkrimi e ekspozicioni dhe shkurtazi përshkruan ndjenjat e tij dhe përjetimin e pjesës letrare ose të ndonjë pjese tjetër artistike; Rrëfen tekstin letrar artistik dhe i ndanë pjesët kryesore. Në fund jep një përmbledhje (rezyme) të tekstit letrar ose joletrar; 2GJSH.1.3.3. Në diskutime me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura, në pika të shkurtëra mund ta shpreh dhe ta argumentojë idenë ose qëndrimin për të cilin angazhohet; Pra, ai mund të flasë ngadalë duke u mbështetur kryesisht në fakte; Është në gjendje ta dëgjojë mendimin e tjetrit dhe ta marrë parasysh gjatë argumentimit të tij; Shkruan tekst me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura; 2GJSH.1.3.4. Shfrytëzon librin drejtshkrimor të gjuhës shqipe; zbaton rregullat elementare të drejtshkrimit dhe mund të shërbehet me botime të tjera nga Ortografia; Në të shkruar ndan pjesët tekstit, jep titujt dhe nëntitujt, citon dhe parafrazon; Bën punimin e maturës duke respektuar rregullat e shkruarjes së punimit shkencor (përdor fusnotat, shkruan përmbajtjen dhe bibliografinë); Shkruan letra zyrtare dhe jozyrtare, biografi (CV), lutje, ankesë, kërkesë; Di të mbushë formularë të ndryshëm etj.; 2GJSH.1.3.5. Ka aftësinë që në mënyra të ndryshme (informim, mësim, zhvillim personal, përjetim estetik, argëtim …) të lexojë tekstet të rëndësisë (tekstet letrare, tekste profesionale, shkencore, popullore) nga fusha e shkencës për gjuhën dhe letërsinë, tekstet nga mediet; tekstet që janë të përshtatshme për përpunimin e planit për gjuhë dhe	audiencës, respekton kohën gjatë prezantimit; • përdor TIK-un për të realizuar prezantime të ndryshme, sidomos në situata formale. • përdor strategjitë e të dëgjuarit dhe kupton tekste të llojeve të ndryshme; • analizon tiparet e formës e të përmbajtjes së teksteve; • përdor material udhëzuese dhe hulumton në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin; • përdor, në mënyrë efektive, programet e TIK-ut për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënit, duke përfshirë edhe të nxënit në distancë; • vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediesh; • është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.	

letërsi); zbaton strategjitë e të lexuarit; 2GJSH.1.3.6. Kupton tekstin letrar e joletrar dhe njeh rëndësinë e tyre, gjen informacione nga më të ndryshmet, ndan pjesët kryesore të tekstit; e di kuptimin e përmbajtjes në tekst; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste. 2GJSH.1.3.7. Në mënyrë kritike jep sqarim për tekstin letrar e joletrar; dallon faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson (dhe argumenton) se a i prezanton autori i tekstit joartistik të gjitha informacionet e nevojshme dhe a jep fakte të mjaftueshme e të besueshme për atë që thotë; vlerëson se a është neutral autori i tekstit ose i angazhuar apo i anshëm dhe e arsyeton vlerësimin e tij; njeh gjuhën e urrejtjes, diskriminimit, sharjes dhe për këto çështje ka qëndrim negativ.		
2GJSH.1.3.8. Njeh strukturën, elementet e ndryshme, figurat stilistike (metoniminë, metaforën, asonancën, aliteracionin, onomatopenë, anaforën…); Njeh domethënien konotative të fjalës në kontekstin e dhënë dhe kupton qëllimin e domethënies konotative në tekstin letrar dhe joartistik; vlerëson domethënien e fjalëve të panjohura në bazë të kontekstit dhe modelit të formacionit; kupton domethënien e leximit për pasurimin e fondit leksikor. 2GJSH.2.3.1. Nëpër situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë, flet për temat nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës, duke e përdorur gjuhën letrare dhe terminologjinë përgjegjëse; merr pjesë në bisedat publike ku ka më shumë pjesëmarrës; vlerëson auditoriumin dhe e përshtat fjalimin e tij sipas mundësive dhe kërkesave të tij; në të folur duhet ta zhvillojë më shumë kulturën e tij shprehëse; me vëmendje dëgjon prezantimet nga të tjerët (psh. ligjëratat) me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura etj. 2GJSH.2.3.2. Ndërton tekstin e folur a të shkruar nga gjuha, letërsia etj., duke e karakterizuar nga kohezioni dhe koherenca, pra me mënyrën se si		

lidhen midis tyre në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës njësitë që e përbëjnë tekstin (kohezioni) dhe me organizimin logjik të tekstit me mënyrën se si gjykimet dhe arsyetimet lidhen midis tyre (koherenca); në diskutimet e shkruara apo të folura, shpreh idetë dhe argumenton qëndrimet e tij; përkujdeset që të shkruaj e të folë në mënyrë të drejtë duke respektuar normën gjuhësore pa bërë ndonjë digresion (shmangie) nga rregullat; shfaq përjetimin dhe përshtypjet e tij rreth pjesës letrare ose artistike; rrëfen tekstin letrar dhe jep një përfundim për të sipas mundësive të tij shprehëse; zbaton rregullat drejtshkrimore etj. 2GJSH.2.3.3. Për të pasur një informim edhe më te gjerë, pra për ta zhvilluar aftësimin personal dhe për ta arritur përjetimin letrar e estetik, lexon tekste edhe më të ndërlikuara si tekste letraro-artistike, tekste shkencore, tekste nga mediet etj; është i apasionuar pas leximit; zbaton dhe zgjedh strategjitë e përshtatshme të leximit. 2GJSH.2.3.4. Kupton tekstin joletrar; nxjerr thelbin e tij; gjen pjesët e nënkuptueshme, por edhe e shtjellon tekstin në fjalë; gjen idenë kryesore; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste për të kuptuar aspektin domethënës e stilistik; i gjen dhe i analizon motivet dhe figurat, të cilat paraqiten në veprën letrare; interpreton tekstet duke u mbështetur në tekstet e tjera letrare. 2GJSH.2.3.5. Në mënyrë kritike jep vlerësim për tekstin letrar joartistik; ndan faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson neutralitetin (anshmërinë) e autorit; vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit argumentues; prezanton të gjitha informatat dhe faktet e autorit për ato që i thotë. 2GJSH.2.3.6. Vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit joartistik; teksti a është koheziv dhe		

koherent, a janë dhënë idetë qartë dhe saktë; vëren dukuritë stilistike; vëren se sa ndikojnë pjesët e caktuara të tekstit për ta kutpuar atë. 2GJSH.3.3.1. Diskuton për temat komplekse nga gjuha, letërsia dhe kultura; flet për tekstet letrare dhe joletrare duke shfrytëzuar terminologjinë profesionale. 2GJSH.3.2.2. Prezanton në situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë paraqitet me tema nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës; është orator dhe paraqet qëndrimet e tij para auditoriumit me argumente; gjatë ligjërimit përdor fjalë dhe shprehje nga gjuha amtare duke respektuar normën e gjuhës standarde etj. 2GJSH.3.3.3. Shkruan në mënyrë kompozicionale e logjike tekstin profesional me temë nga gjuha dhe letërsia si edhe artikullin gazetaresk. 2GJSH.3.3.4. I mbledh, i shënon dhe në fund i përpunon informacionet nga tekstet letrare joartistike në bazë të rregullave të parapara. 2GJSH.3.3.5. Teksti mendon se ka një strukturë dhe organizim të brendshëm, kuptohet pa vështirësi, lexohet me kënaqësi, pra bart informacionin te lexuesi dhe është i shkruar sipas rregullave të ndërtimit të fjalive dhe të periudhave; 2GJSH.3.3.6. I njeh stilet funksionale të shqipes standarde (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili stili shkencor-teknik, stili juridik-administrativ) dhe të gjitha këto (stile) mund t'i trajtojë sipas veçorive të tyre leksikore. 2GJSH.3.3.7. Në të shkruar, përdor shenjat e pikësimit varësisht nga lloji i fjalive (dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse, urdhërore).		

Fjalët kyçe: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, kultura e gjuhës

Disa përmbajtje mësimore për të cilat mësuesi vlerëson se gjatë vitit ato nuk mund t'i realizojë gjatë orëve të rregullta, mund të planifikohen për përpunim gjatë orëve të mësimit me projekt, orëve në ambient të hapur, si dhe në orët të tjera të mësimit shtues e plotësues dhe në eksione.

UDHËZIME DIDAKTIKO – METODIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Programin e mësimdhënies dhe nxënies të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe përbëhet prej tri fushave/lëmive mësimore: Letërsisë, Gjuhës dhe Kulturës së Gjuhës. Shpërndarja e rekomanduar e

orëve sipas fushave të njihurive është: Letërsi – 36 orë, Gjuhë – 34 orë dhe Kultura e gjuhës – 20 orë. Fondi i përgjithshëm i orëve, në nivelin vjetor, është 90 orë. Të tri fushat e programit të mësimdhënies dhe nxënies janë të ndërlidhura dhe nuk mund të mësohen të ndara dhe pa bashkëpunim ndërmjet njëra – tjetrës.

Programi mësimor dhe mësimor i Gjuhës dhe Letërsisë shqipe bazohet në rezultatet, domethënë në procesin e të mësuarit dhe arritjet e nxënësve. Rezultatet janë një përshkrim i njohurive të integruara, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që nxënësi ndërton, zgjeron dhe thellon nëpër të tri fushat lëndore të kësaj lënde.

I. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

Programi i mësimdhënies dhe mësimit i orientuar në rezultate, mësuesit i jep liri më të madhe krijimi dhe për të menduar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Roli i mësuesit është që mënyrat e ralizimit të studimit dhe mësimit t`ia përshtat nevojave të çdo paraleleje, duke pasur parasysh:përbërjen e paraleles dhe karakteristikat e nxënësve; tekstet dhe materialet tjera të cilat do t`i shfrytëzojë; kushtet teknike, mjetet mësimore dhe mediumet të cilat shkolla i disponon; resurset, mundësitë, si dhe nevojat e mjedisit local ku shkolla gjendet, duke u nisur nga rezultatet e dhëna dhe përmbajtjet, mësuesi fillimisht harton planin e vet vjetor, të quajturin plani global i punës, nga i cili më vonë do të zhvillojëplanet e veta operative. Rezultatet e definuara sipas lëmive i lehtësojnë mësuesit operacionalizimin e mëtejshëm të rezultateve në nivelin e njësive konkrete mësimore. Nga mësusei pritet që për çdo njësi mësimore, në fazën e planifikimit dhe hartimit të përgatitjes për orën e mësimit t`ia përshtatë rezultateve të mësimit. Gjatë planifikimit, gjithashtu, duhet patur parasysh se disa rezultate realizohen më shpejtë e më lehtë, por për pjesën më të madhe të rezultateve (veçanësrisht për fushën lëndore Letërsi) duhet më tepër kohë, më shumë aktivitete të ndryshme dhe punë në shumë tekste të ndryshme. Rezultatet e rekomanduara nuk janë të diferencuar sipas niveleve të të arriturave të nxënësve. Ota paraqesin pjesë obligative të përshkrimit të standardeve dhe mund të imtësohen ose të zgjerohen, në vartësi prej mundësive individuale të nxënësit dhe nevojave të tjera mësimore.

Në fazën e planifikimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies është shumë e rëndësishme të keni parasysh se teksti është një mjet mësimor dhe se nuk përcakton përmbajtjen e lëndës. Për këtë përmbajtjeve të dhëna në tekst është e nevojshme t`i qasemi në mënyrë selektive dhe në raport me rezultatet e parashikuara që duhet të arrihen. Përveç kësaj nxënësit duhet të aftësohen për shfrytëzimin e tekstit, si një nga burimet e njohurive, mësuesi vlen që t`i udhëzojë në mënyrat dhe format e përdorimit të burimeve të tjera të njohurive

II. REALIZIMI I MËSIMIT DHE NXËNIES

LETËRSIA

Boshtin e programit të letërsisë e përbëjnë tekstet nga lektura. Lektura është e ndarë sipas gjinive letrare – lirika, epika, drama dhe e pasuruar me zgjedhjen e teksteve jofikcionale, shkencore – popullore dhe informative. Zgjedhja e veprave në masën më të madhe bazohet në principin e përshtatjes së moshës. Krahas teksteve që duhet përpunuar gjatë orës është dhënë lista e lekturës shtëpiake. Qëllimi i përpunimit të veprës në kuadër të lekturës shtëpiake është formimi, zhvillimi ose kultivimi i shprehive të leximit tek nxënësit. Veprat voluminoze nxënësit mund t`i lexojnë gjatë pushimit, me çka nxitet zhvillimi i vazhdueshëm i shprehisë së leximit. Krahas listës obligative të veprave është dhënë edhe zgjedhja plotësuese e teksteve. Pjesa e zgjedhur i mundëson mësimdhënësit mundësi më të madhe kreativiteti në arritjen e rezultateve.

Me një korpus dominuese të teksteve të shkrimtarëve që mund të ndikojnë në formimin e shijes estetike të nxënësve, ndërton dhe pasuron vetëdijen për natyrës e letërsisë kombëtare (dhe vlerat e klasikëve të letërsisë botërore), por edhe identitetin kulturore dhe kombëtar.

Qëllimi i sjelljes së veprave letrare bashkëkohore është që sipas motivit ose me përkatësisë tematike të tyre lidhen me temat dhe motivet ekzistuese brenda programit mësimor, dhe me shembuj të tillë të tregojë se si shkrimtarët bashkëkohorë i mendojnë traditat epike popullore ose temat e miqësisë, etikës, zhvillimin e imagjinatës dhe empatisë, me çka do të pasurojnë përvojën vertikale të leximit të nxënësve dhe modernizon qasjen në mësimdhënie. Përmes një numri veprash letrare të shkrimtarëve bashkëkohorë, nxënësit do të jenë në gjendje të në mënyrë kritike të vlerësojnë poetikën e veprave të tyre.

Zgjedhja e veprave mundëson aplikimin e qasjes së studimit krahasues të të krijimtarisë letrare, me zgjedhjen e niveleve të ndryshme të përpunimit: interpretimit, paraqitjes ose rishikimeve. Dallimet në tërësinë artistike dhe vlerat informative të disa teksteve ndikojnë në zgjidhje përkatëse metodike (përshtatja e leximit të llojit të tekstit, shtrirja e komentimit të tekstit në vartësi nga ndërlikueshmëria e strukturës së tij, lidhja dhe grupimi me përmbajtjet gjegjëse nga fushat tjera lëndore – gramatika, drejtshkrimi dhe kulturë gjuhe dhe të ngjashme.).

Tekstet nga pjesa e programit plotësues duhet t`i shërbejë mësimdhënësit edhe gjatë përpunimit të njësive mësimore nga gramatika, si dhe për përpunim dhe përforcim të përmbajtjeve nga kultura e gjuhës. Veprat të cilat nuk i përpunon mësimdhënësi duhet t`i rekomandojë nxënësve për lexim gjatë kohës së lirë.

Programi i ri bazohet në njohjen e natyrës dhe rolin e veprës letrare, si dhe njohjen e dallimit të teksteve letrare dhe jo letrare, përkatësisht korelaciont të tyre.

Nxënësit duhet të jenë të aftë të dallojnë veçantitë e tekstit letrar (konotacionin, veprimet letrare, denotativitetit, informimin, dhe duke treguar në bazë të fakteve dhe të dhënave në mënyra të ndryshme të teksteve jo letrare. Korelacioni është mundësuar me kombinime adekuate të veprave obligative dhe zgjedhore. I njëjti tekst mund të lidhet me të tjerët në mënyra të ndryshme, sipas motiveve të ndryshme ose tonit të rrëfimit, në kuadër të mësimit me projekt, që bazohet në rezultate, kurse jo në përmbajtjet mësimore.

Tekstet e propozura obligative, letrare, shkencore – popullore dhe informative dhe përmbajtja e lekturës shtëpiake obligative, si dhe shembujt nga zgjedhja plotësuese, me rastin e planifikimit të planit vjetor të punës, dhe pastaj edhe gjatë formësimit të planeve të punës orientuese mujore, mund të ledhen tamatikisht.

Nga lista e zgjedhjes plotësuese mësimdhënësi zgjedh oto vepra të cilat, me pjesën obigative të lekturës, përbëjnë tërësitë tematike – motivuese. Mësimdhënësi mund t`i grupojë sipas gjinisë veprat nga programi obligativ dhe plotësues në mënyra të ndryshme. Shembujt e mundshëm të lidhjes funksionale të njësive mësimore mund të jenë këto (në asnjë mënyrë të vetme).

GJUHA

Në mësimin e gjuhës nxënësit aftësohen të komunikojnë të drejtë me gojë e me shkrim në gjuhën standarde shqipe. Nga kjo kërkesat në këtë program nuk janë të drejtuar vetëm në përvetësimin e rregullave gjuhësore dhe normës gramatikore, por edhe në kuptimin e funksioneve të tyre dhe zbatimin e drejtë në të shprehurit me gojë e me shkrim.

Kur në përmbajtjet e programit jepen njësi mësimore, të cilat nxënësit i kanë përpunuar edhe më herët, kuptohet se shkalla e përvetësimit dhe aftësimit të zbatimit të lëndës së përpunuar më herët verifikohet, kurse përsëritja dhe ushtrimi në këta shembuj i paraprin përpunimit të përmbajtjeve të reja, me çka sigurohet kontuiniteti i punës dhe sistematizimit në lidhjen e materialit të ri me njohuritë ekzistuese.

Granmatika

Kërkesa themelore programore në mësimin e gramatikës është që nxënësve gjuha t`i paraqitet dhe t`i shpjegohet si sistem. Asnjë dukuri gjuhësore nuk duhet të studiohet dhe shpjegohet e izoluar, jashtë kontekstit në cilin realizohet funksioni i saj (në secilin rast të përshtatshëm mund të vendosen në funksion, njohuritë nga gramatike, në shpjegimin e tekstit, si atij artistik edhe atij shkencor – popullor). Një nga veprimet e veçanta funksionale në mësimin e gramatikës është ushtrimet e bazuara në shfrytëzimin e shembujve nga praktika e drejtpërdrejtë e të folurit, çka mësimin e gramatikës ia ofron nevojave jetësore, në të cilat paraqitet gjuha e aplikuar si aktivitet i motivuar dhe i gjithanshëm i aktivitetit njerëzor

Në këtë mënyrë tek nxënësi zhvillohet edhe vetëdija e rëndësisë së kulturës e të folurit, e cila është e domosdoshem në jetën e përditshemsi pjesë e kulturës së përgjithshme, e jo vetëm si pjesë e programit mësimor.

Mësimi i morfologjisë nënkupton rrumbullakësimin e e njohurive për ndërtimin e formave foljore. Është e domosdoshme lidhja e përmbajtjeve të reja me mësimet e punuara në klasat e më hershme, prandaj me shikimin e të gjitha formave foljore të përpunuara të bëhet nj[sintezë dhe të ndahen të gjitha format e foljeve fillimisht në vetore dhe pavetore dhe pastaj format e foljeve vetore në kohë dhe mënyra. Gjithashtu, është e nevojshme të theksohet edhe ndarja e të gjitha formave të foljeve në të thjeshta dhe të përbëra. Përdorimin e mbiemrit pasiv të foljes duhet shpjeguar me shembujt më tipik të konstruksioneve pasive. Duhet sistematizuar llojet e fjalëve duke përvetësuar përmbajtje të reja si: lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat.

Mësimi i sintaksës nënkupton sjellja e shprehjes së sintagmës dhe njohjen e gjymtyrës kryesore dhe të varur në kuadër të saj. Në shembujt e qartë dhe të pakontestueshëm nxënësit nëpërmjet ushtrimeve dallojnë gjymtyrënkryesore dhe të varur si dhe llojin e sintagmës. Futet atributi edhe atë si sintagmor, e jo si gjymtyrë e fjalisë. Është e rëndësishme të thaksohet se cilat lloje të fjalëve paraqiten në kuadër të atributit. Në klasat e më hershme është përpunuar subjekti gramatikor, kurse tani futet edhe shprehja e subjektit logjik.

Drejtshkrimi

Përmbajtjet nga drejtshkrimi është e domosdoshme të lidhen me temat përkatëse edhe në orët e gramatikës edhe në ato të letërsisë. Për shembull. Kur përpunohet ndërtimi i formave të foljeve, duhet

përpunuar edhe zgjidhjet drejtshkrimore të foljeve në lidhje me drejtshkrimin e formave të foljes. Në lidheje me përvetësimin e tipave të fjalisë është e nevojshem të përpunhen edhe pikësimi, para së gjithash presjen si shenja më të rëndësishme të pikësimit. Duhet të jepen qartë rregullat kur duhet të shkruhet presja, dhe kur presja është shenjë jo e domosdoshme ose veçori e stilit. Lidhja e përmbajtjeve nga gramatika dhe letërsia bëhet me analizimin e përdorimit të presjes në fjalitë e ndara dhe dallimin e përdorimit të presjes në veprat letrare. Në pika të shkurta duhet theksuar në specifikat e stilit artistiko – letrar, ku mdonjherë si rezultat i kreativitetit të shkrimtarit me qëllim nuk zbatohen rregulat e drejtshkrimit (veçanërisht në poezi). Kombinimi i shenjave të drejtshkrimit miratohet që në klasat e më hershme në lidhje të folurit e drejtuar, por edhe tani theksohet në llojet tjera të shenjave drejtshkrimore të kombinuara, para së gjithash në përdorimin e presjes pas shkurtesave dhe numrave rendor. Shkrimi i shkurtesave ka të bëjë me përsëritjen e asaj që është mësuar në lidhje me shkurtesat, por edhe në zgjerimin e llojeve të shkurtesave të cilat theksohen në drejtshkrimin që është në fuqi.

Rregullat e drejtshkrimit miratohen me anë të ushtrimeve sistematike (diktimeve drejtshkrimore, përmirësimit të gabimeve në tekstin e dhënë, testeve me pyetje nga drejtshkrimi etj.). gjithashtu duhet nxitur nxënësit që vet të dallojnë dhe përmirësojnë gabimet drejtshkrimore gjatë komunikimitme SMS, si dhe në llojet e ndryshme të komunikimit nëpërmjet internetit. . Pos kësaj, nxënësit duhet udhëzuar në shërbimin e drejtshkrimit dhe të fjalorit të drejtshkrimit (botim shkolle). Është e preferueshme që mësimdhënësi të sjellë në orë ekzemplar të Drejtshkrimit sa herë që përpunohen tema të drejtshkrimit (kështu do të mund që individualisht nxënësve t`i japë të gjejnë fjal[në fjalorin drejtshkrimor dhe të përcaktojnë formën e rregullt të saj ose shkrimin e drejtë).

Drejtshqiptimi

Ushtrimet drejtshqiptimore nuk duhet realizuar si njësi të veçanta mësimore, por përmes temave përkatëse nga gramatika, por edhe në orët nga letërsia. Në këtë nivel nxënësit duhet të dallojnë dallimet ndërmjet theksit zbritës dhe atij ngjitës dhe t`i shënojnë drejtë të theksat në shembujt tipik. Nëse për këtë ekzistojnë kushtet, mësimdhënësi duhet të lëshojë incizime të drejtshqiptimit dhe t`i tregojë dallimet në shqiptim. Nxënësit duhet mësuar të njohin, riprodhojnë dhe përvetësojnë të folurit e theksuar, kurse në vendet ku shmangemi nga norma e theksimit të dallojnë theksin standard nga theksi i vet, ose nga theksimi dialektor.

KULTURA E GJUHËS

Një nga detyrat themelore të mësimit të kulturës së gjuhës ka të bëjë përvetësimin e mjeteve të shprehjeve gjuhësore tek nxënësit, kurse qëllimi i fundit është që nxënësit të aftësohen në vendosjen e cislësisë dhe të komunikimit kuptimplotë. Edhe pse fusha e kulturës gjuhësore është e konstituar si hapësirë e veçantë programore, është parashikuar në mësimin e tërësishëm të gjuhës dhe letërsisë shqipe të lidhet edhe me dy fushat e tjera letërsinë dhe gjuhën. Fusha Kulturë gjuhe përfshinë të shprehurit me gojë dhe meshkrim. Me ç`rast duhet kushtuar kujdes të njejtë të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

Në këtë moshë duhet shqyrtuar specifikat e dy stileve funksionale, atij letraro – artistik dhe publicistik.

Nxënësit duhet të inkurajohen që në tekstin e dhënë, të përzier dhe të kreuar me dedikim të gjejnë dhe të radhisin fjalitë duke pasur parasysh se a i përkasin stilit letraro – artistik apo atij publicistik. Pastaj, të gjejnë fjalinë e shkruar në tekst në stilin publicistik, i cili është shkruar në stilin letraro – artistik dhe anasjelltas. Duhet të shpjegojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet dy stileve funksionale, të zhvillojnë aftësitë e kuptimit të veçorive të tyre.

Koherenca paraqet një shenjë të rëndësishme të strukturës tekstuale dhe udhëzohet në karakterin kontinuitiv të ndonjë teksti. Nga kjo në mësmin e kulturës gjuhësore duhet aftësuar nxënësit që në formë gojore dhe me shkrim të koncipojnë përbërjet sipas drejtimeve të cila do t`u jenë dhënë. Për shembull, duhet të hartojnë tekste të menduara logjike në bazë të fjalëve të dhëna të cilat fjalë duhet patjetër t`i përdorin; të hartojnë tekste gjatësia e të cilëve do të jetë e kufizuar (numri i kufizuar i fjalëve); që në tekstin që e hartojnë të përdorin kryesisht modele të caktuara gramatikore ose të leksikun e caktuar. Gjithashtu, duhet inkurajuar të mendojnë disa fillime të ndryshme të tekstevenë temën e njejtë të dhënë ose të mendojnë disa përfundime të ndryshme me përgatitje të dedikuar dhe sipas tekstit të përshtatshëm të papërfunduar; të ndryshojnë fundin (ose pjesë tjera të përshtatshme) e një shabloni letrar; të vendosin renditje të shthurur kronologjike ose të menduar në tekstin e dhënë dhe ngjashëm.

Një kompetencë shumë e rëndësishme e cila gjendet në baën e shumë niveleve të kuptimit të teksti, është shkathtësia e argumentimit. Duke pasur parasysh që zhvillimi i mendimit të argumentuar ka rol të rëndësishëm në arsim, sepse mund të ndikojë pozitivisht në fitimin e njohurive, gjatë mësimit të kulturës gjuhësore duhet verifikuar deri në ç`masë nxënësit janë në gjendje të kuptojnë

tekstet e argumentuara. Duhet inkurajuar nxënësit që të arsyetojnë me argumente qëndrimin e vet lidhur me situatën problemore në veprën letrare; që me argumente të arsyetojnë qëndrimin e vet eksplicit të paraqitur për dikë, për ata, çështje e rëndësishme.

Një nga format themelore të shprehjes me gojë dhe me shkrim – përshkrimi. Paraqet përmbajtje bazike programore për përsosjen dhe kultivimin e kulturës së duhur gjuhësore të nxënësit. Në këtë moshë nxënësit duhet të shfrytëzojnë të dy llojet e përshkrimit: teknik dhe sugjestiv, përkatësisht duhet aftësuar të përshkruajnë një lëndë, nocion apo qenie të caktuar, fillimisht nëmënyrë objektive (përshkrim teknik), dhe pastaj duke i shprehur përshtypjet e veta (përshkrim sugjestiv). Gjithashtu, duhet inkurajuar të mendojnë paralelisht të dy llojet e përshkrimit të të njëjtit send përshkrimi; të gjejnë elemente e dy përshkrimeve në tekstin e përzier;

Gjatë mësimit të kulturës së gjuhës në këtë moshë duhet tërhequr vëmendjen nxënësve, ndërmjet tjerash, edhe në metodat e paraqitjes së burimeve dhe ideve, si dhe shpjegimeve plotësuese të cilat përdoren në tekst. Duhet inkurajuar të shpjegojnë shkaqet dhe funksionet e citimit; të shpjegojnë situatat problemore të vërejtura në tekstet letrare dhe të tjera me ndihmën e citateve: të komentojnë rëndësin dhe kuptimin e fusnotës së përdorur në shembullin e dhënë; të dallojnë citatet dhe parafrazat në shembujt e dhënë. Gjithashtu, duhet tërhequr vërejtjen në rregullat të cilat ndikojnë në shkrimin numrave të eksponuar me të cilët shënohen fusnotat në fund të fjalisë.

Llojet e ushtrimeve gjuhësore duhet zgjedhur sipas intersimeve të nxënësve ose në kontekst ë përmbajtjes mësimore. Këto mund të jenë: plotësimi i tekstit me forma të ndryshme të fjalëve të ndryshueshme; plotësimi tekstit me fjalë të pandryshueshme; shënimi i fjalive komunikuese në tekst; paraqitja e gjymtrës së fjalisë në mënyra të shumta.

Me zbatimin e ushtrimeve gjuhësore krijohet shprehia që të mendojnë dhe kërkojnë shprehje adekuate për atë që e dëshirojnë ta tregojnë (në vartësi prej situatës së komunikimit) dhe të shtojnë fondin e shprehjeve të trillanë fjalorin e tyre, me theks të veçantë në frazeologjizma dhe shprehje të krijuara (shembujt të meren nga tekstet e përpunuara).

Në çdo gjysmëvjetor punohen nga dy detyra (hartime) me shkrim (gjithsej katër në vit).

Rekomandohet të punohen tetë detyra (hartime) me shkrim (përmbajtje të shkruara).

III. PËRCJELLJA DHE VLERËSIMI I MËSIMIT DHE NXËNIES

Përcjellja dhe vlerësimi i rezultateve të përparimit nxënësit është në funksion të realizimit të rezultateve, kurse fillon me vlerësimin inicial të nivelit të arritur të njohurive, në raport me atë se si do të matet përparimi mëtejshëm dhe si do të formohet notimi. Secila orë mësimore dhe çdo aktivitet i nxënësit është rast për notimin formal të nxënësit, përkatësisht regjistrimi i përparimit të nxënësit dhe udhëzimi për aktivitete të mëtejshme.

Vlerësimi formal është pjeës e qasjes moderne të mësimit dhe nënkupton vlerësimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe sjelljeve si dhe zhvillimin e kompetencave përkatëse gjatë mësimit dhe nxënies. Matja formale nënkupton grumbullimin e të dhënave mbi të arriturat e nxënësit, me ç`rast më shpesh zbatohen këto teknika: realizimi i detyrave praktike, vështrimi dhe regjistrimi i aktiviteteve të nxënësit gjatë mësimit, komunikimii drejtpërdrejtë ndërmjet nxënësit dhe mësimdhënësit, regjistri për çdo nxënës (harta e përparimit) etj. Rezultatet e vlerësimit formal në fund të ciklit mësimor duhet të jenë të paraqitur edhe me notë numerike.

Puna e çdo mësimdhënësi përbëhet nga planifikimi, realizimi, përcjellja dhe vlerësimi. Është e rëndësishme që mësimdhënësi, krahas arritjeve të nxënësit, në vazhdimësi të përcjellë dhe vlerësojë punën e vet. E gjitha që tregohet e mire dhe efikase, mësimdhënësi do ta shfrytëzojë edhe më tej në praktikën e vet mësimore, kurse ajo që vlerësohet si e pamjaftueshëm efektive, duhet të avancohet.

АЛБАНСКИ ЈЕЗИК И КЊИЖЊВНОСТ

1. PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR PËR KLASËN E KATËR TË SHKOLLËS SË MESME – ELEKTEKNIK I KOMPJUTERËVE

Emri i lëndës	**GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE**
Qëllimi	Qëllimi i mësimit të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe është që të përvetësojnë rregullat themelore të gjuhës letrare standarde shqipe me qëllim të përdorimit të drejtë në të folur, në të shkruar dhe gjatë të shprehurit në komunikim; kultivimi i vetëdijes mbi rëndësinë e rolit të gjuhës në ruajtjen e identitetit kombëtar; aftësimin e nxënësit për të komentuar pjesë të zgjedhura letrare dhe vepra të zgjedhura artistike nga letërsia shqipe dhe trashëgimia botërore, me qëllim të kultivimit të traditës dhe kulturës së popullit shqiptar; zhvillimin interkulturor;

	Zhvillimi i aftësisë dhe kulturës së leximit; gjetjes së përvojave dhe ideve letrare; nxitjen dhe vlerësimin e krijimtarisë personale dhe krijimtarisë së të tjerëve; kuptimin e tekstit në kontekste të ndryshme kulturore, ndërkulturore dhe shoqërore.
Klasa	**E KATËR**
Fondi vjetor i orëve	**93 orë**

KOMPETENCAT E PRGJITHSHME LËNDORE

Nxënësi njeh veprat e letërsisë shqipe që i përkasin trashëgimisë kulturore kombëtare dhe korrespondojnë me epokën e saj, njihet me kryeveprat e letërsisë botërore dhe parimet themelore të interpretimit të teksteve letrare. Ai njihet me karakteristikat themelore të komunikimit, rregullat e komunikimit me gojë dhe me shkrim janë të qarta për të. Ai flet dhe shkruan duke respektuar pritjet e normave gjuhësore. Ai krijon një tekst të plotë, të saktë gojor dhe të shkruar, në përputhje me aspektet stilistike, kupton dhe vlerëson në mënyrë kritike atë që ka lexuar, pasuron përgjithmonë fondin e tij leksikor. Ai lexon, përjeton dhe interpreton vepra letrare dhe joletrare. Ai e konsideron të lexuarit si një mjet për të njohur veten dhe botën. Ai gradualisht bëhet lexues, zgjedh leximin sipas shijes së tij, zhvillon nevojën për të përmirësuar kompetencën e tij për të kuptuar tekstin dhe kulturën e të folurit. Ai respekton, ruan me vetëdije gjuhën e tij amtare.

Niveli bazë

Nxënësi flet qartë dhe rrjedhshëm, respekton normat gjuhësore, dëgjon me kujdes dhe me respekt mendimet e të tjerëve. Përbën një tekst të plotë, gjuhësor dhe stilistik, të formuar mirë, më të shkurtër, më të thjeshtë me gojë ose me shkrim. Miraton zakone zyrtare dhe informale të shkrim-leximit në praktikë. Ai kupton tekste letrare dhe joletrare më të shkurtra, më të thjeshta, të ndërlidhura dhe rishikon në mënyrë kritike përmbajtjen e tyre. Gradualisht ai ndërtoi fondin e tij poetik leksikor.

Nxënësi ka njohuri themelore për gjuhën, faktorët dhe funksionet e komunikimit, njeh shtresat gjuhësore dhe dallon variantet gjuhësore. Ai mëson bazat e fonetikës, fjalorit dhe sintaksës së gjuhës shqipe, dhe është në gjendje të zbatojë rregulla gramatikore në të folur dhe shkrim. Përvetëson njohuri themelore të tekstologjisë dhe stilistikës.

Nxënësi pasuron vazhdimisht fondin e tij leksikor, dhe prej tij, sipas situatës, ai zgjedh dhe përdor shprehje të përshtatshme. Ata zhvillojnë një nevojë natyrore për të mësuar, ruajtur dhe ushqyer gjuhën e tyre amtare.

Nxënësi i njeh veprat letrare të përcaktuara nga kurrikula, dhe është në gjendje t'i vendosë ato sipas opusit të autorit dhe kontekstit letrar-historik. Ai dallon qartë karakteristikat themelore poetike dhe stilistike të epokave stilistike dhe drejtimeve të letërsisë shqiptare dhe botërore. Njoh karakteristikat gjuhësore, kompozicionale dhe stilistike të teksteve dhe është në gjendje të përdorë argumente për të argumentuar përfundimet e tyre. Zhvillon zakonet e të lexuarit, mëson rolin e të lexuarit në njohjen e vetvetes.

Nxënësi njihet me përdorimin e manualeve, me rregullat e përdorimit të bibliotekës, merr njohuri për mënyrat e mbledhjes së informacionit përmes Internetit. Ai është i qartë për rregullat e gjuhës elektronike, si dhe sistemin e rregullave të nevojshme për krijimin e dokumenteve elektronike. Përdor fjalorët më të rëndësishëm, rregullat e drejtshkrimit, njeh strukturën e artikullit të fjalorit.

Niveli i mesëm

Nxënësi përballet mirë në situata të ndryshme të komunikimit publik. Ai flet para një audiencë mbi tema gjuhësore, letrare dhe kulturore. Ai gjithashtu paraqet mendimet e tij pikërisht kur harton tekste më komplekse të gjuhës gojore ose të shkruara. Ka një shije të formuar leximi. Ai i kupton dhe interpreton tekstet më të gjata, thjesht të lidhura letrare dhe joletrare gjatë leximit, që synojnë të fitojnë përvojë dhe me një qëllim shkencor. Ai rishikon në mënyrë kritike tekstet letrare dhe joletrare.

Nxënësi ka një njohuri më të gjerë për karakteristikat e gjuhës, rolin, funksionet dhe ka një njohuri themelore të gjuhëve të botës. Ai menaxhon në botën e mediave masive, njihet me zhanret e mediave. Ai njihet me origjinën e gjuhës shqipe, epokat e saj historike, si dhe historinë e zhvillimit të letërsisë shqipe. Ai e kupton që gjuha jeton në variante, bën dallimin midis dialekteve dhe varianteve gjuhësore shoqërore. Ai ka një njohuri më të gjerë për gramatikën e niveleve të gjuhës (fonetikë, leksikë, sintaksë, tekstologji). Ai analizon tekste të ndryshme bazuar në njohuritë e tij për stilistikën dhe aspektet e klasifikimit të llojeve të teksteve, dhe krijon veprat e tij.

Nxënësi pasuron përgjithmonë fondin e tij leksikor, zbaton njohuritë e tij për gjuhën dhe gramatikën në praktikë, ai mund të shprehet saktësisht, qartë dhe ndryshe.

Nxënësi interpreton me vetëbesim temën, mesazhin e teksteve letrare, karakteristikat e tyre kompozicionale, poetike, stilistike, gjuhësore dhe zhanre. Ai i njeh konceptet e teorisë letrare dhe i zbaton ato kur interpreton veprat letrare. Lexon tekste me mirëkuptim. Në mënyrë të pavarur njeh dhe analizon çështjet themelore të veprave letrare, shpjegon mendimin e tij me argumente bindëse. Njoh natyrën dhe karakteristikat e lidhjeve midis letërsisë dhe arteve të tjera.

Nxënësi është i njohur me rregullat në lidhje me përdorimin e bibliotekës dhe manualeve, d.m.th. Internetit për të mbledhur informacion. Mund të përdorë një program për përpunimin e fjalëve për të hartuar një tekst që përputhet me rregullat e drejtshkrimit.

Niveli i avancuar

Nxënësi përvetëson aftësinë për të diskutuar tema komplekse letrare, kulturore dhe gjuhësore të përcaktuara nga materiali mësimor. Ai ka një aftësi të zhvilluar për retorikë. Ai krijon tekste profesionale në të cilat merret me tema gjuhësore dhe letrare.

Zhvillon aftësinë për të lexuar dhe interpretuar tekste, me vetëdije ushqen rolin pritës (lexues). Ai zhvillon një qasje kritike, të udhëhequr nga mendimi i tij dhe kur interpreton tekste më të ndërlikuara letrare dhe joletrare. Ajo njeh tiparet kompozicionale dhe stilistike të teksteve me siguri. Përveç leximit të detyrueshëm në shtëpi, ai mund të interpretojë edhe tekste që ai zgjedh vetë. Kur prezanton mendimin e tij, ai aplikon teknikën e argumentimit të pjekur. Ai bëhet një lexues i rregullt, duke përshtatur strategjitë e leximit me karakteristikat e një vepre të caktuar letrare dhe qëllimet e leximit (përvoja, kërkimi, krijimi). Ai është në gjendje të përdorë në mënyrë të pavarur njohuritë e tij për lidhjen midis degëve të ndryshme të artit për të zbuluar lidhje intermediative.

Ai ka njohuri të gjera për gjuhën dhe sistemin e gjuhës shqipe, si dhe zhanret e vjetër dhe të rinj të komunikimit. Njeh dhe krahason karakteristikat poetike, kompozicionale dhe stilistike të teksteve. Ai zbaton njohuritë teorike të marra në lidhje me mjetet gjuhësore të shtresave stilistike në praktikë (kur analizon dhe krijon tekste). Ai njihet me drejtimet e gjuhësisë moderne dhe i vë njohuritë e marra në një kontekst ndërdisiplinor. Ndërsa mëson karakteristikat pragmatike të tekstit, kështu që akti i funksionimit të gjuhës i zbulohet atij, hapen mundësi të shumta për të analizuar kuptimin e tekstit.

Ai administron bibliotekën, manualet dhe internetin me siguri. Kur interpreton vepra letrare, ai rregullisht përdor letërsi më të gjerë profesionale. Duke pasur parasysh rregullat etike në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit, ai krijon veprat e tij duke përdorur përparësitë dhe mjetet e mediave dixhitale. Ai zbaton një sistem rregullash të nevojshme për krijimin e dokumenteve elektronike, në përputhje me rregullat gjuhësore të dokumenteve elektronike.

Studenti ka një njohuri të gjerë për karakteristikat e përgjithshme të gjuhës, funksionet e tij dhe sistemin e gjuhës shqipe (rreth niveleve të ndryshme të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji). Duke pasur njohuri për tekstologjinë, ai është në gjendje të vartësojë faktorët e botës tekstuale në aspektet e përpunimit të tekstit. Ai fiton njohuri në drejtimet e gjuhësisë moderne, dhe zbaton njohuritë e marra gjatë përpilimit të punimeve të projektit të tij. Kupton natyrën e marrëdhënies midis gjuhësisë dhe fushave të tjera shkencore.

KOMPETENCA E VEÇANTA Gjuha shqipe dhe komunikimi

Niveli bazë

Nx[nësi përvetëson njohuri për rolin themelor të gjuhës, karakteristikat dhe funksionet e tij komunikuese. Ai tregon respekt për gjuhën e tij amtare, si dhe gjuhën dhe kulturën e popujve të tjerë. Në nivelin bazë, ai zotëron sistemin e gjuhës shqipe (gramatika e niveleve të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji).

Nxënësi gjendet mirë në nivele më të ulëta të tekstit, përvetëson njohuri për fonetikë, dallon llojet e fjalëve, njeh sistemin morfologjik të gjuhës shqipe. Ai është në gjendje të formulojë në mënyrë të pavarur mendimet e tij, në përputhje me normat gjuhësore, fjalitë e qarta dhe të sakta dhe të analizojë fjalitë në një nivel bazë. Përvetëson njohuri për marrëdhëniet midis shenjës dhe kuptimit, njihet me zhvillimin historik të gjuhës shqipe.

Njoftohet me karakteristikat e përgjithshme të tekstit, shtresat stilistike, konceptet themelore të stilistikës, llojet e teksteve. Mund të përcaktojë elementet e teksteve të shkurtra (temën, titullin, analizën, paragrafët), njeh forcën lidhëse, elementët lidhës të tekstit.

Ai mëson rregullat e shqiptimit të saktë, mjetet e shprehjes gjuhësore të kultivuar. Në mënyrë ekspresive dhe besnike, ai rrëfen fragmente më të shkurtër tekstesh, memorizuesish, në origjinal.

Përdor fjalorët më të rëndësishëm të gjuhës shqipe, rregullat e drejtshkrimit dhe fiton përvojë në mbledhjen e informacionit nga Interneti. Miraton rregullat e sjelljes së gjuhës dhe rregullat etike të

komunikimit në internet. Ai me edukatë dhe argumentim shpreh mendimin e tij në debate mbi temën nga materiali mësimor dhe çështje nga jeta e përditshme.

Ai e ndërton strategjinë e tij të diskutimit në paraqitjen e argumenteve në një mënyrë logjike dhe të dëgjojë me kujdes mendimet e njerëzve të tjerë. Mund të përdor llojet themelore të teksteve të shkruara joformale dhe formale (lutjet, CV, letër motivuese, ankesë), si dhe programe kompjuterike dhe teknika prezantimi. Në fund të shkollimit, ai shkruan një punim diplome, duke respektuar kërkesat tematike, stilistike dhe kompozicionale në lidhje me shkrimin e një punimi profesional.

Niveli i mesëm

Nxënësi tregon njohuri më të plota të veçorive të sistemit gjuhësor. Nocioni i farefisnisë së gjuhëve është i qartë për të, ashtu si dhe sistemi i marrëdhënieve të farefisnisë midis gjuhëve. Di dhe zbaton në shprehjen e rregullave të shqiptimit të saktë dhe mjeteve të të folurit të kultivuar. Gjatë leximit me zë të lartë dhe interpretimit të teksteve letrare, si dhe në situata të komunikimit të përditshëm, ai krijon prodhimin e tij në bazë të njohurive për mjetet e fonetikës së tekstit. Di dhe zbaton rregullat themelore të drejtshkrimit.

Nxënësi zhvillon një kuptim të konceptit të integritetit të sistemit gjuhësor. Ai ka një njohuri më të plotë mbi sistemin e llojit të fjalëve dhe strukturën e fjalive. Duke përdorur aftësinë për të analizuar me siguri, ai përdor sistemin morfologjik të gjuhës amtare, njeh pjesë të një fjalie dhe i analizon duke përdorur modele të përshtatshme të fjalive.

Njeh tiparet stilistike të llojeve dhe zhanreve të ndryshëm të teksteve, si dhe mjeteve stilistike. Ai është i sigurt në temën e komunikimit masiv, njihet me zhanret e mediave.

Ai lexon në mënyrë ekspresive, pasuron fondin e tij leksikor, në situata të ndryshme të të folurit ai shprehet në përputhje me rrethanat komunikuese, dhe në shprehjen e folur dhe të shkruar përdor elemente të përshtatshme të fjalorit.

Informohet nga burime të shtypura dhe elektronike. Ai mund të hartojë lloje më të ndërlikuara të teksteve, ai shprehet saktësisht dhe qartë. Në mënyrë të pavarur përgatit letra për tema të ndryshme.

Niveli i avancuar

Nxënësi ka një njohuri më të gjerë për karakteristikat e përgjithshme të gjuhës, funksionet e saj dhe sistemin e gjuhës shqipe (rreth niveleve të ndryshme të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji). Duke pasur njohuri për tekstologjinë, ai është në gjendje t`i vartësojë faktorët e botës tekstuale në aspektet e përpunimit të tekstit. Ai i di karakteristikat formale të përmbajtjes së zhanreve të reja të komunikimit dhe llojeve të teksteve në internet, dhe në mënyrë të pavarur formon një mendim rreth tyre.

Tiparet pragmatike të tekstit janë të qarta për të. Fiton njohuri në drejtimet e gjuhësisë moderne, zbaton njohuritë e tij gjatë përpilimit të dokumenteve të projektit. Njoh natyrën e lidhjeve midis gjuhësisë dhe fushave të tjera shkencore.

Duke aplikuar njohuri për retorikën, ai është në gjendje të krijojë dhe të paraqesë një tekst argumentues bindës, duke përdorur me vetëdije mjete gjuhësore dhe jo-gjuhësore të interpretimit të tekstit, duke marrë parasysh pritjet e dëgjuesve. Krijon dhe interpreton tekste të ndryshme profesionale, gazetare dhe letrare, duke mbajtur në vëmendje shkallën e krijimit të tekstit, në një stil që i përgjigjet situatës së të folurit dhe zhanrit, duke aplikuar elementet e duhura të lidhjes.

Ai është në gjendje të kryejë punë kërkimore në bibliotekë, mbledh në mënyrë të pavarur dhe klasifikon informacione me qëllim të punimeve të shkruara, paraqitjeve dhe eseve, në të cilat ai paraqet mënyrën e tij individuale të të gjykuarit.

KOMPETENCAT E VEÇANTA: Letërsia

Niveli bazë

Lexon qartë dhe rrjedhshëm. Ai është në gjendje të lexojë tekste letrare dhe joletrare, kupton dhe parafrazon tekste të shkurta letrare të thjeshta. Ai është në gjendje të përmbledhë temën e një vepre letrare, dallon informacionin e kërkuar në një tekst jo letrar. Ai i njeh veprat letrare të përcaktuara me planin dhe programin mësimor, krijimtarin e autorëve dhe karakteristikat më të rëndësishme përmbajtësosoro-formale të epokave letrare. Dallon letërsinë gojore nga ajo e shkruar. Ai i di karakteristikat e poezisë popullore dhe autoritare, si dhe lidhjen e tyre. Njeh tiparet formale, stilistike dhe zhanre të veprave letrare, është në gjendje të formulojë temën dhe karakteristikat e botës së tyre tekstuale. Interpreton pyetje që lidhen me tekste letrare të thjeshta. Ai e kupton rëndësinë e leximit për zhvillimin e personalitetit të tij dhe fondit leksikor. Kur shpreh përshtypjet dhe konkluzionet e tij, ai i referohet shembujve nga tekstet letrare dhe joletrare. Ai mund të bëjë dallimin midis përmbajtjes letrare dhe asaj transmetuese, metaforike. Mund të përcaktojë vendin e letërsisë në sistemin e artit (muzikë, film, arte të bukura, teatër, etj.). Përvetëson njohuri ndërdisiplinore.

Niveli i ndërmjetëm

Njeh strategjitë themelore të leximit dhe di si t'i përdorë ato në situata të dhëna leximi. Ai përdor më shumë këndvështrime në interpretimin e tij dhe i konsideron në mënyrë kritike tekste të gjata, të thjeshta letrare dhe joletrare. Duke përdorur njohuritë e marra sipas programit mësimor, ai interpreton dhe dallon elementet të rëndësishme të përbërjes dhe shtresave të kuptimit të një vepre letrare, karakteristikat stilistike, gjuhësore dhe formale të saj. Ai i njeh konceptet themelore letrare, teoriko – letrare, termat, dhe kur interpreton veprat letrare i përdor ato në harmoni me qëllimin. Në mënyrë të pavarur analizon çështje që lidhen me veprat letrare, argumenton gjykimin e tij për to. Ai është në gjendje të zbulojë lidhje midis veprave të ndryshme letrare, epokave dhe drejtimeve stilistike. Zbulon lidhjet intertekstuale dhe ndërdisiplinore midis veprave letrare. Kupton dhe vlerëson lidhjen midis letërsisë dhe arteve të tjera. Merr një qëndrim të qartë ndaj tekstit të lexuar. Ai zgjedh në mënyrë të pavarur veprat për të lexuar nga vargu i letërsisë, i përshtatshëm për moshën e tij. Vë në dukje kureshtjen e lexuesit. Kupton rëndësinë e leximit për zhvillimin e kulturës dhe njohurive të tij të përgjithshme. Në mënyrë eksploruese dhe krijuese, ai përvetëson një aftësi leximi që mund ta përdorë, gjatë studimit të veprave dhe zhanreve të ndryshme letrare, me ndihmën e të cilave mund të zhvillojë identitetin e tij letrar, gjuhësor, kulturor dhe kombëtar.

Niveli i avancuar

Me dëshirë, kureshtje hulumtuese dhe mënyrë kritike lexon, interpretojë dhe vlerëson tekste komplekse letrare dhe joletrare të rekomanduara nga programi mësimor, por gjithashtu kënaqësi liston dhe interpreton si veprat e rekomanduara dhe ato të zgjedhura në mënyrë të pavarur. Në mënyrë të pavarur vëren dhe interpreton çështje që trajtohen në veprat letrare. Ai përdor disa këndvështrime kur interpreton vepra letrare, ai është në gjendje t'i vendosë ato në një kontekst të ndërmjetëm ndërdisiplinor: lidh ato me degë të tjera artistike dhe fusha shkencore. Ai përvetëson aftësinë e krahasimit të tipareve të shquara tematike dhe formale – stilistike të veprave letrare. Ai përvetëson një teknikë të zhvilluar të argumentimit kur shpreh mendimin e tij mbi tekstin dhe përfundimet e tij. Kur interpreton vepra letrare të përcaktuara nga programi mësimor, ai hulumton tërësisht letërsinë profesionale të shkruar dhe elektronike. Zbaton strategjitë e leximit në përputhje me detyrën e leximit. Ai përvetëson një kulturë të zhvilluar leximi, leximi i një vepre letrare është një përvojë për të. Përmes leximit, ai pasuron njohuritë e tij, fondin leksikor, zhvillon aftësinë e argumentimit, di të shprehë mendimin e tij, di të mbrojë pozicionin e tij. Ai mund t'u rekomandojë vepra letrare të tjerëve dhe të shpjegojë zgjedhjen e tij. Ai tregon respekt për vlerat e letërsisë dhe kulturës kombëtare dhe për kulturën e kombeve të tjera. Ai pasuron njohuritë e tij ndërkulturore duke u njohur me përkthimet e veprave letrare të huaja dhe kontaktet me kombet e tjera. Ai aplikon një aspekt kritik kur zgjedh midis burimeve të letërsisë profesionale në lidhje me veprat letrare në internet, ai u jep përparësi revistave cilësore.

Rezultatet e mëposhtme përshkruajnë atë që nxënësi e di dhe është në gjendje ta bëjë në **nivelin themelo**r të çdo fushë të njohurive.

GJUHA DHE LETËRSIA SHQIPE

(Klasa e katër)

Standardet e përgjithshme të arritjeve – Standardet arsimore për përfundimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për lëndën Gjuhë dhe Letërsi shqipe përmbajnë standarde e arritjeve për fushat: Gjuha, Letërsia dhe Kultura e Gjuhës. Brenda secilës fushë/temë, janë përshkruar kërkesat në tre nivele.

Standardet e përgjithshme të arritjeve – standardet arsimore për fund të arsimit të mesëm për lëndën e dhe Letërsisë shqipe:	**REZULTATET** Nxënësi është në gjendje që:	**PËRMBAJTJA**
2GJSH.1.1.1. Posedon njohuritë elementare për gjuhën (ç'është gjuha, si funksionon, veçoritë e saj) etj. Respekton gjuhën e tij dhe gjuhën e të tjerëve; përdor fjalë (shprehje) stereotipe për gjuhën. E di nocionin e tekstit dhe dallon pjesët e tij (hyrjen, pjesën kryesore, përmbajtjen, përfundiminfundin), po	• zotëron njohuri gramatikore dhe leksikore që mundësojnë nivele të larta arritjeje në lexim-shkrim; • analizon ndryshimet mes gjuhës së folur dhe të shkruar, mes	**– Teksti** – Teksti përshkrues – Teksti rrëfyes, bindës – Kronika – Reportazhi – Autobiografia

ashtu dallon llojet e teksteve (varësisht nga diskursi). Ka njohuri për sociolinguistikën sidomos për njëgjuhësinë (monolinguizmin) dhe shumëgjuhësisë (polilinguizmin) dhe njeh rastet gjegjëse gjuhësore në Shqipëri, Kosovë, Mqedoni, Serbi…). E di konceptin e varietetit gjuhësor dhe njeh varietete themelore të gjuhës. 2GJSH.1.1.2. Dallon gjuhën letrare (standarde) nga dialekti; e di ndarjen dialektore të gjuhës shqipe; ka njohuri për dialektin e tij dhe për dialektin tjetër të gjuhës shqipe si dhe për të folmet e tjera dhe kështu përdor fjalë apo shprehje nga e folmja e tij, nganjëherë edhe nga e folmja e palës tjetër, por gjithmonë është konservator ndaj varietetit gjuhësor së cilës i përket. Me shembuj mund t'i paraqes veçoritë që i dallojnë të dy dialaktet e shqipes (nga aspekti fonetik, gramatikor e leksikor) dhe kështu mund ta mësojë, ta ruaj e ta kultivojë edhe më shumë gjuhën letrare. Njeh gramatikat kryesore dhe librat normativë të shqipes, të cilat i përdor në situata të caktuara. E di që gjuha shqipe zë një vend të rëndësishëm në rrethin e gjuhëve indoevropiane, duke pasur një traditë të gjatë të të folurit dhe të shkruarit dhe kjo ka po ashtu një rëndësi të madhe për kulturën shqiptare. Ka njohuri për etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, fillimet e shkrimit të shqipes dhe rregullat e drejtshkrimit. 2GJSH.1.1.3. E di nocionin e theksit. Në fjali mund t'i dallojë llojet e theksave (theks i lirë, dinamik, ritmik, logjik, i fjalisë). Mund t'i ndajë tingujt në: tinguj zanorë dhe bashkëtingëllorë dhe i bashkon në formimin e fjalëve duke i dhënë kuptim atyre. Kur shqipton me zë më të fortë ose me zë më të ngritur një fjalë a një pjesë të fjalisë, mund ta vë rëndësinë kuptimore të saj dhe kështu i heton dallimet eventuale mes akcentit të tij nga ai letrar.	regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve e shtresave leksikore dhe gjuhës standarde; • vlerëson me argumente pasurinë leksikore të gjuhës shqipe; • kërkon materiale ose botime në biblioteka dhe në internet për të gjetur informacionin e nevojshëm për sistemin gjuhësor tëshqipes; • vlerëson zbatimin e rregullave të drejtshkrimit dhe të pikësimit, si të domosdoshme në çdo profesion dhe veprimtari të jetës njerëzore; • përkufizon konceptet "fjalë" e "morfemë" si koncepte gjuhësore; • përcakton llojet e morfemave; • bën dallimin e analizës morfemore dhe analizës fjalëformuese; • liston mënyrat e fjalëformimit të fjalëve; • dallon llojet e prejardhjes mes tyre; • pasuron leksikun e tij me sa më shumë fjalë të përbëra • shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj që kanë *-ia,-ie,-iu,* me **i** të theksuar në trup të tyre; • shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj me *-oo-*; • shkruan drejt fjalët nga latinishtja ose nga gjuhët romane si dhe nga greqishtja; • Klasifikon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra; • Bën tabelën e klasifikimit të tyre;	– Ditari – Letra – Kujtimet – Teksti udhëzues – Rregullat, ligjet – Udhëzuesit, recetat – Teksti argumentues, fjalimet politike, eseja argumentuese, debate – Teksti informues-shpjegues – Leksioni, lajmi – Kryeartikulli, artikulli me komente – Intervista – Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit – Fjalia e thjeshtë dhe e përbërë – Fjalia me bshkërendtije dhe me nënërenditje, skemat – Gjuha dhe komunikimi, stilet, ligjërimet – Eseja dhe llojet e saj.

	• Përcakton tiparet e përbashkëta dhe dallimet; • Rikujton njohuritë rreth lidhëzave; • Klasifikon lidhëzat;	
2GJSH.1.1.4. E di definicionin e fjalës dhe karakteristikat e saj. Njeh njësitë themelore të gjuhës (fonemën, morfemën, fjalën, togfjalëshin dhe fjalinë). Ndan fjalët në njësi më të vogla gjuhësore si p.sh.: fjalët për-pun-oj, kënd-o-j etj, Fjalën mund ta analizoj nga aspekti gramatikor me parashtesa, prapashtesa e mbaresa. Njeh mënyrat elementare të ndërtimit të fjalëve. Fjala si strukturë ka dy anë: përmbajtjen dhe formën dhe kështu dallon aspektin leksiko-gramatikor nga ai fonetiko-gramatikor. 2GJSH.1.1.5. Fjalinë e shkruan sipas rregullave gramatikore; mund t'i klasifikojë njësitë sintaksore; dallon fjalitë pohore dhe mohore; analizon fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra. 2GJSH.1.1.6. Ka një fond leksikor, i cili i përmbush nevojat në nivelin e mesëm të arsimimit; bën dallimin mes leksikut letrar dhe joletrar dhe i përdor sipas situatës së krijuar; ka njohuri për domethënien e fjalës; njeh grupet (paradigmat) e fjalëve: sinonimet, antonimet, homonimet; njeh metaforën si mekanizëm leksikor. Nëse ndonjë fjalë ka prejardhje të huaj, e përdorë dhe nuk ndien ndonjë "armiqësi" ndaj saj. Por, nganjëherë bën edhe kritika për shkak të futjes së saj në strukturën e shqipes. Njeh nocionin e frazeologjisë. Përdor fjalorët e gjuhës shqipe (Fjalorin drejtshkrimor, frazeologjik, sinonimik) etj. 2GJSH.2.1.1. Ka njohuri më të thella për gjuhën në krahasim me nivelin fillestar; Njeh njësitë, të cilat i përkasin niveleve të ndryshme të gjuhës, pra nënsistemet; Ka njohuri për shkrimin e letrave. Tashmë njeh parimet kryesore të gjuhës shqipe si parimin fonetik, morfologjik, etimologjik etj.; I di disa gjëra elementare për gjuhët e botës (ngjajshmëritë gjuhësore,		

përbashkësitë (universaliet) gjuhësore; I njeh parimet e zhvillimit të dialogut; kupton nocionin e aktit të të folurit; në tekst dallon pjesëzat dëftuese apo deiksin; Njeh varietetet gjuhësore të shqipes gjatë paraqitjes së një moderatori në medie kur ai flet në vernakularin gjuhësor – krahinor, pra nëse përdor ndonjë fjalë apo shprehje nga rajoni i tij. 2GJSH.2.1.2. I di tiparet dalluese të të dy dialekteve të gjuhës shqipe; P.sh.: në sistemin fonetik për gegërishten është karakteristike seria e zanoreve hundore kurse në toskërishte ka vetëm zanore gojore (hĩ-ni, rê-ja, zã-ni-gegërishte dhe hi-ri, re-ja, zë-ri- toskërishtja); toskërishtja ka **"ë"** në serinë e zanoreve të theksuara kurse gegërishtja nuk e ka, pra ajo i përgjigjet toskërishtes me **ã**; gegërishtja ka grupin nistor **vo** kurse toskërishtja ka grupin **va** (vaj, varr, vatër-toskërishtja., dhe voj, vorr, votër-gegërishtja) etj.; Në toskërishte ruhen grupet **mb, nd, ng** ndërkaq në gegërishte kanë dhënë **m, n, n**; Po ashtu e di se këto dialekte veçohen edhe nga tiparet morfologjike e leksikore; Mund t'i rirendis etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, të cilat janë të njohura edhe më parë; 2GJSH.2.1.3. Njeh aparatin e të folurit dhe mënyrën se si prodhohen tingujt; dallon tingujt sipas pikëpamjes së artikulimit; e jep definicionin për fonemën; bën ndarjen fonetike të të folurit dhe në një frazë apo sintagmë spikat llojin e theksit (theks logjik, emfatik apo emocional) dhe kështu në mënyrë të drejtë mund ta shqiptojë fjalën në njësitë e lartëpërmenduara; njeh mekanizmat e ndryshimit të tingujve (ndryshimet kombinatore) siç janë: asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat e tingujve (proteza, epenteza, epiteza), rëniet e tingujve (afereza, sinkopa, apokopa). 2GJSH.2.1.4. Ka njohuri të gjera për fjalën dhe veçoritë e saj; e di se forma e fjlaës është fonetiko-gramatikore sepse përbëhet nga elemente fonetike e gramtikore duke e paraqitur me shembull si bie fjala:		

emri *vëlla-i* ka tingujt e nyjëtuar *v-ë-ll-a-i* dhe temën fjalëformuese *vëlla-* dhe mbaresën *–i*, e cila tregon gjininë, numrin, rasën e trajtën e emrit; e njeh termin morfemë; ndan apo zbërthen fjalën në morfema si p.sh.: mal-or, qytet-ar, hekur-os, lag-a, mal-i, për-dredh, sh-thur etj., dhe në bazë të shembujve dallon morfemat rrënjore, parashtesore e prapashtesore; i di anët kryesore të strukturës së fjalës (përmbajtjen dhe formën); zbaton kriterin theksor (akcentologjik) si kriter dallues i fjalës së një tipari fonetik. 2GJSH.2.1.5. Gjatë procesit të ligjërimit, përdor fjalë duke i bashkuar për ta shprehur e transmetuar mendimin dhe ato (fjalë) duke hyrë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore krijojnë njësi të ndryshme sintaksore; dallon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra; analizon fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme; ka njohuri të gjera rreth sintagmës; klasifikon fjalitë e varura; njeh termin elipsë; i di rasat dhe kategoritë gramatikore të foljes. 2GJSH.2.1.6. Ka fond të pasur leksikor (leksikun individual e të huaj); është i njoftuar për prefiksat e sufiksat që përdoren nga gjuhët e huaja në shqipen; fondin leksikor e shfrytëzon sipas rastit; sipas tij, gjuha është i vemi mjet i komunikimt që shërben për ta shprehur mendimin e tij, por edhe përvojën individuale dhe kështu e pasuron edhe më tepër fjalorin; njeh hiperoniminë, hiponiminë, paroniminë; dallon shtresat leksikore; njeh metaforën dhe metoniminë si mekanizma leksikorë.		
2GJSH.3.1.1. E di që ekziston lidhja e afërt mes gjuhës dhe mendimit dhe e di nocionin e tyre; e jep përkufizimin e fjalisë duke e ditur gjithashtu se ajo ka dy anë: anën kuptimore dhe anën strukturore; dallon kohezionin leksikor dhe gramatikor. 2GJSH.3.1.2. Gjatë ndarjes së fjalëve në rrokje, përdor mjetet		

fonetike për spikatjen e saj (rrokjes) si: gjatësinë dhe forcën. 2GJSH.3.1.3. Ka njohuri për morfologjinë në kuptimin e gjerë të fjalës, në të cilën jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes..; e ndan apo e zbërthen fjalën në morfema duke e dalluar morfemën rrënjë, parashtesore dhe prapeshtesore. 2GJSH.3.1.4. Ka njohuri më të gjera për përdorimin e rasave dhe të formave foljore; mund t'i analizojë fjalitë nga pikëpamja morfologjike (duke i gjetur pjesët e ligjëratës); i njeh tipat e fjalive; dallon kryefjalën, kallëzuesin dhe gjymtyrët e dyta duke i analizuar sintaksorisht. 2GJSH.3.1.5. Ka njohuri themelore për fjalorët dhe për strukturën e tyre.		
2GJSH.1.2.1. Njeh autorët nga programi obligativ shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letraro-historik. 2GJSH.1.2.2. Njeh terminologjinë e teorisë së letërsisë, në të cilën njihen shkrimet e veçanta dhe ku letërsia trajtohet në mënyrë teorike. 2GJSH.1.2.3. Në interpretimin e pjesëve letraro – artistike dhe pjesëve letraro-shkencor, dallon metodat e qasjes së brendshme dhe të jashtme. 2GJSH.1.2.4. Vëren dhe me shembuj argumenton tiparet letrare, poetike, gjuhësore, estetike e strukturore të veprave letrare. 2GJSH.1.2.5. I di tiparet e letërsisë si dhe i shpjegon raportet e saj me gjuhën dhe marrëdhëniet me artet e tjera. 2GJSH.1.2.6. Paraqet tiparet historike dhe poetike të periudhave letrare, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe botërore duke përfshirë edhe shkrimtarët shqiptarë e të huaj nga lektura e obliguar shkollore.	• përshkruan dhe analizon kushtet historike në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; • analizon dhe gjykon pasojat që shkaktuan dy luftërat botërore; • përshkruan dhe analizon realitetin shoqëror në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; • rendit disa nga zbulimet e mëdha në shkencat e natyrës, të cilat ndikuan në jetën e njeriut; • përcakton dhe analizon zhvillimet në shkencat shoqërore, si: psikologjia, filozofia, sociologjia; • dallon dhe analizon veçoritë e përgjithshme të letërsisë së shekullit XX, si: larmia e drejtimeve letrare, individualitete krijuese të spikatura dhe	**– Letërsi botërore** – Letërsia botërore e shek. XX **– Franc Kafka**, jeta vepra – Metamorfoza – analizë **– Alber Kamy ,** filozofia absurdi, I huaji – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shek. XX** **– Gjergj Fishta,** simbol i madhështisë së poezisë shqipe Lahuta e Malcis – analizë, Vranina – koment, Kënga e Lulashit – koment **– Lasgush Poradeci ,** liriku i madh, Ylli i zemrës – analizë **– Migjeni,** poeti vullkanik Vargjet e lira, Novelat e qytetit të veriut – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shek. XX** **-Ismail Kadare,** ambasadori i letrave shqipe

2GJSH.1.2.7. Analizon pjesët letrare nga ato joletrare dhe mund t'i argumentoj teorikisht. 2GJSH.1.2.8. Shfrytëzon po ashtu literaturën sekondare qoftë letrare, historike, kritike, poetike, teorike duke i sjellë punimet e tij para të tjerëve. 2GJSH.1.2.9. Duke i lexuar veprat e letërsisë shqipe dhe botërore, e kupton rëndësinë e të lexuarit të pjesës letrare dhe kështu ky pozitivitet ndikon në formimin e identitetit të tij gjuhësor, letrar, kulturor e kombëtar. 2GJSH.2.2.1. Interpreton veprën letrare duke nxjerrë thelbin dhe veçoritë e saj; kontekstin historik; motivet letrare; tematikën para se gjithash; kompozicionin; figurat letrare; idenë e shkrimtarit; aspektin gjuhësor e stilistik etj. 2GJSH.2.2.2. Njeh terminologjinë e Teorisë së Letërsisë dhe njohuritë teorike-letrare i zbaton në mënyrë adekuate në interpretimin e pjesëve apo edhe veprave letrare. 2GJSH.2.2.3. Dallon metodat e qasjes së brendshme e të jashtme në interpretimin e pjesëve apo veprave letraro-arstistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistike. 2GJSH.2.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave letraro-artistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistik si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekstet apo veprat përkatëse. 2GJSH.2.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv dhe këto elemente e përcaktojnë edhe vetë llojin si: tragjedinë, komedinë, elegjinë etj.	origjinale, veçori kombëtare të krijuesve; • përcakton dhe analizon tiparet e letërsisë që vijoi traditën realiste të shek. XIX; • analizon risitë që sollën shkrimtarët që ndoqën rrugën e letërsisë realiste të shek. XIX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsive të vendeve të ndryshme si dhe veprat e tyre letrare; • përcakton gjinitë dhe llojet letrare që lëvruan më shumë shkrimtarët që ndoqën prirjen realiste • përcakton veçoritë kryesore të letërsisë moderne; • dallon dhe analizon drejtimet (rrymat) kryesore letrare të letërsisë moderne të shek. XX; • analizon gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë moderne të shek. XX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë moderne, si dhe veprat e tyre letrare; • përshkruan dhe analizon risitë e letërsisë së kësaj periudhe; • rendit dhe analizon shkrimtarët që me krijimtarinë e tyre shërbyen si urë lidhëse mes letërsisë së shek. XIX dhe letërsisë së shek. XX;	Pallati i ëndrrave – analizë **– Martin Camaj** **– Azem Shkreli,** mjeshtri i fjalës poetike – Lirikë me shi – analizë **Lektura shtëpiake:** *25. Franc Kafka – Procesi* *26. Dritëro Agolli – Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* *27. Ismail Kadare – Gjenerali i ushtrisë së vdekur* *28. Ernest Heminguej – Plaku dhe deti* *29. Gabriel G. Markez – Njëqind vjet vetmi* *30. Jakov Xoxa – Lumi i vdekur* **Vërejtje: arsimtari mund të bëjë zgjedhje të lirë të lekturave shtëpiake në pajtueshmëri me planin dhe programin për klasën e katërt të Gjimnazit.*

2GJSH.2.2.6. Gjatë interpretimit të pjesëve letraro-artistike dhe letraro-shkencor, i përdor njohuritë paraprake nga fusha e teorisë së letërsisë; i njeh drejtimet dhe formacionet e zhvillimit të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.2.2.7. Në mënyrë të pavarur analizon pjesët letrare dhe mund t'i argumentojë qëndrimet e tij përballë të tjerëve. 2GJSH.2.2.8. Shfrytëzon literaturë shtesë nga letërsia, historia dhe fusha të tjera shoqërore, me qëllim të afirmimit të tij në interpretimin e pjesëve të tjera letraro-artistike e letraro-shkencor të parapara sipas planit dhe programit mësimor. 2GJSH.2.2.9. Duke i lexuar veprat letrare shqipe e botërore, e zhvillon edhe më shumë aftësinë shprehëse për interpretim dhe vlerësim të pjesëve të ndryshme letraro-artistike dhe letraro-shkencor , po ashtu e pasuron fondin leksikor, letrar, kulturor; me leximin e veprave të ndryshme, ai mund të bëhet më i arsimuar e më i kulturuar. 2GJSH.3.2.1. Lexon dhe analizon pjesët letraro-artistike dhe letraro-shkencor të parapara nga plani dhe programi mësimor dhe tekstet shtesë apo fakultative po ashtu letraro-artistike dhe letraro-shkencor duke i analizuar në kontekst më të gjerë historik.	• rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së kësaj periudhe dhe krijimtarinë e tyre; • vlerëson kontributin e shkrimtarëve të kësaj periudhe; • veçon dhe analizon risitë që sjell Kadare në letërsi pas viteve'90 analizon kushtet historike, shoqërore dhe politike pas Luftës së Dytë Botërore; përshkruan, analizon dhe gjykon për dukuritë letrare të kësaj periudhe;	
2GJSH.3.2.2. Është i njoftuar me terminologjinë teorike-letrare duke e zbatuar në interpretimin e veprave letraro-artistike dhe letraro-shkencor të cilat janë të parapara me planin dhe programin mësimor; shfrytëzon edhe vepra të zhanreve të tjera, jashtë obligatives. 2GJSH.3.2.3. Në procesin e interpretimit të veprave përkatëse, zbaton metodat adekuate të qasjes së brendshme e të jashtme. 2GJSH.3.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave gjegjëse e publicistike si: esenë, biografinë, autobiografinë,		

memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekst. 2GJSH.3.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv. 2GJSH.3.2.6. Gjatë interpretimit dhe vlerësimit të veprave letraro-artistike dhe letraro- shkencor, zbaton dhe krahason tiparet historike e letrare (stilistike) të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.3.2.7. I vëren e i interpreton problemet dhe idetë në veprën letrare dhe qëndrimet e tij mund t'i argumentojë në bazë të tekstit primar dhe kontekstit letrar. 2GJSH.3.2.8. Për ta interpretuar (njohur) apo për t'i bërë analizë filologjike veprës letrare, duhet të ketë njohuri të caktuara, një kulturë letrare nga leximi i veprave të tjera që për nga rëndësia hyjnë në radhën e kryeveprave nacionale e botërore. 2GJSH.3.2.9. Pasi t'i ketë lexuar veprat letrare shqipe e botërore, të cilat janë obligative, dhe veprat letrare me përzgjedhje, vërehet aftësia e tij shprehëse kundrejt të tjerëve dhe me këto zhvillohet e pasurohet edhe më shumë identiteti i tij kulturor e arsimor.		
2GJSH.1.3.1. Flet qartë duke respektuar drejtshqiptimin (ortoepinë) e gjuhës letrare; zbaton theksin (akcentin) gjuhësor-letrar ose e krahason akcentin e tij me atë letrar me tendencë të përshtatjes; Rrjedhshëm dhe qartë lexon me zë tekstet letrare dhe joletrare; shprehimisht lexon dhe lehtë i tregon tekstet letrare artistike; Në situata formale flet për temat e thjeshta si: nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe të kulurës duke u shërbyer me shprehje korrekte gjuhësore; Pra, flet qartë, pa pengesa, pa dridhje të zërit e pa	• zgjeron gamën e strategjive përmbledhjen e të dhënave të nevojshme që do të përdorë gjatë prezantimeve; • zbaton hapat e përgatitjes dhe të mbajtjes së një fjalimi për tema të ndryshme; • përzgjedh fjalët dhe shprehjet e përshtatshme, në mënyrë që të ndikojë te dëgjuesit, si dhe përmirëson zgjedhjen	Gjuha e medies; Gazeta; publiciteti dhe reklama,

pauza të mëdha; Sipas nevojës, përdor teminologjinë shkencore për gjuhën dhe letërsinë, duke e përshtatur me rastet apo situatat, bashkëfolësin ose përdor edhe mjetet gjuhësore verbale a joverbale sidomos mimikën, gjestikulacionin, lëvizjet e duarve etj, që në gjuhësi njihet me emrin Semiotikë; Ka kulturë të të dëgjuarit kur dikush flet në gjuhën e tij dhe me vëmendje dëgjon e kupton ligjëratat nga fusha e gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës dhe kështu gjatë dëgjimit të ndonjë ligjërimi, mund të marrë shënime; 2.GJSH.1.3.2. Dukë folur apo shkruar për ndonjë temë nga gjuha, letërsia apo për jetën shoqërore, e strukturon rrëfimin dhe i lidh pjesët në mënyrën e duhur; Dallon të rëndësishmen nga e parëndësishmja dhe i përmbahet temës kryesore; Shkruan një tekst duke u shërbyer nga përshkrimi e ekspozicioni dhe shkurtazi përshkruan ndjenjat e tij dhe përjetimin e pjesës letrare ose të ndonjë pjese tjetër artistike; Rrëfen tekstin letrar artistik dhe i ndanë pjesët kryesore. Në fund jep një përmbledhje (rezyme) të tekstit letrar ose joletrar; 2GJSH.1.3.3. Në diskutime me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura, në pika të shkurtëra mund ta shpreh dhe ta argumentojë idenë ose qëndrimin për të cilin angazhohet; Pra, ai mund të flasë ngadalë duke u mbështetur kryesisht në fakte; Është në gjendje ta dëgjojë mendimin e tjetrit dhe ta marrë parasysh gjatë argumentimit të tij; Shkruan tekst me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura; 2GJSH.1.3.4. Shfrytëzon librin drejtshkrimor të gjuhës shqipe; zbaton rregullat elementare të drejtshkrimit dhe mund të shërbehet me botime të tjera nga Ortografia; Në të shkruar ndan pjesët tekstit, jep titujt dhe nëntitujt, citon dhe parafrazon; Bën punimin e maturës duke respektuar rregullat e shkruarjes së punimit shkencor (përdor fusnotat, shkruan përmbajtjen dhe bibliografinë); Shkruan letra zyrtare dhe jozyrtare,	e fjalëve duke përdorur mjete retorike dhe të figurshme; • vlerëson rolin e përdorimit të TIK-ut gjatë prezantimeve me gojë dhe analizon funksione te këtij përdorimi; • reflekton ndaj informacionit të dëgjuar, rikujton përmbajtjen e informacionit, si dhe analizon mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose e një ligjërate mbështetin qëllimin e saj; • reflekton mbi informacione të llojeve dhe të fushave të ndryshme, si dhe përgjigjet në mënyrë të përshtatshme; • demonstron aftësitë e domosdoshme të të dëgjuarit kritik. • përshtat shkrimin me qëllimet dhe lexuesit, p.sh.:të përshkruajë, të rrëfejë, të udhëzojë,të informojë, të argumentojë; • karakteristikat e tyre; • vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediesh; është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.	

biografi (CV), lutje, ankesë, kërkesë; Di të mbushë formularë të ndryshëm etj.; 2GJSH.1.3.5. Ka aftësinë që në mënyra të ndryshme (informim, mësim, zhvillim personal, përjetim estetik, argëtim …) të lexojë tekstet të rëndësisë (tekstet letrare, tekste profesionale, shkencore, popullore) nga fusha e shkencës për gjuhën dhe letërsinë, tekstet nga mediet; tekstet që janë të përshtatshme për përpunimin e planit për gjuhë dhe letërsi); zbaton strategjitë e të lexuarit; 2GJSH.1.3.6. Kupton tekstin letrar e joletrar dhe njeh rëndësinë e tyre, gjen informacione nga më të ndryshmet, ndan pjesët kryesore të tekstit; e di kuptimin e përmbajtjes në tekst; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste.		
2GJSH.1.3.7. Në mënyrë kritike jep sqarim për tekstin letrar e joletrar; dallon faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson (dhe argumenton) se a i prezanton autori i tekstit joartistik të gjitha informacionet e nevojshme dhe a jep fakte të mjaftueshme e të besueshme për atë që thotë; vlerëson se a është neutral autori i tekstit ose i angazhuar apo i anshëm dhe e arsyeton vlerësimin e tij; njeh gjuhën e urrejtjes, diskriminimit, sharjes dhe për këto çështje ka qëndrim negativ. 2GJSH.1.3.8. Njeh strukturën, elementet e ndryshme, figurat stilistike (metoniminë, metaforën, asonancën, aliteracionin, onomatopenë, anaforën…); Njeh domethënien konotative të fjalës në kontekstin e dhënë dhe kupton qëllimin e domethënies konotative në tekstin letrar dhe joartistik; vlerëson domethënien e fjalëve të panjohura në bazë të kontekstit dhe modelit të formacionit; kupton domethënien e leximit për pasurimin e fondit leksikor. 2GJSH.2.3.1. Nëpër situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë, flet për temat nga fusha e gjuhës,		*Të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit e teksteve të ndryshme.* *Intervista për punë.* *Letra e mospranimit për punë,* *Ftesa,* *Intervista me gojë, biseda.* *Tekstet e digjitalizuar,*

letërsisë dhe kulturës, duke e përdorur gjuhën letrare dhe terminologjinë përgjegjëse; merr pjesë në bisedat publike ku ka më shumë pjesëmarrës; vlerëson auditoriumin dhe e përshtat fjalimin e tij sipas mundësive dhe kërkesave të tij; në të folur duhet ta zhvillojë më shumë kulturën e tij shprehëse; me vëmendje dëgjon prezantimet nga të tjerët (psh. ligjëratat) me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura etj. 2GJSH.2.3.2. Ndërton tekstin e folur a të shkruar nga gjuha, letërsia etj., duke e karakterizuar nga kohezioni dhe koherenca, pra me mënyrën se si lidhen midis tyre në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës njësitë që e përbëjnë tekstin (kohezioni) dhe me organizimin logjik të tekstit me mënyrën se si gjykimet dhe arsyetimet lidhen midis tyre (koherenca); në diskutimet e shkruara apo të folura, shpreh idetë dhe argumenton qëndrimet e tij; përkujdeset që të shkruaj e të folë në mënyrë të drejtë duke respektuar normën gjuhësore pa bërë ndonjë digresion (shmangie) nga rregullat; shfaq përjetimin dhe përshtypjet e tij rreth pjesës letrare ose artistike; rrëfen tekstin letrar dhe jep një përfundim për të sipas mundësive të tij shprehëse; zbaton rregullat drejtshkrimore etj. 2GJSH.2.3.3. Për të pasur një informim edhe më te gjerë, pra për ta zhvilluar aftësimin personal dhe për ta arritur përjetimin letrar e estetik, lexon tekste edhe më të ndërlikuara si tekste letraro-artistike, tekste shkencore, tekste nga mediet etj; është i apasionuar pas leximit; zbaton dhe zgjedh strategjitë e përshtatshme të leximit. 2GJSH.2.3.4. Kupton tekstin joletrar; nxjerr thelbin e tij; gjen pjesët e nënkuptueshme, por edhe e shtjellon tekstin në fjalë; gjen idenë kryesore; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste për të kuptuar aspektin domethënës e stilistik; i gjen dhe i analizon motivet dhe figurat, të cilat paraqiten në veprën letrare; interpreton tekstet		

duke u mbështetur në tekstet e tjera letrare. 2GJSH.2.3.5. Në mënyrë kritike jep vlerësim për tekstin letrar joartistik; ndan faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson neutralitetin (anshmërinë) e autorit; vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit argumentues; prezanton të gjitha informatat dhe faktet e autorit për ato që i thotë. 2GJSH.2.3.6. Vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit joartistik; teksti a është koheziv dhe koherent, a janë dhënë idetë qartë dhe saktë; vëren dukuritë stilistike; vëren se sa ndikojnë pjesët e caktuara të tekstit për ta kutpuar atë. 2GJSH.3.3.1. Diskuton për temat komplekse nga gjuha, letërsia dhe kultura; flet për tekstet letrare dhe joletrare duke shfrytëzuar terminologjinë profesionale. 2GJSH.3.2.2. Prezanton në situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë paraqitet me tema nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës; është orator dhe paraqet qëndrimet e tij para auditoriumit me argumente; gjatë ligjërimit përdor fjalë dhe shprehje nga gjuha amtare duke respektuar normën e gjuhës standarde etj. 2GJSH.3.3.3. Shkruan në mënyrë kompozicionale e logjike tekstin profesional me temë nga gjuha dhe letërsia si edhe artikullin gazetaresk. 2GJSH.3.3.4. I mbledh, i shënon dhe në fund i përpunon informacionet nga tekstet letrare joartistike në bazë të rregullave të parapara. 2GJSH.3.3.5. Teksti mendon se ka një strukturë dhe organizim të brendshëm, kuptohet pa vështirësi, lexohet me kënaqësi, pra bart informacionin te lexuesi dhe është i shkruar sipas rregullave të ndërtimit të fjalive dhe të periudhave;		

2GJSH.3.3.6. I njeh stilet funksionale të shqipes standarde (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili stili shkencor-teknik, stili juridik-administrativ) dhe të gjitha këto (stile) mund t'i trajtojë sipas veçorive të tyre leksikore. 2GJSH.3.3.7. Në të shkruar, përdor shenjat e pikësimit varësisht nga lloji i fjalive (dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse, urdhërore).		

Fjalët kyçe: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, kultura e gjuhës

Disa përmbajtje mësimore për të cilat mësuesi vlerëson se gjatë vitit ato nuk mund t'i realizojë gjatë orëve të rregullta, mund të planifikohen për përpunim gjatë orëve të mësimit me projekt, orëve në ambient të hapur, si dhe në orët të tjera të mësimit shtues e plotësues dhe në eksione.

UDHËZIME DIDAKTIKO – METODIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Programin e mësimdhënies dhe nxënies të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe përbëhet prej tri fushave/lëmive mësimore: Letërsisë, Gjuhës dhe Kulturës së Gjuhës. Shpërndarja e rekomanduar e orëve sipas fushave të njohurive është: Letërsi – 39 orë, Gjuhë – 36 orë dhe Kultura e gjuhës – 18 orë. Fondi i përgjithshëm i orëve, në nivelin vjetor, është 93 orë. Të tri fushat e programit të mësimdhënies dhe nxënies janë të ndërlidhura dhe nuk mund të mësohen të ndara dhe pa bashkëpunim ndërmjet njëra – tjetrës.

Programi mësimor dhe mësimor i Gjuhës dhe Letërsisë shqipe bazohet në rezultatet, domethënë në procesin e të mësuarit dhe arritjet e nxënësve. Rezultatet janë një përshkrim i njohurive të integruara, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që nxënësi ndërton, zgjeron dhe thellon nëpër të tri fushat lëndore të kësaj lënde.

I. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

Programi i mësimdhënies dhe mësimit i orientuar në rezultate, mësuesit i jep liri më të madhe krijimi dhe për të menduar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Roli i mësuesit është që mënyrat e ralizimit të studimit dhe mësimit t`ia përshtat nevojave të çdo paraleleje, duke pasur parasysh:përbërjen e paraleles dhe karakteristikat e nxënësve; tekstet dhe materialet tjera të cilat do t`i shfrytëzojë; kushtet teknike, mjetet mësimore dhe mediumet të cilat shkolla i disponon; resurset, mundësitë, si dhe nevojat e mjedisit local ku shkolla gjendet, duke u nisur nga rezultatet e dhëna dhe përmbajtjet, mësuesi fillimisht harton planin e vet vjetor, të quajturin plani global i punës, nga i cili më vonë do të zhvillojë planet e veta operative. Rezultatet e definuara sipas lëmive i lehtësojnë mësuesit operacionalizimin e mëtejshëm të rezultateve në nivelin e njësive konkrete mësimore. Nga mësuesi pritet që për çdo njësi mësimore, në fazën e planifikimit dhe hartimit të përgatitjes për orën e mësimit t`ia përshtatë rezultateve të mësimit. Gjatë planifikimit, gjithashtu, duhet patur parasysh se disa rezultate realizohen më shpejtë e më lehtë, por për pjesën më të madhe të rezultateve (veçanërisht për fushën lëndore Letërsi) duhet më tepër kohë, më shumë aktivitete të ndryshme dhe punë në shumë tekste të ndryshme. Rezultatet e rekomanduara nuk janë të diferencuar sipas niveleve të të arriturave të nxënësve. Ota paraqesin pjesë obligative të përshkrimit të standardeve dhe mund të imtësohen ose të zgjerohen, në vartësi prej mundësive individuale të nxënësit dhe nevojave të tjera mësimore.

Në fazën e planifikimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies është shumë e rëndësishme të keni parasysh se teksti është një mjet mësimor dhe se nuk përcakton përmbajtjen e lëndës. Për këtë përmbajtjeve të dhëna në tekst është e nevojshme t`i qasemi në mënyrë selektive dhe në raport me rezultatet e parashikuara që duhet të arrihen. Përveç kësaj nxënësit duhet të aftësohen për shfrytëzimin e tekstit, si një nga burimet e njohurive, mësuesi vlen që t`i udhëzojë në mënyrat dhe format e përdorimit të burimeve të tjera të njohurive

II. REALIZIMI I MËSIMIT DHE NXËNIES

LETËRSIA

Boshtin e programit të letërsisë e përbëjnë tekstet nga lektura. Lektura është e ndarë sipas gjinive letrare – lirika, epika, drama dhe e pasuruar me zgjedhjen e teksteve jo fikcionale, shkencore – popullore dhe informative. Zgjedhja e veprave në masën më të madhe bazohet në principin e përshtatjes së moshës. Krahas teksteve që duhet përpunuar gjatë orës është dhënë lista e lekturës

shtëpiake. Qëllimi i përpunimit të veprës në kuadër të lekturës shtëpiake është formimi, zhvillimi ose kultivimi i shprehive të leximit tek nxënësit. Veprat voluminoze nxënësit mund t`i lexojnë gjatë pushimit, me çka nxitet zhvillimi i vazhdueshëm i shprehisë së leximit. Krahas listës obligative të veprave është dhënë edhe zgjedhja plotësuese e teksteve. Pjesa e zgjedhur i mundëson mësimdhënësit mundësi më të madhe kreativiteti në arritjen e rezultateve.

Me një korpus dominuese të teksteve të shkrimtarëve që mund të ndikojnë në formimin e shijes estetike të nxënësve, ndërton dhe pasuron vetëdijen për natyrës e letërsisë kombëtare (dhe vlerat e klasikëve të letërsisë botërore), por edhe identitetin kulturore dhe kombëtar.

Qëllimi i sjelljes së veprave letrare bashkëkohore është që sipas motivit ose me përkatësisë tematike të tyre lidhen me temat dhe motivet ekzistuese brenda programit mësimor, dhe me shembuj të tillë të tregojë se si shkrimtarët bashkëkohorë i mendojnë traditat epike popullore ose temat e miqësisë, etikës, zhvillimin e imagjinatës dhe empatisë, me çka do të pasurojnë përvojën vertikale të leximit të nxënësve dhe modernizon qasjen në mësimdhënie. Përmes një numri veprash letrare të shkrimtarëve bashkëkohorë, nxënësit do të jenë në gjendje të në mënyrë kritike të vlerësojnë poetikën e veprave të tyre.

Zgjedhja e veprave mundëson aplikimin e qasjes së studimit krahasues të të krijimtarisë letrare, me zgjedhjen e niveleve të ndryshme të përpunimit: interpretimit, paraqitjes ose rishikimeve. Dallimet në tërësinë artistike dhe vlerat informative të disa teksteve ndikojnë në zgjidhje përkatëse metodike (përshtatja e leximit të llojit të tekstit, shtrirja e komentimit të tekstit në vartësi nga ndërlikueshmëria e strukturës së tij, lidhja dhe grupimi me përmbajtjet gjegjëse nga fushat tjera lëndore – gramatika, drejtshkrimi dhe kulturë gjuhe dhe të ngjashme.).

Tekstet nga pjesa e programit plotësues duhet t`i shërbejë mësimdhënësit edhe gjatë përpunimit të njësive mësimore nga gramatika, si dhe për përpunim dhe përforcim të përmbajtjeve nga kultura e gjuhës. Veprat të cilat nuk i përpunon mësimdhënësi duhet t`i rekomandojë nxënësve për lexim gjatë kohës së lirë.

Programi i ri bazohet në njohjen e natyrës dhe rolin e veprës letrare, si dhe njohjen e dallimit të teksteve letrare dhe jo letrare, përkatësisht korrelacionit të tyre.

Nxënësit duhet të jenë të aftë të dallojnë veçantitë e tekstit letrar (konotacionin, veprimet letrare, denotativitetit, informimin, dhe duke treguar në bazë të fakteve dhe të dhënave në mënyra të ndryshme të teksteve jo letrare. Korrelacioni është mundësuar me kombinime adekuate të veprave obligative dhe zgjedhore. I njëjti tekst mund të lidhet me të tjerët në mënyra të ndryshme, sipas motiveve të ndryshme ose tonit të rrëfimit, në kuadër të mësimit me projekt, që bazohet në rezultate, kurse jo në përmbajtjet mësimore.

Tekstet e propozuara obligative, letrare, shkencore – popullore dhe informative dhe përmbajtja e lekturës shtëpiake obligative, si dhe shembujt nga zgjedhja plotësuese, me rastin e planifikimit të planit vjetor të punës, dhe pastaj edhe gjatë formësimit të planeve të punës orientuese mujore, mund të lиdhen tematikisht.

Nga lista e zgjedhjes plotësuese mësimdhënësi zgjedh oto vepra të cilat, me pjesën obigative të lekturës, përbëjnë tërësitë tematike – motivuese. Mësimdhënësi mund t`i grupojë sipas gjinisë veprat nga programi obligativ dhe plotësues në mënyra të ndryshme. Shembujt e mundshëm të lidhjes funksionale të njësive mësimore mund të jenë këto (në asnjë mënyrë të vetme).

GJUHA

Në mësimin e gjuhës nxënësit aftësohen të komunikojnë të drejtë me gojë e me shkrim në gjuhën standarde shqipe. Nga kjo kërkesat në këtë program nuk janë të drejtuar vetëm në përvetësimin e rregullave gjuhësore dhe normës gramatikore, por edhe në kuptimin e funksioneve të tyre dhe zbatimin e drejtë në të shprehurit me gojë e me shkrim.

Kur në përmbajtjet e programit jepen njësi mësimore, të cilat nxënësit i kanë përpunuar edhe më herët, kuptohet se shkalla e përvetësimit dhe aftësimit të zbatimit të lëndës së përpunuar më herët verifikohet, kurse përsëritja dhe ushtrimi në këta shembuj i paraprin përpunimit të përmbajtjeve të reja, me çka sigurohet kontuiniteti i punës dhe sistematizimit në lidhjen e materialit të ri me njohuritë ekzistuese.

Gramatika

Kërkesa themelore programore në mësimin e gramatikës është që nxënësve gjuha t`i paraqitet dhe t`i shpjegohet si sistem. Asnjë dukuri gjuhësore nuk duhet të studiohet dhe shpjegohet e izoluar, jashtë kontekstit në cilin realizohet funksioni i saj (në secilin rast të përshtatshëm mund të vendosen në funksion, njohuritë nga gramatike, në shpjegimin e tekstit, si atij artistik edhe atij shkencor – popullor). Një nga veprimet e veçanta funksionale në mësimin e gramatikës është ushtrimet e bazuara në shfrytëzimin e shembujve nga praktika e drejtpërdrejtë e të folurit, çka mësimin e gramatikës ia

ofron nevojave jetësore, në të cilat paraqitet gjuha e aplikuar si aktivitet i motivuar dhe i gjithanshëm i aktivitetit njerëzor.

Në këtë mënyrë tek nxënësi zhvillohet edhe vetëdija e rëndësisë së kulturës e të folurit, e cila është e domosdoshme në jetën e përditshem si pjesë e kulturës së përgjithshme, e jo vetëm si pjesë e programit mësimor.

Mësimi i morfologjisë nënkupton rrumbullakësimin e e njohurive për ndërtimin e formave foljore. Është e domosdoshme lidhja e përmbajtjeve të reja me mësimet e punuara në klasat e më hershme, prandaj me shikimin e të gjitha formave foljore të përpunuara të bëhet nj[sintezë dhe të ndahen të gjitha format e foljeve fillimisht në vetore dhe pavetore dhe pastaj format e foljeve vetore në kohë dhe mënyra. Gjithashtu, është e nevojshme të theksohet edhe ndarja e të gjitha formave të foljeve në të thjeshta dhe të përbëra. Përdorimin e mbiemrit pasiv të foljes duhet shpjeguar me shembujt më tipik të konstruksioneve pasive. Duhet sistematizuar llojet e fjalëve duke përvetësuar përmbajtje të reja si: lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat.

Mësimi i sintaksës nënkupton sjellja e shprehjes së sintagmës dhe njohjen e gjymtyrës kryesore dhe të varur në kuadër të saj. Në shembujt e qartë dhe të pakontestueshëm nxënësit nëpërmjet ushtrimeve dallojnë gjymtyrën kryesore dhe të varur si dhe llojin e sintagmës. Futet atributi edhe atë si sintagmor, e jo si gjymtyrë e fjalisë. Është e rëndësishme të theksohet se cilat lloje të fjalëve paraqiten në kuadër të atributit. Në klasat e më hershme është përpunuar subjekti gramatikor, kurse tani futet edhe shprehja e subjektit logjik.

Drejtshkrimi

Përmbajtjet nga drejtshkrimi është e domosdoshme të lidhen me temat përkatëse edhe në orët e gramatikës edhe në ato të letërsisë. Për shembull. Kur përpunohet ndërtimi i formave të foljeve, duhet përpunuar edhe zgjidhjet drejtshkrimore të foljeve në lidhje me drejtshkrimin e formave të foljes. Në lidhje me përvetësimin e tipave të fjalisë është e nevojshëm të përpunohen edhe pikësimi, para së gjithash presjen si shenja më të rëndësishme të pikësimit. Duhet të jepen qartë rregullat kur duhet të shkruhet presja, dhe kur presja është shenjë jo e domosdoshme ose veçori e stilit. Lidhja e përmbajtjeve nga gramatika dhe letërsia bëhet me analizimin e përdorimit të presjes në fjalitë e ndara dhe dallimin e përdorimit të presjes në veprat letrare. Në pika të shkurta duhet theksuar në specifikat e stilit artistiko – letrar, ku ndonjëherë si rezultat i kreativitetit të shkrimtarit me qëllim nuk zbatohen rregullat e drejtshkrimit (veçanërisht në poezi). Kombinimi i shenjave të drejtshkrimit miratohet që në klasat e më hershme në lidhje të folurit e drejtuar, por edhe tani theksohet në llojet tjera të shenjave drejtshkrimore të kombinuara, para së gjithash në përdorimin e presjes pas shkurtesave dhe numrave rendor. Shkrimi i shkurtesave ka të bëjë me përsëritjen e asaj që është mësuar në lidhje me shkurtesat, por edhe në zgjerimin e llojeve të shkurtesave të cilat theksohen në drejtshkrimin që është në fuqi.

Rregullat e drejtshkrimit miratohen me anë të ushtrimeve sistematike (diktimeve drejtshkrimore, përmirësimit të gabimeve në tekstin e dhënë, testeve me pyetje nga drejtshkrimi etj.). gjithashtu duhet nxitur nxënësit që vet të dallojnë dhe përmirësojnë gabimet drejtshkrimore gjatë komunikimit me SMS, si dhe në llojet e ndryshme të komunikimit nëpërmjet internetit.

Pos kësaj, nxënësit duhet udhëzuar në shërbimin e drejtshkrimit dhe të fjalorit të drejtshkrimit (botim shkolle). Është e preferueshme që mësimdhënësi të sjellë në orë ekzemplar të Drejtshkrimit sa herë që përpunohen tema të drejtshkrimit (kështu do të mund që individualisht nxënësve t`i japë të gjejnë fjalë në fjalorin drejtshkrimorë dhe të përcaktojnë formën e rregullt të saj ose shkrimin e drejtë).

Drejtshqiptimi

Ushtrimet drejtshqiptimore nuk duhet realizuar si njësi të veçanta mësimore, por përmes temave përkatëse nga gramatika, por edhe në orët nga letërsia. Në këtë nivel nxënësit duhet të dallojnë dallimet ndërmjet theksit zbritës dhe atij ngjitës dhe t`i shënojnë drejtë të theksat në shembujt tipik. Nëse për këtë ekzistojnë kushtet, mësimdhënësi duhet të lëshojë incizime të drejtshqiptimit dhe t`i tregojë dallimet në shqiptim. Nxënësit duhet mësuar të njohin, riprodhojnë dhe përvetësojnë të folurit e theksuar, kurse në vendet ku shmangemi nga norma e theksimit të dallojnë theksin standard nga theksi i vet, ose nga theksimi dialektor.

KULTURA E GJUHËS

Një nga detyrat themelore të mësimit të kulturës së gjuhës ka të bëjë përvetësimin e mjeteve të shprehjeve gjuhësore tek nxënësit, kurse qëllimi i fundit është që nxënësit të aftësohen në vendosjen e cilësi së dhe të komunikimit kuptimplotë. Edhe pse fusha e kulturës gjuhësore është e konstituuar si hapësirë e veçantë programore, është parashikuar në mësimin e tërësishëm të gjuhës dhe letërsisë shqipe të lidhet edhe me dy fushat e tjera letërsinë dhe gjuhën. Fusha Kulturë gjuhe përfshinë të

shprehurit me gojë dhe me shkrim. Me ç`rast duhet kushtuar kujdes të njejtë të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

Në këtë moshë duhet shqyrtuar specifikat e dy stileve funksionale, atij letraro – artistik dhe publicistik.

Nxënësit duhet të inkurajohen që në tekstin e dhënë, të përzier dhe të kreuar me dedikim të gjejnë dhe të radhisin fjalitë duke pasur parasysh se a i përkasin stilit letraro – artistik apo atij publicistik. Pastaj, të gjejnë fjalinë e shkruar në tekst në stilin publicistik, i cili është shkruar në stilin letraro – artistik dhe anasjelltas. Duhet të shpjegojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet dy stileve funksionale, të zhvillojnë aftësitë e kuptimit të veçorive të tyre.

Koherenca paraqet një shenjë të rëndësishme të strukturës tekstuale dhe udhëzohet në karakterin kontinuitiv të ndonjë teksti. Nga kjo në mësmin e kulturës gjuhësore duhet aftësuar nxënësit që në formë gojore dhe me shkrim të koncipojnë përbërjet sipas drejtimeve të cila do t`u jenë dhënë. Për shembull, duhet të hartojnë tekste të menduara logjike në bazë të fjalëve të dhëna të cilat fjalë duhet patjetër t`i përdorin; të hartojnë tekste gjatësia e të cilëve do të jetë e kufizuar (numri i kufizuar i fjalëve); që në tekstin që e hartojnë të përdorin kryesisht modele të caktuara gramatikore ose të leksikun e caktuar. Gjithashtu, duhet inkurajuar të mendojnë disa fillime të ndryshme të teksteve në temën e njejtë të dhënë ose të mendojnë disa përfundime të ndryshme me përgatitje të dedikuar dhe sipas tekstit të përshtatshëm të papërfunduar; të ndryshojnë fundin (ose pjesë tjera të përshtatshme) e një shabloni letrar; të vendosin renditje të shthurur kronologjike ose të menduar në tekstin e dhënë dhe ngjashëm.

Një kompetencë shumë e rëndësishme e cila gjendet në baën e shumë niveleve të kuptimit të teksti, është shkathtësia e argumentimit. Duke pasur parasysh që zhvillimi i mendimit të argumentuar ka rol të rëndësishëm në arsim, sepse mund të ndikojë pozitivisht në fitimin e njohurive, gjatë mësimit të kulturës gjuhësore duhet verifikuar deri në ç`masë nxënësit janë në gjendje të kuptojnë tekstet e argumentuara. Duhet inkurajuar nxënësit që të arsyetojnë me argumente qëndrimin e vet lidhur me situatën problemore në veprën letrare; që me argumente të arsyetojnë qëndrimin e vet eksplicit të paraqitur për dikë, për ata, çështje e rëndësishme.

Një nga format themelore të shprehjes me gojë dhe me shkrim – përshkrimi. Paraqet përmbajtje bazike programore për përsosjen dhe kultivimin e kulturës së duhur gjuhësore të nxënësit. Në këtë moshë nxënësit duhet të shfrytëzojnë të dy llojet e përshkrimit: teknik dhe sugjestiv, përkatësisht duhet aftësuar të përshkruajnë një lëndë, nocion apo qenie të caktuar, fillimisht në mënyrë objektive (përshkrim teknik), dhe pastaj duke i shprehur përshtypjet e veta (përshkrim sugjestiv). Gjithashtu, duhet inkurajuar të mendojnë paralelisht të dy llojet e përshkrimit të të njëjtit send përshkrimi; të gjejnë elemente e dy përshkrimeve në tekstin e përzier;

Gjatë mësimit të kulturës së gjuhës në kët moshë duhet tërhequr vëmendjen nxënësve, ndërmjet tjerash, edhe në metodat e paraqitjes së burimeve dhe ideve, si dhe shpjegimeve plotësuese të cilat përdoren në tekst. Duhet inkurajuar të shpjegojnë shkaqet dhe funksionet e citimit; të shpjegojnë situatat problemore të vërejtura në tekstet letrare dhe të tjera me ndihmën e citateve: të komentojnë rëndësin dhe kuptimin e fusnotës së përdorur në shembullin e dhënë; të dallojnë citatet dhe parafrazat në shembujt e dhënë. Gjithashtu, duhet tërhequr vërejtjen në rregullat të cilat ndikojnë në shkrimin numrave të eksponuar me të cilët shënohen fusnotat në fund të fjalisë.

Llojet e ushtrimeve gjuhësore duhet zgjedhur sipas interesimeve të nxënësve ose në kontekst ë përmbajtjes mësimore. Këto mund të jenë: plotësimi i tekstit me forma të ndryshme të fjalëve të ndryshueshme; plotësimi tekstit me fjalë të pandryshueshme; shënimi i fjalive komunikuese në tekst; paraqitja e gjymtrës së fjalisë në mënyra të shumta.

Me zbatimin e ushtrimeve gjuhësore krijohet shprehia që të mendojnë dhe kërkojnë shprehje adekuate për atë që e dëshirojnë ta tregojnë (në vartësi prej situatës së komunikimit) dhe të shtojnë fondin e shprehjeve të trillanë fjalorin e tyre, me theks të veçantë në frazeologjizma dhe shprehje të krijuara (shembujt të meren nga tekstet e përpunuara).

Në çdo gjysmëvjetor punohen nga dy detyra (hartime) me shkrim (gjithsej katër në vit).

Rekomandohet të punohen tetë detyra (hartime) me shkrim (përmbajtje të shkruara).

III. PËRCJELLJA DHE VLERËSIMI I MËSIMIT DHE NXËNIES

Përcjellja dhe vlerësimi i rezultateve të përparimit nxënësit është në funksion të realizimit të rezultateve, kurse fillon me vlerësimin inicial të nivelit të arritur të njohurive, në raport me atë se si do të matet përparimi mëtejshëm dhe si do të formohet notimi. Secila orë mësimore dhe çdo aktivitet i nxënësit është rast për notimin formal të nxënësit, përkatësisht regjistrimi i përparimit të nxënësit dhe udhëzimi për aktivitete të mëtejshme.

Vlerësimi formal është pjesë e qasjes moderne të mësimit dhe nënkupton vlerësimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe sjelljeve si dhe zhvillimin e kompetencave përkatëse gjatë mësimit dhe

nxënies. Matja formale nënkupton grumbullimin e të dhënave mbi të arriturat e nxënësit, me ç`rast më shpesh zbatohen këto teknika: realizimi i detyrave praktike, vështrimi dhe regjistrimi i aktiviteteve të nxënësit gjatë mësimit, komunikimi i drejtpërdrejtë ndërmjet nxënësit dhe mësimdhënësit, regjistri për çdo nxënës (harta e përparimit) etj. Rezultatet e vlerësimit formal në fund të ciklit mësimor duhet të jenë të paraqitur edhe me notë numerike.

Puna e çdo mësimdhënësi përbëhet nga planifikimi, realizimi, përcjellja dhe vlerësimi. Është e rëndësishme që mësimdhënësi, krahas arritjeve të nxënësit, në vazhdimësi të përcjellë dhe vlerësojë punën e vet. E gjitha që tregohet e mirë dhe efikase, mësimdhënësi do ta shfrytëzojë edhe më tej në praktikën e vet mësimore, kurse ajo që vlerësohet si e pamjaftueshëm efektive, duhet të avancohet.

2. PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR PËR KLASËN E KATËR TË SHKOLLËS SË MESME – TEKNIK I KOMUNIKACIONIT

Emri i lëndës	**GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE**
Qëllimi	Qëllimi i mësimit të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe është që të përvetësojnë rregullat themelore të gjuhës letrare standarde shqipe me qëllim të përdorimit të drejtë në të folur, në të shkruar dhe gjatë të shprehurit në komunikim; kultivimi i vetëdijes mbi rëndësinë e rolit të gjuhës në ruajtjen e identitetit kombëtar; aftësimin e nxënësit për të komentuar pjesë të zgjedhura letrare dhe vepra të zgjedhura artistike nga letërsia shqipe dhe trashëgimia botërore, me qëllim të kultivimit të traditës dhe kulturës së popullit shqiptar; zhvillimin interkulturor; Zhvillimi i aftësisë dhe kulturës së leximit; gjetjes së përvojave dhe ideve letrare; nxitjen dhe vlerësimin e krijimtarisë personale dhe krijimtarisë së të tjerëve; kuptimin e tekstit në kontekste të ndryshme kulturore, ndërkulturore dhe shoqërore.
Klasa	**E KATËR**
Fondi vjetor i orëve	**94 orë**

KOMPETENCAT E PRGJITHSHME LËNDORE

Nxënësi njeh veprat e letërsisë shqipe që i përkasin trashëgimisë kulturore kombëtare dhe korrespondojnë me epokën e saj, njihet me kryeveprat e letërsisë botërore dhe parimet themelore të interpretimit të teksteve letrare. Ai njihet me karakteristikat themelore të komunikimit, rregullat e komunikimit me gojë dhe me shkrim janë të qarta për të. Ai flet dhe shkruan duke respektuar pritjet e normave gjuhësore. Ai krijon një tekst të plotë, të saktë gojor dhe të shkruar, në përputhje me aspektet stilistike, kupton dhe vlerëson në mënyrë kritike atë që ka lexuar, pasuron përgjithmonë fondin e tij leksikor. Ai lexon, përjeton dhe interpreton vepra letrare dhe joletrare. Ai e konsideron të lexuarit si një mjet për të njohur veten dhe botën. Ai gradualisht bëhet lexues, zgjedh leximin sipas shijes së tij, zhvillon nevojën për të përmirësuar kompetencën e tij për të kuptuar tekstin dhe kulturën e të folurit. Ai respekton, ruan me vetëdije gjuhën e tij amtare.

Niveli bazë

Nxënësi flet qartë dhe rrjedhshëm, respekton normat gjuhësore, dëgjon me kujdes dhe me respekt mendimet e të tjerëve. Përbën një tekst të plotë, gjuhësor dhe stilistik, të formuar mirë, më të shkurtër, më të thjeshtë me gojë ose me shkrim. Miraton zakone zyrtare dhe informale të shkrim-leximit në praktikë. Ai kupton tekste letrare dhe joletrare më të shkurtra, më të thjeshta, të ndërlidhura dhe rishikon në mënyrë kritike përmbajtjen e tyre. Gradualisht ai ndërtoi fondin e tij poetik leksikor.

Nxënësi ka njohuri themelore për gjuhën, faktorët dhe funksionet e komunikimit, njeh shtresat gjuhësore dhe dallon variantet gjuhësore. Ai mëson bazat e fonetikës, fjalorit dhe sintaksës së gjuhës shqipe, dhe është në gjendje të zbatojë rregulla gramatikore në të folur dhe shkrim. Përvetëson njohuri themelore të tekstologjisë dhe stilistikës.

Nxënësi pasuron vazhdimisht fondin e tij leksikor, dhe prej tij, sipas situatës, ai zgjedh dhe përdor shprehje të përshtatshme. Ata zhvillojnë një nevojë natyrore për të mësuar, ruajtur dhe ushqyer gjuhën e tyre amtare.

Nxënësi i njeh veprat letrare të përcaktuara nga kurrikula, dhe është në gjendje t'i vendosë ato sipas opusit të autorit dhe kontekstit letrar-historik. Ai dallon qartë karakteristikat themelore poetike dhe stilistike të epokave stilistike dhe drejtimeve të letërsisë shqiptare dhe botërore. Njoh karakteristikat gjuhësore, kompozicionale dhe stilistike të teksteve dhe është në gjendje të përdorë argumente për të argumentuar përfundimet e tyre. Zhvillon zakonet e të lexuarit, mëson rolin e të lexuarit në njohjen e vetvetes.

Nxënësi njihet me përdorimin e manualeve, me rregullat e përdorimit të bibliotekës, merr njohuri për mënyrat e mbledhjes së informacionit përmes Internetit. Ai është i qartë për rregullat e gjuhës elektronike, si dhe sistemin e rregullave të nevojshme për krijimin e dokumenteve elektronike. Përdor fjalorët më të rëndësishëm, rregullat e drejtshkrimit, njeh strukturën e artikullit të fjalorit.

Niveli i mesëm

Nxënësi përballet mirë në situata të ndryshme të komunikimit publik. Ai flet para një audiencë mbi tema gjuhësore, letrare dhe kulturore. Ai gjithashtu paraqet mendimet e tij pikërisht kur harton tekste më komplekse të gjuhës gojore ose të shkruara. Ka një shije të formuar leximi. Ai i kupton dhe interpreton tekstet më të gjata, thjesht të lidhura letrare dhe joletrare gjatë leximit, që synojnë të fitojnë përvojë dhe me një qëllim shkencor. Ai rishikon në mënyrë kritike tekstet letrare dhe joletrare.

Nxënësi ka një njohuri më të gjerë për karakteristikat e gjuhës, rolin, funksionet dhe ka një njohuri themelore të gjuhëve të botës. Ai menaxhon në botën e mediave masive, njihet me zhanret e mediave. Ai njihet me origjinën e gjuhës shqipe, epokat e saj historike, si dhe historinë e zhvillimit të letërsisë shqipe. Ai e kupton që gjuha jeton në variante, bën dallimin midis dialekteve dhe varianteve gjuhësore shoqërore. Ai ka një njohuri më të gjerë për gramatikën e niveleve të gjuhës (fonetikë, leksikë, sintaksë, tekstologji). Ai analizon tekste të ndryshme bazuar në njohuritë e tij për stilistikën dhe aspektet e klasifikimit të llojeve të teksteve, dhe krijon veprat e tij.

Nxënësi pasuron përgjithmonë fondin e tij leksikor, zbaton njohuritë e tij për gjuhën dhe gramatikën në praktikë, ai mund të shprehet saktësisht, qartë dhe ndryshe.

Nxënësi interpreton me vetëbesim temën, mesazhin e teksteve letrare, karakteristikat e tyre kompozicionale, poetike, stilistike, gjuhësore dhe zhanre. Ai i njeh konceptet e teorisë letrare dhe i zbaton ato kur interpreton veprat letrare. Lexon tekste me mirëkuptim. Në mënyrë të pavarur njeh dhe analizon çështjet themelore të veprave letrare, shpjegon mendimin e tij me argumente bindëse. Njoh natyrën dhe karakteristikat e lidhjeve midis letërsisë dhe arteve të tjera.

Nxënësi është i njohur me rregullat në lidhje me përdorimin e bibliotekës dhe manualeve, d.m.th. Internetit për të mbledhur informacion. Mund të përdorë një program për përpunimin e fjalëve për të hartuar një tekst që përputhet me rregullat e drejtshkrimit.

Niveli i avancuar

Nxënësi përvetëson aftësinë për të diskutuar tema komplekse letrare, kulturore dhe gjuhësore të përcaktuara nga materiali mësimor. Ai ka një aftësi të zhvilluar për retorikë. Ai krijon tekste profesionale në të cilat merret me tema gjuhësore dhe letrare.

Zhvillon aftësinë për të lexuar dhe interpretuar tekste, me vetëdije ushqen rolin pritës (lexues). Ai zhvillon një qasje kritike, të udhëhequr nga mendimi i tij dhe kur interpreton tekste më të ndërlikuara letrare dhe joletrare. Ajo njeh tiparet kompozicionale dhe stilistike të teksteve me siguri. Përveç leximit të detyrueshëm në shtëpi, ai mund të interpretojë edhe tekste që ai zgjedh vetë. Kur prezanton mendimin e tij, ai aplikon teknikën e argumentimit të pjekur. Ai bëhet një lexues i rregullt, duke përshtatur strategjitë e leximit me karakteristikat e një vepre të caktuar letrare dhe qëllimet e leximit (përvoja, kërkimi, krijimi). Ai është në gjendje të përdorë në mënyrë të pavarur njohuritë e tij për lidhjen midis degëve të ndryshme të artit për të zbuluar lidhje intermediative.

Ai ka njohuri të gjera për gjuhën dhe sistemin e gjuhës shqipe, si dhe zhanret e vjetër dhe të rinj të komunikimit. Njeh dhe krahason karakteristikat poetike, kompozicionale dhe stilistike të teksteve. Ai zbaton njohuritë teorike të marra në lidhje me mjetet gjuhësore të shtresave stilistike në praktikë (kur analizon dhe krijon tekste). Ai njihet me drejtimet e gjuhësisë moderne dhe i vë njohuritë e marra në një kontekst ndërdisiplinor. Ndërsa mëson karakteristikat pragmatike të tekstit, kështu që akti i funksionimit të gjuhës i zbulohet atij, hapen mundësi të shumta për të analizuar kuptimin e tekstit.

Ai administron bibliotekën, manualet dhe internetin me siguri. Kur interpreton vepra letrare, ai rregullisht përdor letërsi më të gjerë profesionale. Duke pasur parasysh rregullat etike në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit, ai krijon veprat e tij duke përdorur përparësitë dhe mjetet e mediave dixhitale. Ai zbaton një sistem rregullash të nevojshme për krijimin e dokumenteve elektronike, në përputhje me rregullat gjuhësore të dokumenteve elektronike.

Studenti ka një njohuri të gjerë për karakteristikat e përgjithshme të gjuhës, funksionet e tij dhe sistemin e gjuhës shqipe (rreth niveleve të ndryshme të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë,

tekstologji). Duke pasur njohuri për tekstologjinë, ai është në gjendje të vartësojë faktorët e botës tekstuale në aspektet e përpunimit të tekstit. Ai fiton njohuri në drejtimet e gjuhësisë moderne, dhe zbaton njohuritë e marra gjatë përpilimit të punimeve të projektit të tij. Kupton natyrën e marrëdhënies midis gjuhësisë dhe fushave të tjera shkencore.

KOMPETENCA E VEÇANTA

Gjuha shqipe dhe komunikimi

Niveli bazë

Nx[nësi përvetëson njohuri për rolin themelor të gjuhës, karakteristikat dhe funksionet e tij komunikuese. Ai tregon respekt për gjuhën e tij amtare, si dhe gjuhën dhe kulturën e popujve të tjerë. Në nivelin bazë, ai zotëron sistemin e gjuhës shqipe (gramatika e niveleve të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji).

Nxënësi gjendet mirë në nivele më të ulëta të tekstit, përvetëson njohuri për fonetikë, dallon llojet e fjalëve, njeh sistemin morfologjik të gjuhës shqipe. Ai është në gjendje të formulojë në mënyrë të pavarur mendimet e tij, në përputhje me normat gjuhësore, fjalitë e qarta dhe të sakta dhe të analizojë fjalitë në një nivel bazë. Përvetëson njohuri për marrëdhëniet midis shenjës dhe kuptimit, njihet me zhvillimin historik të gjuhës shqipe.

Njoftohet me karakteristikat e përgjithshme të tekstit, shtresat stilistike, konceptet themelore të stilistikës, llojet e teksteve. Mund të përcaktojë elementet e teksteve të shkurtra (temën, titullin, analizën, paragrafët), njeh forcën lidhëse, elementët lidhës të tekstit.

Ai mëson rregullat e shqiptimit të saktë, mjetet e shprehjes gjuhësore të kultivuar. Në mënyrë ekspresive dhe besnike, ai rrëfen fragmente më të shkurtër tekstesh, memorizuesish, në origjinal.

Përdor fjalorët më të rëndësishëm të gjuhës shqipe, rregullat e drejtshkrimit dhe fiton përvojë në mbledhjen e informacionit nga Interneti. Miraton rregullat e sjelljes së gjuhës dhe rregullat etike të komunikimit në internet. Ai me edukatë dhe argumentim shpreh mendimin e tij në debate mbi temën nga materiali mësimor dhe çështje nga jeta e përditshme.

Ai e ndërton strategjinë e tij të diskutimit në paraqitjen e argumenteve në një mënyrë logjike dhe të dëgjojë me kujdes mendimet e njerëzve të tjerë. Mund të përdor llojet themelore të teksteve të shkruara joformale dhe formale (lutjet, CV, letër motivuese, ankesë), si dhe programe kompjuterike dhe teknika prezantimi. Në fund të shkollimit, ai shkruan një punim diplome, duke respektuar kërkesat tematike, stilistike dhe kompozicionale në lidhje me shkrimin e një punimi profesional.

Niveli i mesëm

Nxënësi tregon njohuri më të plota të veçorive të sistemit gjuhësor. Nocioni i farefisnisë së gjuhëve është i qartë për të, ashtu si dhe sistemi i marrëdhënieve të farefisnisë midis gjuhëve. Di dhe zbaton në shprehjen e rregullave të shqiptimit të saktë dhe mjeteve të të folurit të kultivuar. Gjatë leximit me zë të lartë dhe interpretimit të teksteve letrare, si dhe në situata të komunikimit të përditshëm, ai krijon prodhimin e tij në bazë të njohurive për mjetet e fonetikës së tekstit. Di dhe zbaton rregullat themelore të drejtshkrimit.

Nxënësi zhvillon një kuptim të konceptit të integritetit të sistemit gjuhësor. Ai ka një njohuri më të plotë mbi sistemin e llojit të fjalëve dhe strukturën e fjalive. Duke përdorur aftësinë për të analizuar me siguri, ai përdor sistemin morfologjik të gjuhës amtare, njeh pjesë të një fjalie dhe i analizon duke përdorur modele të përshtatshme të fjalive.

Njeh tiparet stilistike të llojeve dhe zhanreve të ndryshëm të teksteve, si dhe mjeteve stilistike. Ai është i sigurt në temën e komunikimit masiv, njihet me zhanret e mediave.

Ai lexon në mënyrë ekspresive, pasuron fondin e tij leksikor, në situata të ndryshme të të folurit ai shprehet në përputhje me rrethanat komunikuese, dhe në shprehjen e folur dhe të shkruar përdor elemente të përshtatshme të fjalorit.

Informohet nga burime të shtypura dhe elektronike. Ai mund të hartojë lloje më të ndërlikuara të teksteve, ai shprehet saktësisht dhe qartë. Në mënyrë të pavarur përgatit letra për tema të ndryshme.

Niveli i avancuar

Nxënësi ka një njohuri më të gjerë për karakteristikat e përgjithshme të gjuhës, funksionet e saj dhe sistemin e gjuhës shqipe (rreth niveleve të ndryshme të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji). Duke pasur njohuri për tekstologjinë, ai është në gjendje t`i vartësojë faktorët e botës tekstuale në aspektet e përpunimit të tekstit. Ai i di karakteristikat formale të përmbajtjes së zhanreve të reja të komunikimit dhe llojeve të teksteve në internet, dhe në mënyrë të pavarur formon një mendim rreth tyre.

Tiparet pragmatike të tekstit janë të qarta për të. Fiton njohuri në drejtimet e gjuhësisë moderne, zbaton njohuritë e tij gjatë përpilimit të dokumenteve të projektit. Njoh natyrën e lidhjeve midis gjuhësisë dhe fushave të tjera shkencore.

Duke aplikuar njohuri për retorikën, ai është në gjendje të krijojë dhe të paraqesë një tekst argumentues bindës, duke përdorur me vetëdije mjete gjuhësore dhe jo-gjuhësore të interpretimit të tekstit, duke marrë parasysh pritjet e dëgjuesve. Krijon dhe interpreton tekste të ndryshme profesionale, gazetare dhe letrare, duke mbajtur në vëmendje shkallën e krijimit të tekstit, në një stil që i përgjigjet situatës së të folurit dhe zhanrit, duke aplikuar elementet e duhura të lidhjes.

Ai është në gjendje të kryejë punë kërkimore në bibliotekë, mbledh në mënyrë të pavarur dhe klasifikon informacione me qëllim të punimeve të shkruara, paraqitjeve dhe eseve, në të cilat ai paraqet mënyrën e tij individuale të të gjykuarit.

KOMPETENCAT E VEÇANTA: Letërsia

Niveli bazë

Lexon qartë dhe rrjedhshëm. Ai është në gjendje të lexojë tekste letrare dhe joletrare, kupton dhe parafrazon tekste të shkurta letrare të thjeshta. Ai është në gjendje të përmbledhë temën e një vepre letrare, dallon informacionin e kërkuar në një tekst jo letrar. Ai i njeh veprat letrare të përcaktuara me planin dhe programin mësimor, krijimtarin e autorëve dhe karakteristikat më të rëndësishme përmbajtësosoro-formale të epokave letrare. Dallon letërsinë gojore nga ajo e shkruar. Ai i di karakteristikat e poezisë popullore dhe autoritare, si dhe lidhjen e tyre. Njeh tiparet formale, stilistike dhe zhanre të veprave letrare, është në gjendje të formulojë temën dhe karakteristikat e botës së tyre tekstuale. Interpreton pyetje që lidhen me tekste letrare të thjeshta. Ai e kupton rëndësinë e leximit për zhvillimin e personalitetit të tij dhe fondit leksikor. Kur shpreh përshtypjet dhe konkluzionet e tij, ai i referohet shembujve nga tekstet letrare dhe joletrare. Ai mund të bëjë dallimin midis përmbajtjes litrare dhe asaj transmetuese, metaforike. Mund të përcaktojë vendin e letërsisë në sistemin e artit (muzikë, film, arte të bukura, teatër, etj.). Përvetëson njohuri ndërdisiplinore.

Niveli i ndërmjetëm

Njeh strategjitë themelore të leximit dhe di si t'i përdorë ato në situata të dhëna leximi. Ai përdor më shumë këndvështrime në interpretimin e tij dhe i konsideron në mënyrë kritike tekste të gjata, të thjeshta letrare dhe joletrare. Duke përdorur njohuritë e marra sipas programit mësimor, ai interpreton dhe dallon elementet të rëndësishme të përbërjes dhe shtresave të kuptimit të një vepre letrare, karakteristikat stilistike, gjuhësore dhe formale të saj. Ai i njeh konceptet themelore letrare, teoriko – letrare, termat, dhe kur interpreton veprat letrare i përdor ato në harmoni me qëllimin. Në mënyrë të pavarur analizon çështje që lidhen me veprat letrare, argumenton gjykimin e tij për to. Ai është në gjendje të zbulojë lidhje midis veprave të ndryshme letrare, epokave dhe drejtimeve stilistike. Zbulon lidhjet intertekstuale dhe ndërdisiplinore midis veprave letrare. Kupton dhe vlerëson lidhjen midis letërsisë dhe arteve të tjera. Merr një qëndrim të qartë ndaj tekstit të lexuar. Ai zgjedh në mënyrë të pavarur veprat për të lexuar nga vargu i letërsisë, i përshtatshëm për moshën e tij. Vë në dukje kureshtjen e lexuesit. Kupton rëndësinë e leximit për zhvillimin e kulturës dhe njohurive të tij të përgjithshme. Në mënyrë eksploruese dhe krijuese, ai përvetëson një aftësi leximi që mund ta përdorë, gjatë studimit të veprave dhe zhanreve të ndryshme letrare, me ndihmën e të cilave mund të zhvillojë identitetin e tij letrar, gjuhësor, kulturor dhe kombëtar.

Niveli i avancuar

Me dëshirë, kureshtje hulumtuese dhe mënyrë kritike lexon, interpreton dhe vlerëson tekste komplekse letrare dhe joletrare të rekomanduara nga programi mësimor, por gjithashtu me kënaqësi liston dhe interpreton si veprat e rekomanduara dhe ato të zgjedhura në mënyrë të pavarur. Në mënyrë të pavarur vëren dhe interpreton çështje që trajtohen në veprat letrare. Ai përdor disa këndvështrime, kur interpreton vepra letrare, ai është në gjendje t'i vendosë ato në një kontekst të ndërmjetëm ndërdisiplinor: lidh ato me degë të tjera artistike dhe fusha shkencore. Ai përvetëson aftësinë e krahasimit të tipareve të shquara tematike dhe formale – stilistike të veprave letrare. Ai përvetëson një teknikë të zhvilluar të argumentimit kur shpreh mendimin e tij mbi tekstin dhe përfundimet e tij. Kur interpreton vepra letrare të përcaktuara nga programi mësimor, ai hulumton tërësisht letërsinë profesionale të shkruar dhe elektronike. Zbaton strategjitë e leximit në përputhje me detyrën e leximit. Ai përvetëson një kulturë të zhvilluar leximi, leximi i një vepre letrare është një përvojë për të. Përmes leximit, ai pasuron njohuritë e tij, fondin leksikor, zhvillon aftësinë e argumentimit, di të shprehë mendimin e tij, di të mbrojë pozicionin e tij. Ai mund t'u rekomandojë vepra letrare të tjerëve dhe të shpjegojë zgjedhjen e tij. Ai tregon respekt për vlerat e letërsisë dhe kulturës kombëtare dhe për kulturën e kombeve të tjera. Ai pasuron njohuritë e tij ndërkulturore duke u njohur me përkthimet e veprave letrare të huaja dhe kontaktet me kombet e tjera. Ai aplikon një aspekt kritik kur zgjedh midis burimeve të letërsisë profesionale në lidhje me veprat letrare në internet, ai u jep përparësi revistave cilësore.

Rezultatet e mëposhtme përshkruajnë atë që nxënësi e di dhe është në gjendje ta bëjë në **nivelin themelo**r të çdo fushë të njohurive.

GJUHA DHE LETËRSIA SHQIPE
(Klasa e katër)

Standardet e përgjithshme të arritjeve – Standardet arsimore për përfundimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për lëndën Gjuhë dhe Letërsi shqipe përmbajnë standarde e arritjeve për fushat: Gjuha, Letërsia dhe Kultura e Gjuhës. Brenda secilës fushë/temë, janë përshkruar kërkesat në tre nivele.

Standardet e përgjithshme të arritjeve – standardet arsimore për fund të arsimit të mesëm për lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe:	**REZULTATET** Nxënësi është në gjendje që:	**PËRMBAJTJA**
2GJSH.1.1.1. Posedon njohuritë elementare për gjuhën (ç'është gjuha, si funksionon, veçoritë e saj) etj. Respekton gjuhën e tij dhe gjuhën e të tjerëve; përdor fjalë (shprehje) stereotipe për gjuhën. E di nocionin e tekstit dhe dallon pjesët e tij (hyrjen, pjesën kryesore, përmbajtjen, përfundiminfundin), po ashtu dallon llojet e teksteve (varësisht nga diskursi). Ka njohuri për sociolinguistikën sidomos për njëgjuhësinë (monolinguizmin) dhe shumëgjuhësisë (polilinguizmin) dhe njeh rastet gjegjëse gjuhësore në Shqipëri, Kosovë, Mqedoni, Serbi…). E di konceptin e varietetit gjuhësor dhe njeh varietete themelore të gjuhës. 2GJSH.1.1.2. Dallon gjuhën letrare (standarde) nga dialekti; e di ndarjen dialektore të gjuhës shqipe; ka njohuri për dialektin e tij dhe për dialektin tjetër të gjuhës shqipe si dhe për të folmet e tjera dhe kështu përdor fjalë apo shprehje nga e folmja e tij, nganjëherë edhe nga e folmja e palës tjetër, por gjithmonë është konservator ndaj varietetit gjuhësor së cilës i përket. Me shembuj mund t'i paraqes veçoritë që i dallojnë të dy dialaktet e shqipes (nga aspekti fonetik, gramatikor e leksikor) dhe kështu mund ta mësojë, ta ruaj e ta kultivojë edhe më shumë gjuhën letrare. Njeh gramatikat kryesore dhe librat normativë të shqipes, të cilat i përdor në situata të caktuara. E di që gjuha shqipe zë një vend të rëndësishëm në rrethin e gjuhëve indoevropiane, duke pasur një traditë të gjatë të të folurit dhe të shkruarit dhe kjo ka po ashtu një rëndësi të madhe për kulturën	• zotëron njohuri gramatikore dhe leksikore që mundësojnë nivele të larta arritjeje në lexim-shkrim; • analizon ndryshimet mes gjuhës së folur dhe të shkruar, mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve e shtresave leksikore dhe gjuhës standarde; • vlerëson me argumente pasurinë leksikore të gjuhës shqipe; • kërkon materiale ose botime në biblioteka dhe në internet për të gjetur informacionin e nevojshëm për sistemin gjuhësor tëshqipes; • vlerëson zbatimin e rregullave të drejtshkrimit dhe të pikësimit, si të domosdoshme në çdo profesion dhe veprimtari të jetës njerëzore; • përkufizon konceptet "fjalë" e "morfemë" si koncepte gjuhësore; • përcakton llojet e morfemave; • bën dallimin e analizës morfemore dhe analizës fjalëformuese; • liston mënyrat e fjalëformimit të fjalëve;	**– Teksti** – Teksti përshkrues – Teksti rrëfyes, bindës – Kronika – Reportazhi – Autobiografia – Ditari – Letra – Kujtimet – Teksti udhëzues – Rregullat, ligjet – Udhëzuesit, recetat – Teksti argumentues, fjalimet politike, eseja argumentuese, debate – Teksti informues-shpjegues – Leksioni, lajmi – Kryeartikulli, artikulli me komente – Intervista – Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit – Fjalia e thjeshtë dhe e përbërë – Fjalia me bshkërendtije dhe me nënërenditje, skemat – Gjuha dhe komunikimi, stilet, ligjërimet

shqiptare. Ka njohuri për etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, fillimet e shkrimit të shqipes dhe rregullat e drejtshkrimit.	• dallon llojet e prejardhjes mes tyre; • pasuron leksikun e tij me sa më shumë fjalë të përbëra • shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj që kanë *-ia,-ie,-iu,* me **i** të theksuar në trup të tyre;	– Eseja dhe llojet e saj.
2GJSH.1.1.3. E di nocionin e theksit. Në fjali mund t'i dallojë llojet e theksave (theks i lirë, dinamik, ritmik, logjik, i fjalisë). Mund t'i ndajë tingujt në: tinguj zanorë dhe bashkëtingëllorë dhe i bashkon në formimin e fjalëve duke i dhënë kuptim atyre. Kur shqipton me zë më të fortë ose me zë më të ngritur një fjalë a një pjesë të fjalisë, mund ta vë rëndësinë kuptimore të saj dhe kështu i heton dallimet eventuale mes akcentit të tij nga ai letrar. 2GJSH.1.1.4. E di definicionin e fjalës dhe karakteristikat e saj. Njeh njësitë themelore të gjuhës (fonemën, morfemën, fjalën, togfjalëshin dhe fjalinë). Ndan fjalët në njësi më të vogla gjuhësore si p.sh.: fjalët për-pun-oj, kënd-o-j etj, Fjalën mund ta analizoj nga aspekti gramatikor me parashtesa, prapashtesa e mbaresa. Njeh mënyrat elementare të ndërtimit të fjalëve. Fjala si strukturë ka dy anë: përmbajtjen dhe formën dhe kështu dallon aspektin leksiko-gramatikor nga ai fonetiko-gramatikor. 2GJSH.1.1.5. Fjalinë e shkruan sipas rregullave gramatikore; mund t'i klasifikojë njësitë sintaksore; dallon fjalitë pohore dhe mohore; analizon fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra. 2GJSH.1.1.6. Ka një fond leksikor, i cili i përmbush nevojat në nivelin e mesëm të arsimimit; bën dallimin mes leksikut letrar dhe joletrar dhe i përdor sipas situatës së krijuar; ka njohuri për domethënien e fjalës; njeh grupet (paradigmat) e fjalëve: sinonimet, antonimet, homonimet; njeh metaforën si mekanizëm leksikor. Nëse ndonjë fjalë ka prejardhje të huaj, e përdorë dhe nuk ndien ndonjë "armiqësi" ndaj saj. Por, nganjëherë bën edhe kritika	• shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj me *-oo-*; • shkruan drejt fjalët nga latinishtja ose nga gjuhët romane si dhe nga greqishtja; • Klasifikon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra; • Bën tabelën e klasifikimit të tyre; • Përcakton tiparet e përbashkëta dhe dallimet; • Rikujton njohuritë rreth lidhëzave; • Klasifikon lidhëzat;	

për shkak të futjes së saj në strukturën e shqipes. Njeh nocionin e frazeologjisë. Përdor fjalorët e gjuhës shqipe (Fjalorin drejtshkrimor, frazeologjik, sinonimik) etj. 2GJSH.2.1.1. Ka njohuri më të thella për gjuhën në krahasim me nivelin fillestar; Njeh njësitë, të cilat i përkasin niveleve të ndryshme të gjuhës, pra nënsistemet; Ka njohuri për shkrimin e letrave. Tashmë njeh parimet kryesore të gjuhës shqipe si parimin fonetik, morfologjik, etimologjik etj.; I di disa gjëra elementare për gjuhët e botës (ngjajshmëritë gjuhësore, përbashkësitë (universaliet) gjuhësore; I njeh parimet e zhvillimit të dialogut; kupton nocionin e aktit të të folurit; në tekst dallon pjesëzat dëftuese apo deiksin; Njeh varietetet gjuhësore të shqipes gjatë paraqitjes së një moderatori në medie kur ai flet në vernakularin gjuhësor – krahinor, pra nëse përdor ndonjë fjalë apo shprehje nga rajoni i tij. 2GJSH.2.1.2. I di tiparet dalluese të të dy dialekteve të gjuhës shqipe; P.sh.: në sistemin fonetik për gegërishten është karakteristike seria e zanoreve hundore kurse në toskërishte ka vetëm zanore gojore (hĩ-ni, rê-ja, zã-ni-gegërishte dhe hi-ri, re-ja, zë-ri- toskërishtja); toskërishtja ka **"ë"** në serinë e zanoreve të theksuara kurse gegërishtja nuk e ka, pra ajo i përgjigjet toskërishtes me **ã**; gegërishtja ka grupin nistor **vo** kurse toskërishtja ka grupin **va** (vaj, varr, vatër-toskërishtja., dhe voj, vorr, votër-gegërishtja) etj.; Në toskërishte ruhen grupet **mb, nd, ng** ndërkaq në gegërishte kanë dhënë **m, n, n**; Po ashtu e di se këto dialekte veçohen edhe nga tiparet morfologjike e leksikore; Mund t'i rirendis etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, të cilat janë të njohura edhe më parë; 2GJSH.2.1.3. Njeh aparatin e të folurit dhe mënyrën se si prodhohen tingujt; dallon tingujt sipas pikëpamjes së artikulimit; e jep definicionin për fonemën; bën ndarjen fonetike të të folurit dhe në		

një frazë apo sintagmë spikat llojin e theksit (theks logjik, emfatik apo emocional) dhe kështu në mënyrë të drejtë mund ta shqiptojë fjalën në njësitë e lartëpërmenduara; njeh mekanizmat e ndryshimit të tingujve (ndryshimet kombinatore) siç janë: asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat e tingujve (proteza, epenteza, epiteza), rëniet e tingujve (afereza, sinkopa, apokopa). 2GJSH.2.1.4. Ka njohuri të gjera për fjalën dhe veçoritë e saj; e di se forma e fjlaës është fonetiko-gramatikore sepse përbëhet nga elemente fonetike e gramtikore duke e paraqitur me shembull si bie fjala: emri *vëlla-i* ka tingujt e nyjëtuar *v-ë-ll-a-i* dhe temën fjalëformuese *vëlla-* dhe mbaresën –*i*, e cila tregon gjininë, numrin, rasën e trajtën e emrit; e njeh termin morfemë; ndan apo zbërthen fjalën në morfema si p.sh.: mal-or, qytet-ar, hekur-os, lag-a, mal-i, për-dredh, sh-thur etj., dhe në bazë të shembujve dallon morfemat rrënjore, parashtesore e prapashtesore; i di anët kryesore të strukturës së fjalës (përmbajtjen dhe formën); zbaton kriterin theksor (akcentologjik) si kriter dallues i fjalës së një tipari fonetik. 2GJSH.2.1.5. Gjatë procesit të ligjërimit, përdor fjalë duke i bashkuar për ta shprehur e transmetuar mendimin dhe ato (fjalë) duke hyrë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore krijojnë njësi të ndryshme sintaksore; dallon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra; analizon fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme; ka njohuri të gjera rreth sintagmës; klasifikon fjalitë e varura; njeh termin elipsë; i di rasat dhe kategoritë gramatikore të foljes.		
2GJSH.2.1.6. Ka fond të pasur leksikor (leksikun individual e të huaj); është i njoftuar për prefiksat e sufiksat që përdoren nga gjuhët e huaja në shqipen; fondin leksikor e shfrytëzon sipas rastit; sipas tij, gjuha është i vemi mjet i komunikimt që shërben për ta shprehur mendimin e tij, por edhe		

përvojën individuale dhe kështu e pasuron edhe më tepër fjalorin; njeh hiperoniminë, hiponiminë, paroniminë; dallon shtresat leksikore; njeh metaforën dhe metoniminë si mekanizma leksikorë. 2GJSH.3.1.1. E di që ekziston lidhja e afërt mes gjuhës dhe mendimit dhe e di nocionin e tyre; e jep përkufizimin e fjalisë duke e ditur gjithashtu se ajo ka dy anë: anën kuptimore dhe anën strukturore; dallon kohezionin leksikor dhe gramatikor. 2GJSH.3.1.2. Gjatë ndarjes së fjalëve në rrokje, përdor mjetet fonetike për spikatjen e saj (rrokjes) si: gjatësinë dhe forcën. 2GJSH.3.1.3. Ka njohuri për morfologjinë në kuptimin e gjerë të fjalës, në të cilën jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes..; e ndan apo e zbërthen fjalën në morfema duke e dalluar morfemën rrënjë, parashtesore dhe prapeshtesore. 2GJSH.3.1.4. Ka njohuri më të gjera për përdorimin e rasave dhe të formave foljore; mund t'i analizojë fjalitë nga pikëpamja morfologjike (duke i gjetur pjesët e ligjëratës); i njeh tipat e fjalive; dallon kryefjalën, kallëzuesin dhe gjymtyrët e dyta duke i analizuar sintaksorisht. 2GJSH.3.1.5. Ka njohuri themelore për fjalorët dhe për strukturën e tyre.		
2GJSH.1.2.1. Njeh autorët nga programi obligativ shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letraro-historik. 2GJSH.1.2.2. Njeh terminologjinë e teorisë së letërsisë, në të cilën njihen shkrimet e veçanta dhe ku letërsia trajtohet në mënyrë teorike. 2GJSH.1.2.3. Në interpretimin e pjesëve letraro – artistike dhe pjesëve letraro-shkencor, dallon metodat e qasjes së brendshme dhe të jashtme. 2GJSH.1.2.4. Vëren dhe me shembuj argumenton tiparet letrare, poetike,	• përshkruan dhe analizon kushtet historike në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; • analizon dhe gjykon pasojat që shkaktuan dy luftërat botërore; • përshkruan dhe analizon realitetin shoqëror në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; • rendit disa nga zbulimet e mëdha në shkencat e natyrës, të	**– Letërsi botërore** – Letërsia botërore e shek. XX **– Franc Kafka**, jeta vepra – Metamorfoza – analizë **– Alber Kamy ,** filozofia absurdi, I huaji – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shek. XX** **– Gjergj Fishta,** simbol i madhështisë së poezisë shqipe

gjuhësore, estetike e strukturore të veprave letrare. 2GJSH.1.2.5. I di tiparet e letërsisë si dhe i shpjegon raportet e saj me gjuhën dhe marrëdhëniet me artet e tjera. 2GJSH.1.2.6. Paraqet tiparet historike dhe poetike të periudhave letrare, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe botërore duke përfshirë edhe shkrimtarët shqiptarë e të huaj nga lektura e obliguar shkollore. 2GJSH.1.2.7. Analizon pjesët letrare nga ato joletrare dhe mund t'i argumentoj teorikisht. 2GJSH.1.2.8. Shfrytëzon po ashtu literaturën sekondare qoftë letrare, historike, kritike, poetike, teorike duke i sjellë punimet e tij para të tjerëve. 2GJSH.1.2.9. Duke i lexuar veprat e letërsisë shqipe dhe botërore, e kupton rëndësinë e të lexuarit të pjesës letrare dhe kështu ky pozitivitet ndikon në formimin e identitetit të tij gjuhësor, letrar, kulturor e kombëtar. 2GJSH.2.2.1. Interpreton veprën letrare duke nxjerrë thelbin dhe veçoritë e saj; kontekstin historik; motivet letrare; tematikën para se gjithash; kompozicionin; figurat letrare; idenë e shkrimtarit; aspektin gjuhësor e stilistik etj. 2GJSH.2.2.2. Njeh terminologjinë e Teorisë së Letërsisë dhe njohuritë teorike-letrare i zbaton në mënyrë adekuate në interpretimin e pjesëve apo edhe veprave letrare. 2GJSH.2.2.3. Dallon metodat e qasjes së brendshme e të jashtme në interpretimin e pjesëve apo veprave letraro-arstistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistike. 2GJSH.2.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave letraro-artistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistik si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin,	cilat ndikuan në jetën e njeriut; • përcakton dhe analizon zhvillimet në shkencat shoqërore, si: psikologjia, filozofia, sociologjia; • dallon dhe analizon veçoritë e përgjithshme të letërsisë së shekullit XX, si: larmia e drejtimeve letrare, individualitete krijuese të spikatura dhe origjinale, veçori kombëtare të krijuesve; • përcakton dhe analizon tiparet e letërsisë që vijoi traditën realiste të shek. XIX; • analizon risitë që sollën shkrimtarët që ndoqën rrugën e letërsisë realiste të shek. XIX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsive të vendeve të ndryshme si dhe veprat e tyre letrare; • përcakton gjinitë dhe llojet letrare që lëvruan më shumë shkrimtarët që ndoqën prirjen realiste • përcakton veçoritë kryesore të letërsisë moderne; • dallon dhe analizon drejtimet (rrymat) kryesore letrare të letërsisë moderne të shek. XX; • analizon gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë moderne të shek. XX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë	Lahuta e Malcis – analizë, Vranina – koment, Kënga e Lulashit – koment **– Lasgush Poradeci ,** liriku i madh, Ylli i zemrës – analizë **– Migjeni,** poeti vullkanik Vargjet e lira, Novelat e qytetit të veriut – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shek. XX** **-Ismail Kadare,** ambasadori i letrave shqipe Pallati i ëndrrave – analizë **– Martin Camaj** **– Azem Shkreli,** mjeshtri i fjalës poetike – Lirikë me shi – analizë **Lektura shtëpiake:** *31. Franc Kafka – Procesi* *32. Dritëro Agolli – Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* *33. Ismail Kadare – Gjenerali i ushtrisë së vdekur* *34. Ernest Heminguej – Plaku dhe deti* *35. Gabriel G. Markez – Njëqind vjet vetmi* *36. Jakov Xoxa – Lumi i vdekur* **Vërejtje: arsimtari mund të bëjë zgjedhje të lirë të lekturave shtëpiake në pajtueshmëri me planin dhe programin për klasën e katërt të Gjimnazit.*

fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekstet apo veprat përkatëse. 2GJSH.2.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv dhe këto elemente e përcaktojnë edhe vetë llojin si: tragjedinë, komedinë, elegjinë etj. 2GJSH.2.2.6. Gjatë interpretimit të pjesëve letraro-artistike dhe letraro-shkencor, i përdor njohuritë paraprake nga fusha e teorisë së letërsisë; i njeh drejtimet dhe formacionet e zhvillimit të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.2.2.7. Në mënyrë të pavarur analizon pjesët letrare dhe mund t'i argumentojë qëndrimet e tij përballë të tjerëve. 2GJSH.2.2.8. Shfrytëzon literaturë shtesë nga letërsia, historia dhe fusha të tjera shoqërore, me qëllim të afirmimit të tij në interpretimin e pjesëve të tjera letraro-artistike e letraro-shkencor të parapara sipas planit dhe programit mësimor.	moderne, si dhe veprat e tyre letrare; • përshkruan dhe analizon risitë e letërsisë së kësaj periudhe; • rendit dhe analizon shkrimtarët që me krijimtarinë e tyre shërbyen si urë lidhëse mes letërsisë së shek. XIX dhe letërsisë së shek. XX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së kësaj periudhe dhe krijimtarinë e tyre; • vlerëson kontributin e shkrimtarëve të kësaj periudhe; • veçon dhe analizon risitë që sjell Kadare në letërsi pas viteve'90 analizon kushtet historike, shoqërore dhe politike pas Luftës së Dytë Botërore; përshkruan, analizon dhe gjykon për dukuritë letrare të kësaj periudhe;	
2GJSH.2.2.9. Duke i lexuar veprat letrare shqipe e botërore, e zhvillon edhe më shumë aftësinë shprehëse për interpretim dhe vlerësim të pjesëve të ndryshme letraro-artistike dhe letraro-shkencor , po ashtu e pasuron fondin leksikor, letrar, kulturor; me leximin e veprave të ndryshme, ai mund të bëhet më i arsimuar e më i kulturuar. 2GJSH.3.2.1. Lexon dhe analizon pjesët letraro-artistike dhe letraro-shkencor të parapara nga plani dhe programi mësimor dhe tekstet shtesë apo fakultative po ashtu letraro-artistike dhe letraro-shkencor duke i analizuar në kontekst më të gjerë historik. 2GJSH.3.2.2. Është i njoftuar me terminologjinë teorike-letrare duke e zbatuar në interpretimin e veprave		

letraro-artistike dhe letraro-shkencor të cilat janë të parapara me planin dhe programin mësimor; shfrytëzon edhe vepra të zhanreve të tjera, jashtë obligatives. 2GJSH.3.2.3. Në procesin e interpretimit të veprave përkatëse, zbaton metodat adekuate të qasjes së brendshme e të jashtme. 2GJSH.3.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave gjegjëse e publicistike si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekst. 2GJSH.3.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv. 2GJSH.3.2.6. Gjatë interpretimit dhe vlerësimit të veprave letraro-artistike dhe letraro- shkencor, zbaton dhe krahason tiparet historike e letrare (stilistike) të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.3.2.7. I vëren e i interpreton problemet dhe idetë në veprën letrare dhe qëndrimet e tij mund t'i argumentojë në bazë të tekstit primar dhe kontekstit letrar. 2GJSH.3.2.8. Për ta interpretuar (njohur) apo për t'i bërë analizë filologjike veprës letrare, duhet të ketë njohuri të caktuara, një kulturë letrare nga leximi i veprave të tjera që për nga rëndësia hyjnë në radhën e kryeveprave nacionale e botërore. 2GJSH.3.2.9. Pasi t'i ketë lexuar veprat letrare shqipe e botërore, të cilat janë obligative, dhe veprat letrare me përzgjedhje, vërehet aftësia e tij shprehëse kundrejt të tjerëve dhe me këto zhvillohet e pasurohet edhe më shumë identiteti i tij kulturor e arsimor.		

përfundimet e tij. Kur interpreton vepra letrare të përcaktuara nga programi mësimor, ai hulumton tërësisht letërsinë profesionale të shkruar dhe elektronike. Zbaton strategjitë e leximit në përputhje me detyrën e leximit. Ai përvetëson një kulturë të zhvilluar leximi, leximi i një vepre letrare është një përvojë për të. Përmes leximit, ai pasuron njohuritë e tij, fondin leksikor, zhvillon aftësinë e argumentimit, di të shprehë mendimin e tij, di të mbrojë pozicionin e tij. Ai mund t'u rekomandojë vepra letrare të tjerëve dhe të shpjegojë zgjedhjen e tij. Ai tregon respekt për vlerat e letërsisë dhe kulturës kombëtare dhe për kulturën e kombeve të tjera. Ai pasuron njohuritë e tij ndërkulturore duke u njohur me përkthimet e veprave letrare të huaja dhe kontaktet me kombet e tjera. Ai aplikon një aspekt kritik kur zgjedh midis burimeve të letërsisë profesionale në lidhje me veprat letrare në internet, ai u jep përparësi revistave cilësore.

Rezultatet e mëposhtme përshkruajnë atë që nxënësi e di dhe është në gjendje ta bëjë në **nivelin themelo**r të çdo fushë të njohurive.

GJUHA DHE LETËRSIA SHQIPE
(Klasa e katër)

Standardet e përgjithshme të arritjeve – Standardet arsimore për përfundimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për lëndën Gjuhë dhe Letërsi shqipe përmbajnë standarde e arritjeve për fushat: Gjuha, Letërsia dhe Kultura e Gjuhës. Brenda secilës fushë/temë, janë përshkruar kërkesat në tre nivele.

Standardet e përgjithshme të arritjeve – standardet arsimore për fund të arsimit të mesëm për lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe:	**REZULTATET** Nxënësi është në gjendje që:	**PËRMBAJTJA**
2GJSH.1.1.1. Posedon njohuritë elementare për gjuhën (ç'është gjuha, si funksionon, veçoritë e saj) etj. Respekton gjuhën e tij dhe gjuhën e të tjerëve; përdor fjalë (shprehje) stereotipe për gjuhën. E di nocionin e tekstit dhe dallon pjesët e tij (hyrjen, pjesën kryesore, përmbajtjen, përfundiminfundin), po ashtu dallon llojet e teksteve (varësisht nga diskursi). Ka njohuri për sociolinguistikën sidomos për njëgjuhësinë (monolinguizmin) dhe shumëgjuhësisë (polilinguizmin) dhe njeh rastet gjegjëse gjuhësore në Shqipëri, Kosovë, Mqedoni, Serbi…). E di konceptin e varietetit gjuhësor dhe njeh varietete themelore të gjuhës. 2GJSH.1.1.2. Dallon gjuhën letrare (standarde) nga dialekti; e di ndarjen dialektore të gjuhës shqipe; ka njohuri për dialektin e tij dhe për dialektin tjetër të gjuhës shqipe si dhe për të folmet e tjera dhe kështu përdor fjalë apo shprehje nga e folmja e tij, nganjëherë edhe nga e folmja e palës tjetër, por gjithmonë është konservator ndaj varietetit gjuhësor së cilës i përket. Me shembuj mund t'i paraqes veçoritë që i dallojnë të dy dialaktet e	• zotëron njohuri gramatikore dhe leksikore që mundësojnë nivele të larta arritjeje në lexim-shkrim; • analizon ndryshimet mes gjuhës së folur dhe të shkruar, mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve e shtresave leksikore dhe gjuhës standarde; • vlerëson me argumente pasurinë leksikore të gjuhës shqipe; • kërkon materiale ose botime në biblioteka dhe në internet për të gjetur informacionin e nevojshëm për sistemin gjuhësor tëshqipes; • vlerëson zbatimin e rregullave të drejtshkrimit dhe të pikësimit, si të domosdoshme në çdo profesion dhe	**– Teksti** – Teksti përshkrues – Teksti rrëfyes, bindës – Kronika – Reportazhi – Autobiografia – Ditari – Letra – Kujtimet – Teksti udhëzues – Rregullat, ligjet – Udhëzuesit, recetat – Teksti argumentues, fjalimet politike, eseja argumentuese, debate – Teksti informues-shpjegues – Leksioni, lajmi – Kryeartikulli, artikulli me komente – Intervista

shqipes (nga aspekti fonetik, gramatikor e leksikor) dhe kështu mund ta mësojë, ta ruaj e ta kultivojë edhe më shumë gjuhën letrare. Njeh gramatikat kryesore dhe librat normativë të shqipes, të cilat i përdor në situata të caktuara. E di që gjuha shqipe zë një vend të rëndësishëm në rrethin e gjuhëve indoevropiane, duke pasur një traditë të gjatë të të folurit dhe të shkruarit dhe kjo ka po ashtu një rëndësi të madhe për kulturën shqiptare. Ka njohuri për etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, fillimet e shkrimit të shqipes dhe rregullat e drejtshkrimit.	veprimtari të jetës njerëzore; • përkufizon konceptet "fjalë" e "morfemë" si koncepte gjuhësore; • përcakton llojet e morfemave; • bën dallimin e analizës morfemore dhe analizës fjalëformuese; • liston mënyrat e fjalëformimit të fjalëve; • dallon llojet e prejardhjes mes tyre; • pasuron leksikun e tij me sa më shumë fjalë të përbëra	– Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit – Fjalia e thjeshtë dhe e përbërë – Fjalia me bshkërendtije dhe me nënërenditje, skemat – Gjuha dhe komunikimi, stilet, ligjërimet – Eseja dhe llojet e saj.
2GJSH.1.1.3. E di nocionin e theksit. Në fjali mund t'i dallojë llojet e theksave (theks i lirë, dinamik, ritmik, logjik, i fjalisë). Mund t'i ndajë tingujt në: tinguj zanorë dhe bashkëtingëllorë dhe i bashkon në formimin e fjalëve duke i dhënë kuptim atyre. Kur shqipton me zë më të fortë ose me zë më të ngritur një fjalë a një pjesë të fjalisë, mund ta vë rëndësinë kuptimore të saj dhe kështu i heton dallimet eventuale mes akcentit të tij nga ai letrar. 2GJSH.1.1.4. E di definicionin e fjalës dhe karakteristikat e saj. Njeh njësitë themelore të gjuhës (fonemën, morfemën, fjalën, togfjalëshin dhe fjalinë). Ndan fjalët në njësi më të vogla gjuhësore si p.sh.: fjalët për-pun-oj, kënd-o-j etj, Fjalën mund ta analizoj nga aspekti gramatikor me parashtesa, prapashtesa e mbaresa. Njeh mënyrat elementare të ndërtimit të fjalëve. Fjala si strukturë ka dy anë: përmbajtjen dhe formën dhe kështu dallon aspektin leksiko-gramatikor nga ai fonetiko-gramatikor. 2GJSH.1.1.5. Fjalinë e shkruan sipas rregullave gramatikore; mund t'i klasifikojë njësitë sintaksore; dallon fjalitë pohore dhe mohore; analizon fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra. 2GJSH.1.1.6. Ka një fond leksikor, i cili i përmbush nevojat në nivelin e mesëm të arsimimit; bën dallimin mes leksikut letrar dhe joletrar dhe i	• shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj që kanë *-ia,-ie,-iu,* me **i** të theksuar në trup të tyre; • shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj me *-oo-*; • shkruan drejt fjalët nga latinishtja ose nga gjuhët romane si dhe nga greqishtja; • Klasifikon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra; • Bën tabelën e klasifikimit të tyre; • Përcakton tiparet e përbashkëta dhe dallimet; • Rikujton njohuritë rreth lidhëzave; • Klasifikon lidhëzat;	

përdor sipas situatës së krijuar; ka njohuri për domethënien e fjalës; njeh grupet (paradigmat) e fjalëve: sinonimet, antonimet, homonimet; njeh metaforën si mekanizëm leksikor. Nëse ndonjë fjalë ka prejardhje të huaj, e përdorë dhe nuk ndien ndonjë "armiqësi" ndaj saj. Por, nganjëherë bën edhe kritika për shkak të futjes së saj në strukturën e shqipes. Njeh nocionin e frazeologjisë. Përdor fjalorët e gjuhës shqipe (Fjalorin drejtshkrimor, frazeologjik, sinonimik) etj. 2GJSH.2.1.1. Ka njohuri më të thella për gjuhën në krahasim me nivelin fillestar; Njeh njësitë, të cilat i përkasin niveleve të ndryshme të gjuhës, pra nënsistemet; Ka njohuri për shkrimin e letrave. Tashmë njeh parimet kryesore të gjuhës shqipe si parimin fonetik, morfologjik, etimologjik etj.; I di disa gjëra elementare për gjuhët e botës (ngjajshmëritë gjuhësore, përbashkësitë (universaliet) gjuhësore; I njeh parimet e zhvillimit të dialogut; kupton nocionin e aktit të të folurit; në tekst dallon pjesëzat dëftuese apo deiksin; Njeh varietetet gjuhësore të shqipes gjatë paraqitjes së një moderatori në medie kur ai flet në vernakularin gjuhësor – krahinor, pra nëse përdor ndonjë fjalë apo shprehje nga rajoni i tij. 2GJSH.2.1.2. I di tiparet dalluese të të dy dialekteve të gjuhës shqipe; P.sh.: në sistemin fonetik për gegërishten është karakteristike seria e zanoreve hundore kurse në toskërishte ka vetëm zanore gojore (hĩ-ni, rê-ja, zã-ni-gegërishte dhe hi-ri, re-ja, zë-ri- toskërishtja); toskërishtja ka **"ë"** në serinë e zanoreve të theksuara kurse gegërishtja nuk e ka, pra ajo i përgjigjet toskërishtes me **ã**; gegërishtja ka grupin nistor **vo** kurse toskërishtja ka grupin **va** (vaj, varr, vatër-toskërishtja., dhe voj, vorr, votër-gegërishtja) etj.; Në toskërishte ruhen grupet **mb, nd, ng** ndërkaq në gegërishte kanë dhënë **m, n, n**; Po ashtu e di se këto dialekte veçohen edhe nga tiparet morfologjike e leksikore; Mund t'i		

rirendis etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, të cilat janë të njohura edhe më parë; 2GJSH.2.1.3. Njeh aparatin e të folurit dhe mënyrën se si prodhohen tingujt; dallon tingujt sipas pikëpamjes së artikulimit; e jep definicionin për fonemën; bën ndarjen fonetike të të folurit dhe në një frazë apo sintagmë spikat llojin e theksit (theks logjik, emfatik apo emocional) dhe kështu në mënyrë të drejtë mund ta shqiptojë fjalën në njësitë e lartëpërmenduara; njeh mekanizmat e ndryshimit të tingujve (ndryshimet kombinatore) siç janë: asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat e tingujve (proteza, epenteza, epiteza), rëniet e tingujve (afereza, sinkopa, apokopa). 2GJSH.2.1.4. Ka njohuri të gjera për fjalën dhe veçoritë e saj; e di se forma e fjlaës është fonetiko-gramatikore sepse përbëhet nga elemente fonetike e gramtikore duke e paraqitur me shembull si bie fjala: emri *vëlla-i* ka tingujt e nyjëtuar *v-ë-ll-a-i* dhe temën fjalëformuese *vëlla-* dhe mbaresën –*i*, e cila tregon gjininë, numrin, rasën e trajtën e emrit; e njeh termin morfemë; ndan apo zbërthen fjalën në morfema si p.sh.: mal-or, qytet-ar, hekur-os, lag-a, mal-i, për-dredh, sh-thur etj., dhe në bazë të shembujve dallon morfemat rrënjore, parashtesore e prapashtesore; i di anët kryesore të strukturës së fjalës (përmbajtjen dhe formën); zbaton kriterin theksor (akcentologjik) si kriter dallues i fjalës së një tipari fonetik. 2GJSH.2.1.5. Gjatë procesit të ligjërimit, përdor fjalë duke i bashkuar për ta shprehur e transmetuar mendimin dhe ato (fjalë) duke hyrë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore krijojnë njësi të ndryshme sintaksore; dallon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra; analizon fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme; ka njohuri të gjera rreth sintagmës; klasifikon fjalitë e varura; njeh termin elipsë; i di rasat dhe kategoritë gramatikore të foljes.		

2GJSH.2.1.6. Ka fond të pasur leksikor (leksikun individual e të huaj); është i njoftuar për prefiksat e sufiksat që përdoren nga gjuhët e huaja në shqipen; fondin leksikor e shfrytëzon sipas rastit; sipas tij, gjuha është i vemi mjet i komunikimt që shërben për ta shprehur mendimin e tij, por edhe përvojën individuale dhe kështu e pasuron edhe më tepër fjalorin; njeh hiperoniminë, hiponiminë, paroniminë; dallon shtresat leksikore; njeh metaforën dhe metoniminë si mekanizma leksikorë. 2GJSH.3.1.1. E di që ekziston lidhja e afërt mes gjuhës dhe mendimit dhe e di nocionin e tyre; e jep përkufizimin e fjalisë duke e ditur gjithashtu se ajo ka dy anë: anën kuptimore dhe anën strukturore; dallon kohezionin leksikor dhe gramatikor. 2GJSH.3.1.2. Gjatë ndarjes së fjalëve në rrokje, përdor mjetet fonetike për spikatjen e saj (rrokjes) si: gjatësinë dhe forcën. 2GJSH.3.1.3. Ka njohuri për morfologjinë në kuptimin e gjerë të fjalës, në të cilën jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes..; e ndan apo e zbërthen fjalën në morfema duke e dalluar morfemën rrënjë, parashtesore dhe prapeshtesore. 2GJSH.3.1.4. Ka njohuri më të gjera për përdorimin e rasave dhe të formave foljore; mund t'i analizojë fjalitë nga pikëpamja morfologjike (duke i gjetur pjesët e ligjëratës); i njeh tipat e fjalive; dallon kryefjalën, kallëzuesin dhe gjymtyrët e dyta duke i analizuar sintaksorisht. 2GJSH.3.1.5. Ka njohuri themelore për fjalorët dhe për strukturën e tyre.		
2GJSH.1.2.1. Njeh autorët nga programi obligativ shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letraro-historik. 2GJSH.1.2.2. Njeh terminologjinë e teorisë së letërsisë, në të cilën njihen	• përshkruan dhe analizon kushtet historike në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe;	**– Letërsi botërore** – Letërsia botërore e shek. XX **– Franc Kafka**, jeta vepra – Metamorfoza – analizë

shkrimet e veçanta dhe ku letërsia trajtohet në mënyrë teorike. 2GJSH.1.2.3. Në interpretimin e pjesëve letraro – artistike dhe pjesëve letraro-shkencor, dallon metodat e qasjes së brendshme dhe të jashtme. 2GJSH.1.2.4. Vëren dhe me shembuj argumenton tiparet letrare, poetike, gjuhësore, estetike e strukturore të veprave letrare. 2GJSH.1.2.5. I di tiparet e letërsisë si dhe i shpjegon raportet e saj me gjuhën dhe marrëdhëniet me artet e tjera. 2GJSH.1.2.6. Paraqet tiparet historike dhe poetike të periudhave letrare, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe botërore duke përfshirë edhe shkrimtarët shqiptarë e të huaj nga lektura e obliguar shkollore. 2GJSH.1.2.7. Analizon pjesët letrare nga ato joletrare dhe mund t'i argumentoj teorikisht. 2GJSH.1.2.8. Shfrytëzon po ashtu literaturën sekondare qoftë letrare, historike, kritike, poetike, teorike duke i sjellë punimet e tij para të tjerëve. 2GJSH.1.2.9. Duke i lexuar veprat e letërsisë shqipe dhe botërore, e kupton rëndësinë e të lexuarit të pjesës letrare dhe kështu ky pozitivitet ndikon në formimin e identitetit të tij gjuhësor, letrar, kulturor e kombëtar. 2GJSH.2.2.1. Interpreton veprën letrare duke nxjerrë thelbin dhe veçoritë e saj; kontekstin historik; motivet letrare; tematikën para se gjithash; kompozicionin; figurat letrare; idenë e shkrimtarit; aspektin gjuhësor e stilistik etj. 2GJSH.2.2.2. Njeh terminologjinë e Teorisë së Letërsisë dhe njohuritë teorike-letrare i zbaton në mënyrë adekuate në interpretimin e pjesëve apo edhe veprave letrare. 2GJSH.2.2.3. Dallon metodat e qasjes së brendshme e të jashtme në interpretimin e pjesëve apo	• analizon dhe gjykon pasojat që shkaktuan dy luftërat botërore; • përshkruan dhe analizon realitetin shoqëror në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; • rendit disa nga zbulimet e mëdha në shkencat e natyrës, të cilat ndikuan në jetën e njeriut; • përcakton dhe analizon zhvillimet në shkencat shoqërore, si: psikologjia, filozofia, sociologjia; • dallon dhe analizon veçoritë e përgjithshme të letërsisë së shekullit XX, si: larmia e drejtimeve letrare, individualitete krijuese të spikatura dhe origjinale, veçori kombëtare të krijuesve; • përcakton dhe analizon tiparet e letërsisë që vijoi traditën realiste të shek. XIX; • analizon risitë që sollën shkrimtarët që ndoqën rrugën e letërsisë realiste të shek. XIX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsive të vendeve të ndryshme si dhe veprat e tyre letrare; • përcakton gjinitë dhe llojet letrare që lëvruan më shumë shkrimtarët që ndoqën prirjen realiste • përcakton veçoritë kryesore të letërsisë moderne;	**– Alber Kamy ,** filozofia absurdi, I huaji – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shek. XX** **– Gjergj Fishta,** simbol i madhështisë së poezisë shqipe Lahuta e Malcis – analizë, Vranina – koment, Kënga e Lulashit – koment **– Lasgush Poradeci ,** liriku i madh, Ylli i zemrës – analizë **– Migjeni,** poeti vullkanik Vargjet e lira, Novelat e qytetit të veriut – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shek. XX** **-Ismail Kadare,** ambasadori i letrave shqipe Pallati i ëndrrave – analizë **– Martin Camaj** **– Azem Shkreli,** mjeshtri i fjalës poetike – Lirikë me shi – analizë **Lektura shtëpiake:** *37. Franc Kafka – Procesi* *38. Dritëro Agolli – Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* *39. Ismail Kadare – Gjenerali i ushtrisë së vdekur* *40. Ernest Heminguej – Plaku dhe deti* *41. Gabriel G. Markez – Njëqind vjet vetmi* *42. Jakov Xoxa – Lumi i vdekur* **Vërejtje: arsimtari mund të bëjë zgjedhje të lirë të lekturave shtëpiake në pajtueshmëri me planin dhe programin për klasën e katërt të Gjimnazit.*

veprave letraro-arstistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistike. 2GJSH.2.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave letraro-artistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistik si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekstet apo veprat përkatëse. 2GJSH.2.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv dhe këto elemente e përcaktojnë edhe vetë llojin si: tragjedinë, komedinë, elegjinë etj. 2GJSH.2.2.6. Gjatë interpretimit të pjesëve letraro-artistike dhe letraro-shkencor, i përdor njohuritë paraprake nga fusha e teorisë së letërsisë; i njeh drejtimet dhe formacionet e zhvillimit të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.2.2.7. Në mënyrë të pavarur analizon pjesët letrare dhe mund t'i argumentojë qëndrimet e tij përballë të tjerëve. 2GJSH.2.2.8. Shfrytëzon literaturë shtesë nga letërsia, historia dhe fusha të tjera shoqërore, me qëllim të afirmimit të tij në interpretimin e pjesëve të tjera letraro-artistike e letraro-shkencor të parapara sipas planit dhe programit mësimor.	• dallon dhe analizon drejtimet (rrymat) kryesore letrare të letërsisë moderne të shek. XX; • analizon gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë moderne të shek. XX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë moderne, si dhe veprat e tyre letrare; • përshkruan dhe analizon risitë e letërsisë së kësaj periudhe; • rendit dhe analizon shkrimtarët që me krijimtarinë e tyre shërbyen si urë lidhëse mes letërsisë së shek. XIX dhe letërsisë së shek. XX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së kësaj periudhe dhe krijimtarinë e tyre; • vlerëson kontributin e shkrimtarëve të kësaj periudhe; • veçon dhe analizon risitë që sjell Kadare në letërsi pas viteve'90 analizon kushtet historike, shoqërore dhe politike pas Luftës së Dytë Botërore; përshkruan, analizon dhe gjykon për dukuritë letrare të kësaj periudhe;	
2GJSH.2.2.9. Duke i lexuar veprat letrare shqipe e botërore, e zhvillon edhe më shumë aftësinë shprehëse për interpretim dhe vlerësim të pjesëve të ndryshme letraro-artistike dhe letraro-shkencor , po ashtu e pasuron fondin leksikor, letrar, kulturor; me leximin e veprave të		

ndryshme, ai mund të bëhet më i arsimuar e më i kulturuar. 2GJSH.3.2.1. Lexon dhe analizon pjesët letraro-artistike dhe letraro-shkencor të parapara nga plani dhe programi mësimor dhe tekstet shtesë apo fakultative po ashtu letraro-artistike dhe letraro-shkencor duke i analizuar në kontekst më të gjerë historik. 2GJSH.3.2.2. Është i njoftuar me terminologjinë teorike-letrare duke e zbatuar në interpretimin e veprave letraro-artistike dhe letraro-shkencor të cilat janë të parapara me planin dhe programin mësimor; shfrytëzon edhe vepra të zhanreve të tjera, jashtë obligatives. 2GJSH.3.2.3. Në procesin e interpretimit të veprave përkatëse, zbaton metodat adekuate të qasjes së brendshme e të jashtme. 2GJSH.3.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave gjegjëse e publicistike si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekst. 2GJSH.3.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv. 2GJSH.3.2.6. Gjatë interpretimit dhe vlerësimit të veprave letraro-artistike dhe letraro- shkencor, zbaton dhe krahason tiparet historike e letrare (stilistike) të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.3.2.7. I vëren e i interpreton problemet dhe idetë në veprën letrare dhe qëndrimet e tij mund t'i argumentojë në bazë të tekstit primar dhe kontekstit letrar. 2GJSH.3.2.8. Për ta interpretuar (njohur) apo për t'i bërë analizë filologjike veprës letrare, duhet të		

ketë njohuri të caktuara, një kulturë letrare nga leximi i veprave të tjera që për nga rëndësia hyjnë në radhën e kryeveprave nacionale e botërore. 2GJSH.3.2.9. Pasi t'i ketë lexuar veprat letrare shqipe e botërore, të cilat janë obligative, dhe veprat letrare me përzgjedhje, vërehet aftësia e tij shprehëse kundrejt të tjerëve dhe me këto zhvillohet e pasurohet edhe më shumë identiteti i tij kulturor e arsimor.		
2GJSH.1.3.1. Flet qartë duke respektuar drejtshqiptimin (ortoepinë) e gjuhës letrare; zbaton theksin (akcentin) gjuhësor-letrar ose e krahason akcentin e tij me atë letrar me tendencë të përshtatjes; Rrjedhshëm dhe qartë lexon me zë tekstet letrare dhe joletrare; shprehimisht lexon dhe lehtë i tregon tekstet letrare artistike; Në situata formale flet për temat e thjeshta si: nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe të kulurës duke u shërbyer me shprehje korrekte gjuhësore; Pra, flet qartë, pa pengesa, pa dridhje të zërit e pa pauza të mëdha; Sipas nevojës, përdor teminologjinë shkencore për gjuhën dhe letërsinë, duke e përshtatur me rastet apo situatat, bashkëfolësin ose përdor edhe mjetet gjuhësore verbale a joverbale sidomos mimikën, gjestikulacionin, lëvizjet e duarve etj, që në gjuhësi njihet me emrin Semiotikë; Ka kulturë të të dëgjuarit kur dikush flet në gjuhën e tij dhe me vëmendje dëgjon e kupton ligjëratat nga fusha e gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës dhe kështu gjatë dëgjimit të ndonjë ligjërimi, mund të marrë shënime; 2.GJSH.1.3.2. Dukë folur apo shkruar për ndonjë temë nga gjuha, letërsia apo për jetën shoqërore, e strukturon rrëfimin dhe i lidh pjesët në mënyrën e duhur; Dallon të rëndësishmen nga e parëndësishmja dhe i përmbahet temës kryesore; Shkruan një tekst duke u shërbyer nga përshkrimi e ekspozicioni dhe shkurtazi përshkruan ndjenjat e tij dhe përjetimin e pjesës letrare ose të ndonjë pjese tjetër artistike; Rrëfen tekstin letrar artistik dhe i	• zgjeron gamën e strategjive përmbledhjen e të dhënave të nevojshme që do të përdorë gjatë prezantimeve; • zbaton hapat e përgatitjes dhe të mbajtjes së një fjalimi për tema të ndryshme; • përzgjedh fjalët dhe shprehjet e përshtatshme, në mënyrë që të ndikojë te dëgjuesit, si dhe përmirëson zgjedhjen e fjalëve duke përdorur mjete retorike dhe të figurshme; • vlerëson rolin e përdorimit të TIK-ut gjatë prezantimeve me gojë dhe analizon funksione te këtij përdorimi; • reflekton ndaj informacionit të dëgjuar, rikujton përmbajtjen e informacionit, si dhe analizon mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose e një ligjërate mbështetin qëllimin e saj; • reflekton mbi informacione të llojeve dhe të fushave të ndryshme, si dhe përgjigjet në mënyrë të përshtatshme;	Gjuha e medies; Gazeta; publiciteti dhe reklama,

ndanë pjesët kryesore. Në fund jep një përmbledhje (rezyme) të tekstit letrar ose joletrar; 2GJSH.1.3.3. Në diskutime me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura, në pika të shkurtëra mund ta shpreh dhe ta argumentojë idenë ose qëndrimin për të cilin angazhohet; Pra, ai mund të flasë ngadalë duke u mbështetur kryesisht në fakte; Është në gjendje ta dëgjojë mendimin e tjetrit dhe ta marrë parasysh gjatë argumentimit të tij; Shkruan tekst me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura; 2GJSH.1.3.4. Shfrytëzon librin drejtshkrimor të gjuhës shqipe; zbaton rregullat elementare të drejtshkrimit dhe mund të shërbehet me botime të tjera nga Ortografia; Në të shkruar ndan pjesët tekstit, jep titujt dhe nëntitujt, citon dhe parafrazon; Bën punimin e maturës duke respektuar rregullat e shkruarjes së punimit shkencor (përdor fusnotat, shkruan përmbajtjen dhe bibliografinë); Shkruan letra zyrtare dhe jozyrtare, biografi (CV), lutje, ankesë, kërkesë; Di të mbushë formularë të ndryshëm etj.;	• demonstron aftësitë e domosdoshme të të dëgjuarit kritik. • përshtat shkrimin me qëllimet dhe lexuesit, p.sh.:të përshkruajë, të rrëfejë, të udhëzojë,të informojë, të argumentojë; • karakteristikat e tyre; • vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediesh; është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.	
2GJSH.1.3.5. Ka aftësinë që në mënyra të ndryshme (informim, mësim, zhvillim personal, përjetim estetik, argëtim …) të lexojë tekstet të rëndësisë (tekstet letrare, tekste profesionale, shkencore, popullore) nga fusha e shkencës për gjuhën dhe letërsinë, tekstet nga mediet; tekstet që janë të përshtatshme për përpunimin e planit për gjuhë dhe letërsi); zbaton strategjitë e të lexuarit; 2GJSH.1.3.6. Kupton tekstin letrar e joletrar dhe njeh rëndësinë e tyre, gjen informacione nga më të ndryshmet, ndan pjesët kryesore të tekstit; e di kuptimin e përmbajtjes në tekst; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste. 2GJSH.1.3.7. Në mënyrë kritike jep sqarim për tekstin letrar e joletrar; dallon faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson (dhe		

argumenton) se a i prezanton autori i tekstit joartistik të gjitha informacionet e nevojshme dhe a jep fakte të mjaftueshme e të besueshme për atë që thotë; vlerëson se a është neutral autori i tekstit ose i angazhuar apo i anshëm dhe e arsyeton vlerësimin e tij; njeh gjuhën e urrejtjes, diskriminimit, sharjes dhe për këto çështje ka qëndrim negativ. 2GJSH.1.3.8. Njeh strukturën, elementet e ndryshme, figurat stilistike (metoniminë, metaforën, asonancën, aliteracionin, onomatopenë, anaforën…); Njeh domethënien konotative të fjalës në kontekstin e dhënë dhe kupton qëllimin e domethënies konotative në tekstin letrar dhe joartistik; vlerëson domethënien e fjalëve të panjohura në bazë të kontekstit dhe modelit të formacionit; kupton domethënien e leximit për pasurimin e fondit leksikor.		
2GJSH.2.3.1. Nëpër situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë, flet për temat nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës, duke e përdorur gjuhën letrare dhe terminologjinë përgjegjëse; merr pjesë në bisedat publike ku ka më shumë pjesëmarrës; vlerëson auditoriumin dhe e përshtat fjalimin e tij sipas mundësive dhe kërkesave të tij; në të folur duhet ta zhvillojë më shumë kulturën e tij shprehëse; me vëmendje dëgjon prezantimet nga të tjerët (psh. ligjëratat) me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura etj. 2GJSH.2.3.2. Ndërton tekstin e folur a të shkruar nga gjuha, letërsia etj., duke e karakterizuar nga kohezioni dhe koherenca, pra me mënyrën se si lidhen midis tyre në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës njësitë që e përbëjnë tekstin (kohezioni) dhe me organizimin logjik të tekstit me mënyrën se si gjykimet dhe arsyetimet lidhen midis tyre (koherenca); në diskutimet e shkruara apo të folura, shpreh idetë dhe argumenton qëndrimet e tij; përkujdeset që të shkruaj e të folë në mënyrë të drejtë duke respektuar		*Të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit e teksteve të ndryshme.* *Intervista për punë.* *Letra e mospranimit për punë,* *Ftesa,* *Intervista me gojë, biseda.* *Tekstet e digjitalizuar,*

normën gjuhësore pa bërë ndonjë digresion (shmangie) nga rregullat; shfaq përjetimin dhe përshtypjet e tij rreth pjesës letrare ose artistike; rrëfen tekstin letrar dhe jep një përfundim për të sipas mundësive të tij shprehëse; zbaton rregullat drejtshkrimore etj. 2GJSH.2.3.3. Për të pasur një informim edhe më te gjerë, pra për ta zhvilluar aftësimin personal dhe për ta arritur përjetimin letrar e estetik, lexon tekste edhe më të ndërlikuara si tekste letraro-artistike, tekste shkencore, tekste nga mediet etj; është i apasionuar pas leximit; zbaton dhe zgjedh strategjitë e përshtatshme të leximit. 2GJSH.2.3.4. Kupton tekstin joletrar; nxjerr thelbin e tij; gjen pjesët e nënkuptueshme, por edhe e shtjellon tekstin në fjalë; gjen idenë kryesore; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste për të kuptuar aspektin domethënës e stilistik; i gjen dhe i analizon motivet dhe figurat, të cilat paraqiten në veprën letrare; interpreton tekstet duke u mbështetur në tekstet e tjera letrare. 2GJSH.2.3.5. Në mënyrë kritike jep vlerësim për tekstin letrar joartistik; ndan faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson neutralitetin (anshmërinë) e autorit; vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit argumentues; prezanton të gjitha informatat dhe faktet e autorit për ato që i thotë. 2GJSH.2.3.6. Vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit joartistik; teksti a është koheziv dhe koherent, a janë dhënë idetë qartë dhe saktë; vëren dukuritë stilistike; vëren se sa ndikojnë pjesët e caktuara të tekstit për ta kutpuar atë. 2GJSH.3.3.1. Diskuton për temat komplekse nga gjuha, letërsia dhe kultura; flet për tekstet letrare dhe		

joletrare duke shfrytëzuar terminologjinë profesionale. 2GJSH.3.2.2. Prezanton në situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë paraqitet me tema nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës; është orator dhe paraqet qëndrimet e tij para auditoriumit me argumente; gjatë ligjërimit përdor fjalë dhe shprehje nga gjuha amtare duke respektuar normën e gjuhës standarde etj. 2GJSH.3.3.3. Shkruan në mënyrë kompozicionale e logjike tekstin profesional me temë nga gjuha dhe letërsia si edhe artikullin gazetaresk. 2GJSH.3.3.4. I mbledh, i shënon dhe në fund i përpunon informacionet nga tekstet letrare joartistike në bazë të rregullave të parapara.		
2GJSH.3.3.5. Teksti mendon se ka një strukturë dhe organizim të brendshëm, kuptohet pa vështirësi, lexohet me kënaqësi, pra bart informacionin te lexuesi dhe është i shkruar sipas rregullave të ndërtimit të fjalive dhe të periudhave; 2GJSH.3.3.6. I njeh stilet funksionale të shqipes standarde (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili stili shkencor-teknik, stili juridik-administrativ) dhe të gjitha këto (stile) mund t'i trajtojë sipas veçorive të tyre leksikore. 2GJSH.3.3.7. Në të shkruar, përdor shenjat e pikësimit varësisht nga lloji i fjalive (dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse, urdhërore).		

Fjalët kyçe: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, kultura e gjuhës

Disa përmbajtje mësimore për të cilat mësuesi vlerëson se gjatë vitit ato nuk mund t'i realizojë gjatë orëve të rregullta, mund të planifikohen për përpunim gjatë orëve të mësimit me projekt, orëve në ambient të hapur, si dhe në orët të tjera të mësimit shtues e plotësues dhe në eksione.

UDHËZIME DIDAKTIKO – METODIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Programin e mësimdhënies dhe nxënies të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe përbëhet prej tri fushave/lëmive mësimore: Letërsisë, Gjuhës dhe Kulturës së Gjuhës. Shpërndarja e rekomanduar e orëve sipas fushave të njohurive është: Letërsi – 36 orë, Gjuhë – 34 orë dhe Kultura e gjuhës – 20 orë. Fondi i përgjithshëm i orëve, në nivelin vjetor, është 90 orë. Të tri fushat e programit të mësimdhënies dhe nxënies janë të ndërlidhura dhe nuk mund të mësohen të ndara dhe pa bashkëpunim ndërmjet njëra – tjetrës.

Programi mësimor dhe mësimor i Gjuhës dhe Letërsisë shqipe bazohet në rezultatet, domethënë në procesin e të mësuarit dhe arritjet e nxënësve. Rezultatet janë një përshkrim i njohurive të integruara, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që nxënësi ndërton, zgjeron dhe thellon nëpër të tri fushat lëndore të kësaj lënde.

I. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

Programi i mësimdhënies dhe mësimit i orientuar në rezultate, mësuesit i jep liri më të madhe krijimi dhe për të menduar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Roli i mësuesit është që mënyrat e ralizimit të studimit dhe mësimit t`ia përshtat nevojave të çdo paraleleje, duke pasur parasysh:përbërjen e paraleles dhe karakteristikat e nxënësve; tekstet dhe materialet tjera të cilat do t`i shfrytëzojë; kushtet teknike, mjetet mësimore dhe mediumet të cilat shkolla i disponon; resurset, mundësitë, si dhe nevojat e mjedisit local ku shkolla gjendet, duke u nisur nga rezultatet e dhëna dhe përmbajtjet, mësuesi fillimisht harton planin e vet vjetor, të quajturin plani global i punës, nga i cili më vonë do të zhvillojë planet e veta operative. Rezultatet e definuara sipas lëmive i lehtësojnë mësuesit operacionalizimin e mëtejshëm të rezultateve në nivelin e njësive konkrete mësimore. Nga mësuesi pritet që për çdo njësi mësimore, në fazën e planifikimit dhe hartimit të përgatitjes për orën e mësimit t`ia përshtatë rezultateve të mësimit. Gjatë planifikimit, gjithashtu, duhet patur parasysh se disa rezultate realizohen më shpejtë e më lehtë, por për pjesën më të madhe të rezultateve (veçanërisht për fushën lëndore Letërsi) duhet më tepër kohë, më shumë aktivitete të ndryshme dhe punë në shumë tekste të ndryshme. Rezultatet e rekomanduara nuk janë të diferencuar sipas niveleve të të arriturave të nxënësve. Ota paraqesin pjesë obligative të përshkrimit të standardeve dhe mund të imtësohen ose të zgjerohen, në vartësi prej mundësive individuale të nxënësit dhe nevojave të tjera mësimore.

Në fazën e planifikimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies është shumë e rëndësishme të keni parasysh se teksti është një mjet mësimor dhe se nuk përcakton përmbajtjen e lëndës. Për këtë përmbajtjeve të dhëna në tekst është e nevojshme t`i qasemi në mënyrë selektive dhe në raport me rezultatet e parashikuara që duhet të arrihen. Përveç kësaj nxënësit duhet të aftësohen për shfrytëzimin e tekstit, si një nga burimet e njohurive, mësuesi vlen që t`i udhëzojë në mënyrat dhe format e përdorimit të burimeve të tjera të njohurive

II. REALIZIMI I MËSIMIT DHE NXËNIES

LETËRSIA

Boshtin e programit të letërsisë e përbëjnë tekstet nga lektura. Lektura është e ndarë sipas gjinive letrare – lirika, epika, drama dhe e pasuruar me zgjedhjen e teksteve jo fikcionale, shkencore – popullore dhe informative. Zgjedhja e veprave në masën më të madhe bazohet në principin e përshtatjes së moshës. Krahas teksteve që duhet përpunuar gjatë orës është dhënë lista e lekturës shtëpiake. Qëllimi i përpunimit të veprës në kuadër të lekturës shtëpiake është formimi, zhvillimi ose kultivimi i shprehive të leximit tek nxënësit. Veprat voluminoze nxënësit mund t`i lexojnë gjatë pushimit, me çka nxitet zhvillimi i vazhdueshëm i shprehisë së leximit. Krahas listës obligative të veprave është dhënë edhe zgjedhja plotësuese e teksteve. Pjesa e zgjedhur i mundëson mësimdhënësit mundësi më të madhe kreativiteti në arritjen e rezultateve.

Me një korpus dominuese të teksteve të shkrimtarëve që mund të ndikojnë në formimin e shijes estetike të nxënësve, ndërton dhe pasuron vetëdijen për natyrës e letërsisë kombëtare (dhe vlerat e klasikëve të letërsisë botërore), por edhe identitetin kulturore dhe kombëtar.

Qëllimi i sjelljes së veprave letrare bashkëkohore është që sipas motivit ose me përkatësisë tematike të tyre lidhen me temat dhe motivet ekzistuese brenda programit mësimor, dhe me shembuj të tillë të tregojë se si shkrimtarët bashkëkohorë i mendojnë traditat epike popullore ose temat e miqësisë, etikës, zhvillimin e imagjinatës dhe empatisë, me çka do të pasurojnë përvojën vertikale të leximit të nxënësve dhe modernizon qasjen në mësimdhënie. Përmes një numri veprash letrare të shkrimtarëve bashkëkohorë, nxënësit do të jenë në gjendje të në mënyrë kritike të vlerësojnë poetikën e veprave të tyre.

Zgjedhja e veprave mundëson aplikimin e qasjes së studimit krahasues të të krijimtarisë letrare, me zgjedhjen e niveleve të ndryshme të përpunimit: interpretimit, paraqitjes ose rishikimeve. Dallimet në tërësinë artistike dhe vlerat informative të disa teksteve ndikojnë në zgjidhje përkatëse metodike (përshtatja e leximit të llojit të tekstit, shtrirja e komentimit të tekstit në vartësi nga ndërlikueshmëria e strukturës së tij, lidhja dhe grupimi me përmbajtjet gjegjëse nga fushat tjera lëndore – gramatika, drejtshkrimi dhe kulturë gjuhe dhe të ngjashme.).

Tekstet nga pjesa e programit plotësues duhet t`i shërbejë mësimdhënësit edhe gjatë përpunimit të njësive mësimore nga gramatika, si dhe për përpunim dhe përforcim të përmbajtjeve nga kultura e gjuhës. Veprat të cilat nuk i përpunon mësimdhënësi duhet t`i rekomandojë nxënësve për lexim gjatë kohës së lirë.

Programi i ri bazohet në njohjen e natyrës dhe rolin e veprës letrare, si dhe njohjen e dallimit të teksteve letrare dhe jo letrare, përkatësisht korrelacionit të tyre.

Nxënësit duhet të jenë të aftë të dallojnë veçantitë e tekstit letrar (konotacionin, veprimet letrare, denotativitetit, informimin, dhe duke treguar në bazë të fakteve dhe të dhënave në mënyra të

ndryshme të teksteve jo letrare. Korrelacioni është mundësuar me kombinime adekuate të veprave obligative dhe zgjedhore. I njëjti tekst mund të lidhet me të tjerët në mënyra të ndryshme, sipas motiveve të ndryshme ose tonit të rrëfimit, në kuadër të mësimit me projekt, që bazohet në rezultate, kurse jo në përmbajtjet mësimore.

Tekstet e propozuara obligative, letrare, shkencore – popullore dhe informative dhe përmbajtja e lekturës shtëpiake obligative, si dhe shembujt nga zgjedhja plotësuese, me rastin e planifikimit të planit vjetor të punës, dhe pastaj edhe gjatë formësimit të planeve të punës orientuese mujore, mund të lиdhen tematikisht.

Nga lista e zgjedhjes plotësuese mësimdhënësi zgjedh oto vepra të cilat, me pjesën obigative të lekturës, përbëjnë tërësitë tematike – motivuese. Mësimdhënësi mund t`i grupojë sipas gjinisë veprat nga programi obligativ dhe plotësues në mënyra të ndryshme. Shembujt e mundshëm të lidhjes funksionale të njësive mësimore mund të jenë këto (në asnjë mënyrë të vetme).

GJUHA

Në mësimin e gjuhës nxënësit aftësohen të komunikojnë të drejtë me gojë e me shkrim në gjuhën standarde shqipe. Nga kjo kërkesat në këtë program nuk janë të drejtuar vetëm në përvetësimin e rregullave gjuhësore dhe normës gramatikore, por edhe në kuptimin e funksioneve të tyre dhe zbatimin e drejtë në të shprehurit me gojë e me shkrim.

Kur në përmbajtjet e programit jepen njësi mësimore, të cilat nxënësit i kanë përpunuar edhe më herët, kuptohet se shkalla e përvetësimit dhe aftësimit të zbatimit të lëndës së përpunuar më herët verifikohet, kurse përsëritja dhe ushtrimi në këta shembuj i paraprin përpunimit të përmbajtjeve të reja, me çka sigurohet kontuiniteti i punës dhe sistematizimit në lidhjen e materialit të ri me njohuritë ekzistuese.

Gramatika

Kërkesa themelore programore në mësimin e gramatikës është që nxënësve gjuha t`i paraqitet dhe t`i shpjegohet si sistem. Asnjë dukuri gjuhësore nuk duhet të studiohet dhe shpjegohet e izoluar, jashtë kontekstit në cilin realizohet funksioni i saj (në secilin rast të përshtatshëm mund të vendosen në funksion, njohuritë nga gramatike, në shpjegimin e tekstit, si atij artistik edhe atij shkencor – popullor). Një nga veprimet e veçanta funksionale në mësimin e gramatikës është ushtrimet e bazuara në shfrytëzimin e shembujve nga praktika e drejtpërdrejtë e të folurit, çka mësimin e gramatikës ia ofron nevojave jetësore, në të cilat paraqitet gjuha e aplikuar si aktivitet i motivuar dhe i gjithanshëm i aktivitetit njerëzor

Në këtë mënyrë tek nxënësi zhvillohet edhe vetëdija e rëndësisë së kulturës e të folurit, e cila është e domosdoshme në jetën e përditshem si pjesë e kulturës së përgjithshme, e jo vetëm si pjesë e programit mësimor.

Mësimi i morfologjisë nënkupton rrumbullakësimin e e njohurive për ndërtimin e formave foljore. Është e domosdoshme lidhja e përmbajtjeve të reja me mësimet e punuara në klasat e më hershme, prandaj me shikimin e të gjitha formave foljore të përpunuara të bëhet nj[sintezë dhe të ndahen të gjitha format e foljeve fillimisht në vetore dhe pavetore dhe pastaj format e foljeve vetore në kohë dhe mënyra. Gjithashtu, është e nevojshme të theksohet edhe ndarja e të gjitha formave të foljeve në të thjeshta dhe të përbëra. Përdorimin e mbiemrit pasiv të foljes duhet shpjeguar me shembujt më tipik të konstruksioneve pasive. Duhet sistematizuar llojet e fjalëve duke përvetësuar përmbajtje të reja si: lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat.

Mësimi i sintaksës nënkupton sjellja e shprehjes së sintagmës dhe njohjen e gjymtyrës kryesore dhe të varur në kuadër të saj. Në shembujt e qartë dhe të pakontestueshëm nxënësit nëpërmjet ushtrimeve dallojnë gjymtyrën kryesore dhe të varur si dhe llojin e sintagmës. Futet atributi edhe atë si sintagmor, e jo si gjymtyrë e fjalisë. Është e rëndësishme të theksohet se cilat lloje të fjalëve paraqiten në kuadër të atributit. Në klasat e më hershme është përpunuar subjekti gramatikor, kurse tani futet edhe shprehja e subjektit logjik.

Drejtshkrimi

Përmbajtjet nga drejtshkrimi është e domosdoshme të lidhen me temat përkatëse edhe në orët e gramatikës edhe në ato të letërsisë. Për shembull. Kur përpunohet ndërtimi i formave të foljeve, duhet përpunuar edhe zgjidhjet drejtshkrimore të foljeve në lidhje me drejtshkrimin e formave të foljes. Në lidhje me përvetësimin e tipave të fjalisë është e nevojshëm të përpunohen edhe pikësimi, para së gjithash presjen si shenja më të rëndësishme të pikësimit. Duhet të jepen qartë rregullat kur duhet të shkruhet presja, dhe kur presja është shenjë jo e domosdoshme ose veçori e stilit. Lidhja e përmbajtjeve nga gramatika dhe letërsia bëhet me analizimin e përdorimit të presjes në fjalitë e ndara dhe dallimin e përdorimit të presjes në veprat letrare. Në pika të shkurta duhet theksuar në specifikat e stilit artistiko – letrar, ku ndonjëherë si rezultat i kreativitetit të shkrimtarit me qëllim nuk zbatohen rregullat e drejtshkrimit (veçanërisht në poezi). Kombinimi i shenjave të drejtshkrimit miratohet që në

klasat e më hershme në lidhje të folurit e drejtuar, por edhe tani theksohet në llojet tjera të shenjave drejtshkrimore të kombinuara, para së gjithash në përdorimin e presjes pas shkurtesave dhe numrave rendor. Shkrimi i shkurtesave ka të bëjë me përsëritjen e asaj që është mësuar në lidhje me shkurtesat, por edhe në zgjerimin e llojeve të shkurtesave të cilat theksohen në drejtshkrimin që është në fuqi.

Rregullat e drejtshkrimit miratohen me anë të ushtrimeve sistematike (diktimeve drejtshkrimore, përmirësimit të gabimeve në tekstin e dhënë, testeve me pyetje nga drejtshkrimi etj.). gjithashtu duhet nxitur nxënësit që vet të dallojnë dhe përmirësojnë gabimet drejtshkrimore gjatë komunikimit me SMS, si dhe në llojet e ndryshme të komunikimit nëpërmjet internetit.

Pos kësaj, nxënësit duhet udhëzuar në shërbimin e drejtshkrimit dhe të fjalorit të drejtshkrimit (botim shkolle). Është e preferueshme që mësimdhënësi të sjellë në orë ekzemplar të Drejtshkrimit sa herë që përpunohen tema të drejtshkrimit (kështu do të mund që individualisht nxënësve t`i japë të gjejnë fjal[në fjalorin drejtshkrimor dhe të përcaktojnë formën e rregullt të saj ose shkrimin e drejtë).

Drejtshqiptimi

Ushtrimet drejtshqiptimore nuk duhet realizuar si njësi të veçanta mësimore, por përmes temave përkatëse nga gramatika, por edhe në orët nga letërsia. Në këtë nivel nxënësit duhet të dallojnë dallimet ndërmjet theksit zbritës dhe atij ngjitës dhe t`i shënojnë drejtë të theksat në shembujt tipik. Nëse për këtë ekzistojnë kushtet, mësimdhënësi duhet të lëshojë incizime të drejtshqiptimit dhe t`i tregojë dallimet në shqiptim. Nxënësit duhet mësuar të njohin, riprodhojnë dhe përvetësojnë të folurit e theksuar, kurse në vendet ku shmangemi nga norma e theksimit të dallojnë theksin standard nga theksi i vet, ose nga theksimi dialektor.

KULTURA E GJUHËS

Një nga detyrat themelore të mësimit të kulturës së gjuhës ka të bëjë përvetësimin e mjeteve të shprehjeve gjuhësore tek nxënësit, kurse qëllimi i fundit është që nxënësit të aftësohen në vendosjen e cilësi së dhe të komunikimit kuptimplotë. Edhe pse fusha e kulturës gjuhësore është e konstituuar si hapësirë e veçantë programore, është parashikuar në mësimin e tërësishëm të gjuhës dhe letërsisë shqipe të lidhet edhe me dy fushat e tjera letërsinë dhe gjuhën. Fusha Kulturë gjuhe përfshinë të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Me ç`rast duhet kushtuar kujdes të njejtë të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

Në këtë moshë duhet shqyrtuar specifikat e dy stileve funksionale, atij letraro – artistik dhe publicistik.

Nxënësit duhet të inkurajohen që në tekstin e dhënë, të përzier dhe të kreuar me dedikim të gjejnë dhe të radhisin fjalitë duke pasur parasysh se a i përkasin stilit letraro – artistik apo atij publicistik. Pastaj, të gjejnë fjalinë e shkruar në tekst në stilin publicistik, i cili është shkruar në stilin letraro – artistik dhe anasjelltas. Duhet të shpjegojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet dy stileve funksionale, të zhvillojnë aftësitë e kuptimit të veçorive të tyre.

Koherenca paraqet një shenjë të rëndësishme të strukturës tekstuale dhe udhëzohet në karakterin kontinuitiv të ndonjë teksti. Nga kjo në mësmin e kulturës gjuhësore duhet aftësuar nxënësit që në formë gojore dhe me shkrim të koncipojnë përbërjet sipas drejtimeve të cila do t`u jenë dhënë. Për shembull, duhet të hartojnë tekste të menduara logjike në bazë të fjalëve të dhëna të cilat fjalë duhet patjetër t`i përdorin; të hartojnë tekste gjatësia e të cilëve do të jetë e kufizuar (numri i kufizuar i fjalëve); që në tekstin që e hartojnë të përdorin kryesisht modele të caktuara gramatikore ose të leksikun e caktuar. Gjithashtu, duhet inkurajuar të mendojnë disa fillime të ndryshme të teksteve në temën e njejtë të dhënë ose të mendojnë disa përfundime të ndryshme me përgatitje të dedikuar dhe sipas tekstit të përshtatshëm të papërfunduar; të ndryshojnë fundin (ose pjesë tjera të përshtatshme) e një shabloni letrar; të vendosin renditje të shthurur kronologjike ose të menduar në tekstin e dhënë dhe ngjashëm.

Një kompetencë shumë e rëndësishme e cila gjendet në baën e shumë niveleve të kuptimit të teksti, është shkathtësia e argumentimit. Duke pasur parasysh që zhvillimi i mendimit të argumentuar ka rol të rëndësishëm në arsim, sepse mund të ndikojë pozitivisht në fitimin e njohurive, gjatë mësimit të kulturës gjuhësore duhet verifikuar deri në ç`masë nxënësit janë në gjendje të kuptojnë tekstet e argumentuara. Duhet inkurajuar nxënësit që të arsyetojnë me argumente qëndrimin e vet lidhur me situatën problemore në veprën letrare; që me argumente të arsyetojnë qëndrimin e vet eksplicit të paraqitur për dikë, për ata, çështje e rëndësishme.

Një nga format themelore të shprehjes me gojë dhe me shkrim – përshkrimi. Paraqet përmbajtje bazike programore për përsosjen dhe kultivimin e kulturës së duhur gjuhësore të nxënësit. Në këtë moshë nxënësit duhet të shfrytëzojnë të dy llojet e përshkrimit: teknik dhe sugjestiv, përkatësisht duhet aftësuar të përshkruajnë një lëndë, nocion apo qenie të caktuar, fillimisht në mënyrë objektive (përshkrim teknik), dhe pastaj duke i shprehur përshtypjet e veta (përshkrim sugjestiv). Gjithashtu,

duhet inkurajuar të mendojnë paralelisht të dy llojet e përshkrimit të të njëjtit send përshkrimi; të gjejnë elemente e dy përshkrimeve në tekstin e përzier;

Gjatë mësimit të kulturës së gjuhës në këtë moshë duhet tërhequr vëmendjen nxënësve, ndërmjet tjerash, edhe në metodat e paraqitjes së burimeve dhe ideve, si dhe shpjegimeve plotësuese të cilat përdoren në tekst. Duhet inkurajuar të shpjegojnë shkaqet dhe funksionet e citimit; të shpjegojnë situatat problemore të vërejtura në tekstet letrare dhe të tjera me ndihmën e citateve: të komentojnë rëndësin dhe kuptimin e fusnotës së përdorur në shembullin e dhënë; të dallojnë citatet dhe parafrazat në shembujt e dhënë. Gjithashtu, duhet tërhequr vërejtjen në rregullat të cilat ndikojnë në shkrimin numrave të eksponuar me të cilët shënohen fusnotat në fund të fjalisë.

fjalëve. Fjala si strukturë ka dy anë: përmbajtjen dhe formën dhe kështu dallon aspektin leksiko-gramatikor nga ai fonetiko-gramatikor. 2GJSH.1.1.5. Fjalinë e shkruan sipas rregullave gramatikore; mund t'i klasifikojë njësitë sintaksore; dallon fjalitë pohore dhe mohore; analizon fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra. 2GJSH.1.1.6. Ka një fond leksikor, i cili i përmbush nevojat në nivelin e mesëm të arsimimit; bën dallimin mes leksikut letrar dhe joletrar dhe i përdor sipas situatës së krijuar; ka njohuri për domethënien e fjalës; njeh grupet (paradigmat) e fjalëve: sinonimet, antonimet, homonimet; njeh metaforën si mekanizëm leksikor. Nëse ndonjë fjalë ka prejardhje të huaj, e përdorë dhe nuk ndien ndonjë "armiqësi" ndaj saj. Por, nganjëherë bën edhe kritika për shkak të futjes së saj në strukturën e shqipes. Njeh nocionin e frazeologjisë. Përdor fjalorët e gjuhës shqipe (Fjalorin drejtshkrimor, frazeologjik, sinonimik) etj. 2GJSH.2.1.1. Ka njohuri më të thella për gjuhën në krahasim me nivelin fillestar; Njeh njësitë, të cilat i përkasin niveleve të ndryshme të gjuhës, pra nënsistemet; Ka njohuri për shkrimin e letrave. Tashmë njeh parimet kryesore të gjuhës shqipe si parimin fonetik, morfologjik, etimologjik etj.; I di disa gjëra elementare për gjuhët e botës (ngjajshmëritë gjuhësore, përbashkësitë (universaliet) gjuhësore; I njeh parimet e zhvillimit të dialogut; kupton nocionin e aktit të të folurit; në tekst dallon pjesëzat dëftuese apo deiksin; Njeh varietetet gjuhësore të shqipes gjatë paraqitjes së një moderatori në medie kur ai flet në vernakularin gjuhësor – krahinor, pra nëse përdor ndonjë fjalë apo shprehje nga rajoni i tij.		
2GJSH.2.1.2. I di tiparet dalluese të të dy dialekteve të gjuhës shqipe; P.sh.: në sistemin fonetik për gegërishten është karakteristike seria e zanoreve hundore kurse në toskërishte ka vetëm zanore gojore (hĩ-ni, rê-ja, zã-ni-gegërishte dhe hi-		

ri, re-ja, zë-ri- toskërishtja); toskërishtja ka **"ë"** në serinë e zanoreve të theksuara kurse gegërishtja nuk e ka, pra ajo i përgjigjet toskërishtes me **ã**; gegërishtja ka grupin nistor **vo** kurse toskërishtja ka grupin **va** (vaj, varr, vatër-toskërishtja., dhe voj, vorr, votër-gegërishtja) etj.; Në toskërishte ruhen grupet **mb, nd, ng** ndërkaq në gegërishte kanë dhënë **m, n, n**; Po ashtu e di se këto dialekte veçohen edhe nga tiparet morfologjike e leksikore; Mund t'i rirendis etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, të cilat janë të njohura edhe më parë; 2GJSH.2.1.3. Njeh aparatin e të folurit dhe mënyrën se si prodhohen tingujt; dallon tingujt sipas pikëpamjes së artikulimit; e jep definicionin për fonemën; bën ndarjen fonetike të të folurit dhe në një frazë apo sintagmë spikat llojin e theksit (theks logjik, emfatik apo emocional) dhe kështu në mënyrë të drejtë mund ta shqiptojë fjalën në njësitë e lartëpërmenduara; njeh mekanizmat e ndryshimit të tingujve (ndryshimet kombinatore) siç janë: asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat e tingujve (proteza, epenteza, epiteza), rëniet e tingujve (afereza, sinkopa, apokopa). 2GJSH.2.1.4. Ka njohuri të gjera për fjalën dhe veçoritë e saj; e di se forma e fjlaës është fonetiko-gramatikore sepse përbëhet nga elemente fonetike e gramtikore duke e paraqitur me shembull si bie fjala: emri *vëlla-i* ka tingujt e nyjëtuar *v-ë-ll-a-i* dhe temën fjalëformuese *vëlla-* dhe mbaresën –*i*, e cila tregon gjininë, numrin, rasën e trajtën e emrit; e njeh termin morfemë; ndan apo zbërthen fjalën në morfema si p.sh.: mal-or, qytet-ar, hekur-os, lag-a, mal-i, për-dredh, sh-thur etj., dhe në bazë të shembujve dallon morfemat rrënjore, parashtesore e prapashtesore; i di anët kryesore të strukturës së fjalës (përmbajtjen dhe formën); zbaton kriterin theksor (akcentologjik) si kriter dallues i fjalës së një tipari fonetik. 2GJSH.2.1.5. Gjatë procesit të ligjërimit, përdor fjalë duke i		

bashkuar për ta shprehur e transmetuar mendimin dhe ato (fjalë) duke hyrë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore krijojnë njësi të ndryshme sintaksore; dallon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra; analizon fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme; ka njohuri të gjera rreth sintagmës; klasifikon fjalitë e varura; njeh termin elipsë; i di rasat dhe kategoritë gramatikore të foljes. 2GJSH.2.1.6. Ka fond të pasur leksikor (leksikun individual e të huaj); është i njoftuar për prefiksat e sufiksat që përdoren nga gjuhët e huaja në shqipen; fondin leksikor e shfrytëzon sipas rastit; sipas tij, gjuha është i vemi mjet i komunikimt që shërben për ta shprehur mendimin e tij, por edhe përvojën individuale dhe kështu e pasuron edhe më tepër fjalorin; njeh hiperoniminë, hiponiminë, paroniminë; dallon shtresat leksikore; njeh metaforën dhe metoniminë si mekanizma leksikorë. 2GJSH.3.1.1. E di që ekziston lidhja e afërt mes gjuhës dhe mendimit dhe e di nocionin e tyre; e jep përkufizimin e fjalisë duke e ditur gjithashtu se ajo ka dy anë: anën kuptimore dhe anën strukturore; dallon kohezionin leksikor dhe gramatikor. 2GJSH.3.1.2. Gjatë ndarjes së fjalëve në rrokje, përdor mjetet fonetike për spikatjen e saj (rrokjes) si: gjatësinë dhe forcën. 2GJSH.3.1.3. Ka njohuri për morfologjinë në kuptimin e gjerë të fjalës, në të cilën jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes..; e ndan apo e zbërthen fjalën në morfema duke e dalluar morfemën rrënjë, parashtesore dhe prapeshtesore. 2GJSH.3.1.4. Ka njohuri më të gjera për përdorimin e rasave dhe të formave foljore; mund t'i analizojë fjalitë nga pikëpamja morfologjike (duke i gjetur pjesët e ligjëratës); i njeh tipat e fjalive; dallon kryefjalën,		

kallëzuesin dhe gjymtyrët e dyta duke i analizuar sintaksorisht. 2GJSH.3.1.5. Ka njohuri themelore për fjalorët dhe për strukturën e tyre.		
2GJSH.1.2.1. Njeh autorët nga programi obligativ shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letraro-historik. 2GJSH.1.2.2. Njeh terminologjinë e teorisë së letërsisë, në të cilën njihen shkrimet e veçanta dhe ku letërsia trajtohet në mënyrë teorike. 2GJSH.1.2.3. Në interpretimin e pjesëve letraro – artistike dhe pjesëve letraro-shkencor, dallon metodat e qasjes së brendshme dhe të jashtme. 2GJSH.1.2.4. Vëren dhe me shembuj argumenton tiparet letrare, poetike, gjuhësore, estetike e strukturore të veprave letrare. 2GJSH.1.2.5. I di tiparet e letërsisë si dhe i shpjegon raportet e saj me gjuhën dhe marrëdhëniet me artet e tjera. 2GJSH.1.2.6. Paraqet tiparet historike dhe poetike të periudhave letrare, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe botërore duke përfshirë edhe shkrimtarët shqiptarë e të huaj nga lektura e obliguar shkollore.	• përshkruan dhe analizon kushtet historike në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; • analizon dhe gjykon pasojat që shkaktuan dy luftërat botërore; • përshkruan dhe analizon realitetin shoqëror në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; • rendit disa nga zbulimet e mëdha në shkencat e natyrës, të cilat ndikuan në jetën e njeriut; • përcakton dhe analizon zhvillimet në shkencat shoqërore, si: psikologjia, filozofia, sociologjia; • dallon dhe analizon veçoritë e përgjithshme të letërsisë së shekullit XX, si: larmia e drejtimeve letrare, individualitete krijuese të spikatura dhe origjinale, veçori kombëtare të krijuesve; • përcakton dhe analizon tiparet e letërsisë që vijoi traditën realiste të shek. XIX; • analizon risitë që sollën shkrimtarët që ndoqën rrugën e letërsisë realiste të shek. XIX;	**– Letërsi botërore** – Letërsia botërore e shek. XX **– Franc Kafka**, jeta vepra – Metamorfoza – analizë **– Alber Kamy ,** filozofia absurdi, I huaji – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shek. XX** **– Gjergj Fishta,** simbol i madhështisë së poezisë shqipe Lahuta e Malcis – analizë, Vranina – koment, Kënga e Lulashit – koment **– Lasgush Poradeci ,** liriku i madh, Ylli i zemrës – analizë **– Migjeni,** poeti vullkanik Vargjet e lira, Novelat e qytetit të veriut – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shek. XX** **-Ismail Kadare,** ambasadori i letrave shqipe Pallati i ëndrrave – analizë **– Martin Camaj** **– Azem Shkreli,** mjeshtri i fjalës poetike – Lirikë me shi – analizë

2GJSH.1.2.7. Analizon pjesët letrare nga ato joletrare dhe mund t'i argumentoj teorikisht. 2GJSH.1.2.8. Shfrytëzon po ashtu literaturën sekondare qoftë letrare, historike, kritike, poetike, teorike duke i sjellë punimet e tij para të tjerëve. 2GJSH.1.2.9. Duke i lexuar veprat e letërsisë shqipe dhe botërore, e kupton rëndësinë e të lexuarit të pjesës letrare dhe kështu ky pozitivitet ndikon në formimin e identitetit të tij gjuhësor, letrar, kulturor e kombëtar. 2GJSH.2.2.1. Interpreton veprën letrare duke nxjerrë thelbin dhe veçoritë e saj; kontekstin historik; motivet letrare; tematikën para se gjithash; kompozicionin; figurat letrare; idenë e shkrimtarit; aspektin gjuhësor e stilistik etj. 2GJSH.2.2.2. Njeh terminologjinë e Teorisë së Letërsisë dhe njohuritë teorike-letrare i zbaton në mënyrë adekuate në interpretimin e pjesëve apo edhe veprave letrare. 2GJSH.2.2.3. Dallon metodat e qasjes së brendshme e të jashtme në interpretimin e pjesëve apo veprave letraro-arstistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistike. 2GJSH.2.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave letraro-artistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistik si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekstet apo veprat përkatëse. 2GJSH.2.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv dhe këto elemente e përcaktojnë edhe vetë llojin si: tragjedinë, komedinë, elegjinë etj.	• rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsive të vendeve të ndryshme si dhe veprat e tyre letrare; • përcakton gjinitë dhe llojet letrare që lëvruan më shumë shkrimtarët që ndoqën prirjen realiste • përcakton veçoritë kryesore të letërsisë moderne; • dallon dhe analizon drejtimet (rrymat) kryesore letrare të letërsisë moderne të shek. XX; • analizon gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë moderne të shek. XX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë moderne, si dhe veprat e tyre letrare; • përshkruan dhe analizon risitë e letërsisë së kësaj periudhe; • rendit dhe analizon shkrimtarët që me krijimtarinë e tyre shërbyen si urë lidhëse mes letërsisë së shek. XIX dhe letërsisë së shek. XX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së kësaj periudhe dhe krijimtarinë e tyre; • vlerëson kontributin e shkrimtarëve të kësaj periudhe; • veçon dhe analizon risitë që sjell Kadare në letërsi pas viteve'90 analizon kushtet historike, shoqërore dhe politike pas Luftës së Dytë Botërore;	**Lektura shtëpiake:** *49. Franc Kafka – Procesi* *50. Dritëro Agolli – Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* *51. Ismail Kadare – Gjenerali i ushtrisë së vdekur* *52. Ernest Heminguej – Plaku dhe deti* *53. Gabriel G. Markez – Njëqind vjet vetmi* *54. Jakov Xoxa – Lumi i vdekur* **Vërejtje: arsimtari mund të bëjë zgjedhje të lirë të lekturave shtëpiake në pajtueshmëri me planin dhe programin për klasën e katërt të Gjimnazit.*

2GJSH.2.2.6. Gjatë interpretimit të pjesëve letraro-artistike dhe letraro-shkencor, i përdor njohuritë paraprake nga fusha e teorisë së letërsisë; i njeh drejtimet dhe formacionet e zhvillimit të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.2.2.7. Në mënyrë të pavarur analizon pjesët letrare dhe mund t'i argumentojë qëndrimet e tij përballë të tjerëve. 2GJSH.2.2.8. Shfrytëzon literaturë shtesë nga letërsia, historia dhe fusha të tjera shoqërore, me qëllim të afirmimit të tij në interpretimin e pjesëve të tjera letraro-artistike e letraro-shkencor të parapara sipas planit dhe programit mësimor. 2GJSH.2.2.9. Duke i lexuar veprat letrare shqipe e botërore, e zhvillon edhe më shumë aftësinë shprehëse për interpretim dhe vlerësim të pjesëve të ndryshme letraro-artistike dhe letraro-shkencor , po ashtu e pasuron fondin leksikor, letrar, kulturor; me leximin e veprave të ndryshme, ai mund të bëhet më i arsimuar e më i kulturuar. 2GJSH.3.2.1. Lexon dhe analizon pjesët letraro-artistike dhe letraro-shkencor të parapara nga plani dhe programi mësimor dhe tekstet shtesë apo fakultative po ashtu letraro-artistike dhe letraro-shkencor duke i analizuar në kontekst më të gjerë historik. 2GJSH.3.2.2. Është i njoftuar me terminologjinë teorike-letrare duke e zbatuar në interpretimin e veprave letraro-artistike dhe letraro-shkencor të cilat janë të parapara me planin dhe programin mësimor; shfrytëzon edhe vepra të zhanreve të tjera, jashtë obligatives. 2GJSH.3.2.3. Në procesin e interpretimit të veprave përkatëse, zbaton metodat adekuate të qasjes së brendshme e të jashtme. 2GJSH.3.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave gjegjëse e publicistike si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin,	përshkruan, analizon dhe gjykon për dukuritë letrare të kësaj periudhe;	

udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekst. 2GJSH.3.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv. 2GJSH.3.2.6. Gjatë interpretimit dhe vlerësimit të veprave letraro-artistike dhe letraro- shkencor, zbaton dhe krahason tiparet historike e letrare (stilistike) të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.3.2.7. I vëren e i interpreton problemet dhe idetë në veprën letrare dhe qëndrimet e tij mund t'i argumentojë në bazë të tekstit primar dhe kontekstit letrar. 2GJSH.3.2.8. Për ta interpretuar (njohur) apo për t'i bërë analizë filologjike veprës letrare, duhet të ketë njohuri të caktuara, një kulturë letrare nga leximi i veprave të tjera që për nga rëndësia hyjnë në radhën e kryeveprave nacionale e botërore. 2GJSH.3.2.9. Pasi t'i ketë lexuar veprat letrare shqipe e botërore, të cilat janë obligative, dhe veprat letrare me përzgjedhje, vërehet aftësia e tij shprehëse kundrejt të tjerëve dhe me këto zhvillohet e pasurohet edhe më shumë identiteti i tij kulturor e arsimor.		
2GJSH.1.3.1. Flet qartë duke respektuar drejtshqiptimin (ortoepinë) e gjuhës letrare; zbaton theksin (akcentin) gjuhësor-letrar ose e krahason akcentin e tij me atë letrar me tendencë të përshtatjes; Rrjedhshëm dhe qartë lexon me zë tekstet letrare dhe joletrare; shprehimisht lexon dhe lehtë i tregon tekstet letrare artistike; Në situata formale flet për temat e thjeshta si: nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe të kulurës duke u shërbyer me shprehje korrekte gjuhësore; Pra, flet qartë, pa pengesa, pa dridhje të zërit e pa pauza të mëdha; Sipas nevojës,	• zgjeron gamën e strategjive përmbledhjen e të dhënave të nevojshme që do të përdorë gjatë prezantimeve; • zbaton hapat e përgatitjes dhe të mbajtjes së një fjalimi për tema të ndryshme; • përzgjedh fjalët dhe shprehjet e përshtatshme, në mënyrë që të ndikojë te dëgjuesit, si dhe përmirëson zgjedhjen e fjalëve duke	Gjuha e medies; Gazeta; publiciteti dhe reklama,

përdor teminologjinë shkencore për gjuhën dhe letërsinë, duke e përshtatur me rastet apo situatat, bashkëfolësin ose përdor edhe mjetet gjuhësore verbale a joverbale sidomos mimikën, gjestikulacionin, lëvizjet e duarve etj, që në gjuhësi njihet me emrin Semiotikë; Ka kulturë të të dëgjuarit kur dikush flet në gjuhën e tij dhe me vëmendje dëgjon e kupton ligjëratat nga fusha e gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës dhe kështu gjatë dëgjimit të ndonjë ligjërimi, mund të marrë shënime; 2.GJSH.1.3.2. Dukë folur apo shkruar për ndonjë temë nga gjuha, letërsia apo për jetën shoqërore, e strukturon rrëfimin dhe i lidh pjesët në mënyrën e duhur; Dallon të rëndësishmen nga e parëndësishmja dhe i përmbahet temës kryesore; Shkruan një tekst duke u shërbyer nga përshkrimi e ekspozicioni dhe shkurtazi përshkruan ndjenjat e tij dhe përjetimin e pjesës letrare ose të ndonjë pjese tjetër artistike; Rrëfen tekstin letrar artistik dhe i ndanë pjesët kryesore. Në fund jep një përmbledhje (rezyme) të tekstit letrar ose joletrar; 2GJSH.1.3.3. Në diskutime me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura, në pika të shkurtëra mund ta shpreh dhe ta argumentojë idenë ose qëndrimin për të cilin angazhohet; Pra, ai mund të flasë ngadalë duke u mbështetur kryesisht në fakte; Është në gjendje ta dëgjojë mendimin e tjetrit dhe ta marrë parasysh gjatë argumentimit të tij; Shkruan tekst me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura; 2GJSH.1.3.4. Shfrytëzon librin drejtshkrimor të gjuhës shqipe; zbaton rregullat elementare të drejtshkrimit dhe mund të shërbehet me botime të tjera nga Ortografia; Në të shkruar ndan pjesët tekstit, jep titujt dhe nëntitujt, citon dhe parafrazon; Bën punimin e maturës duke respektuar rregullat e shkruarjes së punimit shkencor (përdor fusnotat, shkruan përmbajtjen dhe bibliografinë); Shkruan letra zyrtare dhe jozyrtare, biografi (CV), lutje, ankesë, kërkesë;	përdorur mjete retorike dhe të figurshme; • vlerëson rolin e përdorimit të TIK-ut gjatë prezantimeve me gojë dhe analizon funksione te këtij përdorimi; • reflekton ndaj informacionit të dëgjuar, rikujton përmbajtjen e informacionit, si dhe analizon mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose e një ligjërate mbështetin qëllimin e saj; • reflekton mbi informacione të llojeve dhe të fushave të ndryshme, si dhe përgjigjet në mënyrë të përshtatshme; • demonstron aftësitë e domosdoshme të të dëgjuarit kritik. • përshtat shkrimin me qëllimet dhe lexuesit, p.sh.:të përshkruajë, të rrëfejë, të udhëzojë,të informojë, të argumentojë; • karakteristikat e tyre; • vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediesh; është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.	

Di të mbushë formularë të ndryshëm etj.; 2GJSH.1.3.5. Ka aftësinë që në mënyra të ndryshme (informim, mësim, zhvillim personal, përjetim estetik, argëtim …) të lexojë tekstet të rëndësisë (tekstet letrare, tekste profesionale, shkencore, popullore) nga fusha e shkencës për gjuhën dhe letërsinë, tekstet nga mediet; tekstet që janë të përshtatshme për përpunimin e planit për gjuhë dhe letërsi); zbaton strategjitë e të lexuarit; 2GJSH.1.3.6. Kupton tekstin letrar e joletrar dhe njeh rëndësinë e tyre, gjen informacione nga më të ndryshmet, ndan pjesët kryesore të tekstit; e di kuptimin e përmbajtjes në tekst; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste. 2GJSH.1.3.7. Në mënyrë kritike jep sqarim për tekstin letrar e joletrar; dallon faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson (dhe argumenton) se a i prezanton autori i tekstit joartistik të gjitha informacionet e nevojshme dhe a jep fakte të mjaftueshme e të besueshme për atë që thotë; vlerëson se a është neutral autori i tekstit ose i angazhuar apo i anshëm dhe e arsyeton vlerësimin e tij; njeh gjuhën e urrejtjes, diskriminimit, sharjes dhe për këto çështje ka qëndrim negativ. 2GJSH.1.3.8. Njeh strukturën, elementet e ndryshme, figurat stilistike (metoniminë, metaforën, asonancën, aliteracionin, onomatopenë, anaforën…); Njeh domethënien konotative të fjalës në kontekstin e dhënë dhe kupton qëllimin e domethënies konotative në tekstin letrar dhe joartistik; vlerëson domethënien e fjalëve të panjohura në bazë të kontekstit dhe modelit të formacionit; kupton domethënien e leximit për pasurimin e fondit leksikor. 2GJSH.2.3.1. Nëpër situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë, flet për temat nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës, duke e		

përdorur gjuhën letrare dhe terminologjinë përgjegjëse; merr pjesë në bisedat publike ku ka më shumë pjesëmarrës; vlerëson auditoriumin dhe e përshtat fjalimin e tij sipas mundësive dhe kërkesave të tij; në të folur duhet ta zhvillojë më shumë kulturën e tij shprehëse; me vëmendje dëgjon prezantimet nga të tjerët (psh. ligjëratat) me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura etj.		
2GJSH.2.3.2. Ndërton tekstin e folur a të shkruar nga gjuha, letërsia etj., duke e karakterizuar nga kohezioni dhe koherenca, pra me mënyrën se si lidhen midis tyre në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës njësitë që e përbëjnë tekstin (kohezioni) dhe me organizimin logjik të tekstit me mënyrën se si gjykimet dhe arsyetimet lidhen midis tyre (koherenca); në diskutimet e shkruara apo të folura, shpreh idetë dhe argumenton qëndrimet e tij; përkujdeset që të shkruaj e të folë në mënyrë të drejtë duke respektuar normën gjuhësore pa bërë ndonjë digresion (shmangie) nga rregullat; shfaq përjetimin dhe përshtypjet e tij rreth pjesës letrare ose artistike; rrëfen tekstin letrar dhe jep një përfundim për të sipas mundësive të tij shprehëse; zbaton rregullat drejtshkrimore etj. 2GJSH.2.3.3. Për të pasur një informim edhe më te gjerë, pra për ta zhvilluar aftësimin personal dhe për ta arritur përjetimin letrar e estetik, lexon tekste edhe më të ndërlikuara si tekste letraro-artistike, tekste shkencore, tekste nga mediet etj; është i apasionuar pas leximit; zbaton dhe zgjedh strategjitë e përshtatshme të leximit. 2GJSH.2.3.4. Kupton tekstin joletrar; nxjerr thelbin e tij; gjen pjesët e nënkuptueshme, por edhe e shtjellon tekstin në fjalë; gjen idenë kryesore; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste për të kuptuar aspektin domethënës e stilistik; i gjen dhe i analizon motivet dhe figurat, të cilat paraqiten në veprën letrare; interpreton tekstet		*Të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit e teksteve të ndryshme.* *Intervista për punë.* *Letra e mospranimit për punë,* *Ftesa,* *Intervista me gojë, biseda.* *Tekstet e digjitalizuar,*

duke u mbështetur në tekstet e tjera letrare. 2GJSH.2.3.5. Në mënyrë kritike jep vlerësim për tekstin letrar joartistik; ndan faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson neutralitetin (anshmërinë) e autorit; vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit argumentues; prezanton të gjitha informatat dhe faktet e autorit për ato që i thotë. 2GJSH.2.3.6. Vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit joartistik; teksti a është koheziv dhe koherent, a janë dhënë idetë qartë dhe saktë; vëren dukuritë stilistike; vëren se sa ndikojnë pjesët e caktuara të tekstit për ta kutpuar atë. 2GJSH.3.3.1. Diskuton për temat komplekse nga gjuha, letërsia dhe kultura; flet për tekstet letrare dhe joletrare duke shfrytëzuar terminologjinë profesionale. 2GJSH.3.2.2. Prezanton në situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë paraqitet me tema nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës; është orator dhe paraqet qëndrimet e tij para auditoriumit me argumente; gjatë ligjërimit përdor fjalë dhe shprehje nga gjuha amtare duke respektuar normën e gjuhës standarde etj. 2GJSH.3.3.3. Shkruan në mënyrë kompozicionale e logjike tekstin profesional me temë nga gjuha dhe letërsia si edhe artikullin gazetaresk. 2GJSH.3.3.4. I mbledh, i shënon dhe në fund i përpunon informacionet nga tekstet letrare joartistike në bazë të rregullave të parapara. 2GJSH.3.3.5. Teksti mendon se ka një strukturë dhe organizim të brendshëm, kuptohet pa vështirësi, lexohet me kënaqësi, pra bart informacionin te lexuesi dhe është i shkruar sipas rregullave të ndërtimit të fjalive dhe të periudhave;		

2GJSH.3.3.6. I njeh stilet funksionale të shqipes standarde (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili stili shkencor-teknik, stili juridik-administrativ) dhe të gjitha këto (stile) mund t'i trajtojë sipas veçorive të tyre leksikore. 2GJSH.3.3.7. Në të shkruar, përdor shenjat e pikësimit varësisht nga lloji i fjalive (dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse, urdhërore).		

Fjalët kyçe: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, kultura e gjuhës

Disa përmbajtje mësimore për të cilat mësuesi vlerëson se gjatë vitit ato nuk mund t'i realizojë gjatë orëve të rregullta, mund të planifikohen për përpunim gjatë orëve të mësimit me projekt, orëve në ambient të hapur, si dhe në orët të tjera të mësimit shtues e plotësues dhe në eksione.

UDHËZIME DIDAKTIKO – METODIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Programin e mësimdhënies dhe nxënies të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe përbëhet prej tri fushave/lëmive mësimore: Letërsisë, Gjuhës dhe Kulturës së Gjuhës. Shpërndarja e rekomanduar e orëve sipas fushave të njohurive është: Letërsi – 36 orë, Gjuhë – 34 orë dhe Kultura e gjuhës – 20 orë. Fondi i përgjithshëm i orëve, në nivelin vjetor, është 90 orë. Të tri fushat e programit të mësimdhënies dhe nxënies janë të ndërlidhura dhe nuk mund të mësohen të ndara dhe pa bashkëpunim ndërmjet njëra – tjetrës.

Programi mësimor dhe mësimor i Gjuhës dhe Letërsisë shqipe bazohet në rezultatet, domethënë në procesin e të mësuarit dhe arritjet e nxënësve. Rezultatet janë një përshkrim i njohurive të integruara, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që nxënësi ndërton, zgjeron dhe thellon nëpër të tri fushat lëndore të kësaj lënde.

I. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

Programi i mësimdhënies dhe mësimit i orientuar në rezultate, mësuesit i jep liri më të madhe krijimi dhe për të menduar mësimdhënien dhe mësimnxënien. Roli i mësuesit është që mënyrat e ralizimit të studimit dhe mësimit t`ia përshtat nevojave të çdo paraleleje, duke pasur parasysh:përbërjen e paraleles dhe karakteristikat e nxënësve; tekstet dhe materialet tjera të cilat do t`i shfrytëzojë; kushtet teknike, mjetet mësimore dhe mediumet të cilat shkolla i disponon; resurset, mundësitë, si dhe nevojat e mjedisit local ku shkolla gjendet, duke u nisur nga rezultatet e dhëna dhe përmbajtjet, mësuesi fillimisht harton planin e vet vjetor, të quajturin plani global i punës, nga i cili më vonë do të zhvillojë planet e veta operative. Rezultatet e definuara sipas lëmive i lehtësojnë mësuesit operacionalizimin e mëtejshëm të rezultateve në nivelin e njësive konkrete mësimore. Nga mësuesi pritet që për çdo njësi mësimore, në fazën e planifikimit dhe hartimit të përgatitjes për orën e mësimit t`ia përshtatë rezultateve të mësimit. Gjatë planifikimit, gjithashtu, duhet patur parasysh se disa rezultate realizohen më shpejtë e më lehtë, por për pjesën më të madhe të rezultateve (veçanërisht për fushën lëndore Letërsi) duhet më tepër kohë, më shumë aktivitete të ndryshme dhe punë në shumë tekste të ndryshme. Rezultatet e rekomanduara nuk janë të diferencuar sipas niveleve të të arriturave të nxënësve. Ota paraqesin pjesë obligative të përshkrimit të standardeve dhe mund të imtësohen ose të zgjerohen, në vartësi prej mundësive individuale të nxënësit dhe nevojave të tjera mësimore.

Në fazën e planifikimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies është shumë e rëndësishme të keni parasysh se teksti është një mjet mësimor dhe se nuk përcakton përmbajtjen e lëndës. Për këtë përmbajtjeve të dhëna në tekst është e nevojshme t`i qasemi në mënyrë selektive dhe në raport me rezultatet e parashikuara që duhet të arrihen. Përveç kësaj nxënësit duhet të aftësohen për shfrytëzimin e tekstit, si një nga burimet e njohurive, mësuesi vlen që t`i udhëzojë në mënyrat dhe format e përdorimit të burimeve të tjera të njohurive

II. REALIZIMI I MËSIMIT DHE NXËNIES

LETËRSIA

Boshtin e programit të letërsisë e përbëjnë tekstet nga lektura. Lektura është e ndarë sipas gjinive letrare – lirika, epika, drama dhe e pasuruar me zgjedhjen e teksteve jo fikcionale, shkencore – popullore dhe informative. Zgjedhja e veprave në masën më të madhe bazohet në principin e përshtatjes së moshës. Krahas teksteve që duhet përpunuar gjatë orës është dhënë lista e lekturës

shtëpiake. Qëllimi i përpunimit të veprës në kuadër të lekturës shtëpiake është formimi, zhvillimi ose kultivimi i shprehive të leximit tek nxënësit. Veprat voluminoze nxënësit mund t`i lexojnë gjatë pushimit, me çka nxitet zhvillimi i vazhdueshëm i shprehisë së leximit. Krahas listës obligative të veprave është dhënë edhe zgjedhja plotësuese e teksteve. Pjesa e zgjedhur i mundëson mësimdhënësit mundësi më të madhe kreativiteti në arritjen e rezultateve.

Me një korpus dominuese të teksteve të shkrimtarëve që mund të ndikojnë në formimin e shijes estetike të nxënësve, ndërton dhe pasuron vetëdijen për natyrës e letërsisë kombëtare (dhe vlerat e klasikëve të letërsisë botërore), por edhe identitetin kulturore dhe kombëtar.

Qëllimi i sjelljes së veprave letrare bashkëkohore është që sipas motivit ose me përkatësisë tematike të tyre lidhen me temat dhe motivet ekzistuese brenda programit mësimor, dhe me shembuj të tillë të tregojë se si shkrimtarët bashkëkohorë i mendojnë traditat epike popullore ose temat e miqësisë, etikës, zhvillimin e imagjinatës dhe empatisë, me çka do të pasurojnë përvojën vertikale të leximit të nxënësve dhe modernizon qasjen në mësimdhënie. Përmes një numri veprash letrare të shkrimtarëve bashkëkohorë, nxënësit do të jenë në gjendje të në mënyrë kritike të vlerësojnë poetikën e veprave të tyre.

Zgjedhja e veprave mundëson aplikimin e qasjes së studimit krahasues të të krijimtarisë letrare, me zgjedhjen e niveleve të ndryshme të përpunimit: interpretimit, paraqitjes ose rishikimeve. Dallimet në tërësinë artistike dhe vlerat informative të disa teksteve ndikojnë në zgjidhje përkatëse metodike (përshtatja e leximit të llojit të tekstit, shtrirja e komentimit të tekstit në vartësi nga ndërlikueshmëria e strukturës së tij, lidhja dhe grupimi me përmbajtjet gjegjëse nga fushat tjera lëndore – gramatika, drejtshkrimi dhe kulturë gjuhe dhe të ngjashme.).

Tekstet nga pjesa e programit plotësues duhet t`i shërbejë mësimdhënësit edhe gjatë përpunimit të njësive mësimore nga gramatika, si dhe për përpunim dhe përforcim të përmbajtjeve nga kultura e gjuhës. Veprat të cilat nuk i përpunon mësimdhënësi duhet t`i rekomandojë nxënësve për lexim gjatë kohës së lirë.

Programi i ri bazohet në njohjen e natyrës dhe rolin e veprës letrare, si dhe njohjen e dallimit të teksteve letrare dhe jo letrare, përkatësisht korrelacionit të tyre.

Nxënësit duhet të jenë të aftë të dallojnë veçantitë e tekstit letrar (konotacionin, veprimet letrare, denotativitetit, informimin, dhe duke treguar në bazë të fakteve dhe të dhënave në mënyra të ndryshme të teksteve jo letrare. Korrelacioni është mundësuar me kombinime adekuate të veprave obligative dhe zgjedhore. I njëjti tekst mund të lidhet me të tjerët në mënyra të ndryshme, sipas motiveve të ndryshme ose tonit të rrëfimit, në kuadër të mësimit me projekt, që bazohet në rezultate, kurse jo në përmbajtjet mësimore.

Tekstet e propozuara obligative, letrare, shkencore – popullore dhe informative dhe përmbajtja e lekturës shtëpiake obligative, si dhe shembujt nga zgjedhja plotësuese, me rastin e planifikimit të planit vjetor të punës, dhe pastaj edhe gjatë formësimit të planeve të punës orientuese mujore, mund të lиdhen tematikisht.

Nga lista e zgjedhjes plotësuese mësimdhënësi zgjedh oto vepra të cilat, me pjesën obigative të lekturës, përbëjnë tërësitë tematike – motivuese. Mësimdhënësi mund t`i grupojë sipas gjinisë veprat nga programi obligativ dhe plotësues në mënyra të ndryshme. Shembujt e mundshëm të lidhjes funksionale të njësive mësimore mund të jenë këto (në asnjë mënyrë të vetme).

GJUHA

Në mësimin e gjuhës nxënësit aftësohen të komunikojnë të drejtë me gojë e me shkrim në gjuhën standarde shqipe. Nga kjo kërkesat në këtë program nuk janë të drejtuar vetëm në përvetësimin e rregullave gjuhësore dhe normës gramatikore, por edhe në kuptimin e funksioneve të tyre dhe zbatimin e drejtë në të shprehurit me gojë e me shkrim.

Kur në përmbajtjet e programit jepen njësi mësimore, të cilat nxënësit i kanë përpunuar edhe më herët, kuptohet se shkalla e përvetësimit dhe aftësimit të zbatimit të lëndës së përpunuar më herët verifikohet, kurse përsëritja dhe ushtrimi në këta shembuj i paraprin përpunimit të përmbajtjeve të reja, me çka sigurohet kontuiniteti i punës dhe sistematizimit në lidhjen e materialit të ri me njohuritë ekzistuese.

Gramatika

Kërkesa themelore programore në mësimin e gramatikës është që nxënësve gjuha t`i paraqitet dhe t`i shpjegohet si sistem. Asnjë dukuri gjuhësore nuk duhet të studiohet dhe shpjegohet e izoluar, jashtë kontekstit në cilin realizohet funksioni i saj (në secilin rast të përshtatshëm mund të vendosen në funksion, njohuritë nga gramatike, në shpjegimin e tekstit, si atij artistik edhe atij shkencor – popullor). Një nga veprimet e veçanta funksionale në mësimin e gramatikës është ushtrimet e bazuara në shfrytëzimin e shembujve nga praktika e drejtpërdrejtë e të folurit, çka mësimin e gramatikës ia

ofron nevojave jetësore, në të cilat paraqitet gjuha e aplikuar si aktivitet i motivuar dhe i gjithanshëm i aktivitetit njerëzor

Në këtë mënyrë tek nxënësi zhvillohet edhe vetëdija e rëndësisë së kulturës e të folurit, e cila është e domosdoshme në jetën e përditshem si pjesë e kulturës së përgjithshme, e jo vetëm si pjesë e programit mësimor.

Mësimi i morfologjisë nënkupton rrumbullakësimin e e njohurive për ndërtimin e formave foljore. Është e domosdoshme lidhja e përmbajtjeve të reja me mësimet e punuara në klasat e më hershme, prandaj me shikimin e të gjitha formave foljore të përpunuara të bëhet nj[sintezë dhe të ndahen të gjitha format e foljeve fillimisht në vetore dhe pavetore dhe pastaj format e foljeve vetore në kohë dhe mënyra. Gjithashtu, është e nevojshme të theksohet edhe ndarja e të gjitha formave të foljeve në të thjeshta dhe të përbëra. Përdorimin e mbiemrit pasiv të foljes duhet shpjeguar me shembujt më tipik të konstruksioneve pasive. Duhet sistematizuar llojet e fjalëve duke përvetësuar përmbajtje të reja si: lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrmat.

Mësimi i sintaksës nënkupton sjellja e shprehjes së sintagmës dhe njohjen e gjymtyrës kryesore dhe të varur në kuadër të saj. Në shembujt e qartë dhe të pakontestueshëm nxënësit nëpërmjet ushtrimeve dallojnë gjymtyrën kryesore dhe të varur si dhe llojin e sintagmës. Futet atributi edhe atë si sintagmor, e jo si gjymtyrë e fjalisë. Është e rëndësishme të theksohet se cilat lloje të fjalëve paraqiten në kuadër të atributit. Në klasat e më hershme është përpunuar subjekti gramatikor, kurse tani futet edhe shprehja e subjektit logjik.

Drejtshkrimi

Përmbajtjet nga drejtshkrimi është e domosdoshme të lidhen me temat përkatëse edhe në orët e gramatikës edhe në ato të letërsisë. Për shembull. Kur përpunohet ndërtimi i formave të foljeve, duhet përpunuar edhe zgjidhjet drejtshkrimore të foljeve në lidhje me drejtshkrimin e formave të foljes. Në lidhje me përvetësimin e tipave të fjalisë është e nevojshëm të përpunohen edhe pikësimi, para së gjithash presjen si shenja më të rëndësishme të pikësimit. Duhet të jepen qartë rregullat kur duhet të shkruhet presja, dhe kur presja është shenjë jo e domosdoshme ose veçori e stilit. Lidhja e përmbajtjeve nga gramatika dhe letërsia bëhet me analizimin e përdorimit të presjes në fjalitë e ndara dhe dallimin e përdorimit të presjes në veprat letrare. Në pika të shkurta duhet theksuar në specifikat e stilit artistiko – letrar, ku ndonjëherë si rezultat i kreativitetit të shkrimtarit me qëllim nuk zbatohen rregullat e drejtshkrimit (veçanërisht në poezi). Kombinimi i shenjave të drejtshkrimit miratohet që në klasat e më hershme në lidhje të folurit e drejtuar, por edhe tani theksohet në llojet tjera të shenjave drejtshkrimore të kombinuara, para së gjithash në përdorimin e presjes pas shkurtesave dhe numrave rendor. Shkrimi i shkurtesave ka të bëjë me përsëritjen e asaj që është mësuar në lidhje me shkurtesat, por edhe në zgjerimin e llojeve të shkurtesave të cilat theksohen në drejtshkrimin që është në fuqi.

Rregullat e drejtshkrimit miratohen me anë të ushtrimeve sistematike (diktimeve drejtshkrimore, përmirësimit të gabimeve në tekstin e dhënë, testeve me pyetje nga drejtshkrimi etj.). gjithashtu duhet nxitur nxënësit që vet të dallojnë dhe përmirësojnë gabimet drejtshkrimore gjatë komunikimit me SMS, si dhe në llojet e ndryshme të komunikimit nëpërmjet internetit.

Pos kësaj, nxënësit duhet udhëzuar në shërbimin e drejtshkrimit dhe të fjalorit të drejtshkrimit (botim shkolle). Është e preferueshme që mësimdhënësi të sjellë në orë ekzemplar të Drejtshkrimit sa herë që përpunohen tema të drejtshkrimit (kështu do të mund që individualisht nxënësve t`i japë të gjejnë fjal[në fjalorin drejtshkrimor dhe të përcaktojnë formën e rregullt të saj ose shkrimin e drejtë).

Drejtshqiptimi

Ushtrimet drejtshqiptimore nuk duhet realizuar si njësi të veçanta mësimore, por përmes temave përkatëse nga gramatika, por edhe në orët nga letërsia. Në këtë nivel nxënësit duhet të dallojnë dallimet ndërmjet theksit zbritës dhe atij ngjitës dhe t`i shënojnë drejtë të theksat në shembujt tipik. Nëse për këtë ekzistojnë kushtet, mësimdhënësi duhet të lëshojë incizime të drejtshqiptimit dhe t`i tregojë dallimet në shqiptim. Nxënësit duhet mësuar të njohin, riprodhojnë dhe përvetësojnë të folurit e theksuar, kurse në vendet ku shmangemi nga norma e theksimit të dallojnë theksin standard nga theksi i vet, ose nga theksimi dialektor.

KULTURA E GJUHËS

Një nga detyrat themelore të mësimit të kulturës së gjuhës ka të bëjë përvetësimin e mjeteve të shprehjeve gjuhësore tek nxënësit, kurse qëllimi i fundit është që nxënësit të aftësohen në vendosjen e cilësi së dhe të komunikimit kuptimplotë. Edhe pse fusha e kulturës gjuhësore është e konstituuar si hapësirë e veçantë programore, është parashikuar në mësimin e tërësishëm të gjuhës dhe letërsisë shqipe të lidhet edhe me dy fushat e tjera letërsinë dhe gjuhën. Fusha Kulturë gjuhe përfshinë të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Me ç`rast duhet kushtuar kujdes të njejtë të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

Në këtë moshë duhet shqyrtuar specifikat e dy stileve funksionale, atij letraro – artistik dhe publicistik.

Nxënësit duhet të inkurajohen që në tekstin e dhënë, të përzier dhe të kreuar me dedikim të gjejnë dhe të radhisin fjalitë duke pasur parasysh se a i përkasin stilit letraro – artistik apo atij publicistik. Pastaj, të gjejnë fjalinë e shkruar në tekst në stilin publicistik, i cili është shkruar në stilin letraro – artistik dhe anasjelltas. Duhet të shpjegojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet dy stileve funksionale, të zhvillojnë aftësitë e kuptimit të veçorive të tyre.

Koherenca paraqet një shenjë të rëndësishme të strukturës tekstuale dhe udhëzohet në karakterin kontinuitiv të ndonjë teksti. Nga kjo në mësmin e kulturës gjuhësore duhet aftësuar nxënësit që në formë gojore dhe me shkrim të koncipojnë përbërjet sipas drejtimeve të cila do t`u jenë dhënë. Për shembull, duhet të hartojnë tekste të menduara logjike në bazë të fjalëve të dhëna të cilat fjalë duhet patjetër t`i përdorin; të hartojnë tekste gjatësia e të cilëve do të jetë e kufizuar (numri i kufizuar i fjalëve); që në tekstin që e hartojnë të përdorin kryesisht modele të caktuara gramatikore ose të leksikun e caktuar. Gjithashtu, duhet inkurajuar të mendojnë disa fillime të ndryshme të teksteve në temën e njejtë të dhënë ose të mendojnë disa përfundime të ndryshme me përgatitje të dedikuar dhe sipas tekstit të përshtatshëm të papërfunduar; të ndryshojnë fundin (ose pjesë tjera të përshtatshme) e një shabloni letrar; të vendosin renditje të shthurur kronologjike ose të menduar në tekstin e dhënë dhe ngjashëm.

Një kompetencë shumë e rëndësishme e cila gjendet në baën e shumë niveleve të kuptimit të teksti, është shkathtësia e argumentimit. Duke pasur parasysh që zhvillimi i mendimit të argumentuar ka rol të rëndësishëm në arsim, sepse mund të ndikojë pozitivisht në fitimin e njohurive, gjatë mësimit të kulturës gjuhësore duhet verifikuar deri në ç`masë nxënësit janë në gjendje të kuptojnë tekstet e argumentuara. Duhet inkurajuar nxënësit që të arsyetojnë me argumente qëndrimin e vet lidhur me situatën problemore në veprën letrare; që me argumente të arsyetojnë qëndrimin e vet eksplicit të paraqitur për dikë, për ata, çështje e rëndësishme.

Një nga format themelore të shprehjes me gojë dhe me shkrim – përshkrimi. Paraqet përmbajtje bazike programore për përsosjen dhe kultivimin e kulturës së duhur gjuhësore të nxënësit. Në këtë moshë nxënësit duhet të shfrytëzojnë të dy llojet e përshkrimit: teknik dhe sugjestiv, përkatësisht duhet aftësuar të përshkruajnë një lëndë, nocion apo qenie të caktuar, fillimisht në mënyrë objektive (përshkrim teknik), dhe pastaj duke i shprehur përshtypjet e veta (përshkrim sugjestiv). Gjithashtu, duhet inkurajuar të mendojnë paralelisht të dy llojet e përshkrimit të të njëjtit send përshkrimi; të gjejnë elemente e dy përshkrimeve në tekstin e përzier;

Gjatë mësimit të kulturës së gjuhës në kët moshë duhet tërhequr vëmendjen nxënësve, ndërmjet tjerash, edhe në metodat e paraqitjes së burimeve dhe ideve, si dhe shpjegimeve plotësuese të cilat përdoren në tekst. Duhet inkurajuar të shpjegojnë shkaqet dhe funksionet e citimit; të shpjegojnë situatat problemore të vërejtura në tekstet letrare dhe të tjera me ndihmën e citateve: të komentojnë rëndësin dhe kuptimin e fusnotës së përdorur në shembullin e dhënë; të dallojnë citatet dhe parafrazat në shembujt e dhënë. Gjithashtu, duhet tërhequr vërejtjen në rregullat të cilat ndikojnë në shkrimin numrave të eksponuar me të cilët shënohen fusnotat në fund të fjalisë.

Llojet e ushtrimeve gjuhësore duhet zgjedhur sipas interesimeve të nxënësve ose në kontekst ë përmbajtjes mësimore. Këto mund të jenë: plotësimi i tekstit me forma të ndryshme të fjalëve të ndryshueshme; plotësimi tekstit me fjalë të pandryshueshme; shënimi i fjalive komunikuese në tekst; paraqitja e gjymtrës së fjalisë në mënyra të shumta.

Me zbatimin e ushtrimeve gjuhësore krijohet shprehia që të mendojnë dhe kërkojnë shprehje adekuate për atë që e dëshirojnë ta tregojnë (në vartësi prej situatës së komunikimit) dhe të shtojnë fondin e shprehjeve të trillanë fjalorin e tyre, me theks të veçantë në frazeologjizma dhe shprehje të krijuara (shembujt të meren nga tekstet e përpunuara).

Në çdo gjysmëvjetor punohen nga dy detyra (hartime) me shkrim (gjithsej katër në vit).

Rekomandohet të punohen tetë detyra (hartime) me shkrim (përmbajtje të shkruara).

III. PËRCJELLJA DHE VLERËSIMI I MËSIMIT DHE NXËNIES

Përcjellja dhe vlerësimi i rezultateve të përparimit nxënësit është në funksion të realizimit të rezultateve, kurse fillon me vlerësimin inicial të nivelit të arritur të njohurive, në raport me atë se si do të matet përparimi mëtejshëm dhe si do të formohet notimi. Secila orë mësimore dhe çdo aktivitet i nxënësit është rast për notimin formal të nxënësit, përkatësisht regjistrimi i përparimit të nxënësit dhe udhëzimi për aktivitete të mëtejshme.

Vlerësimi formal është pjesë e qasjes moderne të mësimit dhe nënkupton vlerësimin e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe sjelljeve si dhe zhvillimin e kompetencave përkatëse gjatë mësimit dhe nxënies. Matja formale nënkupton grumbullimin e të dhënave mbi të arriturat e nxënësit, me ç`rast më shpesh zbatohen këto teknika: realizimi i detyrave praktike, vështrimi dhe regjistrimi i aktiviteteve

të nxënësit gjatë mësimit, komunikimi i drejtpërdrejtë ndërmjet nxënësit dhe mësimdhënësit, regjistri për çdo nxënës (harta e përparimit) etj. Rezultatet e vlerësimit formal në fund të ciklit mësimor duhet të jenë të paraqitur edhe me notë numerike.

Puna e çdo mësimdhënësi përbëhet nga planifikimi, realizimi, përcjellja dhe vlerësimi. Është e rëndësishme që mësimdhënësi, krahas arritjeve të nxënësit, në vazhdimësi të përcjellë dhe vlerësojë punën e vet. E gjitha që tregohet e mirë dhe efikase, mësimdhënësi do ta shfrytëzojë edhe më tej në praktikën e vet mësimore, kurse ajo që vlerësohet si e pamjaftueshëm efektive, duhet të avancohet.

6. PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR PËR KLASËN E KATËR TË SHKOLLËS SË MESME – TEKNIK I EKONOMISË

Emri i lëndës	**GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE**
Qëllimi	Qëllimi i mësimit të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe është që të përvetësojnë rregullat themelore të gjuhës letrare standarde shqipe me qëllim të përdorimit të drejtë në të folur, në të shkruar dhe gjatë të shprehurit në komunikim; kultivimi i vetëdijes mbi rëndësinë e rolit të gjuhës në ruajtjen e identitetit kombëtar; aftësimin e nxënësit për të komentuar pjesë të zgjedhura letrare dhe vepra të zgjedhura artistike nga letërsia shqipe dhe trashëgimia botërore, me qëllim të kultivimit të traditës dhe kulturës së popullit shqiptar; zhvillimin interkulturor; Zhvillimi i aftësisë dhe kulturës së leximit; gjetjes së përvojave dhe ideve letrare; nxitjen dhe vlerësimin e krijimtarisë personale dhe krijimtarisë së të tjerëve; kuptimin e tekstit në kontekste të ndryshme kulturore, ndërkulturore dhe shoqërore.
Klasa	**E KATËR**
Fondi vjetor i orëve	**99 orë**

KOMPETENCAT E PRGJITHSHME LËNDORE

Nxënësi njeh veprat e letërsisë shqipe që i përkasin trashëgimisë kulturore kombëtare dhe korrespondojnë me epokën e saj, njihet me kryeveprat e letërsisë botërore dhe parimet themelore të interpretimit të teksteve letrare. Ai njihet me karakteristikat themelore të komunikimit, rregullat e komunikimit me gojë dhe me shkrim janë të qarta për të. Ai flet dhe shkruan duke respektuar pritjet e normave gjuhësore. Ai krijon një tekst të plotë, të saktë gojor dhe të shkruar, në përputhje me aspektet stilistike, kupton dhe vlerëson në mënyrë kritike atë që ka lexuar, pasuron përgjithmonë fondin e tij leksikor. Ai lexon, përjeton dhe interpreton vepra letrare dhe joletrare. Ai e konsideron të lexuarit si një mjet për të njohur veten dhe botën. Ai gradualisht bëhet lexues, zgjedh leximin sipas shijes së tij, zhvillon nevojën për të përmirësuar kompetencën e tij për të kuptuar tekstin dhe kulturën e të folurit. Ai respekton, ruan me vetëdije gjuhën e tij amtare.

Niveli bazë

Nxënësi flet qartë dhe rrjedhshëm, respekton normat gjuhësore, dëgjon me kujdes dhe me respekt mendimet e të tjerëve. Përbën një tekst të plotë, gjuhësor dhe stilistik, të formuar mirë, më të shkurtër, më të thjeshtë me gojë ose me shkrim. Miraton zakone zyrtare dhe informale të shkrim-leximit në praktikë. Ai kupton tekste letrare dhe joletrare më të shkurtra, më të thjeshta, të ndërlidhura dhe rishikon në mënyrë kritike përmbajtjen e tyre. Gradualisht ai ndërtoi fondin e tij poetik leksikor.

Nxënësi ka njohuri themelore për gjuhën, faktorët dhe funksionet e komunikimit, njeh shtresat gjuhësore dhe dallon variantet gjuhësore. Ai mëson bazat e fonetikës, fjalorit dhe sintaksës së gjuhës shqipe, dhe është në gjendje të zbatojë rregulla gramatikore në të folur dhe shkrim. Përvetëson njohuri themelore të tekstologjisë dhe stilistikës.

Nxënësi pasuron vazhdimisht fondin e tij leksikor, dhe prej tij, sipas situatës, ai zgjedh dhe përdor shprehje të përshtatshme. Ata zhvillojnë një nevojë natyrore për të mësuar, ruajtur dhe ushqyer gjuhën e tyre amtare.

Nxënësi i njeh veprat letrare të përcaktuara nga kurrikula, dhe është në gjendje t'i vendosë ato sipas opusit të autorit dhe kontekstit letrar-historik. Ai dallon qartë karakteristikat themelore poetike

dhe stilistike të epokave stilistike dhe drejtimeve të letërsisë shqiptare dhe botërore. Njoh karakteristikat gjuhësore, kompozicionale dhe stilistike të teksteve dhe është në gjendje të përdorë argumente për të argumentuar përfundimet e tyre. Zhvillon zakonet e të lexuarit, mëson rolin e të lexuarit në njohjen e vetvetes.

Nxënësi njihet me përdorimin e manualeve, me rregullat e përdorimit të bibliotekës, merr njohuri për mënyrat e mbledhjes së informacionit përmes Internetit. Ai është i qartë për rregullat e gjuhës elektronike, si dhe sistemin e rregullave të nevojshme për krijimin e dokumenteve elektronike. Përdor fjalorët më të rëndësishëm, rregullat e drejtshkrimit, njeh strukturën e artikullit të fjalorit.

Niveli i mesëm

Nxënësi përballet mirë në situata të ndryshme të komunikimit publik. Ai flet para një audiencë mbi tema gjuhësore, letrare dhe kulturore. Ai gjithashtu paraqet mendimet e tij pikërisht kur harton tekste më komplekse të gjuhës gojore ose të shkruara. Ka një shije të formuar leximi. Ai i kupton dhe interpreton tekstet më të gjata, thjesht të lidhura letrare dhe joletrare gjatë leximit, që synojnë të fitojnë përvojë dhe me një qëllim shkencor. Ai rishikon në mënyrë kritike tekstet letrare dhe joletrare.

Nxënësi ka një njohuri më të gjerë për karakteristikat e gjuhës, rolin, funksionet dhe ka një njohuri themelore të gjuhëve të botës. Ai menaxhon në botën e mediave masive, njihet me zhanret e mediave. Ai njihet me origjinën e gjuhës shqipe, epokat e saj historike, si dhe historinë e zhvillimit të letërsisë shqipe. Ai e kupton që gjuha jeton në variante, bën dallimin midis dialekteve dhe varianteve gjuhësore shoqërore. Ai ka një njohuri më të gjerë për gramatikën e niveleve të gjuhës (fonetikë, leksikë, sintaksë, tekstologji). Ai analizon tekste të ndryshme bazuar në njohuritë e tij për stilistikën dhe aspektet e klasifikimit të llojeve të teksteve, dhe krijon veprat e tij.

Nxënësi pasuron përgjithmonë fondin e tij leksikor, zbaton njohuritë e tij për gjuhën dhe gramatikën në praktikë, ai mund të shprehet saktësisht, qartë dhe ndryshe.

Nxënësi interpreton me vetëbesim temën, mesazhin e teksteve letrare, karakteristikat e tyre kompozicionale, poetike, stilistike, gjuhësore dhe zhanre. Ai i njeh konceptet e teorisë letrare dhe i zbaton ato kur interpreton veprat letrare. Lexon tekste me mirëkuptim. Në mënyrë të pavarur njeh dhe analizon çështjet themelore të veprave letrare, shpjegon mendimin e tij me argumente bindëse. Njoh natyrën dhe karakteristikat e lidhjeve midis letërsisë dhe arteve të tjera.

Nxënësi është i njohur me rregullat në lidhje me përdorimin e bibliotekës dhe manualeve, d.m.th. Internetit për të mbledhur informacion. Mund të përdorë një program për përpunimin e fjalëve për të hartuar një tekst që përputhet me rregullat e drejtshkrimit.

Niveli i avancuar

Nxënësi përvetëson aftësinë për të diskutuar tema komplekse letrare, kulturore dhe gjuhësore të përcaktuara nga materiali mësimor. Ai ka një aftësi të zhvilluar për retorikë. Ai krijon tekste profesionale në të cilat merret me tema gjuhësore dhe letrare.

Zhvillon aftësinë për të lexuar dhe interpretuar tekste, me vetëdije ushqen rolin pritës (lexues). Ai zhvillon një qasje kritike, të udhëhequr nga mendimi i tij dhe kur interpreton tekste më të ndërlikuara letrare dhe joletrare. Ajo njeh tiparet kompozicionale dhe stilistike të teksteve me siguri. Përveç leximit të detyrueshëm në shtëpi, ai mund të interpretojë edhe tekste që ai zgjedh vetë. Kur prezanton mendimin e tij, ai aplikon teknikën e argumentimit të pjekur. Ai bëhet një lexues i rregullt, duke përshtatur strategjitë e leximit me karakteristikat e një vepre të caktuar letrare dhe qëllimet e leximit (përvoja, kërkimi, krijimi). Ai është në gjendje të përdorë në mënyrë të pavarur njohuritë e tij për lidhjen midis degëve të ndryshme të artit për të zbuluar lidhje intermediative.

Ai ka njohuri të gjera për gjuhën dhe sistemin e gjuhës shqipe, si dhe zhanret e vjetër dhe të rinj të komunikimit. Njeh dhe krahason karakteristikat poetike, kompozicionale dhe stilistike të teksteve. Ai zbaton njohuritë teorike të marra në lidhje me mjetet gjuhësore të shtresave stilistike në praktikë (kur analizon dhe krijon tekste). Ai njihet me drejtimet e gjuhësisë moderne dhe i vë njohuritë e marra në një kontekst ndërdisiplinor. Ndërsa mëson karakteristikat pragmatike të tekstit, kështu që akti i funksionimit të gjuhës i zbulohet atij, hapen mundësi të shumta për të analizuar kuptimin e tekstit.

Ai administron bibliotekën, manualet dhe internetin me siguri. Kur interpreton vepra letrare, ai rregullisht përdor letërsi më të gjerë profesionale. Duke pasur parasysh rregullat etike në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit, ai krijon veprat e tij duke përdorur përparësitë dhe mjetet e mediave dixhitale. Ai zbaton një sistem rregullash të nevojshme për krijimin e dokumenteve elektronike, në përputhje me rregullat gjuhësore të dokumenteve elektronike.

Studenti ka një njohuri të gjerë për karakteristikat e përgjithshme të gjuhës, funksionet e tij dhe sistemin e gjuhës shqipe (rreth niveleve të ndryshme të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji). Duke pasur njohuri për tekstologjinë, ai është në gjendje të vartësojë faktorët e botës tekstuale në aspektet e përpunimit të tekstit. Ai fiton njohuri në drejtimet e gjuhësisë moderne, dhe

zbaton njohuritë e marra gjatë përpilimit të punimeve të projektit të tij. Kupton natyrën e marrëdhënies midis gjuhësisë dhe fushave të tjera shkencore.

KOMPETENCA E VEÇANTA Gjuha shqipe dhe komunikimi

Niveli bazë

Nx[nësi përvetëson njohuri për rolin themelor të gjuhës, karakteristikat dhe funksionet e tij komunikuese. Ai tregon respekt për gjuhën e tij amtare, si dhe gjuhën dhe kulturën e popujve të tjerë. Në nivelin bazë, ai zotëron sistemin e gjuhës shqipe (gramatika e niveleve të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji).

Nxënësi gjendet mirë në nivele më të ulëta të tekstit, përvetëson njohuri për fonetikë, dallon llojet e fjalëve, njeh sistemin morfologjik të gjuhës shqipe. Ai është në gjendje të formulojë në mënyrë të pavarur mendimet e tij, në përputhje me normat gjuhësore, fjalitë e qarta dhe të sakta dhe të analizojë fjalitë në një nivel bazë. Përvetëson njohuri për marrëdhëniet midis shenjës dhe kuptimit, njihet me zhvillimin historik të gjuhës shqipe.

Njoftohet me karakteristikat e përgjithshme të tekstit, shtresat stilistike, konceptet themelore të stilistikës, llojet e teksteve. Mund të përcaktojë elementet e teksteve të shkurtra (temën, titullin, analizën, paragrafët), njeh forcën lidhëse, elementët lidhës të tekstit.

Ai mëson rregullat e shqiptimit të saktë, mjetet e shprehjes gjuhësore të kultivuar. Në mënyrë ekspresive dhe besnike, ai rrëfen fragmente më të shkurtër tekstesh, memorizuesish, në origjinal.

Përdor fjalorët më të rëndësishëm të gjuhës shqipe, rregullat e drejtshkrimit dhe fiton përvojë në mbledhjen e informacionit nga Interneti. Miraton rregullat e sjelljes së gjuhës dhe rregullat etike të komunikimit në internet. Ai me edukatë dhe argumentim shpreh mendimin e tij në debate mbi temën nga materiali mësimor dhe çështje nga jeta e përditshme.

Ai e ndërton strategjinë e tij të diskutimit në paraqitjen e argumenteve në një mënyrë logjike dhe të dëgjojë me kujdes mendimet e njerëzve të tjerë. Mund të përdor llojet themelore të teksteve të shkruara joformale dhe formale (lutjet, CV, letër motivuese, ankesë), si dhe programe kompjuterike dhe teknika prezantimi. Në fund të shkollimit, ai shkruan një punim diplome, duke respektuar kërkesat tematike, stilistike dhe kompozicionale në lidhje me shkrimin e një punimi profesional.

Niveli i mesëm

Nxënësi tregon njohuri më të plota të veçorive të sistemit gjuhësor. Nocioni i farefisnisë së gjuhëve është i qartë për të, ashtu si dhe sistemi i marrëdhënieve të farefisnisë midis gjuhëve. Di dhe zbaton në shprehjen e rregullave të shqiptimit të saktë dhe mjeteve të të folurit të kultivuar. Gjatë leximit me zë të lartë dhe interpretimit të teksteve letrare, si dhe në situata të komunikimit të përditshëm, ai krijon prodhimin e tij në bazë të njohurive për mjetet e fonetikës së tekstit. Di dhe zbaton rregullat themelore të drejtshkrimit.

Nxënësi zhvillon një kuptim të konceptit të integritetit të sistemit gjuhësor. Ai ka një njohuri më të plotë mbi sistemin e llojit të fjalëve dhe strukturën e fjalive. Duke përdorur aftësinë për të analizuar me siguri, ai përdor sistemin morfologjik të gjuhës amtare, njeh pjesë të një fjalie dhe i analizon duke përdorur modele të përshtatshme të fjalive.

Njeh tiparet stilistike të llojeve dhe zhanreve të ndryshëm të teksteve, si dhe mjeteve stilistike. Ai është i sigurt në temën e komunikimit masiv, njihet me zhanret e mediave.

Ai lexon në mënyrë ekspresive, pasuron fondin e tij leksikor, në situata të ndryshme të të folurit ai shprehet në përputhje me rrethanat komunikuese, dhe në shprehjen e folur dhe të shkruar përdor elemente të përshtatshme të fjalorit.

Informohet nga burime të shtypura dhe elektronike. Ai mund të hartojë lloje më të ndërlikuara të teksteve, ai shprehet saktësisht dhe qartë. Në mënyrë të pavarur përgatit letra për tema të ndryshme.

Niveli i avancuar

Nxënësi ka një njohuri më të gjerë për karakteristikat e përgjithshme të gjuhës, funksionet e saj dhe sistemin e gjuhës shqipe (rreth niveleve të ndryshme të gjuhës: fonetikë, leksikologji, sintaksë, tekstologji). Duke pasur njohuri për tekstologjinë, ai është në gjendje t`i vartësojë faktorët e botës tekstuale në aspektet e përpunimit të tekstit. Ai i di karakteristikat formale të përmbajtjes së zhanreve të reja të komunikimit dhe llojeve të teksteve në internet, dhe në mënyrë të pavarur formon një mendim rreth tyre.

Tiparet pragmatike të tekstit janë të qarta për të. Fiton njohuri në drejtimet e gjuhësisë moderne, zbaton njohuritë e tij gjatë përpilimit të dokumenteve të projektit. Njoh natyrën e lidhjeve midis gjuhësisë dhe fushave të tjera shkencore.

Duke aplikuar njohuri për retorikën, ai është në gjendje të krijojë dhe të paraqesë një tekst argumentues bindës, duke përdorur me vetëdije mjete gjuhësore dhe jo-gjuhësore të interpretimit të tekstit, duke marrë parasysh pritjet e dëgjuesve. Krijon dhe interpreton tekste të ndryshme

profesionale, gazetare dhe letrare, duke mbajtur në vëmendje shkallën e krijimit të tekstit, në një stil që i përgjigjet situatës së të folurit dhe zhanrit, duke aplikuar elementet e duhura të lidhjes.

Ai është në gjendje të kryejë punë kërkimore në bibliotekë, mbledh në mënyrë të pavarur dhe klasifikon informacione me qëllim të punimeve të shkruara, paraqitjeve dhe eseve, në të cilat ai paraqet mënyrën e tij individuale të të gjykuarit.

KOMPETENCAT E VEÇANTA: Letërsia

Niveli bazë

Lexon qartë dhe rrjedhshëm. Ai është në gjendje të lexojë tekste letrare dhe joletrare, kupton dhe parafrazon tekste të shkurta letrare të thjeshta. Ai është në gjendje të përmbledhë temën e një vepre letrare, dallon informacionin e kërkuar në një tekst jo letrar. Ai i njeh veprat letrare të përcaktuara me planin dhe programin mësimor, krijimtarin e autorëve dhe karakteristikat më të rëndësishme përmbajtësosoro-formale të epokave letrare. Dallon letërsin[gojore nga ajo e shkruar. Ai i di karakteristikat e poezisë popullore dhe autoritare, si dhe lidhjen e tyre. Njeh tiparet formale, stilistike dhe zhanre të veprave letrare, është në gjendje të formulojë temën dhe karakteristikat e botës së tyre tekstuale. Interpreton pyetje që lidhen me tekste letrare të thjeshta. Ai e kupton rëndësinë e leximit për zhvillimin e personalitetit të tij dhe fondit leksikor. Kur shpreh përshtypjet dhe konkluzionet e tij, ai i referohet shembujve nga tekstet letrare dhe joletrare. Ai mund të bëjë dallimin midis përmbajtjes litrare dhe asaj transmetuese, metaforike. Mund të përcaktojë vendin e letërsisë në sistemin e artit (muzikë, film, arte të bukura, teatër, etj.). Përvetëson njohuri ndërdisiplinore.

Niveli i ndërmjetëm

Njeh strategjitë themelore të leximit dhe di si t'i përdorë ato në situata të dhëna leximi. Ai përdor më shumë këndvështrime në interpretimin e tij dhe i konsideron në mënyrë kritike tekste të gjata, të thjeshta letrare dhe joletrare. Duke përdorur njohuritë e marra sipas programit mësimor, ai interpreton dhe dallon elementet të rëndësishme të përbërjes dhe shtresave të kuptimit të një vepre letrare, karakteristikat stilistike, gjuhësore dhe formale të saj. Ai i njeh konceptet themelore letrare, teoriko – letrare, termat, dhe kur interpreton veprat letrare i përdor ato në harmoni me qëllimin. Në mënyrë të pavarur analizon çështje që lidhen me veprat letrare, argumenton gjykimin e tij për to. Ai është në gjendje të zbulojë lidhje midis veprave të ndryshme letrare, epokave dhe drejtimeve stilistike. Zbulon lidhjet intertekstuale dhe ndërdisiplinore midis veprave letrare. Kupton dhe vlerëson lidhjen midis letërsisë dhe arteve të tjera. Merr një qëndrim të qartë ndaj tekstit të lexuar. Ai zgjedh në mënyrë të pavarur veprat për të lexuar nga vargu i letërsisë, i përshtatshëm për moshën e tij. Vë në dukje kureshtjen e lexuesit. Kupton rëndësinë e leximit për zhvillimin e kulturës dhe njohurive të tij të përgjithshme. Në mënyrë eksploruese dhe krijuese, ai përvetëson një aftësi leximi që mund ta përdorë, gjatë studimit të veprave dhe zhanreve të ndryshme letrare, me ndihmën e të cilave mund të zhvillojë identitetin e tij letrar, gjuhësor, kulturor dhe kombëtar.

Niveli i avancuar

Me dëshirë, kureshtje hulumtuese dhe mënyrë kritike lexon, interpretojë dhe vlerëson tekste komplekse letrare dhe joletrare të rekomanduara nga programi mësimor, por gjithashtu kënaqësi liston dhe interpreton si veprat e rekomanduara dhe ato të zgjedhura në mënyrë të pavarur. Në mënyrë të pavarur vëren dhe interpreton çështje që trajtohen në veprat letrare. Ai përdor disa këndvështrime kur interpreton vepra letrare, ai është në gjendje t'i vendosë ato në një kontekst të ndërmjetëm ndërdisiplinor: lidh ato me degë të tjera artistike dhe fusha shkencore. Ai përvetëson aftësinë e krahasimit të tipareve të shquara tematike dhe formale – stilistike të veprave letrare. Ai përvetëson një teknikë të zhvilluar të argumentimit kur shpreh mendimin e tij mbi tekstin dhe përfundimet e tij. Kur interpreton vepra letrare të përcaktuara nga programi mësimor, ai hulumton tërësisht letërsinë profesionale të shkruar dhe elektronike. Zbaton strategjitë e leximit në përputhje me detyrën e leximit. Ai përvetëson një kulturë të zhvilluar leximi, leximi i një vepre letrare është një përvojë për të. Përmes leximit, ai pasuron njohuritë e tij, fondin leksikor, zhvillon aftësinë e argumentimit, di të shprehë mendimin e tij, di të mbrojë pozicionin e tij. Ai mund t'u rekomandojë vepra letrare të tjerëve dhe të shpjegojë zgjedhjen e tij. Ai tregon respekt për vlerat e letërsisë dhe kulturës kombëtare dhe për kulturën e kombeve të tjera. Ai pasuron njohuritë e tij ndërkulturore duke u njohur me përkthimet e veprave letrare të huaja dhe kontaktet me kombet e tjera. Ai aplikon një aspekt kritik kur zgjedh midis burimeve të letërsisë profesionale në lidhje me veprat letrare në internet, ai u jep përparësi revistave cilësore.

Rezultatet e mëposhtme përshkruajnë atë që nxënësi e di dhe është në gjendje ta bëjë në **nivelin themelo**r të çdo fushë të njohurive.

GJUHA DHE LETËRSIA SHQIPE
(Klasa e katër)

Standardet e përgjithshme të arritjeve – Standardet arsimore për përfundimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për lëndën Gjuhë dhe Letërsi shqipe përmbajnë standarde e arritjeve për fushat: Gjuha, Letërsia dhe Kultura e Gjuhës. Brenda secilës fushë/temë, janë përshkruar kërkesat në tre nivele.

Standardet e përgjithshme të arritjeve – standardet arsimore për fund të arsimit të mesëm për lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë shqipe:	**REZULTATET** Nxënësi është në gjendje që:	**PËRMBAJTJA**
2GJSH.1.1.1. Posedon njohuritë elementare për gjuhën (ç'është gjuha, si funksionon, veçoritë e saj) etj. Respekton gjuhën e tij dhe gjuhën e të tjerëve; përdor fjalë (shprehje) stereotipe për gjuhën. E di nocionin e tekstit dhe dallon pjesët e tij (hyrjen, pjesën kryesore, përmbajtjen, përfundiminfundin), po ashtu dallon llojet e teksteve (varësisht nga diskursi). Ka njohuri për sociolinguistikën sidomos për njëgjuhësinë (monolinguizmin) dhe shumëgjuhësisë (polilinguizmin) dhe njeh rastet gjegjëse gjuhësore në Shqipëri, Kosovë, Mqedoni, Serbi…). E di konceptin e varietetit gjuhësor dhe njeh varietete themelore të gjuhës. 2GJSH.1.1.2. Dallon gjuhën letrare (standarde) nga dialekti; e di ndarjen dialektore të gjuhës shqipe; ka njohuri për dialektin e tij dhe për dialektin tjetër të gjuhës shqipe si dhe për të folmet e tjera dhe kështu përdor fjalë apo shprehje nga e folmja e tij, nganjëherë edhe nga e folmja e palës tjetër, por gjithmonë është konservator ndaj varietetit gjuhësor së cilës i përket. Me shembuj mund t'i paraqes veçoritë që i dallojnë të dy dialaktet e shqipes (nga aspekti fonetik, gramatikor e leksikor) dhe kështu mund ta mësojë, ta ruaj e ta kultivojë edhe më shumë gjuhën letrare. Njeh gramatikat kryesore dhe librat normativë të shqipes, të cilat i përdor në situata të caktuara. E di që gjuha shqipe zë një vend të rëndësishëm në rrethin e gjuhëve indoevropiane, duke pasur një traditë të gjatë të të folurit dhe të shkruarit dhe kjo ka po ashtu një rëndësi të madhe për kulturën	• zotëron njohuri gramatikore dhe leksikore që mundësojnë nivele të larta arritjeje në lexim-shkrim; • analizon ndryshimet mes gjuhës së folur dhe të shkruar, mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve e shtresave leksikore dhe gjuhës standarde; • vlerëson me argumente pasurinë leksikore të gjuhës shqipe; • kërkon materiale ose botime në biblioteka dhe në internet për të gjetur informacionin e nevojshëm për sistemin gjuhësor tëshqipes; • vlerëson zbatimin e rregullave të drejtshkrimit dhe të pikësimit, si të domosdoshme në çdo profesion dhe veprimtari të jetës njerëzore; • përkufizon konceptet "fjalë" e "morfemë" si koncepte gjuhësore; • përcakton llojet e morfemave; • bën dallimin e analizës morfemore dhe analizës fjalëformuese; • liston mënyrat e fjalëformimit të fjalëve;	**– Teksti** – Teksti përshkrues – Teksti rrëfyes, bindës – Kronika – Reportazhi – Autobiografia – Ditari – Letra – Kujtimet – Teksti udhëzues – Rregullat, ligjet – Udhëzuesit, recetat – Teksti argumentues, fjalimet politike, eseja argumentuese, debate – Teksti informues-shpjegues – Leksioni, lajmi – Kryeartikulli, artikulli me komente – Intervista – Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit – Fjalia e thjeshtë dhe e përbërë – Fjalia me bshkërendtije dhe me nënërenditje, skemat – Gjuha dhe komunikimi, stilet, ligjërimet

shqiptare. Ka njohuri për etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, fillimet e shkrimit të shqipes dhe rregullat e drejtshkrimit. 2GJSH.1.1.3. E di nocionin e theksit. Në fjali mund t'i dallojë llojet e theksave (theks i lirë, dinamik, ritmik, logjik, i fjalisë). Mund t'i ndajë tingujt në: tinguj zanorë dhe bashkëtingëllorë dhe i bashkon në formimin e fjalëve duke i dhënë kuptim atyre. Kur shqipton me zë më të fortë ose me zë më të ngritur një fjalë a një pjesë të fjalisë, mund ta vë rëndësinë kuptimore të saj dhe kështu i heton dallimet eventuale mes akcentit të tij nga ai letrar. 2GJSH.1.1.4. E di definicionin e fjalës dhe karakteristikat e saj. Njeh njësitë themelore të gjuhës (fonemën, morfemën, fjalën, togfjalëshin dhe fjalinë). Ndan fjalët në njësi më të vogla gjuhësore si p.sh.: fjalët për-pun-oj, kënd-o-j etj, Fjalën mund ta analizoj nga aspekti gramatikor me parashtesa, prapashtesa e mbaresa. Njeh mënyrat elementare të ndërtimit të fjalëve. Fjala si strukturë ka dy anë: përmbajtjen dhe formën dhe kështu dallon aspektin leksiko-gramatikor nga ai fonetiko-gramatikor. 2GJSH.1.1.5. Fjalinë e shkruan sipas rregullave gramatikore; mund t'i klasifikojë njësitë sintaksore; dallon fjalitë pohore dhe mohore; analizon fjalitë e thjeshta dhe ato të përbëra.	• dallon llojet e prejardhjes mes tyre; • pasuron leksikun e tij me sa më shumë fjalë të përbëra • shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj që kanë *-ia,-ie,-iu,* me **i** të theksuar në trup të tyre; • shkruan drejt fjalët me prejardhje të huaj me *-oo-*; • shkruan drejt fjalët nga latinishtja ose nga gjuhët romane si dhe nga greqishtja; • Klasifikon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra; • Bën tabelën e klasifikimit të tyre; • Përcakton tiparet e përbashkëta dhe dallimet; • Rikujton njohuritë rreth lidhëzave; • Klasifikon lidhëzat;	– Eseja dhe llojet e saj.
2GJSH.1.1.6. Ka një fond leksikor, i cili i përmbush nevojat në nivelin e mesëm të arsimimit; bën dallimin mes leksikut letrar dhe joletrar dhe i përdor sipas situatës së krijuar; ka njohuri për domethënien e fjalës; njeh grupet (paradigmat) e fjalëve: sinonimet, antonimet, homonimet; njeh metaforën si mekanizëm leksikor. Nëse ndonjë fjalë ka prejardhje të huaj, e përdorë dhe nuk ndien ndonjë "armiqësi" ndaj saj. Por, nganjëherë bën edhe kritika për shkak të futjes së saj në strukturën e shqipes. Njeh nocionin e frazeologjisë. Përdor fjalorët e gjuhës shqipe (Fjalorin		

drejtshkrimor, frazeologjik, sinonimik) etj. 2GJSH.2.1.1. Ka njohuri më të thella për gjuhën në krahasim me nivelin fillestar; Njeh njësitë, të cilat i përkasin niveleve të ndryshme të gjuhës, pra nënsistemet; Ka njohuri për shkrimin e letrave. Tashmë njeh parimet kryesore të gjuhës shqipe si parimin fonetik, morfologjik, etimologjik etj.; I di disa gjëra elementare për gjuhët e botës (ngjajshmëritë gjuhësore, përbashkësitë (universaliet) gjuhësore; I njeh parimet e zhvillimit të dialogut; kupton nocionin e aktit të të folurit; në tekst dallon pjesëzat dëftuese apo deiksin; Njeh varietetet gjuhësore të shqipes gjatë paraqitjes së një moderatori në medie kur ai flet në vernakularin gjuhësor – krahinor, pra nëse përdor ndonjë fjalë apo shprehje nga rajoni i tij. 2GJSH.2.1.2. I di tiparet dalluese të të dy dialekteve të gjuhës shqipe; P.sh.: në sistemin fonetik për gegërishten është karakteristike seria e zanoreve hundore kurse në toskërishte ka vetëm zanore gojore (hĩ-ni, rê-ja, zã-ni-gegërishte dhe hi-ri, re-ja, zë-ri- toskërishtja); toskërishtja ka **"ë"** në serinë e zanoreve të theksuara kurse gegërishtja nuk e ka, pra ajo i përgjigjet toskërishtes me **ã**; gegërishtja ka grupin nistor **vo** kurse toskërishtja ka grupin **va** (vaj, varr, vatër-toskërishtja., dhe voj, vorr, votër-gegërishtja) etj.; Në toskërishte ruhen grupet **mb, nd, ng** ndërkaq në gegërishte kanë dhënë **m, n, n**; Po ashtu e di se këto dialekte veçohen edhe nga tiparet morfologjike e leksikore; Mund t'i rirendis etapat e zhvillimit të gjuhës letrare, të cilat janë të njohura edhe më parë; 2GJSH.2.1.3. Njeh aparatin e të folurit dhe mënyrën se si prodhohen tingujt; dallon tingujt sipas pikëpamjes së artikulimit; e jep definicionin për fonemën; bën ndarjen fonetike të të folurit dhe në një frazë apo sintagmë spikat llojin e theksit (theks logjik, emfatik apo emocional) dhe kështu në mënyrë të drejtë mund ta shqiptojë fjalën në		

njësitë e lartëpërmenduara; njeh mekanizmat e ndryshimit të tingujve (ndryshimet kombinatore) siç janë: asimilimi, disimilimi, metateza, shtesat e tingujve (proteza, epenteza, epiteza), rëniet e tingujve (afereza, sinkopa, apokopa). 2GJSH.2.1.4. Ka njohuri të gjera për fjalën dhe veçoritë e saj; e di se forma e fjlaës është fonetiko-gramatikore sepse përbëhet nga elemente fonetike e gramtikore duke e paraqitur me shembull si bie fjala: emri *vëlla-i* ka tingujt e nyjëtuar *v-ë-ll-a-i* dhe temën fjalëformuese *vëlla-* dhe mbaresën –*i*, e cila tregon gjininë, numrin, rasën e trajtën e emrit; e njeh termin morfemë; ndan apo zbërthen fjalën në morfema si p.sh.: mal-or, qytet-ar, hekur-os, lag-a, mal-i, për-dredh, sh-thur etj., dhe në bazë të shembujve dallon morfemat rrënjore, parashtesore e prapashtesore; i di anët kryesore të strukturës së fjalës (përmbajtjen dhe formën); zbaton kriterin theksor (akcentologjik) si kriter dallues i fjalës së një tipari fonetik. 2GJSH.2.1.5. Gjatë procesit të ligjërimit, përdor fjalë duke i bashkuar për ta shprehur e transmetuar mendimin dhe ato (fjalë) duke hyrë në lidhje e marrëdhënie të ndryshme kuptimore e formale gramatikore krijojnë njësi të ndryshme sintaksore; dallon fjalinë e thjeshtë nga e përbëra; analizon fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme; ka njohuri të gjera rreth sintagmës; klasifikon fjalitë e varura; njeh termin elipsë; i di rasat dhe kategoritë gramatikore të foljes. 2GJSH.2.1.6. Ka fond të pasur leksikor (leksikun individual e të huaj); është i njoftuar për prefiksat e sufiksat që përdoren nga gjuhët e huaja në shqipen; fondin leksikor e shfrytëzon sipas rastit; sipas tij, gjuha është i vemi mjet i komunikimt që shërben për ta shprehur mendimin e tij, por edhe përvojën individuale dhe kështu e pasuron edhe më tepër fjalorin; njeh hiperoniminë, hiponiminë, paroniminë; dallon shtresat		

leksikore; njeh metaforën dhe metoniminë si mekanizma leksikorë. 2GJSH.3.1.1. E di që ekziston lidhja e afërt mes gjuhës dhe mendimit dhe e di nocionin e tyre; e jep përkufizimin e fjalisë duke e ditur gjithashtu se ajo ka dy anë: anën kuptimore dhe anën strukturore; dallon kohezionin leksikor dhe gramatikor. 2GJSH.3.1.2. Gjatë ndarjes së fjalëve në rrokje, përdor mjetet fonetike për spikatjen e saj (rrokjes) si: gjatësinë dhe forcën. 2GJSH.3.1.3. Ka njohuri për morfologjinë në kuptimin e gjerë të fjalës, në të cilën jepet përshkrimi i kategorive gramatikore të shqipes..; e ndan apo e zbërthen fjalën në morfema duke e dalluar morfemën rrënjë, parashtesore dhe prapeshtesore.		
2GJSH.3.1.4. Ka njohuri më të gjera për përdorimin e rasave dhe të formave foljore; mund t'i analizojë fjalitë nga pikëpamja morfologjike (duke i gjetur pjesët e ligjëratës); i njeh tipat e fjalive; dallon kryefjalën, kallëzuesin dhe gjymtyrët e dyta duke i analizuar sintaksorisht. 2GJSH.3.1.5. Ka njohuri themelore për fjalorët dhe për strukturën e tyre.		
2GJSH.1.2.1. Njeh autorët nga programi obligativ shkollor dhe i vendos në kontekst të opusit krijues dhe në kontekst letraro-historik. 2GJSH.1.2.2. Njeh terminologjinë e teorisë së letërsisë, në të cilën njihen shkrimet e veçanta dhe ku letërsia trajtohet në mënyrë teorike. 2GJSH.1.2.3. Në interpretimin e pjesëve letraro – artistike dhe pjesëve letraro-shkencor, dallon metodat e qasjes së brendshme dhe të jashtme. 2GJSH.1.2.4. Vëren dhe me shembuj argumenton tiparet letrare, poetike, gjuhësore, estetike e strukturore të veprave letrare. 2GJSH.1.2.5. I di tiparet e letërsisë si dhe i shpjegon raportet e saj me	• përshkruan dhe analizon kushtet historike në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; • analizon dhe gjykon pasojat që shkaktuan dy luftërat botërore; • përshkruan dhe analizon realitetin shoqëror në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; • rendit disa nga zbulimet e mëdha në shkencat e natyrës, të cilat ndikuan në jetën e njeriut;	**– Letërsi botërore** – Letërsia botërore e shek. XX **– Franc Kafka**, jeta vepra – Metamorfoza – analizë **– Alber Kamy ,** filozofia absurdi, I huaji – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shek. XX** **– Gjergj Fishta,** simbol i madhështisë së poezisë shqipe Lahuta e Malcis – analizë, Vranina – koment, Kënga e Lulashit – koment **– Lasgush Poradeci ,** liriku i madh,

gjuhën dhe marrëdhëniet me artet e tjera. 2GJSH.1.2.6. Paraqet tiparet historike dhe poetike të periudhave letrare, drejtimeve dhe formacioneve në zhvillimin e letërsisë shqipe dhe botërore duke përfshirë edhe shkrimtarët shqiptarë e të huaj nga lektura e obliguar shkollore. 2GJSH.1.2.7. Analizon pjesët letrare nga ato joletrare dhe mund t'i argumentoj teorikisht. 2GJSH.1.2.8. Shfrytëzon po ashtu literaturën sekondare qoftë letrare, historike, kritike, poetike, teorike duke i sjellë punimet e tij para të tjerëve. 2GJSH.1.2.9. Duke i lexuar veprat e letërsisë shqipe dhe botërore, e kupton rëndësinë e të lexuarit të pjesës letrare dhe kështu ky pozitivitet ndikon në formimin e identitetit të tij gjuhësor, letrar, kulturor e kombëtar. 2GJSH.2.2.1. Interpreton veprën letrare duke nxjerrë thelbin dhe veçoritë e saj; kontekstin historik; motivet letrare; tematikën para se gjithash; kompozicionin; figurat letrare; idenë e shkrimtarit; aspektin gjuhësor e stilistik etj. 2GJSH.2.2.2. Njeh terminologjinë e Teorisë së Letërsisë dhe njohuritë teorike-letrare i zbaton në mënyrë adekuate në interpretimin e pjesëve apo edhe veprave letrare. 2GJSH.2.2.3. Dallon metodat e qasjes së brendshme e të jashtme në interpretimin e pjesëve apo veprave letraro-arstistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistike. 2GJSH.2.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave letraro-artistike dhe llojet letraro-shkencor e publicistik si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekstet apo veprat përkatëse. 2GJSH.2.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen	• përcakton dhe analizon zhvillimet në shkencat shoqërore, si: psikologjia, filozofia, sociologjia; • dallon dhe analizon veçoritë e përgjithshme të letërsisë së shekullit XX, si: larmia e drejtimeve letrare, individualitete krijuese të spikatura dhe origjinale, veçori kombëtare të krijuesve; • përcakton dhe analizon tiparet e letërsisë që vijoi traditën realiste të shek. XIX; • analizon risitë që sollën shkrimtarët që ndoqën rrugën e letërsisë realiste të shek. XIX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsive të vendeve të ndryshme si dhe veprat e tyre letrare; • përcakton gjinitë dhe llojet letrare që lëvruan më shumë shkrimtarët që ndoqën prirjen realiste • përcakton veçoritë kryesore të letërsisë moderne; • dallon dhe analizon drejtimet (rrymat) kryesore letrare të letërsisë moderne të shek. XX; • analizon gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë moderne të shek. XX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë moderne, si dhe veprat e tyre letrare;	Ylli i zemrës – analizë **– Migjeni,** poeti vullkanik Vargjet e lira, Novelat e qytetit të veriut – analizë **Letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shek. XX** **-Ismail Kadare,** ambasadori i letrave shqipe Pallati i ëndrrave – analizë **– Martin Camaj** **– Azem Shkreli,** mjeshtri i fjalës poetike – Lirikë me shi – analizë **Lektura shtëpiake:** *55. Franc Kafka – Procesi* *56. Dritëro Agolli – Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo* *57. Ismail Kadare – Gjenerali i ushtrisë së vdekur* *58. Ernest Heminguej – Plaku dhe deti* *59. Gabriel G. Markez – Njëqind vjet vetmi* *60. Jakov Xoxa – Lumi i vdekur* **Vërejtje: arsimtari mund të bëjë zgjedhje të lirë të lekturave shtëpiake në pajtueshmëri me planin dhe programin për klasën e katërt të Gjimnazit.*

autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv dhe këto elemente e përcaktojnë edhe vetë llojin si: tragjedinë, komedinë, elegjinë etj. 2GJSH.2.2.6. Gjatë interpretimit të pjesëve letraro-artistike dhe letraro-shkencor, i përdor njohuritë paraprake nga fusha e teorisë së letërsisë; i njeh drejtimet dhe formacionet e zhvillimit të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.2.2.7. Në mënyrë të pavarur analizon pjesët letrare dhe mund t'i argumentojë qëndrimet e tij përballë të tjerëve. 2GJSH.2.2.8. Shfrytëzon literaturë shtesë nga letërsia, historia dhe fusha të tjera shoqërore, me qëllim të afirmimit të tij në interpretimin e pjesëve të tjera letraro-artistike e letraro-shkencor të parapara sipas planit dhe programit mësimor. 2GJSH.2.2.9. Duke i lexuar veprat letrare shqipe e botërore, e zhvillon edhe më shumë aftësinë shprehëse për interpretim dhe vlerësim të pjesëve të ndryshme letraro-artistike dhe letraro-shkencor , po ashtu e pasuron fondin leksikor, letrar, kulturor; me leximin e veprave të ndryshme, ai mund të bëhet më i arsimuar e më i kulturuar. 2GJSH.3.2.1. Lexon dhe analizon pjesët letraro-artistike dhe letraro-shkencor të parapara nga plani dhe programi mësimor dhe tekstet shtesë apo fakultative po ashtu letraro-artistike dhe letraro-shkencor duke i analizuar në kontekst më të gjerë historik. 2GJSH.3.2.2. Është i njoftuar me terminologjinë teorike-letrare duke e zbatuar në interpretimin e veprave letraro-artistike dhe letraro-shkencor të cilat janë të parapara me planin dhe programin mësimor; shfrytëzon edhe vepra të zhanreve të tjera, jashtë obligatives.	• përshkruan dhe analizon risitë e letërsisë së kësaj periudhe; • rendit dhe analizon shkrimtarët që me krijimtarinë e tyre shërbyen si urë lidhëse mes letërsisë së shek. XIX dhe letërsisë së shek. XX; • rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së kësaj periudhe dhe krijimtarinë e tyre; • vlerëson kontributin e shkrimtarëve të kësaj periudhe; • veçon dhe analizon risitë që sjell Kadare në letërsi pas viteve'90 analizon kushtet historike, shoqërore dhe politike pas Luftës së Dytë Botërore; përshkruan, analizon dhe gjykon për dukuritë letrare të kësaj periudhe;	

2GJSH.3.2.3. Në procesin e interpretimit të veprave përkatëse, zbaton metodat adekuate të qasjes së brendshme e të jashtme.		
2GJSH.3.2.4. I vëren dhe i argumenton format poetike (epiko-lirike) sipas strukturës së pjesëve apo veprave gjegjëse e publicistike si: esenë, biografinë, autobiografinë, memoarin apo kujtimin, ditarin, udhëpërshkrimin, reportazhin, fejtonin; vëren dukuritë stilistike në tekst. 2GJSH.3.2.5. E di se në veprat e gjata letrare, funksionin e kryen autori ose narratori ndërkaq përdorimi i caktuar bëhet në harmoni me kërkesat e motivimit artistik dhe këtij motivimi i nënshtrohet edhe përdorimi i gjuhës me ngjyrim emocionues dhe afektiv. 2GJSH.3.2.6. Gjatë interpretimit dhe vlerësimit të veprave letraro-artistike dhe letraro- shkencor, zbaton dhe krahason tiparet historike e letrare (stilistike) të letërsisë shqipe e botërore. 2GJSH.3.2.7. I vëren e i interpreton problemet dhe idetë në veprën letrare dhe qëndrimet e tij mund t'i argumentojë në bazë të tekstit primar dhe kontekstit letrar. 2GJSH.3.2.8. Për ta interpretuar (njohur) apo për t'i bërë analizë filologjike veprës letrare, duhet të ketë njohuri të caktuara, një kulturë letrare nga leximi i veprave të tjera që për nga rëndësia hyjnë në radhën e kryeveprave nacionale e botërore. 2GJSH.3.2.9. Pasi t'i ketë lexuar veprat letrare shqipe e botërore, të cilat janë obligative, dhe veprat letrare me përzgjedhje, vërehet aftësia e tij shprehëse kundrejt të tjerëve dhe me këto zhvillohet e pasurohet edhe më shumë identiteti i tij kulturor e arsimor.		
2GJSH.1.3.1. Flet qartë duke respektuar drejtshqiptimin (ortoepinë) e gjuhës letrare; zbaton theksin (akcentin) gjuhësor-letrar ose e krahason akcentin e tij me atë letrar me tendencë të përshtatjes;	• zgjeron gamën e strategjive përmbledhjen e të dhënave të nevojshme që do të përdorë gjatë prezantimeve;	Gjuha e medies; Gazeta; publiciteti dhe reklama,

Rrjedhshëm dhe qartë lexon me zë tekstet letrare dhe joletrare; shprehimisht lexon dhe lehtë i tregon tekstet letrare artistike; Në situata formale flet për temat e thjeshta si: nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe të kulurës duke u shërbyer me shprehje korrekte gjuhësore; Pra, flet qartë, pa pengesa, pa dridhje të zërit e pa pauza të mëdha; Sipas nevojës, përdor teminologjinë shkencore për gjuhën dhe letërsinë, duke e përshtatur me rastet apo situatat, bashkëfolësin ose përdor edhe mjetet gjuhësore verbale a joverbale sidomos mimikën, gjestikulacionin, lëvizjet e duarve etj, që në gjuhësi njihet me emrin Semiotikë; Ka kulturë të të dëgjuarit kur dikush flet në gjuhën e tij dhe me vëmendje dëgjon e kupton ligjëratat nga fusha e gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës dhe kështu gjatë dëgjimit të ndonjë ligjërimi, mund të marrë shënime; 2.GJSH.1.3.2. Dukë folur apo shkruar për ndonjë temë nga gjuha, letërsia apo për jetën shoqërore, e strukturon rrëfimin dhe i lidh pjesët në mënyrën e duhur; Dallon të rëndësishmen nga e parëndësishmja dhe i përmbahet temës kryesore; Shkruan një tekst duke u shërbyer nga përshkrimi e ekspozicioni dhe shkurtazi përshkruan ndjenjat e tij dhe përjetimin e pjesës letrare ose të ndonjë pjese tjetër artistike; Rrëfen tekstin letrar artistik dhe i ndanë pjesët kryesore. Në fund jep një përmbledhje (rezyme) të tekstit letrar ose joletrar; 2GJSH.1.3.3. Në diskutime me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura, në pika të shkurtëra mund ta shpreh dhe ta argumentojë idenë ose qëndrimin për të cilin angazhohet; Pra, ai mund të flasë ngadalë duke u mbështetur kryesisht në fakte; Është në gjendje ta dëgjojë mendimin e tjetrit dhe ta marrë parasysh gjatë argumentimit të tij; Shkruan tekst me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura; 2GJSH.1.3.4. Shfrytëzon librin drejtshkrimor të gjuhës shqipe; zbaton rregullat elementare të	• zbaton hapat e përgatitjes dhe të mbajtjes së një fjalimi për tema të ndryshme; • përzgjedh fjalët dhe shprehjet e përshtatshme, në mënyrë që të ndikojë te dëgjuesit, si dhe përmirëson zgjedhjen e fjalëve duke përdorur mjete retorike dhe të figurshme; • vlerëson rolin e përdorimit të TIK-ut gjatë prezantimeve me gojë dhe analizon funksione te këtij përdorimi; • reflekton ndaj informacionit të dëgjuar, rikujton përmbajtjen e informacionit, si dhe analizon mënyrën në të cilën stili dhe struktura e një fjalie ose e një ligjërate mbështetin qëllimin e saj; • reflekton mbi informacione të llojeve dhe të fushave të ndryshme, si dhe përgjigjet në mënyrë të përshtatshme; • demonstron aftësitë e domosdoshme të të dëgjuarit kritik. • përshtat shkrimin me qëllimet dhe lexuesit, p.sh.:të përshkruajë, të rrëfejë, të udhëzojë,të informojë, të argumentojë; • karakteristikat e tyre; • vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediesh; është aktiv dhe i pavarur në procesin e	

drejtshkrimit dhe mund të shërbehet me botime të tjera nga Ortografia; Në të shkruar ndan pjesët tekstit, jep titujt dhe nëntitujt, citon dhe parafrazon; Bën punimin e maturës duke respektuar rregullat e shkruarjes së punimit shkencor (përdor fusnotat, shkruan përmbajtjen dhe bibliografinë); Shkruan letra zyrtare dhe jozyrtare, biografi (CV), lutje, ankesë, kërkesë; Di të mbushë formularë të ndryshëm etj.; 2GJSH.1.3.5. Ka aftësinë që në mënyra të ndryshme (informim, mësim, zhvillim personal, përjetim estetik, argëtim …) të lexojë tekstet të rëndësisë (tekstet letrare, tekste profesionale, shkencore, popullore) nga fusha e shkencës për gjuhën dhe letërsinë, tekstet nga mediet; tekstet që janë të përshtatshme për përpunimin e planit për gjuhë dhe letërsi); zbaton strategjitë e të lexuarit; 2GJSH.1.3.6. Kupton tekstin letrar e joletrar dhe njeh rëndësinë e tyre, gjen informacione nga më të ndryshmet, ndan pjesët kryesore të tekstit; e di kuptimin e përmbajtjes në tekst; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste. 2GJSH.1.3.7. Në mënyrë kritike jep sqarim për tekstin letrar e joletrar; dallon faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson (dhe argumenton) se a i prezanton autori i tekstit joartistik të gjitha informacionet e nevojshme dhe a jep fakte të mjaftueshme e të besueshme për atë që thotë; vlerëson se a është neutral autori i tekstit ose i angazhuar apo i anshëm dhe e arsyeton vlerësimin e tij; njeh gjuhën e urrejtjes, diskriminimit, sharjes dhe për këto çështje ka qëndrim negativ.	mësimdhënies dhe të të nxënit për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.	
2GJSH.1.3.8. Njeh strukturën, elementet e ndryshme, figurat stilistike (metoniminë, metaforën, asonancën, aliteracionin, onomatopenë, anaforën…); Njeh domethënien konotative të fjalës në kontekstin e dhënë dhe kupton qëllimin e domethënies konotative		*Të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit e teksteve të ndryshme.* *Intervista për punë.* *Letra e mospranimit për punë,* *Ftesa,*

në tekstin letrar dhe joartistik; vlerëson domethënien e fjalëve të panjohura në bazë të kontekstit dhe modelit të formacionit; kupton domethënien e leximit për pasurimin e fondit leksikor. 2GJSH.2.3.1. Nëpër situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë, flet për temat nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës, duke e përdorur gjuhën letrare dhe terminologjinë përgjegjëse; merr pjesë në bisedat publike ku ka më shumë pjesëmarrës; vlerëson auditoriumin dhe e përshtat fjalimin e tij sipas mundësive dhe kërkesave të tij; në të folur duhet ta zhvillojë më shumë kulturën e tij shprehëse; me vëmendje dëgjon prezantimet nga të tjerët (psh. ligjëratat) me temë nga gjuha, letërsia dhe kultura etj. 2GJSH.2.3.2. Ndërton tekstin e folur a të shkruar nga gjuha, letërsia etj., duke e karakterizuar nga kohezioni dhe koherenca, pra me mënyrën se si lidhen midis tyre në bazë të rregullave gramatikore të gjuhës njësitë që e përbëjnë tekstin (kohezioni) dhe me organizimin logjik të tekstit me mënyrën se si gjykimet dhe arsyetimet lidhen midis tyre (koherenca); në diskutimet e shkruara apo të folura, shpreh idetë dhe argumenton qëndrimet e tij; përkujdeset që të shkruaj e të folë në mënyrë të drejtë duke respektuar normën gjuhësore pa bërë ndonjë digresion (shmangie) nga rregullat; shfaq përjetimin dhe përshtypjet e tij rreth pjesës letrare ose artistike; rrëfen tekstin letrar dhe jep një përfundim për të sipas mundësive të tij shprehëse; zbaton rregullat drejtshkrimore etj. 2GJSH.2.3.3. Për të pasur një informim edhe më te gjerë, pra për ta zhvilluar aftësimin personal dhe për ta arritur përjetimin letrar e estetik, lexon tekste edhe më të ndërlikuara si tekste letraro-artistike, tekste shkencore, tekste nga mediet etj; është i apasionuar pas leximit; zbaton dhe zgjedh strategjitë e përshtatshme të leximit.		*Intervista me gojë, biseda.* *Tekstet e digjitalizuar,*

2GJSH.2.3.4. Kupton tekstin joletrar; nxjerr thelbin e tij; gjen pjesët e nënkuptueshme, por edhe e shtjellon tekstin në fjalë; gjen idenë kryesore; krahason informacionet dhe idetë nga dy e më shumë tekste për të kuptuar aspektin domethënës e stilistik; i gjen dhe i analizon motivet dhe figurat, të cilat paraqiten në veprën letrare; interpreton tekstet duke u mbështetur në tekstet e tjera letrare. 2GJSH.2.3.5. Në mënyrë kritike jep vlerësim për tekstin letrar joartistik; ndan faktin objektiv nga interpretimi autorial; vlerëson neutralitetin (anshmërinë) e autorit; vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit argumentues; prezanton të gjitha informatat dhe faktet e autorit për ato që i thotë. 2GJSH.2.3.6. Vlerëson se a është i përshtatshëm për planin dhe programin mësimor nga gjuha dhe letërsia shqipe autori i tekstit joartistik; teksti a është koheziv dhe koherent, a janë dhënë idetë qartë dhe saktë; vëren dukuritë stilistike; vëren se sa ndikojnë pjesët e caktuara të tekstit për ta kutpuar atë. 2GJSH.3.3.1. Diskuton për temat komplekse nga gjuha, letërsia dhe kultura; flet për tekstet letrare dhe joletrare duke shfrytëzuar terminologjinë profesionale. 2GJSH.3.2.2. Prezanton në situatat zyrtare dhe para auditoriumit më të gjerë paraqitet me tema nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe kulturës; është orator dhe paraqet qëndrimet e tij para auditoriumit me argumente; gjatë ligjërimit përdor fjalë dhe shprehje nga gjuha amtare duke respektuar normën e gjuhës standarde etj. 2GJSH.3.3.3. Shkruan në mënyrë kompozicionale e logjike tekstin profesional me temë nga gjuha dhe letërsia si edhe artikullin gazetaresk. 2GJSH.3.3.4. I mbledh, i shënon dhe në fund i përpunon informacionet		

nga tekstet letrare joartistike në bazë të rregullave të parapara. 2GJSH.3.3.5. Teksti mendon se ka një strukturë dhe organizim të brendshëm, kuptohet pa vështirësi, lexohet me kënaqësi, pra bart informacionin te lexuesi dhe është i shkruar sipas rregullave të ndërtimit të fjalive dhe të periudhave; 2GJSH.3.3.6. I njeh stilet funksionale të shqipes standarde (stili i letërsisë artistike, stili politiko-shoqëror, stili stili shkencor-teknik, stili juridik-administrativ) dhe të gjitha këto (stile) mund t'i trajtojë sipas veçorive të tyre leksikore. 2GJSH.3.3.7. Në të shkruar, përdor shenjat e pikësimit varësisht nga lloji i fjalive (dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse, urdhërore).		

Fjalët kyçe: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, kultura e gjuhës

Disa përmbajtje mësimore për të cilat mësuesi vlerëson se gjatë vitit ato nuk mund t'i realizojë gjatë orëve të rregullta, mund të planifikohen për përpunim gjatë orëve të mësimit me projekt, orëve në ambient të hapur, si dhe në orët të tjera të mësimit shtues e plotësues dhe në eksione.

UDHËZIME DIDAKTIKO – METODIKE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Programin e mësimdhënies dhe nxënies të Gjuhës dhe Letërsisë shqipe përbëhet prej tri fushave/lëmive mësimore: Letërsisë, Gjuhës dhe Kulturës së Gjuhës. Shpërndarja e rekomanduar e orëve sipas fushave të njohurive është: Letërsi – 39 orë, Gjuhë – 37 orë dhe Kultura e gjuhës – 23 orë. Fondi i përgjithshëm i orëve, në nivelin vjetor, është 99 orë. Të tri fushat e programit të mësimdhënies dhe nxënies janë të ndërlidhura dhe nuk mund të mësohen të ndara dhe pa bashkëpunim ndërmjet njëra – tjetrës.

Programi mësimor dhe mësimor i Gjuhës dhe Letërsisë shqipe bazohet në rezultatet, domethënë në procesin e të mësuarit dhe arritjet e nxënësve. Rezultatet janë një përshkrim i njohurive të integruara, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që nxënësi ndërton, zgjeron dhe thellon nëpër të tri fushat lëndore të kësaj lënde.

I. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

